

# RAPORTI VJETOR

PËR PUNËN DHE REVIZIONET E KRYERA TË
**ENTIT SHTETËROR TË REVIZIONIT**

PËR
VITIN
2023

PËR
VITIN
**2023**

# RAPORTI VJETOR

PËR PUNËN DHE REVIZIONET E KRYERA TË
**ENTIT SHTETËROR TË REVIZIONIT**

**Titulli origjinal:**
Годишен извештај за извршените ревизии и за работата на Државниот завод за ревизија за 2023 година

**Botues:**
Enti Shtetëror i Revizionit – Shkup
Rruga Pavel Shatev nr. 2,
Pallati Emanuel Çuçkov, Shkup

**Për botuesin:**
mr. Maksim Acevski, Kryerevizori shtetëror

**Redaktor:**
mr. Maksim Acevski, Kryerevizori shtetëror

**Shtypi:**
Shoqëria për aktivitetin e shtypjes grafike, tregtinë, prodhimin dhe shërbimet GETEO print Pero SHPKNJP eksport - import - Shkup

**Përpunimi kompjuterik dhe teknik:**
Jana Sajkovska Dimitrievski, Nadica Donevski, Vesna Bogdanovic, Elena Dogazanska

**Албански јазик**
**Përkthim maqedonisht-shqip**:
Sefedin Rexhepi

CIP - Каталогизација во публикација
Национална и универзитетска библиотека «Св. Климент Охридски», Скопје

657.6(497.7)»2022»(047.31)

RAPORTI vjetor për punën dhe revizionet e kryera të entit shtetëror të revizionit për vitin 2023 / [redaktor Maksim Acevski ; përkthim maqedonisht-shqip Sefedin Rexhepi]. - Shkup : Enti shtetëror i revizionit, 2024. - 237 стр. : илустр. ; 30 см

Превод на делото: Годишен извештај за извршените ревизии и за работата на Државниот завод за ревизија за 2023 година

ISBN 978-608-5006-07-6

а) Државен завод за ревизија (Скопје) -- 2023 -- Извештаи

COBISS.MK-ID 63979269

**Viti:**
2024

**Tirazh:**
200 kopje

**Vendi i botimit:**
Shkup

ПРОГРАМА ЗА ПАРЛАМЕНТАРНА ПОДДРШКА
PROGRAM PËR MBËSHTETJE PARLAMENTARE
PARLIAMENT SUPPORT PROGRAMME

Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

**Swiss Agency for Development and Cooperation SDC**

Zbatuar nga:

NDI

IDSCS

Ky publikim është përgatitur në kuadër të Programit për Mbështetje Parlamentare (PSP), projekt i Qeverisë së Zvicrës nën patronazhin e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut. PSP zbatohet nga Instituti Nacional Demokratik (NDI), Instituti për Demokraci "Societas Civilis" - Shkup (IDSCS) dhe Qendra për Menaxhimin e Ndryshimeve (QMP). Përmbajtja e këtij publikimi nuk mund të konsiderohet, në asnjë mënyrë, se pasqyron pikëpamjet e SDC.

# PËRMBAJTJA


| | | |
|---|---|---|
| 1 | PËR ENTIN SHTETËROR TË REVIZIONIT | 20 |
| 1.1. | Korniza juridike | 24 |
| 1.2. | Dokumentet dhe aktivitetet strategjike dhe vjetore | 25 |
| 1.3. | Dokumentet metodologjike dhe zbatimi i praktikave të mira | 35 |
| 2 | KOMUNIKIMI DHE BASHKËPUNIMI ME PALËT E INTERESUAR | 36 |
| 2.1. | Komunikimi dhe transparenca në punë | 37 |
| 2.2. | Bashkëpunimi me Kuvendin, organet shtetërore, asociacionet dhe institucionet profesionale, organizatat qytetare dhe publikun e gjerë | 45 |
| 2.3. | Bashkëpunimi me organet kompetente për revizionet dhe efektet e tyre | 51 |
| 3 | KAPACITETET ADMINISTRATIVE | 54 |
| 3.1. | Struktura organizative dhe resurset njerëzore | 55 |
| 3.2. | Rritja e njohurive dhe aftësive të revizorëve shtetërorë | 58 |
| 3.3. | Resurset e TI-së | 61 |
| 3.4. | Mjetet financiare për punën e ESHR-së | 63 |
| 3.5. | Zhvillimi i qëndrueshëm dhe mbrojtja e mjedisit jetësor | 71 |
| 4 | BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR | 72 |
| 4.1. | Bashkëpunimi Ndërkombëtar | 73 |
| 4.2. | Aktivitetet e projekteve | 83 |
| 4.3. | Integrimet në BE | 89 |
| 5 | REVIZIONET E KRYERA | 90 |
| 5.1. | Vlera e shtuar | 99 |
| 5.2. | Buxheti i Republikës Së Maqedonisë së Veriut | 101 |
| 5.2.1. | Buxheti themelor i Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2022 | 101 |
| 5.2.2. | Efikasiteti i masave dhe politikave për servisimin e borxhit publik | 111 |
| 5.2.3. | Rrogat dhe shtesat e rrogave të nëpunësve administrativë në Republikën e Maqedonisë së Veriut | 114 |

| | | |
|---|---|---|
| 5.2.4. | Menaxhimi i pronës shtetërore | 119 |
| 5.2.5. | Realizimi i investimeve kapitale të financuara përmes buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, fondeve të BE-së dhe mjeteve nga institucionet e tjera financiare ndërkombëtare në kompetencë të pushtetit qendror dhe të vetëqeverisjes lokale | 124 |
| 5.3. | Mbrojtja | 132 |
| 5.3.1. | Ministria e Mbrojtjes | 132 |
| 5.4. | Qëllimet e zhvillimit të qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara | 135 |
| 5.4.1. | Gatishmëria e Republikës së Maqedonisë së Veriut për realizimin e qëllimeve të zhvillimit të qëndrueshëm deri në vitin 2030 | 135 |
| 5.5. | Sistemi shëndetësor | 140 |
| 5.5.1. | Fondi i Sigurimit Shëndetësor i Republikës së Maqedonisë së Veriut | 140 |
| 5.5.2. | Institucionet shëndetësore publike | 143 |
| 5.5.3. | Shfrytëzimi i shërbimeve shëndetësore për diagnostikimin radiologjik me rezonancë magnetike | 145 |
| 5.6. | Sistemet e informacioneve, siguria dhe mbrojtja e të dhënave | 149 |
| 5.6.1. | Efikasiteti i portalit nacional për e-shërbime | 149 |
| 5.6.2. | Efikasiteti i masave të ndërmarra nga organet kompetente për mbrojtjen e sistemeve kritike të informacioneve | 152 |
| 5.7. | Gjyqësori dhe sundimi i së drejtës | 154 |
| 5.7.1. | Komisioni shtetëror për ankesa për prokurime publike | 154 |
| 5.7.2. | Procesi i dhënies së kontratave të prokurimeve publike | 156 |
| 5.7.3. | Gjykata e Lartë Administrative | 158 |
| 5.7.4. | Avokati i Popullit i Republikës së Maqedonisë së Veriut | 159 |
| 5.8. | Mjedisi jetësor | 160 |
| 5.8.1. | Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor | 160 |
| 5.9. | Trafiku, Transporti dhe Komunikacioni | 162 |
| 5.9.1. | Ministria e Transportit dhe Lidhjeve | 162 |
| 5.9.2. | NP për Rrugët Shtetërore | 164 |
| 5.9.3. | NP për mirëmbajtjen dhe mbrojtjen e rrugëve magjistrale dhe rajonale | 167 |
| 5.10. | Energjetika | 169 |
| 5.10.1. | Zhvillimi i sistemit të gazifikimit në republikën e Maqedonisë së Veriut | 169 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| 5.11. | Ekonomia | | 172 |
| | 5.11.1. | Efikasiteti i procedurave për dhënien e së drejtës së shfrytëzimit të lëndëve të para minerale dhe realizimin e kontratave të lidhura, me vështrim të veçantë për mermerin | 172 |
| 5.12. | Veprimtaritë komunale publike | | 176 |
| | 5.12.1. | Ndërmarrjet publike në nivel lokal | 176 |
| 5.13. | Punë dhe Politikë Sociale | | 180 |
| | 5.13.1. | Fondi i Sigurimit Pensional dhe Invalidor i Republikës së Maqedonisë së Veriut | 180 |
| | 5.13.2. | Agjencia e Punësimit Republikës së Maqedonisë së Veriut | 183 |
| 5.14. | Arsimi | | 186 |
| | 5.14.1. | Efektiviteti i masave për të parandaluar largimin e kuadrove profesionale dhe me arsim të lartë | 186 |
| | 5.14.2. | Efikasiteti i masave, politikave dhe projekteve për përmbushjen e kushteve në të cilat funksionojnë konviktet shtetërore të studentëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe zhvillimi i standardit të studentëve | 190 |
| | 5.14.3. | Universiteti "Shën Cirili dhe Metodi" Shkup | 196 |
| 5.15. | Vetëqeverisja Lokale dhe zhvillimi i barabartë rajonal | | 197 |
| | 5.15.1. | Njësitë e Vetëqeverisjes Lokale | 197 |
| | 5.15.2. | Barazia gjinore e grave nga mjediset rurale përmes përfshirjes së tyre në tregun e punës | 200 |
| 5.16. | Partitë Politike dhe Fushatat Zgjedhore | | 202 |
| | 5.16.1. | Partitë politike - puna e rregullt | 202 |
| | 5.16.2. | Fushata Zgjedhore - zgjedhjet lokale 2022 | 203 |

| | | |
|---|---|---|
| **6** | **DOBËSITË SISTEMORE** | **207** |
| **7** | **RAPORTI FINANCIAR I ESHR-së DHE RAPORTI I REVIZORIT TË PAVARUR** | **216** |
| **8** | **SHKURTESAT E SHFRYTËZUARA** | **238** |

# Të nderuar zonja dhe zotërinj,

# I nderuar lexues,

Në duart Tuaja është Raporti Vjetor për revizionet e kryera dhe për punën e Entit Shtetëror të Revizionit për vitin 2023. Ky raport është rezultat i punës së shumtë, përkushtimit dhe entuziazmit dhe është vegël për paraqitjen objektive, transparente dhe të besueshme të rezultateve tona dhe revizioneve të kryera në vitin 2023.

Në vitin 2023, Enti Shtetëror i Revizionit e realizoi Programin Vjetor të Punës me të cilin u përfshin 66 revizione. Kemi konstatuar 957 gjendje dhe kemi dhënë 697 rekomandime të cilat janë të përmbajtura në 100 raportet e revizionit. Këto raporte paraqesin informacione faktike për punën e subjekteve të revizionit dhe fushave të mbuluara nga revizionet e suksesit.

Këtë vit u kushtuam vëmendje të veçantë revizioneve të suksesit, të cilat u referohen temave dhe fushave me interes të palëve të interesuara, tatimpaguesve, qytetarëve dhe publikut të gjerë.

Me këto revizione besojmë se kemi dhënë një pasqyrë të qartë dhe objektive të gjendjeve në fushat e qëllimeve për zhvillimin e qëndrueshëm, barazinë gjinore, largimin e kuadrove me arsim të lartë dhe profesional, eksploatimin e resurseve minerale, zhvillimin e standardit të studentëve, përdorimin e shërbimeve shëndetësore, mbrojtjen e sistemeve kritike të informacioneve, investimeve kapitale, portalit nacional E-shërbime dhe të tjera. Në të njëjtën kohë, kemi dhënë rekomandime për mënyrën e veprimit të organeve kompetente në drejtim të sigurimit të efektivitetit dhe efikasitetit dhe largimin e shkaqeve të gjendjeve të konstatuara.

Në mënyrë shtesë, me rëndësi janë edhe aktivitetet që janë ndërmarrë në fushën e rregullimit dhe miratimit të dokumenteve strategjike dhe vjetore, të tilla si Plani Vjetor për Parandalimin e Korrupsionit dhe Plani Vjetor për Përsosjen e Vazhdueshme Profesionale për vitin 2023.

Punonjësit e ESHR-së si Institucion Suprem i Revizionit këtë vit treguan dhe dëshmuan se janë me integritet dhe etikë të lartë dhe të përkushtuar ndaj rritjes së njohurive dhe aftësive të tyre. Pra, në kuadër të Programit për Parandalimin e Korrupsionit, kanë marrë certifikatën ndërkombëtare nga totali prej 126 punonjës të certifikuar në sektorin publik për menaxhimin e rreziqeve nga korrupsioni, 101 punonjës janë nga ESHR-ja dhe nga gjithsej 18 trajnues për zbatimin e këtij programi, 17 punonjës janë nga ESHR-ja.

Këto rezultate konfirmojnë se ESHR-ja është e përkushtuar në zbatimin e parimeve të INTOSAI - P12, me të cilin ofrojmë: Vlera dhe përfitime nga ISR-të duke bërë dallimin në jetën e qytetarëve me çfarë besojmë se kemi siguruar: forcimin e llogaridhënies, transparencës dhe integritetit të organeve shtetërore dhe subjekteve të sektorit publik; demonstrimin e rëndësisë së përhershme për qytetarët, parlamentin dhe palët e tjera të interesuara dhe paraqesim organizatë si shembull.

Me revizionet në vitin 2023 e kemi rritur fushëveprimin e shpenzimeve të revìduara lidhur me mjetet e përgjithshme buxhetore. Gjithashtu, e kemi rritur vlerën e shtuar nga revizionet e kryera, veçanërisht në lartësinë e mjeteve të përcaktuara më pak të llogaritura, më pak të kthyera ose më pak të paguara në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe në buxhetet e komunave, që tregon për kontributin e konsiderueshëm të ESHR-së për forcimin e institucioneve dhe përgjegjësisë menaxheriale në shoqërinë tonë.

Vazhdimisht i theksojmë dobësitë sistemore, si dhe mangësitë dhe parregullsitë në rregullativin në fusha të caktuara dhe duke e vënë në dukje nevojën për tejkalimin e tyre. Puna jonë kontribuon në forcimin e sistemit juridik dhe krijimin e mjedisit të favorshëm për zhvillimin e mëtejshëm të personave juridikë. Megjithatë, pavarësisht këtyre aktiviteteve, disa dobësi sistemore tërhiqen vite të tëra, gjë që tregon për pasivitetin e organeve të caktuara kompetente në ndërmarrjen e masave për heqjen e tyre.

Transparenca dhe llogaridhënia në punën e ESHR-së, ka rëndësi thelbësore për ndërtimin e besimit, përgjegjësisë dhe efikasitetit në kryerjen e revizionit shtetëror. Për këtë qëllim, në vazhdimësi ndërmarrim aktivitete për të rritur numrin e palëve të interesuara që marrin informacion në kohë për punën e ESHR-së, dhe me kënaqësi theksojmë se numri i palëve të interesuara në dhjetor 2023 ishte 1.215.

Në planin ndërkombëtar, si në nivelin bilateral, janë ndërmarrë një sërë aktivitetesh që e përfshijnë ESHR-në si partner i barabartë me ISR-të e tjera dhe partner të njohur për aktivitetet e tij në grupet e punës së INTOSAI dhe EUROSAI.

Rezultatet e arritura dhe aktivitetet e realizuara për nga vëllimi dhe cilësia, janë për shkak të përkushtimit të madh të punonjësve të ESHR-së, ekspertëve të jashtëm të angazhuar (të brendshëm dhe ndërkombëtarë) dhe numrit të madh të donatorëve të cilëve u shprehim mirënjohje të madhe për mbështetjen e tyre.

Aktivitetet e përmendura i mundësojnë Entit Shtetëror të Revizionit për t'i kryer obligimet e tij në mënyrën që i siguron besim Kuvendit dhe palëve të tjera të interesuara. Kjo i bind se raportet për revizionet e kryera dhe Raportin Vjetor, përmbajnë informacione të sakta dhe objektive të bazuara në fakte, gjetje dhe rekomandime.

Prioriteti ynë në periudhën e ardhshme do të jetë realizimi i aktiviteteve strategjike, orientimi drejt forcimit të pavarësisë dhe integritetit të ESHR-së si ISR, ndërtimi profesional i punonjësve dhe zbatimi i dispozitave të Memorandumit të nënshkruar me Kuvendin.

Besojmë fuqimisht se pushteti ekzekutiv dhe legjislativ do të vazhdojnë me aktivitetet e ndërmarra deri në miratimin përfundimtar të Ligjit të ri për revizionin shtetëror dhe përcaktimin e ESHR-së në Kushtetutën e vendit tonë si ISR, duke siguruar pavarësi kushtetuese dhe të plotë financiare dhe operative të Entit Shtetëror të Revizionit.



**“INVESTIMET KAPITALE KANË VLERË TË SHTUAR NËSE OFROJNË SHËRBIME NË KOHË, CILËSORE DHE TË VAZHDUESHME PËR QYTETARËT”**

**Kryerevizori shtetëror**

**mr. Maksim Acevski**



## **REZULTATET KYÇE**
## NGA PUNA E ENTIT SHTETËROR TË REVIZIONIT;

në 000 denarë

**VLERA E SHTUAR E REVIZIONEVE**

**2.145.513.095**
Totali i aktivës/pasivës

**5.030.418**
Kompensimet/ detyrimet publike/të papaguara/ më pak të paguara/në Buxhetin e shtetit

**3.642.901**
Kompensimet e papaguara më pak të paguara në Buxhetin e komunave të revidiuara

**1.001.206**
Përdorimi i mjeteve në kundërshtim me ligjin

**28.261.918**
Shuma totale e prokurimeve publike

**19.950.492**
Përfshirja e PP-së me revizionet

**3.844.205**
Shuma e përgjithshme nga parregullsitë e konstatuara te PP

**43.252**
Efektet financiare nga revizionet /mjete të paguara gjatë revizionit

**14.952**
Prokurimet e kryera për të cilat nuk është zbatuar procedura për PP

**38.871.654**
Evidentimet korrektuese në Bilancet e gjendjes

**58.057.372**
Gjendjet e konstatuara që ndikojnë në veprimtarinë e subjektit që është lëndë e revizionit dhe investimet kapitale

**5.102.327**
Grantet e anuluara/të humbura

**36.914**
Shuma nga procedurat e humbura gjyqësore

**31.764**
Tatimi mbi të ardhurat personale më pak të llogaritura

**1.812.484**
Komisionet e paguar për fondet e patërhequra nga kreditë/huatë

**1.495.383**
Vlera e kërkesës së padisë në proceset gjyqësore në të cilat subjekti lëndë i revizionit shfaqet në rolin e të paditurit dhe paditësit

**61.985**
Kontributet më pak të llogaritura

**1.777.913**
Vlera tjetër e shtuar e revizionit

# **PROGRAMI VJETOR** I PUNËS SË ENTIT SHTETËROR TË REVIZIONIT PËR VITIN 2023




TEMAT E PËRFSHIRA ME REVIZIONET

| | |
|---|---|
| **66** | **REVIZIONET E KRYERA** |
| **47** | Revizione të rregullshmërisë |
| **9** | Revizione të suksesit |
| **2** | Revizione të TI-së |
| **4** | Revizione të pajtueshmërisë |
| **4** | Revizione – follow up |

QËLLIMET PËR ZHVILLIMIN E QËNDRUESHËM TË PËRFSHIRA ME REVIZIONET



# REVIZIONET PËRMES NUMRAVE

**100** RAPORTET E REVIZORIT

## OPINIONE NGA REVIZIONET REVIZIONI I RREGULLSHMËRISË

**79** opinione për raportet financiare

- **31** pa rezervë
- **12** me rezervë
- **30** opinione të pavolitshëm
- **6** refuzim opinioni

**72** opinione për pajtueshmërinë me ligjet dhe rregullat

- **24** pa rezervë
- **18** me rezervë
- **28** opinione të pavolitshme
- **2** refuzim opinioni

## KONKLUZIONET REVIZIONI I PAJTUESHMËRISË / REVIZIONI I SUKSESIT/ REVIZIONI I ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE

- **4** konkluzionet për revizionin e pajtueshmërisë
- **9** konkluzionet për revizionin e suksesit
- **2** konkluzionet për revizionin e TI-së
- **4** konkluzion për revizionin e zbatimit të rekomandimeve (follow up)

## 957 GJETJET DHE ÇËSHTJET E DETEKTUARA NGA REVIZIONET

- **593** revizioni i rregullshmërisë
- **215** revizioni i suksesit
- **122** revizioni i pajtueshmërisë
- **27** revizioni i TI-së

## 140 SUBJEKTE TË PËRFSHIRA ME REVIZION

- **29** revizioni i rregullshmërisë
- **74** revizioni i suksesit
- **13** revizioni i pajtueshmërisë
- **2** revizioni i TI-së
- **18** pjesëmarrësit në fushatën zgjedhore Zgjedhjet Lokale
- **4** revizioni i zbatimit të rekomandimeve

## 37 DOBËSI TË KONSTATUARA NË GJETJET TE PROKURIMET PUBLIKE

**VLERA TOTALE E KONTRATAVE TË DHËNA PËR PROKURIMET PUBLIKE**
**28.261.918**
në 000 denarë

**PROKURIMET PUBLIKE TË REVIDUARA**
**19.950.492**
në 000 denarë

**3.844.205**
PARREGULLSITË E KONSTATUARA NË PROKURIMET PUBLIKE
në 000 denarë

**14.952**
PROKURIME TË KRYERA PËR TË CILËT NUK ËSHTË ZBATUAR PROCEDUR PËR PROKURIME PUBLIKE
në 000 denarë

- dobësi në realizimin e kontratave të lidhura sipas prokurimeve publike
- moszbatimi i procedurave për prokurimet publike
- dobësi në planifikimin e prokurimeve publike
- parregullsi në përgatitjen e dokumentacionit të tenderit / specifikimit teknik
- dobësi në fazën e kontratave të lidhur me ofertuesit e përzgjedhur

# TË ARDHURAT DHE SHPENZIMET PUBLIKE **TË REVIDUARA**

GJITHSEJ **365.025 MILIONË DENARË** të ardhura publike të reviduara dhe **395.961 MILIONË DENARË** shpenzime publike të reviduara me Programin Vjetor të Punës së ESHR-së për vitin 2023.

| | Të ardhurat publike të reviduara – Programi Vjetor 2023 | Të ardhurat publike të reviduara – Programi Vjetor 2022 | Shpenzimet publike të reviduara – Programi Vjetor 2023 | Shpenzimet publike të reviduara – Programi Vjetor 2022 |
|---|---|---|---|---|
| Buxheti Qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut | 203.174 | 227.343 | 15.619 | 79.847 |
| Buxhetet e fondeve | 135.804 | 123.039 | 129.629 | 115.742 |
| Buxhetet e NJVL-së | 5.243 | 12.515 | 4.888 | 11.536 |
| Shfrytëzuesit e mjeteve nga buxheti i FSSH-së | 1.730 | 1.045 | 1.720 | 1.014 |
| Pjesëmarrësit në fushatën zgjedhore – Zgjedhjet Lokale | 19 | 766 | 19 | 734 |
| Ndërmarrjet publike | 14.681 | 1.659 | 10.947 | 1.709 |
| Institucionet e tjera / Personat juridikë në të cilët shteti është aksionar dominues | 1.523 | 8.134 | 1.539 | 7.958 |
| Të përfshira nga revizionet e pajtueshmërisë | 0 | 1.685 | 50.446 | 3.236 |
| Të përfshira nga revizionet e suksesit | 2.851 | 35.322 | 181.154 | 63.063 |

Programi Vjetor 2023 · Programi Vjetor 2022

në 000.000 denarë

# 2023

**697** GJITHSEJ REKOMANDIMET E DHËNA

▼ **300** REKOMANDIMET PËR TË CILAT KA KALUAR AFATI PREJ 90 DITË PËR DËRGIMIN E INFORMACIONIT KTHYES

▼ **397** REKOMANDIMET PËR TË CILAT NUK KA KALUAR AFATI PREJ 90 DITË PËR DËRGIMIN E INFORMACIONEVE KTHYESE

▼ **111** REKOMANDIMET PËR TË CILAT STATUSI NUK ËSHTË PËRCAKTUAR PAVARËSISHT SE KA KALUAR AFATI PREJ 90 DITË PËR DËRGIMIN E INFORMACIONIT KTHYES

**71%** VEPRUAR SIPAS REKOMANDIMEVE

**189** REKOMANDIMET ME STATUS TË PËRCAKTUAR

**135** REKOMANDIMET SIPAS TË CILAVE JANË NDËRMARRË MASAT

**53** nuk janë të zbatuar

**1** Të pazbatueshme

# 2022


775
REKOMANDIME TË DHËNË
775
REKOMANDIMET PËR TË CILAT KA KALUAR AFATI PREJ 90 DITË PËR DËRGIMIN E INFORMACIONIT KTHYES
75%
VEPRUAR SIPAS REKOMANDIMEVE
644
REKOMANDIMET ME STATUS TË PËRCAKTUAR
131
REKOMANDIMET PËR TË CILAT STATUSI NUK ËSHTË PËRCAKTUAR PAVARËSISHT SE KA KALUAR AFATI PREJ 90 DITË PËR DËRGIMIN E INFORMACIONIT KTHYES
483
REKOMANDIMET SIPAS TË CILAVE JANË NDËRMARRË MASAT
143 nuk janë të zbatuar
18 Të pazbatueshme

# 2021


654
REKOMANDIME TË DHËNË
654
REKOMANDIMET PËR TË CILAT KA KALUAR AFATI PREJ 90 DITË PËR DËRGIMIN E INFORMACIONIT KTHYES
81%
VEPRUAR SIPAS REKOMANDIMEVE
608
REKOMANDIMET ME STATUS TË PËRCAKTUAR
46
REKOMANDIMET PËR TË CILAT STATUSI NUK ËSHTË PËRCAKTUAR PAVARËSISHT SE KA KALUAR AFATI PREJ 90 DITË PËR DËRGIMIN E INFORMACIONIT KTHYES
491
REKOMANDIMET SIPAS TË CILAVE JANË NDËRMARRË MASAT
111 nuk janë të zbatuar
6 Të pazbatueshme

# TRANSPARENCA

**FAQJA**

| | |
|---|---|
| Të cilët kanë shikuar një përmbajtje | 114.465 |
| Numri i përgjithshëm i vizituesve | 542.585 |
| Numri i përgjithshëm për 10 përmbajtjet e fundit të publikuara | 56.281 |
| Ndjekës të faqes | 9.116 |

**Youtube**

| | |
|---|---|
| Video të publikuara | 23 |
| Video për revizionet | 6 |
| Video për Entin Shtetëror të Revizionit | 3 |
| Intervista | 14 |

## LISTA-MEJLING KOMUNIKIMI ME PALË TË JASHTME TË INTERESUARA

2020-2023




## VIZITA NË WWW. DZR.MK

2020-2023




## MARRËDHËNIET ME MEDIUMET

01.01.2023 | 31.12.2023

**519** NJOFTIME TË MEDIUMEVE PËR RAPORTET PËRFUNDIMTARE TË REVIZIONIT

**89** NJOFTIME JANË TRANSMETUAR NGA ANA E TELEVIZIONEVE

**430** NJOFTIME JANË PUBLIKUAR NGA ANA E PORTALEVE TË INTERNETIT

**14** INTERVISTA DHE DEKLARATA PËR MEDIUMET

# PROCESI I REVIZIONIT



# HUAMARRJE
# ME KREDI/GRANTE

Të përfshira me revizionin e Buxhetit themelor për vitin 2022

në 000 denarë

| | | | | | | Dinamika e realizimit, në përputhje me periudhën e huamarrjes me kredi/grante |
|---|---|---|---|---|---|---|
| MF | 4.620.956 | 1.580.515 | 3.040.441 | 66% | 25.955 | 3 projekte nga 2016, 2021 dhe 2023 me dinamikë të rregullt të realizimit |
| MTL | 12.442.956 | 6.911.455 | 5.531.501 | 44% | 26.566 | 2 projekte nga viti 2009-2022 me dinamikë të rregullt e realizimit; 2 projekte nga viti 2010 dhe 2019 me dinamikë të ngadalë të realizimit; |
| MMJPH | 7.958.655 | 0 | 3.084.750 | 39% | 0 | 1 projekt nga viti 2022 me dinamikë të ngadaltë të realizimit; 1 projekt nga viti 2023 me dinamikë të rregullt të realizimit; |
| MSH | 1.661.906 | 832.883 | 829.024 | 50% | 0 | 1 projekt nga viti 2015, që shënon dinamikë shumë të ngadaltë të realizimit (ngecje) |
| MPPS | 8.174.588 | 6.775.252 | 1.399.335 | 17% | 22.691 | 3 projekte nga viti 2018 dhe 2020 me dinamikë të ngadaltë të realizimit; |
| MD DREJTORIA PËR EKZEKUTIMIN E SENKSIONEVE | 3.084.750 | 1.295.595 | 1.789.155 | 58% | 0 | 1 që shënon dinamikë shumë të ngadaltë të realizimit (ngecje) |
| MBPE | 8.020.350 | 287.670 | 7.485.900 | 93% | 29.443 | 1 projekt nga viti 2019 me dinamikë të ngadaltë të realizimit; 1 projekt nga viti 2021/2022 me dinamikë të rregullt; |
| MASH | 11.060.992 | 8.951.008 | 2.409.984 | 22% | 11.903 | 3 projekte nga viti 2011/2022 dhe 2021 me dinamikë të rregullt të realizimit; 1 projekt nga viti 2019 me dinamikë të ngadaltë të realizimit; |
| NPRRSH | 79.471.670 | 10.819.497 | 41.342.864 | 52% | 615.676 | 6 projekte nga viti 2014-2022 me dinamikë të ngadaltë të realizimit; 1 projekt nga viti 2014/2019 me dinamikë shumë të ngadaltë të realizimit (ngecje) |
| NPHRMV-së | 17.123.992 | 4.811.798 | 12.312194 | 72% | 461.852 | 3 projekte nga viti 2010-2018 me dinamikë të ngadaltë të realizimit; |
| SHA ESM | 8.040.151 | 1.025.284 | 5.862.530 | 73% | 56.711 | 2 projekte nga viti 2019 dhe 2023 me dinamikë të rregullt të realizimit; 2 me dinamikë të ngadaltë të realizimit; 1 projekt në vazhdim të vlerësimit të ofertave; |
| SHA MEPSO | 4.565.430 | 2.456.868 | 2.108.562 | 46% | 126.008 | 2 projekte nga viti 2013 dhe 2015 me dinamikë të ngadaltë të realizimit; |
| SHA NOMAGAS | 13.537.364 | 5.552.550 | 7.984.814 | 59% | 240.547 | 2 projekte nga viti 2015 dhe 2021 me dinamikë të ngadaltë të realizimit; |
| M-NAV | 602.760 | 0 | 602.760 | 100% | 1.546 | 1 projekt nga viti 2022 me dinamikë të ngadaltë të realizimit; |
| QYTETI I SHKUPIT | 4.318.650 | 0 | 4.318.650 | 100% | 0 | 1 projekt nga viti 2021 me dinamikë shumë të ngadaltë (ngecje) |
| NP UJËSJELLËSI DHE KANALIZIMI Shkup | 7.773.570 | 0 | 7.773.570 | 100% | 0 | 1 projekt nga 2019/2023 me dinamikë të ngadaltë të realizimit |
| | 192.458.740 | 51.000.374 | 107.876.034 | | 1.618.897 | |

- Institucionet kompetente për realizimin e projektit
- Shuma totale e kredive/grantet investuese
- Shuma e mjeteve të tërhequr
- Shuma e mjeteve të patërhequr
- % e mjeteve të patërhequr
- Shpenzimet për komision të mjeteve të patërhequr

# 1

# PËR ENTIN SHTETËROR TË REVIZIONIT



Enti Shtetëror i Revizionit (ESHR) është institucion suprem i pavarur i revizionit në Republikën e Maqedonisë së Veriut, i cili për më shumë se 20 vjet në mënyrë transparente, në kohë dhe objektive i informon institucionet kompetente dhe publikun për gjendjet e konstatuara nga revizionet e kryera.

ESHR-ja i kryen revizionet në përputhje me parimet, standardet dhe udhëzimet e revizorit të përmbajtura në Kornizën e Publikimeve Profesionale të Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Revizorit (INTOSAI).

Pavarësia e institucionit përcaktohet me Ligjin për revizionin shtetëror, i cili rregullon kompetencat e ESHR-së, përcaktohet mandati i gjerë në kryerjen e revizioneve, me qasje në të gjitha informacionet, dokumentacionet, evidencat e nevojshme për zbatimin e revizionit shtetëror.

ESHR-ja e përcakton në mënyrë të pavarur Programin Vjetor të Punës, vendos në mënyrë objektive për subjektet që janë lëndë e revizionit dhe mënyrën, përmbajtjen e njoftimit të revizioneve të kryera, pa paragjykime dhe i liruar nga ndikimet e pushtetit legjislativ dhe ekzekutiv.



# MISIONI

## KUSH JEMI DHE ÇFARË BËJMË?

Enti Shtetëror i Revizionit është Institucioni Suprem i Revizionit në Republikën e Maqedonisë së Veriut, i cili ka mandat t'i kryejë punët e revizionit shtetëror. Enti Shtetëror i Revizionit e kryen revizionin shtetëror të raporteve financiare, të pajtueshmërisë me rregullat dhe rregullativat ligjore, si dhe revizionin e suksesit në përputhje me kërkesat e standardeve të INTOSAI-t.

Detyra jonë është të **zbatojmë kontrolle, të japim vlerësime dhe të shprehim opinione** pas revizioneve të kryera, gjë që do të ketë vlerë të shtuar për qytetarët dhe shoqërinë.

Rezultatet e punës dhe mandatit tonë janë në funksion të përmbushjes së nevojave dhe pritshmërive të përdoruesve tanë, me qëllim të promovimit dhe sigurimit të llogaridhënies, objektivitetit dhe transparencës në mbështetjen e shtetit, në drejtim të menaxhimit të mençur dhe të ndershëm të mjeteve publike.

# VIZIONI

## ÇFARË SYNOJMË?

Në synimet për të përmbushur misionin tonë, besojmë se edhe më tutje do ta ruajmë pavarësinë, profesionalizmin, etikën dhe ndershmërinë tonë, duke i kryer detyrat tona në përputhje me ligjin dhe mandatin, do të sigurojmë promovimin e vazhdueshëm të objektivitetit dhe transparencës, do të jemi frymëzues dhe novatorë dhe do të japim shembullin më të mirë të mbrojtjes së interesit publik në funksion të arritjes së nivelit të lartë të besimit nga publiku.

Në drejtim të realizimit të këtyre vlerave tona, të gjithë punonjësit tanë punojnë me përkushtim si profesionistë të lartë, duke i mbrojtur dhe respektuar interesat e profesionit të revizorit.



## 1.1 KORNIZA JURIDIKE

### PAVARËSIA DHE KOMPETENCAT LIGJORE

Enti Shtetëror i Revizionit është Institucioni Suprem i Revizionit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, kompetencat e të cilit janë të përcaktuara me Ligjin për revizionin shtetëror ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 66/10, 145/10, 12/14, 43/14, 154/15, 192/15, 27/16 dhe 83/18 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 122/2021) dhe ato kryhen në përputhje me standardet ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Revizionit të miratuara nga Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Revizionit - INTOSAI.

Përveç ligjit themelor, me ligje të veçanta nga legjislacioni nacional rregullohen çështjet e caktuara nga kompetencat e Entit Shtetëror të Revizionit, nga të cilat veçanërisht veçohen për nga kuptimi dispozitat e Ligjit për financimin e partive politike që i referohen revizionit të raporteve financiare të partive politike, dispozitat e Kodit Zgjedhor për revizionin e raporteve financiare të pjesëmarrësve në fushatat zgjedhore, revizionin e buxhetit të Republikës në përputhje me Ligjin për buxhete, revizionin e raporteve financiare të komunave në përputhje me Ligjin për financimin e njësive të vetëqeverisjes lokale dhe Ligjin për vetëqeverisjen lokale.

Enti Shtetëror i Revizionit është pjesëmarrës aktiv në zbatimin e Programit Nacional për miratimin e së drejtës së Bashkimit Evropian (NPAA) 2021-2025 për Kapitullin 3.32. Kontrolli financiar, ndërsa kontribuon e vet në grupet e punës për negociata dhe kontributin në raportin për progresin e vendit në procesin e integrimit evropian e jep vazhdimisht në një numër më të madh kapitujsh, si prokurimet publike, drejtësia, lufta kundër korrupsionit, barazia gjinore, funksionaliteti i institucioneve demokratike dhe reforma e administratës publike.

Enti Shtetëror i Revizionit është faktor aktiv në arritjen e qëllimeve, ndërmarrjen e masave dhe zbatimin e aktiviteteve të përfshira në një nga dokumentet më të rëndësishme programore të shtetit, Programi për Reformën e Menaxhimit të Financave Publike «SMART FINANCAT PUBLIKE» 2022 - 2025.

Krahas përditësimit të vazhdueshëm të akteve metodologjike në përputhje me të cilat kryhen revizionet, në vitin 2023 vëmendje e veçantë i është kushtuar kornizës juridike për mënyrën dhe procedurën e parashtrimit të raporteve përfundimtare të revizorit në Prokurorinë Publike të Republikës së Maqedonisë së Veriut, të përforcuar me më shumë punëtori dhe takime teknike ndërmjet revizorëve shtetërorë dhe prokurorëve publikë në drejtim të procesimit efikas të veprimeve hetimore lidhur me gjendjet e konstatuara në revizionet për të cilat ekziston dyshimi i arsyeshëm për kryerjen e veprës penale nga subjektet e revizionit. Për këtë qëllim, më 19 dhjetor 2023, kryerevizori shtetëror miratoi Udhëzim për njoftimin e gjendjeve të konstatuara në kryerjen e revizionit shtetëror për të cilat ekziston dyshimi se subjekti që është lëndë e revizionit ka kryer vepër penale.

Miratimi i propozim-amendamenteve për ndryshimin dhe plotësimin e Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë së Veriut me qëllim të themelimit kushtetues, përkatësisht garancisë më të lartë juridike për pavarësinë dhe mëvetësinë e saj, si dhe Propozim-ligjin për revizionin shtetëror të përgatitur dhe të harmonizuar me standardet ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Revizionit, në përputhje me legjislacionin e vendeve-anëtare të Bashkimit Evropian dhe praktikën e Institucioneve Supreme të Revizionit që janë anëtare të EUROSAI-t, mbeten sfidë kryesore për organet e pushtetit ekzekutiv dhe legjislativ edhe në vitin 2024.

## 1.2 DOKUMENTET DHE AKTIVITETET STRATEGJIKE DHE VJETORE

Në raportet nga vlerësimet e kryera të organizatave ndërkombëtare relevante, si dhe në Raportin për Republikën e Maqedonisë së Veriut për vitin 2022 të Komisionit Evropian në lidhje me fushën e Revizionit të Jashtëm, janë theksuar aspektet për përmirësim nga organet kompetente si në vijim:

- përfundimi efektiv i procedurës së rregullimit të kushtetutshmërisë dhe miratimi i Ligjit të ri për revizionin shtetëror me qëllim të forcimit të pavarësisë financiare dhe operative të ESHR-së, në përputhje me parimet, standardet dhe udhëzimet e INTOSAI-t;
- rritja e mbikëqyrjes dhe ndjekjes nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut përmes shqyrtimit të raporteve të ESHR-së me qëllim të përmirësimit të shkallës së rekomandimeve të zbatuara.

Këto aspekte për përmirësim, si dhe prioritetet e përcaktuara në Programin për Reformën e Menaxhimit të Financave Publike «SMART FINANCAT PUBLIKE» 2022 - 2025 në lidhje me ESHR-në, janë të përmbajtura në dokumentet strategjike të ESHR-së, siç janë:

### STRATEGJIA PËR ZHVILLIMIN E ESHR-SË PËR 2023 – 2027

Në drejtim të përditësimit të qëllimeve strategjike të ESHR-së dhe përshtatjes së funksionimit të ESHR-së me gjendjet dhe sfidat aktuale që janë paraqitur në shoqëri, në vitin 2023 ESHR-ja miratoi Strategji të re për Zhvillimin e Revizionit Shtetëror për periudhën 2023-2027 dhe ndërmori aktivitete të shumta për realizimin e qëllimeve të saj strategjike lidhur me:

- Sigurimin dhe ruajtjen e pavarësisë së plotë të Entit Shtetëror të Revizionit - pavarësia institucionale dhe korniza institucionale ligjore;
- Ndërtimin dhe ruajtjen e kapaciteteve në fushat e interesit – menaxhimi i brendshëm, mbështetja institucionale, përmirësimet e vazhdueshme, marrëdhëniet me palët e interesuara/komunikimi, kapacitetet njerëzore dhe metodologjia dhe standardet e revizorit;
- Ofrimin e rezultateve të matshme nga kryerja e revizionit shtetëror, në drejtim të ofrimit të revizioneve të cilësisë së lartë, revizioneve me interes publik dhe rritjes së besimit publik, me qëllim të përmirësimit të jetës së qytetarëve;
- Hartimin e planit strategjik për fushat e mundshme të revizioneve dhe vlerësimit të sfidave në fushat me interes dhe sipas vlerësimit të rreziqeve për periudhën 2023 - 2027.

Sipas Raportit për shkallën e realizimit të Strategjisë për Zhvillimin e ESHR-së 2023-2027, bazuar në treguesit e përcaktuar për ndjekjen e shkallës së realizimit, mund të konkludohet se ESHR-ja nga dita e miratimit të Strategjisë deri në dhjetor 2023, realizoi 75% të aktiviteteve të parapara.

### STRATEGJIA E TI-SË E ESHR-SË PËR VITET 2023 – 2027

Me qëllim të rritjes së efikasitetit të sistemit të informacioneve të Entit Shtetëror të Revizionit dhe njëherazi për të kontribuar në zbatimin e Strategjisë Zhvillimore të Entit Shtetëror të Revizionit 2023-2027, në vitin 2023 u miratua Strategji e re e TI-së për periudhën 2023-2027 me qëllim që të mundësohet zhvillimi dhe qëndrueshmëria e drejtë e kapaciteteve të TI-së dhe e sistemit të informacioneve për të ofruar mbështetje të vazhdueshme dhe cilësore për punën e ESHR-së, me qëllim të arritjes së qëllimeve strategjike të TI-së lidhur me:

- Zhvillimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të TI-së të ESHR-së;
- Zhvillimin dhe mirëmbajtjen e arkitekturës së TKI-së;
- Zhvillimin dhe mirëmbajtjen e zgjidhjeve aplikative dhe mbështetjen e TKI-së së revizionit;
- Prezantimin e rezultateve të punës së ESHR-së;
- Hulumtimin e zgjidhjeve inovative të TI-së dhe aplikimin e tyre në të ardhmen;
- Edukimin në fushën e TI-së, certifikimin dhe trajnimet për punonjësit.

Në përputhje me Raportin për shkallën e zbatimit të Strategjisë së TI-së të Entit Shtetëror të Revizionit 2023-2027, bazuar në treguesit e përcaktuar për ndjekjen e shkallës së realizimit, mund të konkludohet se ESHR-ja nga dita e miratimit të Strategjisë deri në dhjetor 2023, përqindja totale e aktiviteteve të realizuara është 89.66%.

## STRATEGJIA E MENAXHIMIT TË RESURSEVE NJERËZORE PËR VITET 2020 – 2023 DHE VITET 2024-2027

Me Strategjinë e menaxhimit të resurseve njerëzore vendoset qëndrueshmëria strategjike e procesit të menaxhimit të resurseve njerëzore të ESHR-së. Pas skadimit të periudhës së vlefshmërisë së Strategjisë së menaxhimit të resurseve njerëzore në ESHR për vitet 2020-2023, është miratuar Strategji e re e menaxhimit të resurseve njerëzore në ESHR për vitet 2024-2027, e cila u mundëson punonjësve të mbajnë të rrisin interesin e tyre për të punuar në institucion duke përmirësuar kushtet e punës, kushtet e barabarta për punësim dhe avancim, përsosjen e vazhdueshme profesionale dhe vlerësimin e punës së punonjësve.

Me Strategjinë e menaxhimit të resurseve jerëzore propozohen masa lidhur me:

- Punësimin;
- Karrierën;
- Edukimin profesional të vazhdueshëm;
- Matjen e rezultatit/vlerësimin e punës së punonjësve;
- Qëndrueshmërinë e mjedisit të punës; dhe
- Digjitalizimin e proceseve të menaxhimit të resurseve njerëzore.

Rritja e njohurive dhe aftësive të punonjësve të ESHR-së është një nga angazhimet bazë të institucionit, të cilat shndërrohen në planet vjetore për përsosjen e vazhdueshme profesionale.

## STRATEGJIA E MENAXHIMIT TË RREZIQEVE TË ENTIT SHTETËROR TË REVIZIONIT PËR VITET 2020-2023 DHE VITET 2024 – 2027

Me Strategjinë e menaxhimit të rreziqeve identifikohen të gjitha rreziqet e mundshme që mund të ndikojnë në arritjen e qëllimeve dhe funksionimin e suksesshëm të ESHR-së dhe rregullohen procedurat dhe aktivitetet për menaxhimin e rreziqeve të identifikuara. Pas zbatimit të suksesshëm të Strategjisë së menaxhimit të rreziqeve të ESHR-së për periudhën 2020-2023, u miratua Strategjia e re e menaxhimit të rreziqeve të ESHR-së për vitet 2024-2027, që i përkufizon qëllimet dhe përfitimet e menaxhimit të rreziqeve, përgjegjësitë për menaxhimin e rreziqeve dhe ofron pasqyrë të kornizës që vendoset për menaxhimin me sukses të tyre, për realizimin e vazhdueshëm të qëllimeve strategjike të ESHR-së.

Menaxhimi efikas i rreziqeve kërkon që rreziqet të identifikohen dhe vlerësohen në mënyrë efikase në mënyrë që të zbatohen kontrollet dhe aktivitetet përkatëse në lidhje me minimizimin e rreziqeve.




## PLANİ STRATEGJİK İ REVİZİONİT PËR VİTET 2021 – 2023 DHE VİTET 2024 – 2027

Qëllimet strategjike dhe fushat prioritare për revizionet përcaktohen fillimisht në Planin Strategjik të Revizionit për periudhën 2021-2023, më pas në Planin Strategjik të Revizionit për periudhën 2024-2027. Këto plane strategjike të revizionit janë hartuar në bazë të Vendimit për përcaktimin e qëllimeve strategjike për revizionet e Entit Shtetëror të Revizionit për periudhën 2021 - 2023 dhe për fushat prioritare për revizionet sipas sektorëve që kryejnë revizione, i cili më pas është zëvendësuar me Vendim të ri që i referohet periudhës 2024 - 2027, si dhe në përputhje me Udhëzimin për planifikimin strategjik dhe vjetor të revizioneve dhe qëllimeve strategjike të përcaktuara në Strategjitë Zhvillimore të Entit Shtetëror të Revizionit për vitet 2018 - 2022 dhe vitet 2023 - 2027.

Plani Strategjik i Revizionit paraqet bazë të mëtejshme për proceset e planifikimit vjetor të revizioneve pranë sektorëve të revizionit, me qëllim të:

- sigurojë bazë solide për udhëheqësit e sektorëve në ofrimin e udhëzimeve strategjike që kanë të bëjnë me mbulimin e revizioneve të ardhshme;
- identifikohen dhe përzgjidhen revizionet që kanë potencial për të përmirësuar llogaridhënien e sektorit publik dhe administratës;
- kuptojnë rreziqet e mundshme dhe të pranishme dhe ato t'i marrin parasysh kur i zgjedhin revizionet;
- sigurojnë bazë për llogaridhënien e sektorit të revizionit dhe të përgatisin program të revizorit që mund të arrihet në mënyrë optimale me rezultatet e pritura dhe resurset dhe njohuritë në dispozicion.

Në përputhje me Raportin për shkallën e zbatimit të Planit Strategjik të Revizionit të Entit Shtetëror të Revizionit për vitet 2021-2023, në përputhje me qëllimet e përcaktuara strategjike dhe fushat prioritare të revizionit për periudhën 2021-2023, mund të konkludohet se ESHR-ja nga dita e miratimit të Strategjisë deri në dhjetor 2023, i mbuloi të gjitha 18 fushat prioritare të përcaktuara.

## STRATEGJIA E KOMUNIKIMIT E ESHR-SË PËR VITET 2020 – 2023 DHE VITET 2024 - 2027

Strategjia e komunikimit e ESHR-së për periudhën 2020 - 2023 ishte plotësuar me Strategji të re të komunikimit për periudhën 2024 - 2027, e cila mundëson që përmes komunikimit të vazhdueshëm të motivojë dhe të bëjë të mundur përfshirjen më të thellë dhe gjithëpërfshirëse, me bazë strategjike të grupeve të synuara në fushën civile, me qëllim që në mënyrë konsekuente të forcohet efekti i gjetjeve dhe rekomandimeve të Entit Shtetëror të Revizionit.

Në drejtim të rritjes së transparencës dhe llogaridhënies në punën e ESHR-së dhe mundësimit të disponueshmërisë së informacioneve mbi punën e ESHR-së dhe gjendjet e përmbajtura në Raportet Përfundimtare të Revizorit, ESHR-ja vendosi regjistër të palëve të interesuara, i cili për momentin përmban 1.215 palë të interesuara.

Për këtë qëllim, ESHR-ja vendosi/përcaktoi abstrakt të revizionit dhe njoftim për publikun ku gjendjet/informacionet kryesore nga raporti përfundimtar i revizorit jepen në mënyrë të lehtë dhe të kuptueshme. Në momentin e publikimit të raportit përfundimtar të revizorit, informacioni i abstraktit u dërgohet të gjitha palëve të interesuara. Informacionet mbi punën e ESHR-së dhe ISR-së publikohen në faqen e internetit të ESHR-së (www.dzr.mk) dhe FB (https://www.facebook.com/DrzavenZavodzaRevizija ).

Në përputhje me Raportin për shkallën e realizimit të Strategjisë së komunikimit për vitet 2020-2023, bazuar në treguesit e përcaktuar për ndjekjen e shkallës së realizimit, mund të konkludohet se ESHR-ja nga dita e miratimit të Strategjisë deri në dhjetor 2023, realizoi 85% të aktiviteteve të parapara.

PËRFSHIRJA E STRATEGJISË



## NË STRATEGJI JANË PËRKUFIZUAR DY QËLLIME STRATEGJIKE TË KOMUNIKIMIT:

### QËLLIMI I PARË STRATEGJIK I KOMUNIKIMIT TONË

Për të mundësuar përfshirje më të thellë dhe gjithëpërfshirëse, me bazë strategjike të grupeve të synuara në fushën civile, në luftën e përbashkët për efikasitet më të madh, transparencë dhe llogaridhënie të aktorëve në sistemin institucional të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

**1 QËLLIMI SPECIFIK**

T'i sjellim gjetjet tona për punën e institucioneve më afër qytetarëve dhe t'ua afrojmë misionin tonë të përgjithshëm atyre, duke forcuar nivelin e tyre të njohurive dhe besimit në institucionin tonë.

**2 QËLLIMI SPECIFIK**

Të forcojmë eko-sistemin e komunikimit në të cilin zhvillohet biseda e vazhdueshme midis ESHR-së dhe aktorëve në fushën civile: gazetarët dhe aktivistët në organizatat qytetare, në mënyrë që bashkërisht të motivojmë qeverisjen e mirë me institucionet.

**3 QËLLIMI SPECIFIK**

Të zgjerojmë fushëveprimin e komunikimit me aktorët në fushën civile që punojnë jashtë kryeqytetit dhe që ofrojnë shërbime për qytetarët e cenueshëm dhe të margjinalizuar.

### QËLLIMI I DYTË STRATEGJIK I KOMUNIKIMIT TONË

T'u mundësojmë aktorëve në sistemin institucional që të njohin më qartë punën tonë si bazë për forcimin e qeverisjes së mirë, ndërsa institucionin tonë si katalizator të demokratizimit.

**4 QËLLIMI SPECIFIK**

Të strukturojmë dhe të intensifikojmë dialogun me Prokurorinë Publike të RMV-së për të vendosur praktikë të diskutimit të rregullt të revizorëve me prokurorët publikë rreth gjetjeve të revizioneve tona.

**5 QËLLIMI SPECIFIK**

Duke e rritur njohurinë e deputetëve dhe shërbimeve të Kuvendit për revizionin, të sigurojmë që gjetjet e raporteve të revizorit të diskutohen rregullisht dhe sipas rëndësisë në diskutimet e komisioneve dhe seancave plenare.

**6 QËLLIMI SPECIFIK**

Le të hapim dialog me Qeverinë për rëndësinë e gjetjeve të ESHR-së për ndërtimin e politikave të përgjithshme në vend.

## PROGRAMİ PËR REFORMËN E MENAXHİMİT TË FİNANCAVE PUBLİKE «SMART FINANCAT PUBLIKE» 2022 – 2025

Në Programin për Reformën e Menaxhimit të Financave Publike "SMART FINANCAT PUBLIKE" 2022-2025 të miratuar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, janë përcaktuar prioritetet për revizionin e jashtëm dhe mbikëqyrjen parlamentare në kompetencë të Entit Shtetëror të Revizionit. Qëllimi i këtyre prioriteteve është forcimi i menaxhimit të financave publike dhe sigurimi i llogaridhënies në përdorimin e mjeteve publike përmes forcimit të kornizës juridike për revizionin e jashtëm duke arritur pavarësinë kushtetuese të ESHR-së dhe forcimin e pavarësisë financiare dhe operative në përputhje me parimet, standardet dhe udhëzimet e INTOSAI-t, vendosjen e mekanizmit për rolin proaktiv për shqyrtimin e raporteve të revizorit në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe masat e ndërmarra sipas rekomandimeve të dhëna në raportet e revizorit dhe forcimin e kapaciteteve institucionale të revizionit të jashtëm dhe për shqyrtimin e raporteve të revizorit në Kuvend.

Në Planin e Veprimit për zbatimin e Programit për Reformën e Menaxhimit të Financave Publike për vitin 2023 të miratuar nga Qeveria e RMV-së, përmbahen aktivitetet dhe nënaktivitetet për zbatimin e masave dhe për realizimin e treguesve që kanë të bëjnë me prioritetet për revizionin e jashtëm dhe mbikëqyrjen parlamentare në kompetencë të ESHR-së.

Enti Shtetëror i Revizionit mori pjesë në mënyrë aktive edhe në hartimin e Programit të ri për Menaxhimin e Financave Publike për vitet 2024-2027, i cili pritet të miratohet në vitin 2024.

## GRUPİ SEKTORİAL İ PUNËS DHE KËSHİLLİ PËR MENAXHİMİN E FİNANCAVE PUBLİKE

Enti Shtetëror i Revizionit merr pjesë në mënyrë aktive në Grupin Sektorial të Punës për Menaxhimin e Financave Publike të kryesuar nga ministri i Financave, qëllimi i të cilit është vendosja dhe mbajtja e qasjes sektoriale funksionale në fushën e menaxhimit të financave publike.

Gjithashtu, kryerevizori shtetëror si anëtar ka marrë pjesë në punën e Këshillit për Menaxhimin e Financave Publike, i cili është trup koordinues i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut për ndjekjen e zbatimit të reformave për menaxhimin e financave publike të parapara me Programin për Reformën e Menaxhimit të Financave Publike.

Arritja e qëllimeve strategjike të përcaktuara në dokumentet e veçanta strategjike të Entit Shtetëror të Revizionit dhe në dokumentet e tjera strategjike kërkon miratimin e akteve në nivel vjetor, të cilat do të sigurojnë realizimin e tyre. Për këtë qëllim, janë miratuar më shumë akte në nivel vjetor, dhe në të njëjtën kohë, është vendosur sistemi i ndjekjes së vazhdueshme të zbatimit të akteve strategjike dhe vjetore të ESHR-së, për të cilat përgatiten raportet përkatëse në nivel gjysmëvjetor dhe vjetor.

## PROGRAMI VJETOR I PUNËS PËR VITIN 2023

Programi Vjetor i Punës së ESHR-së për vitin 2023 është hartuar në përputhje me Ligjin për revizionin shtetëror dhe Rregulloren për mënyrën e kryerjes së revizionit shtetëror dhe bazuar në Planin Strategjik të Revizionit të ESHR-së për vitet 2021-2023, qëllimet dhe prioritetet e Strategjisë Zhvillimore të ESHR-së për vitet 2023-2027, qëllimet e zhvillimit të qëndrueshëm të KB-së dhe kriteret e përcaktuara nga metodologjia e vlerësimit nga OECD-SIGMA, duke pasur parasysh resurset në dispozicion.

Duke e ndier nevojën për të rritur transparencën, llogaridhënien dhe përgjegjësinë e saj në kryerjen e kompetencave të deleguara me ligj, në kuadër të hartimit të Programit Vjetor të Punës së ESHR-së për vitin 2023, ESHR-ja dërgoi njoftim për dorëzimin e kërkesave / propozimeve për kryerjen e revizioneve te të gjitha palët e interesuara dhe në të njëjtën kohë në faqen e saj të internetit vendosi formular «Kërkesë për revizion» dhe në rrjetet sociale (FB) publikoi thirrje për të gjithë personat juridikë dhe fizikë të interesuar për të dorëzuar kërkesë për revizion.

Nga kërkesat e mbërritura, gjithsej 36 kërkesa, në kuadër të hartimit të Programit Vjetor të Punës së ESHR-së për vitin 2023, janë pranuar 13 kërkesa ose 36% e gjithsej kërkesave të marra, ndërsa në përputhje me dokumentet strategjike, kriteret e përzgjedhjes dhe resurset e disponueshme për revizion.

## PASQYRA NR. 1
## KËRKESAT E MBËRRITURA DHE KËRKESAT E PRANUARA SIPAS LLOJEVE TË SUBJEKTEVE QË I KANË DORËZUAR KËRKESAT

| Subjektet që kanë dorëzuar kërkesa | Kërkesat e mbërritura | Kërkesat e pranuara |
|---|---|---|
| NJVL | 13 | 5 |
| Institucionet | 9 | 4 |
| Ndërmarrjet Publike | 3 | 1 |
| Qytetarët | 3 [1] | / |
| Anonim | 8 | 3 |
| | **36** | **13** |

Enti Shtetëror i Revizionit ka zbatuar plotësisht Programin Vjetor të Punës për vitin 2023. Me Programin Vjetor janë realizuar në total 66 revizione prej të cilave 47 revizione të rregullshmërisë, 11 revizione të suksesit, 4 revizione të pajtueshmërisë dhe 4 revizione të ndjekjes së rekomandimeve të dhëna në Raportin Përfundimtar të Revizorit të Autorizuar Shtetëror për revizionin e kryer të raporteve financiare bashkë me revizionin e pajtueshmërisë nga vitet e mëparshme.

Në kuadër të Programit Vjetor të Punës së ESHR-së për vitin 2023, janë zbatuar gjithsej 11 revizione të suksesit, prej të cilave:

- 2 revizione të suksesit janë kryer në bashkëpunim me Zyrën Nacionale Suedeze të Revizionit (SNAO);
- 2 revizione janë kryer në bashkëpunim me Zyrën e Kryerevizorit të Norvegjisë (OAGN);
- 1 revizion i suksesit është kryer si revizion kooperativ i suksesit për barazinë gjinore

[1] Nga 3 (tre) kërkesat e mbërritura për revizione, 2 (dy) kërkesa janë pranuar dhe janë zbatuar me revizione të kryera në përputhje me Programin Vjetor të Punës së Entit Shtetëror të Revizionit për vitet 2021 dhe 2022.

– revizioni i COR 5, i cili u koordinua nga ESHR-ja dhe ishte zbatuar bashkë me Institucionet Supreme të Revizionit të Shqipërisë dhe Kosovës, me mbështetjen e UN Women. Rezultatet e revizionit kooperativ u prezantuan në një ngjarje anësore, të organizuar nga ESHR-ja me mbështetjen e UN Woman, në kuadër të Komisionit të 68-të për Statusin e Grave që u mbajt në mars 2024 në Kombet e Bashkuara me seli në Nju Jork, Shtetet e Bashkuara të Amerikës;

- 1 revizion i suksesit është kryer si revizion kooperativ për zbatimin e Qëllimeve të Zhvillimit të Qëndrueshëm deri në vitin 2030, në bashkëpunim me Institucionin Suprem të Revizionit të Serbisë, me mbështetjen e UNDP-së;
- 2 revizione të suksesit janë kryer me mbështetjen e ekspertëve të jashtëm të ofruar nga WFD;
- 1 revizion i suksesit është kryer me mbështetjen e ekspertëve të OECD - SIGMA.

Me revizionet e suksesit në vitin 2023 janë përfshirë fushat dhe temat e mëposhtme:

- Menaxhimi i pronës shtëtërorет;
- Barazia gjinore dhe emancipimi i grave nga zonat rurale nëpërmjet përfshirjes së tyre në tregun e punës;
- Gatishmëria e Republikës së Maqedonisë së Veriut për zbatimin e Qëllimeve të Zhvillimit të Qëndrueshëm deri në vitin 2030;
- Efektiviteti i masave për të parandaluar "largimin" e kuadrove me arsim të lartë dhe profesional;
- Efikasiteti i masave dhe politikave për servisimin e borxhit publik;
- Realizimi i investimeve kapitale të financuara nga buxheti i RMV-së, fondeve të BE-së dhe mjeteve nga institucionet e tjera financiare ndërkombëtare në kompetencë të pushtetit qendror dhe të vetëqeverisjes lokale;
- Përdorimi i shërbimeve shëndetësore me diagnostifikim radiologjik-MR;
- Dhënia e së drejtës për të kryer kërkime dhe shfrytëzim të detajuar gjeologjik të lëndëve të para minerale, me vështrim të veçantë për mermerin;
- Efikasiteti i masave, politikave dhe projekteve për realizimin dhe zhvillimin e standardit të studentëve;
- Efektiviteti i Portalit Nacional E-Shërbime;
- Efektiviteti i masave të ndërmarra nga organet kompetente për mbrojtjen e sistemeve kritike të informacioneve.

Fushat e mbuluara nga revizionet e përmendura japin bazën për përcaktimin e mënyrës së veprimit nga organet kompetente, por në të njëjtën kohë edhe sigurojnë kontributin aktiv të Entit Shtetëror të Revizionit duke dhënë rekomandime për mënyrën e veprimit të tyre, duke dhënë vlerësim për zbatimin e proceseve reformuese, duke dhënë këshilla për mënyrën e realizimit të të ardhurave publike dhe përdorimin e mjeteve publike, mënyrën e shfrytëzimit të resurseve dhe energjensave natyrore, mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe mjedisin jetësor dhe përmirësimin e mjedisit të kontrollit.

Në përputhje me Raportet për shkallën e realizimit të Programeve Vjetore të Punës së Entit Shtetëror të Revizionit për vitin 2023, mund të konkludohet se ESHR-ja, nga dita e miratimit të këtyre programeve vjetore deri në dhjetor 2023, realizoi 100% të revizioneve të planifikuara.

## PLANİ VJETOR PËR PARANDALİMİN E KORRUPSİONİT PËR VİTİN 2023

Aktivitetet e Entit Shtetëror të Revizionit në lidhje me parandalimin e korrupsionit zhvillohen në përputhje me autorizimet dhe detyrimet e përcaktuara me Ligjin për revizionin shtetëror, Ligjin për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave dhe rregullativën tjetër relevante.

Për realizimin e këtyre kompetencave, ESHR-ja miratoi Planin Vjetor për Parandalimin e Korrupsionit për vitin 2023, i cili parasheh masa dhe aktivitete për parandalimin e korrupsionit në nivel të institucionit.

Në përputhje me Planin Vjetor për Parandalimin

e Korrupsionit të ESHR-së për vitin 2023, Enti Shtetëror i Revizionit zbatoi aktivitete për:

- Dorëzimin e raporteve/njoftimeve përfundimtare të revizorit tek organet kompetente, për gjetjet që tregojnë aktivitete në kompetencën e tyre dhe për të siguruar informacione kthyese për masat e ndërmarra në përputhje me kompetencat e tyre;
- Dorëzimin e raporteve dhe informacioneve për revizionet e kryera, me kërkesë të institucioneve të veçanta;
- Mbajtjen e takimeve të punës për informim, shkëmbimin e përvojave lidhur me metodologjinë e punës dhe prezantimin e gjendjeve të konstatuara në raportet përfundimtare të revizorit, harmonizimin e rregullave, njohjen me legjislativën evropiane nga aspekti i luftës kundër korrupsionit dhe kryerjen e revizionit shtetëror;
- Pjesëmarrjen në punën dhe aktivitetet e Trupit Ndërresor për Koordinimin e Aktiviteteve kundër Korrupsionit, si dhe bashkëpunimin aktiv me Komisionin Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit në pjesën e aktiviteteve të ndërmarra nga Strategjia Nacionale për luftën kundër korrupsionit dhe konfliktit të interesave 2022-2025;
- Bashkëpunimin e vazhdueshëm me organet kompetente, ku në fokus është kryesisht Prokuroria Publike e Republikës së Maqedonisë së Veriut, në përputhje me Memorandumin e Bashkëpunimit të lidhur ndërmjet të dy institucioneve;
- Kontributin aktiv në punën e Koalicionit Afarist kundër Korrupsionit, si dhe organeve të tjera kundër korrupsionit; dhe
- Zbatimin e standardeve ndërkombëtare të revizorit dhe GUID 5270 – Udhëzuesi për Revizionin e Parandalimit të Korrupsionit, Udhëzimet në lidhje me zbulimin e parregullsive, mashtrimeve dhe korrupsionit dhe Udhëzimet për revizionin e Fondeve të BE-së dhe Ndihmës Paraaderuese.

Në përputhje me Raportin për shkallën e realizimit të Planit Vjetor për Parandalimin e Korrupsionit të ESHR-së për vitin 2023, bazuar në treguesit e përcaktuar për ndjekjen e shkallës së realizimit, mund të konkludohet se ESHR-ja nga dita e miratimit deri në dhjetor 2023, realizoi 76% të aktiviteteve të parapara.
Në dhjetor 2023, u miratua një Plan i ri Vjetor për Parandalimin e Korrupsionit për vitin 2024, i cili u publikua në faqen e internetit të ESHR-së[2] .

## PLANİ VJETOR PËR PËRSOSJEN E VAZHDUESHME PROFESİONALE PËR VİTİN 2023

Enti Shtetëror i Revizionit investon në vazhdimësi në forcimin e aftësive dhe njohurive të revizorëve shtetërorë, gjë që siguron cilësi shtesë në punën dhe ruajtjen e integritetit profesional si institucion që është bartës i progresit në menaxhimin e mjeteve publike.

Trajnimet e punonjësve të ESHR-së kryhen në përputhje me Planin Vjetor për Përsosjen e Vazhdueshme Profesionale të ESHR-së për vitin 2023, i cili përbëhet nga trajnimet metodologjike në nivel bazë dhe të avancuar, trajnimet nga kontabiliteti dhe njoftimi financiar, trajnimet në fushën e TI-së, si dhe trajnimet e tjera.

Plani Vjetor për Përsosjen e Vazhdueshme Profesionale të ESHR-së për vitin 2023 ishte hartuar në bazë të analizës së nevojave për përsosjen profesionale të punonjësve.

Për zbatimin e Planit Vjetor për Përsosjen e Vazhdueshme Profesionale të ESHR-së, ishin hartuar materialet përkatëse për trajnim, janë zbatuar trajnimet dhe është bërë vlerësimi i tyre. Këto aktivitete sigurojnë punonjës me kualifikim të lartë, të cilët karakterizohen nga profesionalizmi,

2 dzr.mk/sites/default/files/2023-12/Godisen_plan_sprecuvanje_korupcija_DZR_2024.pdf

përgjegjësia dhe besueshmëria, paanshmëria, pavarësia, ndërgjegjja, etika dhe puna ekipore dhe në këtë mënyrë kontribuojnë drejtpërdrejt në cilësinë e punës së Entit Shtetëror të Revizionit.

## PROCESI I PËRSOSJES SË VAZHDUESHME PROFESIONALE




## RAPORTI VJETOR PËR REVIZIONET E KRYERA DHE PËR PUNËN E ESHR-SË PËR VITIN 2022

Raporti Vjetor për revizionet e kryera dhe për punën e ESHR-së për vitin 2022 ishte hartuar dhe dorëzuar në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut brenda afatit të përcaktuar me ligj deri në fund të qershorit 2023 dhe ai është i disponueshëm në faqen e internetit të ESHR-së në tri gjuhë: maqedonisht, shqip dhe anglisht (link: https://dzr.mk/sites/default/files/2023-06/DZR_Godisen_izvestaj_2022_mkd_0.pdf ).

Është vendosur praktikë për disponueshmërinë e informacioneve dhe të dhënave që përmban Raporti Vjetor për revizionet e kryera dhe për punën e ESHR-së për Institucionet Supreme të Revizionit, Gjykatën Evropiane të Revizionit, INTOSAI dhe EUROSAI, Delegacionin e Bashkimit Evropian në Republikën e Maqedonisë së Veriut, misionet e organizatave ndërkombëtare, si dhe përfaqësitë e caktuara diplomatike në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut në Seancën e 110-të të mbajtur më 27 nëntor 2023 e shqyrtoi dhe miratoi Raportin Vjetor për revizionet e kryera dhe punën e ESHR-së për vitin 2022 dhe miratoi 11 konkluzione naë drejtim të mbështetjes së aktiviteteve të ESHR-së, zbatimit të rekomandimeve, tejkalimit të dobësive dhe parregullsive sistematike të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore dhe forcimit të bashkëpunimit me Kuvendin.

## 1.3 DOKUMENTET METODOLOGJIKE DHE ZBATIMI I PRAKTIKAVE TË MIRA

Në vitin 2023, ESHR-ja miratoi akte metodologji-ke të përmirësuara për paraqitjen e rezultateve dhe rekomandimeve të revizorit në përputhje me standardet ndërkombëtare, të cilat i referohen strukturës dhe përmbajtjes së re të raporteve të revizorit të përmbajtura në formularët për:

- Draft/Raportin Përfundimtar për revizionin e kryer të raporteve financiare dhe revi-zionin e pajtueshmërisë për përdoruesit buxhetorë;
- Draft/Raportin Përfundimtar për revizionin e kryer të raporteve financiare dhe revi-zionin e pajtueshmërisë për ndërmarrjet publike;
- Draft/Raportin Përfundimtar për revizionin e kryer të pajtueshmërisë, dhe
- Draft/Raportin Përfundimtar për revizionin e kryer të suksesit.

Duke vepruar në përputhje me dispozitat e Ligjit për revizionin shtetëror dhe në lidhje me Memo-randumin e Bashkëpunimit dhe forcimin e komu-nikimit ndërinstitucional ndërmjet Entit Shtetëror të Revizionit dhe Prokurorisë Publike të Republikës së Maqedonisë së Veriut, si dhe në drejtimin e zbatimit të gjendjeve të konstatuara në kapitullin 32 - Kontrolli financiar nga Raporti për progresin e Republikës së Maqedonisë së Veriut në procesin e integrimit evropian për vitin 2023, në pjesën e forcimit të bashkëpunimit të institucioneve kun-dër korrupsionit në luftën kundër korrupsionit, përmirësimin e sistemeve të monitorimit dhe zh-villimin e mekanizmave për ndjekjen e numrit të rasteve që janë hetuar dhe procesuar dhe proce-durë në përputhje me ligjin, në bashkëpunim me Prokurorinë Publike të Republikës së Maqedonisë së Veriut, është hartuar dhe miratuar në dhjetor të vitit 2023 **Udhëzimi për njoftimin e gjendjeve të konstatuara gjatë kryerjes së revizionit shtetëror për të cilat ekziston dyshimi se subjekti që është lëndë e revizionit ka kryer vepër penale**, bashkë me formularin për shkresën në Prokurorinë Pub-like me bashkëngjitjen e ekzemplarit të Raportit Përfundimtar të Revizorit dhe formularin Njoftimi i gjendjeve të konstatuara në kryerjen e revizionit shtetëror për të cilat ekziston dyshimi se subjekti i revizionit ka kryer vepër penale, të cilat janë pjesë përbërëse e Udhëzimit.

### Certifikimi ISO

Nga trupi certifikues në gusht 2023 ishte kryer kontrolli i ricertifikimit, për të cilin ishte hartuar raporti i kontrollit në përputhje me të cilin sistemi i menaxhimit të Entit Shtetëror të Revizionit është plotësisht në përputhje me kërkesat e standardit MKS EN ISO 9001:2015, me ç'rast është vazhduar vlefshmëria e certifikatës që konfirmon se ESH-R-ja e zbaton Sistemin e Menaxhimit në përputhje me kërkesat e standardit ISO të vlefshme deri më 30.08.2024.

ESHR-ja i filloi aktivitetet për zbatimin e ISO 37001 - Standardi Ndërkombëtar për sistemin e vendo-sur kundër korrupsionit dhe ISO 27001 - Standardi Ndërkombëtar për sistemin e menaxhimit të sigu-risë së informacioneve. Certifikimi i këtyre stan-dardeve do të zbatohet kur të krijohen kushtet në vend, përkatësisht të ekzistojë trupi i akredituar që do të kryejë certifikimin.

# 2

# KOMUNIKIMI DHE BASHKËPUNIMI ME PALËT E INTERESUARA



## 2.1 KOMUNIKIMI DHE TRANSPARENCA NË PUNË

Transparenca dhe llogaridhënia në punën e Entit Shtetëror të Revizionit është me rëndësi thelbësore për sigurimin e besimit, menaxhimit të përgjegjshëm të financave publike dhe përgjegjësisë institucionale.

Kjo arrihet përmes publikimit të raporteve përfundimtare të revizorit, komunikimit të hapur dhe në kohë me mediat, organizatat qytetare dhe palët e tjera të interesuara, shkallës së lartë të informimit të qytetarëve dhe publikut të gjerë për rezultatet e punës së ESHR-së dhe prezencës aktive, si në rrjetet sociale, ashtu edhe në mediat përmes intervistave dhe emisioneve debatuese.

Angazhimet e vazhdueshme dhe aktivitetet e ndërmarra për ruajtjen e nivelit të lartë të transparencës dhe llogaridhënies së Entit Shtetëror të Revizionit kontribuan në përditësimin shtesë të mejling-listës së ESHR-së, e cila në fund të vitit 2023 përfshinte gjithsej 1215 palë të interesuara.

Gjatë vitit 2023, nëpërmjet pjesëmarrjes proaktive në intervista në mediat nacionale dhe deklaratave të menaxhmentit dhe udhëheqësisë së ESHR-së lidhur me gjendjet e konstatuara në raportet përfundimtare të revizorit, Enti Shtetëror i Revizionit e përmirësoi reputacionin e tij, duke u pozicionuar si një nga institucionet më të besueshme dhe më transparente në shtet.

Në fakt, janë vlerësuar shumë pozitivisht përpjekjet e Entit Shtetëror të Revizionit për përmirësimin e vazhdueshëm, mirëmbajtjen dhe futjen e formave të reja të komunikimit me qëllim të shkëmbimit të informacioneve me publikun e gjerë, mediat dhe organizatat qytetare, në monitorimin e tretë sistematik të Reformës së Administratës Publike 2021/2022, të bërë në rajon nga Instituti për Politika Evropiane (EPI).

Në Monitorin Nacional për Reformat në Administratën Publike 2021/2022, rezultatet më pozitive, sipas treguesve në fushën e Menaxhimit të Financave Publike, janë shënuar për llogaridhënien dhe transparencën e Entit Shtetëror të Revizionit përmes analizës së komunikimit dhe bashkëpunimit me publikun lidhur me punën e tij.

Vlerësimi më i lartë në raportin për punën, llogaridhënien, objektivitetin dhe profesionalizmin e Entit Shtetëror të Revizionit është elaboruar në detaje në fushën e Menaxhimit të Financave Publike - Parimi 16: Institucioni Suprem i Revizionit i zbaton standardet në mënyrën neutrale dhe objektive për sigurimin e revizioneve me cilësi të lartë që ndikojnë pozitivisht në funksionimin e sektorit publik - Treguesi VeBER PFM P16 I1: Enti Shtetëror i Revizionit komunikon dhe bashkëpunon me publikun në lidhje me punën e tij.

Enti Shtetëror i Revizionit, si partner i mediave dhe organizatave qytetare, përdor mjete të ndryshme të komunikimit me publikun, përpiqet që gjendjet e konstatuara në raportet e revizorit t'i prezantojë në mënyrë të lehtë dhe të kuptueshme përmes Abstrakteve dhe Njoftimeve për Mediat me qëllim që të njoftojë publikun për mënyrën e shfrytëzimit të mjeteve publike, njëherazi edhe për veprimin më aktiv të institucioneve kompetente, si dhe është vendosur kanali për parashtrimin e sugjerimeve ose iniciativave në ESHR nga palët e interesuara.

Rezultatet dhe aktivitetet e realizuara me sukses në pjesën e komunikimit me palët e interesuara dhe shkalla e lartë e transparencës së Entit Shtetëror të Revizionit janë paraqitur në grafikët e mëposhtëm:

## LISTA-MEJLING E ESHR-SË DHE KOMUNIKIMI ME PALË TË JASHTME TË INTERESUARA



## LISTA-MEJLING E ESHR-SË DHE KOMUNIKIMI ME 1,200 PALË TË JASHTME TË INTERESUARA

viti 2023

| | |
|---|---|
| Agjenci lajmesh | 11 |
| Gazetarë | 93 |
| Gazeta ditore | 7 |
| Javore | 3 |
| Radiodifuzione | 38 |
| Televizione | 51 |
| Operatorë kabllovikë | 25 |
| Portale të internetit | 96 |
| Organizata qytetare | 166 |
| Institucione | 14 |
| Komuna | 81 |
| Oda edhe asociacione | 12 |
| Ndërmarrje publike në nivel lokal | 122 |
| Ndërmarrje publike në nivel qendror | 34 |
| Institucione Shëndetësore Publike | 117 |
| Subjekte lëndë të revizionit | 256 |
| Universitete dhe fakultete | 74 |

**VITI 2022**
943 PALË TË INTERESUARA

**VITI 2021**
380 PALË TË INTERESUARA

**VITI 2020**
190 PALË TË INTERESUARA

| | 2022 | 2021 | 2020 |
|---|---|---|---|
| Agjenci lajmesh | 11 | 11 | 11 |
| Gazetarë | 92 | 91 | 62 |
| Gazeta ditore | 7 | 7 | 7 |
| Javore | 3 | 3 | 3 |
| Radiodifuzione | 38 | 38 | 38 |
| Televizione | 51 | 51 | 20 |
| Portale të internetit | 96 | 95 | 30 |
| Organizata qytetare | 51 | 50 | 50 |
| Institucione | 9 | 9 | 5 |
| Operatorë kabllovikë | 25 | | |
| Komuna | 81 | | |
| Oda edhe asociacione | 11 | | |
| Ndërmarrje publike në nivel lokal | 70 | | |
| Ndërmarrje publike në nivel qendror | 25 | | |
| Institucione Shëndetësore Publike | 117 | | |
| Subjekte lëndë të revizionit | 256 | | |

PËRMBAJTJET E VIZITUAR TË WWW.DZR.MK 2023



## PËRMBAJTJET E WWW.DZR.MK 2023




## ENTI SHTETËROR I REVIZIONIT DHE marrëdhëniet me MEDIUMET

01.01.2023 | 31.12.2023



# MEDIAT SOCIALE

Me qëllim të rritjes së transparencës dhe llogaridhënies së saj, duke ndjekur trendet botërore të rritjes së përdorimit të mediave sociale, ESHR-ja në mënyrë aktive vazhdoi të rrisë praninë e saj në to duke i përdorur si mjet promovimi të aktiviteteve dhe rezultateve të saj të arritura nga kryerja e revizionit shtetëror. Nëpërmjet tyre qytetarët dhe të gjithë palët e prekura / të interesuara kanë mundësinë të informohen për aktivitetet dhe rezultatet e arritura nga kryerja e revizionit shtetëror. Këto mjete të reja komunikimi të ESHR-së paraqesin hapësirë diskutimi dhe shkëmbimi të mendimeve kreative dhe konstruktive.

Në vitin 2022, ESHR-ja në faqen e vet në Facebook gjithsej ka realizuar 170 publikime / postime, ndërsa në përgjindje ditore janë evidentuar 2.232 vizita që në krahasim me vitin 2021 paraqet rritje për 427%.

ESHR-ja, në mënyrë aktive i përdor edhe faqet YouTube dhe LinkedIn si kanale për komunikim me palët e interesuara.

| | 31.12.2021 | 31.12.2022 | 31.12.2023 |
|---|---|---|---|
| Numri i përgjithshëm për 3 përmbajtjet me më shumë shikime të arritura | 8.000 | 62.869 | 76.697 |
| Numri i përgjithshëm i vizituesve | 22.808 | 705.301 | 542.585 |
| Profile të ndryshme të cilat kanë shikuar një përmbajtje | 8.982 | 104.908 | 114.465 |
| Numri i përgjithshëm për 10 përmbajtjet e fundit të publikuara | 8.363 | 25.021 | 56.281 |
| Ndjekës të faqes | 762 | 6.967 | 9.116 |

17.11.2021

ËSHTË HAPUR

## ANKETA PUBLIKE
SHKALLA E KËNAQËSISË

Enti Shtetëror i Revizionit (ESHR) rregullisht kryen anketë publike për të eksploruar mendimin e palëve të interesuara për punën e tij. Për të përmirësuar cilësinë dhe transparencën, ESHR-ja dërgoi pyetësor mbi kënaqësinë me bashkëpunimin për të gjitha palët e interesuara, duke përfshirë institucionet, mediat dhe organizatat qytetare. Anketat ishin shpërndarë në Facebook dhe në faqen e internetit të ESHR-së.

Rezultatet treguan se 93% e të anketuarve janë të kënaqur me bashkëpunimin me ESHR-në, veçanërisht për shkak të informimit në kohë mbi raportet e revizorit dhe rritjes së transparencës ndaj mediave dhe organizatave qytetare. Të anketuarit e vlerësojnë punën e ESHR-së si të paanshme, të pavarur, ligjore, objektive, transparente dhe profesionale. Gjithashtu, ka kënaqësi të lartë me cilësinë e raporteve të revizorit, të cilat vlerësohen si aktuale, të kuptueshme, të sakta dhe objektive.

| STRUKTURA E PËRGJIGJEVE TË MARRA | |
|---|---|
| Përfaqësuesi i institucionit të sektorit public | 41% |
| Përfaqësuesi i sektorit privat | 2% |
| Organizatat qytetare | 25% |
| Media | 28% |
| Personi fizik | 5% |

| Raportet përfundimtare të revizorit të ESHR-së: | |
|---|---|
| Aktuale | 95% |
| Të kuptueshme | 94% |
| Të sakta | 95% |
| Objektive | 95% |

## SHKËMBIMI I NJOHURIVE

Me qëllim shkëmbimin e njohurive dhe mësimeve të përvetësuar nga revizionet e kryera, përfaqësuesit nga ESHR-ja morën pjesë aktive në konferenca të shumta, panel diskutime, debate, tryeza të rrumbullakëta, të organizuara nga institucionet përkatëse/ palët e interesuar në fushën e lëndës së diskutimit.

ESHR ka krijuar një praktikë, raportet përfundimtare të revizionit nga revizionet e kryera të cilat publikohen në faqen e internetit të ESHR-së, në baza të rregullt t'i dorëzohen një grupi subjektesh, si palë të interesuara në varësi të fushës së lëndës së revizionit (NJVL, ISHP, NP në nivel qendror dhe local dhe SHA në pronësi shtetërore, etj.), me qëllim gjendjet e përcaktuara në përfshira në raportet përfundimtare të revizionit, për të shkëmbyer njohuri dhe informacion, dhe parregullsitë/ kushtet e konstatuara të mos përsëriten dhe në funksionimin e tyre.

Në drejtim të shkëmbimit të njohurive dhe forcimit të bashkëpunimit me shoqatat profesionale, institucionet dhe organizatat civile për tema në fushën e revizionit, me ftesë të ESHR-së, në pjesë të trajnimeve/punëtorive të organizuara morën pjesë edhe punonjës nga NJVL-së, Prokuroria Publike, Shërbimi i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, revizorë të brendshëm nga SHA dhe NP, punonjës të Institucioneve Supreme të Revizionit në rajon, përfaqësues nga media dhe organizata të shoqërisë civile. Në këto trajnime përfaqësuesit patën mundësinë të njihen me metodologjinë e kryerjes së revizionit, mënyrën e zbatimit të Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit, zbatimin e standardeve të revizionit të INTOSAI-t, të kuptuarit e raporteve të revizionit, gabimet më të shpeshta të gjetura në kryerjen e revizioneve, por edhe të shkëmbehen përvoja dhe praktika të mira në drejtim të përmirësimit të punës dhe bashkëpunimit të ndërsjellë.

| Kënaqësia e bashkëpunimit me ESHR-në | |
|---|---|
| Institucionet e sektorit publik | 95% |
| Sektori privat | 80% |
| Organizatat qytetare | 98% |
| Mediat | 99% |
| Personat fizikë | 92% |

| ESHR-ja përmes punës së saj siguron: | |
|---|---|
| Paanshmëri | 95% |
| Pavarësi | 94% |
| Ligjshmëri | 96% |
| Objektivitet | 94% |
| Transparencë | 95% |
| Profesionalizëm | 96% |

## 2.2 BASHKËPUNIMI ME KUVENDIN, ORGANET SHTETËRORE, ASOCIACIONET DHE INSTITUCI NET PROFESIONALE, ORGANIZATAT QYTETARE DHE PUBLIKUN E GJERË

Bashkëpunimi i ESHR-së vazhdoi edhe në vitin 2023 me asociacionet dhe institucionet e shumta profesionale vendase që kanë kontribut të madh në realizimin e qëllimeve strategjike. ESHR-ja njihet nga këto organizata si institucion me përgjegjësi shoqërore dhe me ndikim që ofron të dhëna, informacione dhe shpjegime në kohë dhe aktuale për gjendjet dhe rekomandimet që i jep përmes procesit të revizionit.

Nëpërmjet bashkëpunimit me asociacionet profesionale, institucionet e arsimit të lartë, qendrat kërkimore shkencore dhe organizatat e tjera nga sektori civil, puna e ESHR-së u bë e disponueshme për qytetarët, u mundësoi t'i analizojnë faktorët dhe t'i vlerësojnë performancat e administratës publike dhe të rritet ndërgjegjësimi te qytetarët e mjedisit mikro dhe makro në fushën e menaxhimit të financave publike dhe mbikëqyrjes së shpenzimit të mjeteve publike.

Për këtë qëllim, në vitin 2023, ESHR-ja i ruajti format ekzistuese të bashkëpunimit dhe vazhdoi me procesin e zgjerimit, përkatësisht lidhjen e formave të reja të bashkëpunimit me institucionet shtetërore dhe organizatat profesionale dhe të tjera të sektorit civil, në përputhje me memorandumet e bashkëpunimit:



### Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut

Enti Shtetëror i Revizionit e njofton në kohë dhe në mënyrë objektive Kuvendin për punën e tij, për gjetjet e revizorit nga revizionet e kryera, i ofron mbështetje Kuvendit në përmbushjen e një pjese të kompetencave të tij duke konstatuar dhe paraqitur parregullsi, mosrespektim të rregullave ligjore, veprimin e paligjshëm me mjetet publike dhe rastet e mundshme të korrupsionit dhe keqpërdorimit të detyrës zyrtare, prandaj komunikimi me Kuvendin konsiderohet veçanërisht i rëndësishëm.

Bashkëpunimi ndërmjet ESHR-së dhe Kuvendit zhvillohet në mënyrë të vazhdueshme me më shumë drejtime dhe në përputhje me Ligjin për revizionin shtetëror dhe Memorandumin e Bashkëpunimit ndërmjet Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Entit Shtetëror të Revizionit të nënshkruar më 21 tetor 2022.

Në përputhje me Memorandumin e Bashkëpunimit të nënshkruar, në gjysmën e parë të vitit 2023, ishin hartuar dhe dorëzuar në Kuvend dy raporte përmbledhëse, të cilat paraqesin përmbledhjen e gjetjeve kryesore të revizioneve të veçanta të kryera në përputhje me Programin Vjetor të Punës së ESHR-së për vitin 2022.

Me mbështetjen e Institutit Demokratik Nacional (NDI) dhe në drejtim të bashkëpunimit më të madh ndërmjet institucioneve dhe mbikëqyrjes së shpenzimit publik, gjatë vitit 2023 janë mbajtur takime ndërmjet ESHR-së dhe Kuvendit, duke përfshirë edhe Komisionin për Financim dhe Buxhet, Zyrën Buxhetore të Kuvendit dhe Institutin Parlamentar.

Në tetor të vitit 2023, për herë të parë në Kuvend, u shqyrtua raporti përfundimtar i revizorit për

revizionin e raporteve financiare dhe revizionin e pajtueshmërisë së ISHP Klinikës Universitare për Radioterapi dhe Onkologji Shkup për vitin 2021, në Komisionin për Financim dhe Buxhet, si trup punues amë në Kuvend. Pas diskutimit disaditor, Komisioni për Financim dhe Buxhet miratoi konkluzione me të cilat jepen udhëzime për veprimet e institucioneve kompetente. Ky aktivitet ishte realizuar si rezultat i Memorandumit të Bashkëpunimit të nënshkruar ndërmjet ESHR-së dhe Kuvendit, i cili parashikon shqyrtimin e raporteve të veçanta përfundimtare të revizorit të ESHR-së.

Më 14 mars 2023, në Seancën e 79-të Plenare të Kuvendit, kryerevizori shtetëror e prezantoi Raportin Vjetor për revizionet e kryera dhe për punën e ESHR-së për vitin 2021, ndërsa në Seancën e 120-të Plenare të Kuvendit të mbajtur më 15.11.2023, kryerevizori shtetëror e prezantoi Raportin Vjetor për revizionet e kryera dhe për punën e ESHR-së për vitin 2022. Në prezantimin e tij para deputetëve, kryerevizori shtetëror theksoi se ESHR-ja gjatë zgjedhjes dhe përcaktimit të fushëveprimit të revizioneve udhëhiqet nga qëllimet dhe parimet strategjike të shpenzimit transparent dhe me dedikim të mjeteve për përmirësimin e cilësisë së shërbimeve të denja për qytetarët e shtetit.

Programi Vjetor i Punës së Entit Shtetëror të Revizionit për vitin 2024 është hartuar dhe dorëzuar në Kuvend në dhjetor 2023, për shkak të informimit.

Kryerevizori shtetëror bashkë me kryerevizorin e Zyrës Nacionale të Revizionit të Republikës së Kosovës në korrik 2023 dhe me kryetarin e institucionit të revizionit të Republikës së Sllovakisë bashkë me ambasadorin e Republikës së Sllovakisë në vend, në nëntor 2023, realizuan takim pune me Kryetarin e Kuvendit, ku u diskutua për bashkëpunimin e suksesshëm ndërmjet institucioneve supreme të revizionit, si dhe për thellimin e bashkëpunimit ndërmjet ESHR-së dhe Kuvendit.

## Prokuroria Publike e Republikës së Maqedonisë së Veriut

Një hap i rëndësishëm në forcimin e bashkëpunimit me Prokurorinë Publike është nënshkrimi i Memorandumit të Bashkëpunimit në vitin 2022, i cili rregullon mënyrën e komunikimit, konsultimit dhe dorëzimit të raporteve përfundimtare të revizorit në Prokurorinë Publike, për veprimin e tyre të mëtejshëm, shkëmbimin e të dhënave dhe informacioneve me qëllim të veprimit më efikas pas parregullsive të konstatuara.

Në vitin 2023, përmes punëtorive të realizuara në të cilat bashkërisht revizorët shtetërorë dhe prokurorët publikë i ndanë përvojat e tyre nga praktika dhe i forcuan njohuritë dhe aftësitë e tyre për kuptimin e parregullsive në revizionet dhe trajtimin e tyre në procedurën e ndjekjes penale, dhe në të njëjtën kohë prokurorët publikë u njohën me metodologjinë dhe qasjen e punës së ESHR-së në hartimin dhe përmbajtjen e raporteve përfundimtare të revizorit, ndërsa revizorët shtetërorë u njohën me procedurën e prokurorisë publike. Këto punëtori organizohen me mbështetjen e WFD. Gjithashtu, janë mbajtur më shumë takime pune ndërmjet prokurorëve publikë dhe revizorëve shtetërorë, në drejtim të ofrimit të më shumë informacioneve rreth parregullsive të konstatuara të përmbajtura në raportet e dorëzuara të revizorit.

Në dhjetor 2023, të dy institucionet i miratuan udhëzimet e brendshme të detyrueshme për veprimin e mëtejshëm të raporteve të revizorit, të cilat duhet të kontribuojnë për komunikim dhe bashkëpunim më efikas ndërmjet ESHR-së dhe PPRM-së.

## Drejtoria e Policisë Financiare

Me Memorandumin e Bashkëpunimit ndërmjet Entit Shtetëror të Revizionit dhe Drejtorisë së Policisë Financiare, të nënshkruar në vitin 2023, u sigurua thellimi i bashkëpunimit ndërinstitucional, dhe në drejtim të përmirësimit të cilësisë së komunikimit të ndërsjellë për të garantuar veprimin në kohë, të përshtatshëm dhe efikas sipas gjendjeve të konstatuara në raportet përfundimtare për revizionet e kryera në procesin pas revizionit.

ИНСТИТУТ ЗА ТРАНСФУЗИОНА МЕДИЦИНА НА РЕПУБЛИКА МАКЕДОНИЈА

## ISHP Instituti i Mjekësisë Transfuzive

Në vitin 2023, personat përgjegjës të ESHR-së dhe ISHP-së, Institutit të Mjekësisë Transfuzive, duke nënshkruar Memorandumin e Bashkëpunimit, u angazhuan për thellimin e komunikimit dhe bashkëpunimit në fushën e transfuziologjisë dhe dhurimit të gjakut, pjesëmarrjen e përbashkët në projekte dhe programe me interes të ndërsjellë, si dhe organizimin e evenimenteve edukative me interes të ndërsjellë për punonjësit e ISHP Institutit të Mjekësisë Transfuzive dhe revizorët shtetërorë të përfshirë në revizion në fushën e shëndetësisë dhe mbrojtjes shëndetësore. Në ambientet e Entit Shtetëror të Revizionit organizohen në vazhdimësi aksionet e dhurimit të gjakut, dhe me këtë ESHR-ja jep kontributin e vet në sistemin shëndetësor si institucion me përgjegjësi shoqërore dhe i promovon vlerat e shëndetit më të mirë global, duke shpëtuar jetë dhe duke përmirësuar shëndetin e të tjerëve.

Center for Civil Communications
Центар за граѓански комуникации

## Qendra për Komunikime Civile

Enti Shtetëror i Revizionit, në realizimin e revizioneve, i ndjek në vazhdimësi procedurat e zbatimit të prokurimeve publike pranë subjekteve që janë lëndë e revizionit dhe sugjeron në lëshimet dhe dobësitë e konstatuara në fazat e planifikimit, zbatimit dhe ekzekutimit të procedurave për prokurimet publike. Në vitin 2023, Enti Shtetëror i Revizionit e vazhdoi bashkëpunimin me Qendrën për Komunikime Civile, në fushën e prokurimeve publike, si dhe në kuadër të debatit me temë "Efektet e krizës financiare dhe energjetike mbi politikat dhe qytetarët", në të cilin revizorët shtetërorë i ndanë përvojat e tyre.

## Instituti për Demokraci "Societas Civilis" - Shkup (IDSCSH)

Instituti për Demokraci «Societas Civilis» organizoi një sërë punëtorish në të cilat morën pjesë edhe përfaqësuesit e ESHR-së. Nëpërmjet shkëmbimit të njohurive dhe informacioneve nga punëtoritë e mbajtura, u bë i mundur hartimi i analizës Forsajt mbi sfidat e ardhshme në luftën kundër korrupsionit. Në evenimentin e organizuar në shkurt 2023, u prezantua analiza e Forsajtit mbi skenarët e mundshëm në të cilët korrupsioni dhe lufta kundër korrupsionit do të zhvillohet deri në vitin 2030 në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe se si institucionet e sektorit publik mund të përballen me sfidat e ardhshme.

## Transparensi Interneshënall

Enti Shtetëror i Revizionit mori pjesë edhe në hulumtimin për «Sistemin Nacional të Integritetit, i cili u zbatua në kuadër të «BE-ja për sundimin e së drejtës: Angazhimi Civil për Integritetin Publik (CEPI) në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi», i mbështetur financiarisht nga Bashkimi Evropian. Përmes analizës dhe vlerësimit të 15 shtyllave të integritetit, sipas Metodologjisë së përgatitur nga Sekretariati i Transparensi Interneshënall, iu dha përgjigjja për efektivitetin e përpjekjeve nacionale për përballimin e korrupsionit.
Në organizimin e Transparensi Interneshënall - Maqedoni, në evenimentin e organizuar më 14 janar 2024, u prezantuan rezultatet e Sistemit Nacional të Integritetit për Republikën e Maqedonisë së Veriut, në të cilin u theksua:

«Enti Shtetëror i Revizionit shquhet si institucion me vlerësimin më të lartë të përgjithshëm të realizuar prej 87,6 pikë, nga të cilat 92 pikë në pjesën e menaxhimit dhe 87,5 pikë për rolin në luftën kundër korrupsionit. Institucioni ka politika të forta të integritetit të cilat jo vetëm që janë të shkruara, por edhe të zbatuara plotësisht. Puna e tyre gjithashtu prezantohet mirë për publikun dhe është institucioni më transparent që ofron informacione në kohë dhe cilësore për palët e interesuara relevante dhe publikun".

## SISTEM PËR INTEGRITET NACIONAL – MAQEDONISË SË VERIUT
## REZULTATET NGA SHTYLLAT E SISTEMIT NACIONAL TË INTEGRITETIT



ESHR-ja është pjesë e grupit këshillëdhënës të projektit «Ndjekja e integritetit në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi: Organizatat qytetare në luftën kundër korrupsionit me të dhënat për integritetin politik», i cili do të zbatohet në periudhën mars 2023 - shkurt 2026.

## Publiku i gjerë

ESHR-ja është institucion i pavarur që u mundëson qytetarëve të ndjekin se si shpenzohen paratë publike, duke i informuar për punën e institucioneve publike dhe për masat që duhet të ndërmerren për të siguruar menaxhim të përgjegjshëm dhe transparent të mjeteve publike. Në këtë drejtim, në përputhje me Ligjin për qasje të lirë te informacionet me karakter publik, gjatë vitit 2023 janë marrë 11 kërkesa për informacionet me karakter publik dhe atyre iu është përgjigjur pozitivisht brenda afatit të përcaktuar me ligj. Në të njëjtën kohë, ESHR-ja, në përputhje me Planin Nacional të Veprimit për Partneritet të Hapur Qeveritar dhe angazhimin për «Publikimin proaktiv të informacioneve me karakter publik në faqet e internetit të institucioneve», në kohë i publikoi në faqen e vet të internetit të gjitha dokumentet që janë lëndë e interesit për publikun e gjerë.



## 2.3 BASHKËPUNIMI ME ORGANET KOMPETENTE PËR REVIZIONET DHE EFEKTET E TYRE

Për të arritur qëllimin kryesor të revizionit - kujdesin për mjetet publike dhe avancimin e menaxhimit të tyre, zbulimin në kohë të devijimeve nga standardet e pranuara dhe shkeljet e parimeve të ligjshmërisë, efikasitetit, efektivitetit dhe ekonomizimit në menaxhimin e mjeteve publike, ESHR-ja jep rekomandime të qarta dhe efektive, me qëllim që të ndërmerr hapa që do të parandalojnë ose përkeqësojnë devijimet dhe shkeljet në të ardhmen. Masat korrigjuese për zbatimin e rekomandimeve i mundësojnë udhëheqësisë së subjektit që është lëndë e revizionit të përmirësojë efektivitetin, efikasitetin dhe ekonomizimin në punë.

Në vitin 2023, Enti Shtetëror i Revizionit, nëpërmjet informacioneve të qarta, reale, objektive dhe në kohë për parregullsitë e konstatuara, mosrespektimin e rregullave ligjore, veprimin e paligjshëm me mjetet publike dhe rastet e mundshme të korrupsionit dhe keqpërdorimit të detyrës zyrtare, ka kontribuar në përmbushjen e një pjese të kompetencave të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

ESHR-ja i kushton vëmendjen e duhur përpunimit dhe analizës së informacioneve të nxjerra nga Raportet Përfundimtare të Revizorit të revizorëve të autorizuar shtetërorë. Këto të dhëna në bazë të rregullt i përpunon me aplikacion softuerik që është i integruar, autonom dhe funksional për përpunimin dhe analizimin e të dhënave nga Raportet Përfundimtare të Revizorit. Në këtë mënyrë, ofrohen informacione të besueshme, të përditësuara, në kohë dhe relevante për nevojat e ESHR-së, organeve kompetente dhe palëve të tjera të interesuara.

Me dorëzimin e rregullt të raporteve përfundimtare të revizorit në Kuvend dhe organet kompetente, ESHR-ja e tërheq vëmendjen për dobësitë e konstatuara në punën e subjekteve të revidiuara.

Vazhdimisht i evidentojmë, ndjekim dhe analizojmë informacionet e marra kthyese nga Prokuroria Publike e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, Ministria e Financave, MF - Drejtoria e Policisë Financiare, Ministria e Punëve të Brendshme dhe Zëvendëskryetari i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, i ngarkuar për politikat për qeverisje të mirë, për të vepruar sipas raporteve përfundimtare të revizorit që u dorëzohen atyre.

Efekti i gjendjeve të konstatuara që tregojnë për parregullsi dhe paligjshmëri në punën e subjekteve në menaxhimin më të mirë të mjeteve publike mund të pritet vetëm nëse institucionet kompetente i ndërmarrin masat e nevojshme për tejkalimin e tyre.

Ndjekja dhe informimi për aktivitetet e ndërmarra nga institucionet kompetente për tejkalimin e parregullsive dhe paligjshmërive të konstatuara në punën e subjekteve është një nga qëllimet strategjike të ESHR-së.

Aktivitetet e ESHR-së lidhur me parandalimin e korrupsionit zhvillohen në përputhje me autorizimet dhe detyrimet e përcaktuara me Ligjin për revizionin shtetëror, Ligjin për Prokurorinë Publike, Ligjin për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave, memorandumet e lidhura të bashkëpunimit, si dhe rregullativën tjetër ligjore relevante.

Në kuadër të zbatimit të Programit Vjetor të Punës së ESHR-së për vitin 2023, raportet e revizorit janë dorëzuar në institucionet kompetente si në vijim:

- Prokurorinë Publike të Republikës së Maqedonisë së Veriut janë dorëzuar 18 raporte të revizorit për 14 subjekte të reviduara (revizione);
- Drejtorinë e të Ardhurave Publike është dorëzuar 1 raport i revizorit për 1 subjekt të reviduar (revizion);
- Komisionin Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit janë dorëzuar 18 raporte të revizorit për pjesëmarrësit në fushatën zgjedhore sipas detyrës zyrtare në përputhje me ndryshimet në nenin 85-b të Kodit Zgjedhor ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut", nr. 42/20);
- Zëvendëskryetari i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, i ngarkuar për politikat për qeverisje të mirë, janë dorëzuar 10 raporte të revizorit për 8 subjekte të reviduara (revizione).

**DORËZIMI I RAPORTEVE TË REVIZORIT TEK ORGANET KOMPETENTE**

në përputhje me Programin Vjetor të Punës së ESHR-së për vitin 2023




- Prokuroria Publike
- Drejtorinë e të Ardhurave Publike
- Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, neni 85-b Kodi Zgjedhor
- Zëvendëskryetari i Qeverisë së RMV-së, i ngarkuar për politikat për qeverisje të mirë

Në maj të vitit 2024, ESHR-ja dorëzoi kërkesë tek organet kompetente për dhënien e informacioneve kthyese për aktivitetet e ndërmarra pas raporteve përfundimtare të revizorit të dorëzuara në 3 vitet e fundit. Deri në ditën e njoftimit janë dhënë informacione kthyese nga Prokuroria Publike e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Enti Shtetëror i Revizionit bashkëpunon në mënyrë aktive me të gjitha organet shtetërore në drejtim të parandalimit dhe reduktimit të korrupsionit, në kuadër të Protokollit të Bashkëpunimit për Parandalimin dhe Represionin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesave.

Enti Shtetëror i Revizionit merr pjesë në zbatimin e Programit Nacional për miratimin e së drejtës së Bashkimit Evropian (NPAA) nëpërmjet aktiviteteve të parashikuara në Kapitullin 3.23. Gjyqësori dhe të drejtat fondamentale, Fushën - Politika kundër korrupsionit dhe Kapitullin 3.32 Kontrolli financiar, Fushën - Revizioni i jashtëm, si dhe në punën e organeve dhe trupave të tjerë për parandalimin e korrupsionit.



# 3

# KAPACITETET ADMINISTRATIVE



## 3.1 STRUKTURA ORGANIZATIVE DHE RESURSET NJERËZORE

Enti Shtetëror i Revizionit, në funksion të kryerjes së kompetencave dhe detyrave të tij, vazhdimisht i kushton vëmendje ndërtimit të sistemit modern, efikas dhe funksional të menaxhimit të resurseve njerëzore, i cili lidhet drejtpërdrejt me efikasitetin dhe efektivitetin organizativ dhe siguron zhvillimin e vazhdueshëm të tyre nëpërmjet:

- Përmirësimit permanent të kushteve të punës
- Specializimit të njësive të brendshme organizative
- Sistemimit të punonjësve në vendet e punës sipas kualifikimeve të tyre profesionale, përvojës së punës dhe aftësive të fituara
- Progresit të vazhdueshëm në karrierën e punonjësve përmes avancimit
- Shpërblimit përkatës për rezultatet e arritura adekuate
- Sigurimit të kuadrove të reja të kualifikuara në revizionin shtetëror

STRUKTURA E RREGULLT UDHËHEQËSE E EKIPIT TË REVIZORËVE

| 15 GRA | 7 BURRA | 22 |
|---|---|---|

STRUKTURA E RREGULLT E REVIZORËVE SHTETËROR/ NËPUNËSIT ADMNISTRATIVË/ PERSONAT NDIHMËSE - TEKNIKE

| | | |
|---|---|---|
| 39 | revizorë shtetëror | 67 |
| / | nëpunës administrativë | 6 |
| 2 | personat ndihmës teknikë | 1 |

# BURIMET NJERËZORE:

# 120

PUNONJËS NË ESHR

**76** punonjës janë gra

**44** punonjës janë burra




STRUKTURA UDHËHEQËSE NË ESHR




Të emëruar

Sekretari i Përgjithshëm

Këshilltarë të KRSH
4 punonjësit

Ndihmës të KRSH
10 punonjësit

## 3.2 RRITJA E NJOHURIVE DHE AFTËSIVE TË REVIZORËVE SHTETËRORË

Enti Shtetëror i Revizionit ndërmerr në vazhdimësi aktivitete për forcimin e njohurive dhe aftësive të resurseve njerëzore për të krijuar nivel të lartë profesional të punës dhe atmosferë të përshtatshme për mësim, përparim dhe zhvillim të të gjithë punonjësve.

Në përputhje me kërkesat e INTOSAI-t dhe ISSAI-t, gjatë hartimit të Planit Vjetor për Përsosjen e Vazhdueshme Profesionale për vitin 2023, vëmendje iu kushtua temave që lidhen me sfidat profesionale aktuale në kryerjen e revizioneve, të cilat janë pjesë e Programit Vjetor të Punës së ESHR-së për vitin 2023, por edhe temave për të cilat është shfaqur interes në përputhje me hulumtimin e kryer.

Plani Vjetor për PVP-në për vitin 2023 i ESHR-së është zbatuar duke përdorur resurse të brendshme, por edhe duke përdorur ekspertë vendas dhe ndërkombëtarë në fushën përkatëse. Në vitin 2023, punonjësit realizuan 13.168 orë trajnim ose mesatarisht 110 orë për punonjës. Me qëllim të marrjes së informacioneve kthyese mbi cilësinë e edukimeve të mbajtura, ESHR-ja kryen rregullisht vlerësime. Rezultatet treguan se më shumë se 80% e punonjësve u shprehën të kënaqur me trajnimet e organizuara dhe se ata kontribuojnë në përmirësimin e punës së tyre.

Gjatë vitit 2023 janë zbatuar trajnime të posaçme të dizajnuara për revizorët shtetërorë të sapopunësuar, me qëllim të përshtatjes së tyre më të lehtë profesionale në mjedisin e ri të punës.

Qasja serioze e Entit Shtetëror të Revizionit si institucion që investon vazhdimisht në avancimin dhe forcimin e kapaciteteve të punonjësve të tij, si dhe bashkëpunimi i suksesshëm me organizatat ndërkombëtare Instituti i Autorizuar për Financat Publike dhe Kontabilitetin (CIPFA) dhe Fondacioni Ndërkombëtar për Sistemet Zgjedhore (IFES) dhe USAID, mundësoi nga gjithsej 126 punonjës në sektorin publik që kanë fituar Certifikatën Ndërkombëtare për Menaxhimin e Rreziqeve nga Korrupsioni, 101 punonjës janë nga radhët e ESHR-së dhe njëkohësisht 17 revizorë të autorizuar shtetërorë e përfunduan trajnimin me sukses për trajnues për zbatimin e Programit për Parandalimin e Korrupsionit. Këto rezultate të arritura e bëjnë ESHR-në pionier dhe institucion me vizion, jo vetëm në rajon, por edhe më gjerë, në fushën e zbatimit, menaxhimit dhe ndjekjes së rreziqeve nga korrupsioni dhe planeve të integritetit në nivel shtetëror, në të gjitha subjektet e sektorit publik.

Programi për Parandalimin e Korrupsionit u hartua dhe u përgatit si program ambicioz nga Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin (UNODC) dhe Instituti i Autorizuar për Financat Publike dhe Kontabilitetin - CIPFA.

Forcimi i njohurive dhe aftësive të punonjësve të ESHR-së kryhet edhe nëpërmjet zbatimit të revizioneve paralele dhe kooperative në bashkëpunim me ISR-të e tjera, vizitave studimore të kryera, pjesëmarrjes në seminare, punëtori dhe konferenca brenda grupeve të punës së INTOSAI, EUROSAI, si dhe në bashkëpunim me organizatat ndërkombëtare; Banka Botërore, UNWomen, UNDP, NDI, Fondacioni për Demokraci Vestminster, Fondacioni Ndërkombëtar për Sistemet Zgjedhore, dhe të tjera.

**Plani Vjetor për Përsosjen e Vazhdueshme Profesionale për vitin 2023 është zbatuar në tërësi dhe janë zbatuar trajnime në fushat e mëposhtme:**

| |
|---|
| Revizioni, trajnimet metodologjike – niveli bazë dhe niveli i avancuar |
| Revizioni i TI-së |
| Kontabiliteti dhe njoftimi financiar |
| Zbatimi praktik i standardeve të revizorit të ISR (INTOSAI) |
| Parandalimi i mashtrimit, korrupsionit dhe integritetit |
| Teknologjia informatike |
| Analiza e të dhënave |
| Zhvillimi i aftësive të buta dhe zhvillimi personal |
| Rregullativa ligjore |
| Mbrojtja dhe sigurimi i qasjes në informacionet me karakter publik |
| Prokurimet publike |
| Tatimet dhe kontributet |
| Revizioni i njësive të vetëqeverisjes lokale |
| Planifikimi strategjik dhe vjetor |
| Lloje të tjera të trajnimeve |

ESHR-ja ndërmerr aktivitete edhe për edukimin e punonjësve në fusha të tjera që janë të domosdoshme për kryerjen e kompetencave të ESHR-së në bashkëpunim me organizatat vendase dhe ndërkombëtare duke ndjekur programe të specializuara për edukim dhe trajnim:

- **101** Certifikatë Ndërkombëtare për Menaxhimin e Rrezikut nga Korrupsioni
- **17** Trajnues të certifikuar për Certifikatën Ndërkombëtare të Menaxhimit të Rrezikut nga Korrupsioni
- **3** Akademia e Dizajnit Grafik
- **1** Studime të magjistraturës për antikorrupsion
- **7** Akademia për Data Science
- **2** Pionerë për shfrytëzimin e progresit teknologjik (LOTA Pioneers)
- **8** Revizioni i suksesit

## 3.3 RESURSET E TI-së

Zhvillimi i teknologjisë informatike ndikon në të gjitha sferat e shoqërisë, si në revizionin e Entit Shtetëror të Revizionit e ndjek vazhdimisht zhvillimin e teknologjisë informatike edhe në bazë të analizave aktuale dhe përvojave të mëparshme dhe rregullisht investon në përmirësimin e teknologjisë informatike, me qëllim të kryerjes pa probleme të revizionit.

### Firewall dhe VPN

Në vitin 2023, Enti Shtetëror i Revizionit i realizoi prokurimet e domosdoshme të planifikuara në pjesën e sigurisë së TIK-së dhe TIK-së, me ç'rast u zbatua me sukses prokurimi i zgjidhjes moderne firewall, e cila ofron mbrojtje të rrjetit të komunikimit, të dhënave dhe serviseve, në lokacion rezervë.

Përveç kësaj, për zgjidhjen firewall në lokacionin primar, u zbatuan përmirësimet në pjesën e lidhjes VPN, që përfshijnë nivel shtesë të identifikimit të përdoruesit.

### Pajisje dhe Aplikacione

Si risi në punën sistematike, gjithçka filloi me zbatimin e zgjidhjes për administrimin e centralizuar të resurseve të TI-së. Gjithashtu, janë realizuar prokurimet për nevojat e revizionit, si për shembull prokurimi i laptopëve dhe desktopëve, si dhe laptopëve me performanca të avancuar të biznesit të dedikuara për Departamentin e analizës së të dhënave dhe kërkimin, zhvillimin dhe aplikimin e zgjidhjeve inovative të TI-së në revizionet - Laboratorët Inovativë, si dhe dronët për dokumentimin e dëshmive të revizorit.

Në pjesën e infrastrukturës së TI-së u ndërrua sistemi i ftohjes në sallën e serverit, pajisjet UPS për të mbështetur infrastrukturën e rrjetit nëpër kate, si dhe instalimi i konzolës së re KVM për qasje dhe menaxhim në largësi të pajisjeve të serverit.

### Office 365

Për lehtësimin dhe unifikimin e resurseve për punonjësit, filloi aplikimi i veglave Office 365, i cili do të zbatohet në tri faza (2023-2025) dhe si rezultat përfundimtar do të japë sistem modern dhe të mbrojtur të mesazheve elektronike dhe mbrojtje cloud të një pjese të të dhënave që përdoren në punë

### Trajnimet e TI-së

Për punonjësit e rinj ofrohet trajnimi në pjesën e njohjes me sistemin e informacioneve, përdorimin e duhur të resurseve të TI-së, përdorimin e veglave softuerike, aplikacioneve dhe Sistemit të Menaxhimit të Procesit të Revizorit (AMS) që përdoren në mënyrë aktive në procesin e revizionit, si dhe njohjes me politikat dhe procedurat e TI-së – bazë për përdorim të suksesshëm, të drejtë dhe të sigurt të mjeteve të të dhënave. Është realizuar prokurimi i licencës për pakot softuerike për dizajnin grafik, si dhe trajnimi adekuat shumëmujor për 3 punonjës.

## Video konferencat

Praktika e përdorimit të platformës profesionale përkatëse për mbajtjen e video-konferencave dhe takimeve me palët e brendshme dhe të jashtme vazhdoi edhe këtë vit. Përveç kësaj, u krye prokurimi i pajisjeve për video-konferenca, të përbërë nga pajisjet për përdorim në sallë konferencash, si dhe pako shtesë të lëvizshme për video-takime - për përdorim në salla më të vogla.

## CAATs

Zhvillimi i teknologjisë informatike dhe përdorimi i saj nga subjektet që janë lëndë e revizionit ka kontribuar që në procesin e revizionit të përdoren teknikat e ndihmuara kompjuterike të revizorit të njohura si CAAT's. CAAT's janë vegla të bazuara në kompjuter, me ndihmën e të cilave revizori kryen një sërë testesh të automatizuara për vlerësimin e sistemit të informacionit të subjektit ose të të dhënave elektronike. CAAT's ofrojnë nivel më të lartë të sigurisë dhe sigurimin e dëshmive të mjaftueshme dhe të përshtatshme të revizorit. ESHR-ja në revizion e përdor softuerin IDEA për të analizuar të dhënat nga të cilat gjenerohen raportet financiare dhe për të përzgjedhur mostrën për nevojat e procesit të revizionit. Në vitin 2023 u prokuruan laptopë me performanca të avancuara në pjesën e analizës së të dhënave, me qëllim të lehtësimit të përdorimit të softuerit IDEA.

## Politikat dhe procedurat e TI-së

Sigurohet funksionimi i vazhdueshëm i infrastrukturës së sistemit të informacioneve dhe aplikacioneve, duke u kujdesur për parimet dhe rregullat për: disponueshmërinë e të dhënave për përdoruesin e autorizuar, konfidencialitetin, integritetin, ruajtjen e sigurt të të dhënave në lokacion qendror, harmonizimin e ligjeve, bërjen e rregullt të kopjes rezervë (backup), mbrojtjen nga qasja fizike dhe logjike e të dhënave.

## Politika e Sigurisë së Sistemit të Informacioneve dhe ISO 27001:2013

Në të njëjtën kohë, Politika e Sigurisë së Sistemit të Informacioneve të Entit Shtetëror të Revizionit zbatohet në mënyrë të vazhdueshme, me vëmendje të veçantë ndaj aplikimit të procedurave të sigurisë së TI-së dhe procedurave të TI-së për zbatimin e Sistemit të Menaxhimit të Procesit të Revizionit.




Në kuadër të projektit që Enti Shtetëror i Revizionit ka zbatuar në bashkëpunim me Zyrën e Kryerevizorit të Norvegjisë (OAGN), në komponentin për zhvillimin e Laboratorit Inovativ në ESHR, më 08.06.2023 u mbajt Hakatoni i parë në ESHR. Tema e hakatonit ishte «Nga grumbullimi efikas i të dhënave deri në revizionin efikas». Në këtë eveniment, morën pjesë rreth 50 revizorë, të organizuar në disa ekipe. Ekipet punuan mbi idetë e tyre se si të rrisin efikasitetin e revizionit përmes aplikimit të teknologjive të reja.

## 3.4 MJETET FINANCIARE PËR PUNËN E ESHR-SË

Enti Shtetëror i Revizionit është institucion suprem i pavarur i revizorit në Republikën e Maqedonisë së Veriut, i cili për më shumë se 20 vjet në mënyrë transparente, në kohë dhe objektive i informon institucionet kompetente dhe publikun për gjendjet e konstatuara nga revizionet e kryera.

Organizimi, kompetencat dhe puna e institucionit janë të përcaktuara me Ligjin për revizionin shtetëror ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 66/10, 145/10, 12/14, 43/14, 154/15, 192/15, 27/16 dhe 83/18 dhe dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 122/21) me të cilin përcaktohet mandati i gjerë për kryerjen e revizioneve, me qasje në të gjitha informacionet, dokumentacionet dhe evidencat e domosdoshme për zbatimin e revizionit shtetëror.

Enti Shtetëror i Revizionit bën në mënyrë të vazhdueshme dhe të përkushtuar përpjekje për kryerjen e kompetencave të deleguara me ligj dhe arritjen e treguesve të përcaktuar për matjen e rezultateve të punës së tij. Enti Shtetëror i Revizionit, duke filluar nga shembulli i tij, si organizatë me standarde të larta të vendosura të punës dhe menaxhimit financiar, vendosi tregues për matjen e performancave të punës, përkatësisht të vlerës së shtuar të punës.

Me sigurimin e mjeteve të mjaftueshme financiare për kryerjen e vazhdueshme të kompetencave të Entit Shtetëror të Revizionit, i mundësohet Entit Shtetëror të Revizionit të sigurojë kthim të drejtpërdrejtë të mjeteve në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë së Veriut përmes evazionit të përcaktuar tatimor.

Pra, me revizionet e kryera nga Programi Vjetor i Punës së Entit Shtetëror të Revizionit për vitin 2023, vlera e shtuar nga revizionet e kryera të Entit Shtetëror të Revizionit siguron kthim në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë së Veriut në raport me 1:60 përkatësisht 1 buxhet i ESHR-së siguron kthim në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë së Veriut në shumë prej të paktën 60 buxhete të ESHR-së, përkatësisht mjetet e paarkëtuara / më pak të llogaritura dhe të paguara në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe komunave janë 8.673 milionë denarë, përkatësisht 139 milionë euro.

Buxheti i Entit Shtetëror të Revizionit është pjesë përbërëse e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, i cili propozohet nga Ministria e Financave dhe i dorëzohet Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut për miratim dhe pas votimit të tij botohet në Gazetën Zyrtare.

Buxheti i miratuar fillimisht për vitin 2023 i Entit Shtetëror të Revizionit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 282, nga 27.12.2022) është në shumë të përgjithshme prej 141.600 mijë denarë për llogarinë bazë 637 dhe për llogarinë personale 631 në shumë të përgjithshme prej 3.000 mijë denarë.

Në vitin 2023, Enti Shtetëror i Revizionit do të kryejë punën e tij të rregullt përmes llogarive të mëposhtme:

- **020021504063710** - llogaria e rregullt e buxhetit themelor të **ESHR-së**;
- **020021504063119** - llogaria personale e **ESHR-së**;
- **020021504078550** - llogaria e donatorit SAUDI FISP-**donacioni nga Arabia Saudite**;
- **020021504078564** - llogaria e donatorit EUROSAI-**donacioni nga EUROSAI**.

Në bazë të nevojave të mjeteve financiare, Plani Vjetor për Prokurimet Publike dhe procedurat e zbatuara të prokurimeve publike gjatë vitit 2023 janë bërë ndryshime dhe plotësime, ridedikime dhe zgjerime të buxhetit të Entit Shtetëror të Revizionit, me atë që ribalanci i fundit i vitit 2023 për llogarinë 637 është në shumë të përgjithshme prej 148.530 mijë denarë, për llogarinë 631 është 3.000 mijë denarë, për llogarinë e donatorit 78.550 është planifikuar buxheti në shumë prej 1.710 mijë denarë dhe për llogarinë e donatorit 78.564 është planifikuar buxheti në shumë prej 930 mijë denarë.

## PLANI DHE REALIZIMI SIPAS LLOGARIVE TË ENTIT SHTETËROR TË REVIZIONIT PËR VITIN 2023




Nga gjithsej mjetet e planifikuara financiare në shumë prej 154.170 mijë denarë për vitin 2023 për Entin Shtetëror të Revizionit sipas të gjitha llogarive të lartpërmendura, janë realizuar mjete në shumë të përgjithshme prej 147.730 mijë denarë ose 96%.

## LLOGARIA E RREGULLT E ENTIT SHTETËROR TË REVIZIONIT - 020021504063710

Në bazë të ribalancit të fundit të Entit Shtetëror të Revizionit për vitin 2023, për këtë llogari janë planifikuar mjete në shumë të përgjithshme prej 148.530 mijë denarë, ndërsa janë realizuar mjete në shumë prej 145.205 mijë denarë ose 97,76%.

Shpenzimet e planifikuara në këtë llogari në shumë prej 118.700 mijë denarë ose 80% kanë të bëjnë për rrogat, kontributet dhe kompensimet për punonjësit, 21.880 mijë denarë ose 15% janë për mallra dhe shërbime, transfere dhe donacione janë planifikuar në shumë prej 700 mijë denarë ose 0,5% dhe 7.250 mijë denarë ose 5% janë planifikuar për zërin për investimet kapitale nga buxheti i përgjithshëm i planifikuar.

Sa i përket realizimit të shpenzimeve të planifikuara, pjesa më e madhe e buxhetit përfshin kategorinë 40 të dedikuar për rroga, kontribute dhe kompensime tjera për punonjësit, e cila ka realizim në

shumë prej 116.449 mijë denarë ose 80%, e kategorisë për mallra dhe shërbime realizimi është 21.259 mijë denarë ose 15%, në kategorinë për transfere dhe donacione mjetet janë realizuar në shumë të përgjithshme prej 523 mijë denarë ose 0,36% dhe kategoria e fundit 48 është parashikuar për investimet kapitale, realizimi është 6.973 mijë denarë ose 5% në lidhje me buxhetin total të realizuar.

Sipas strukturës së shpenzimeve të planifikuara dhe të realizuara sipas zërave të llogarisë së rregullt 637 për vitin 2023, pjesëmarrjen më të madhe e kanë shërbimet komunale, ngrohja, komunikimi dhe transporti, për të cilat janë planifikuar mjete në shumë prej 6.800 mijë denarë, ndërsa janë realizuar mjete në shumë të përgjithshme prej 6.792 mijë denarë, për shpenzimet e udhëtimit dhe ditore janë planifikuar mjete në shumë prej 5.780 mijë denarë, ndërsa janë realizuar mjete në shumë prej 5.225 mijë denarë, për materiale dhe inventar të imët janë planifikuar mjete në shumë prej 2.000 mijë denarë me mjete të realizuara në shumë prej 1.973 mijë denarë, për mirëmbajtje rrjedhëse nga mjetet e planifikuara në shumë prej 2.500 mijë denarë, janë realizuar mjete në shumë prej 2.497 mijë denarë, për shërbimet kontraktuese janë planifikuar 2.900 mijë denarë dhe janë shpenzuar mjete në shumë prej 2.900 mijë denarë, për shpenzime rrjedhëse operative nga 1.900 mijë denarë të planifikuara, janë realizuar mjete në shumë prej 1.872 mijë denarë. Në zërin për transfere të ndryshme dhe donacione nga 700 mijë denarë të planifikuara janë realizuar mjete në shumë prej 523 mijë denarë.

Për shpenzimet kapitale të dedikuara për prokurimin e pajisjeve kompjuterike, mobilieve për zyrë, prokurimin e zgjidhjeve të reja softuerike dhe licencave lidhur me punën aktuale të punonjësve të ESHR-së prej 7.250 mijë denarë të planifikuar, janë realizuar mjete në shumë prej 6.974 mijë denarë ose 97%.

Struktura e shpenzimeve të planifikuara dhe të realizuara për zërat kapitalë është si vijon: nga mjetet e planifikuara për prokurimin e pajisjeve kompjuterike në shumë prej 3.520 mijë denarë, janë realizuar mjete në shumë prej 3.394 mijë denarë, për prokurimin e mobilieve për zyrë nga mjetet e planifikuara prej 850 mijë denarë, janë realizuar mjete në shumë prej 841 mijë denarë, për prokurimin e softuerëve dhe licencave nga mjetet e planifikuara në shumë prej 1.380 mijë denarë, janë realizuar mjete në shumë prej 1.370 mijë denarë dhe për zërin për prokurimin e automjeteve nga mjetet e planifikuara prej 1.500 mijë denarë, janë realizuar mjete në shumë prej 1.367 mijë denarë, të cilat kanë të bëjnë me pagesën e kësteve për prokurimin e tri automjeteve zyrtare për ESHR-në përmes lizingut financiar.

## LLOGARIA PERSONALE E ESHR-SË PËR VITIN 2023 - 020021504063119

Në punën e tij, Enti Shtetëror i Revizionit ka llogarinë personale 631, përmes së cilës realizohen të ardhurat nga arkëtimi i kompensimeve nga institucionet që janë lëndë e revizionit nga Enti Shtetëror i Revizionit në përputhje me tarifën e publikuar në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë" numër 30 nga 19.04.2000.

Me tarifën e arkëtimit është përcaktuar procedura për llogaritjen dhe faturimin e kompensimeve për kryerjen e revizionit shtetëror te subjektet që janë lëndë e revizionit në përputhje me Ligjin për revizionin shtetëror.

Me heqjen e arkëtimit për revizionin e kryer në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë" numër 66 nga viti 2010, është ndërprerë faturimi për revizionin e kryer të subjekteve, e me këtë edhe evidentimi i kontabilitetit i të ardhurave në këtë llogari.

Për vitin 2023, në këtë llogari janë planifikuar të ardhura në shumë të përgjithshme prej 3.000 denarë, ndërsa realizimi i të ardhurave është 374 mijë denarë.

Sa i përket pjesës së shpenzimeve të llogarisë personale për vitin 2023, ku janë planifikuar mjetet në shumë prej 3.000 denarë, realizim nuk ka.

## LLOGARIA E DONATORIT 020021504078550 - SAUDI FISP

Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Revizionit INTOSAI dhe Institucioni Suprem i Revizionit - General Court of Audit-SAUDI FISP i Arabisë Saudite shpallën thirrje në vitin 2022 për dhënien e granteve për të përmirësuar rezistencën dhe vazhdimësinë në punën e Institucioneve Supreme të Revizionit përmes zgjidhjeve të TIK-së gjatë Covid-19.

Enti Shtetëror i Revizionit aplikoi dhe mori njoftim nga Institucioni Suprem i Revizionit - General Court of Audit-SAUDI FISP i Arabisë Saudite për grant të miratuar në shumë prej 30 mijë dollarë amerikanë të dedikuar për prokurimin e pajisjeve kompjuterike për funksionimin aktual të institucionit.

Nga General Court of Audit-SAUDI FISP është kryer transferi i mjeteve financiare në shumë prej 30 mijë dollarë amerikanë ose në kundërvlerë me denarë prej 1.710 mijë denarë dhe është kryer prokurimi i pajisjeve informatike nga ESHR-ja (18 laptopë kompjuterë dhe 2 dronë).

Projekti pas marrjes së grantit nga Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Revizionit dhe ISR i Arabisë Saudite për përmirësimin e rezistencës dhe vazhdimësisë në punën nëpërmjet mbështetjes në zgjidhjet e TIK-së është realizuar dhe zbatuar plotësisht në vitin 2023, me faktin se në buxhetin e vitit 2023 në këtë llogari të donatorit nga mjetet e planifikuara nga zëri 480 për pajisjen kompjuterike në shumë prej 1.710 mijë denarë, janë realizuar mjete në shumë prej 1.710 mijë denarë ose 100 %.

## LLOGARIA E DONATORIT 020021504078564 - EUROSAI

Enti Shtetëror i Revizionit ka parashtruar aplikacion për miratimin e grantit në shumë prej 15 mijë euro në EUROSAI-Secretary Tribunal de Cuentas Madrid Spanjë të dedikuar për organizimin e evenimenteve dhe takimeve për prezantimin e rezultateve të raportit të përbashkët të revizorit nga revizioni kooperativ «Të ardhurat personale të komunave për ofrimin e shërbimeve cilësore për qytetarët gjatë pandemisë».

Në maj të vitit 2023, Enti Shtetëror i Revizionit mori njoftim nga EUROSAI për grant të miratuar në shumë prej 13 mijë euro të dedikuar për organizimin e evenimenteve dhe takimeve për prezantimin e rezultateve të raportit të përbashkët të revizorit nga revizioni kooperativ.

Mjetet financiare në shumë prej 13 mijë euro ose në kundërvlerë me denarë prej 815 mijë denarë janë transferuar nga llogaria e EUROSAI-t në llogarinë e Entit Shtetëror të Revizionit në muajin 11-2023 dhe ato janë të dedikuara për dhënien me qira të pajisjeve teknike, sallës së konferencave, sherbimeve të përkthimit gjatë evenimentit të mbajtur nga 26 - 27.09. si dhe për të mbuluar shpenzimet për mundësimin e lidhjes virtuale të evenimenteve.

Në buxhetin e Entit Shtetëror të Revizionit për vitin 2023, në këtë llogari të donatorit, në zërin 426, janë planifikuar mjete në shumë prej 930 mijë denarë për organizimin e evenimenteve dhe konferencave, prej të cilave janë realizuar mjete në shumë prej 815 mijë denarë ose 87,7 %.

Raportet financiare të Entit Shtetëror të Revizionit përgatiten në përputhje me dispozitat e Ligjit për kontabilitetin e buxheteve dhe shfrytëzuesve buxhetorë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 61/02, 98/02, 81/02, 81/05, 24/11, 145/15, 170/17 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 122/21) dhe Rregullores për kontabilitetin e buxheteve dhe shfrytëzuesve buxhetorë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 28/03, 62/06, 8/09, 175/11, 101/13) të cilat revidohen çdo vit nga shtëpia e pavarur

e revizionit e zgjedhur nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut pas zbatimit paraprak të procedurës së prokurimit publik për revizion.

Raporti i revizionit të kryer të punës materiale dhe financiare të ESHR-së nga revizori i pavarur është pjesë përbërëse e Raportit Vjetor për revizionet e kryera dhe punën e Entit Shtetëror të Revizionit.



# MBËSHTETJA E PUNËS SË ENTIT SHTETËROR TË REVIZIONIT NGA ORGANIZATAT NDËRKOMBËTARE – AKTIVITETET E FINANCUARA PËRMES DONATORIT

| | |
|---|---|
| UN WOMEN – United Nations Entity for Gender Equality and the Empowerment of Women | Gjatë vitit 2023, me qëllim të forcimit të kapaciteteve të ESHR-së për përfshirjen e perspektivës gjinore në revizionet e suksesit dhe kryerjen e revizioneve gjinore, në bashkëpunim me UN Women, është ofruar mbështetja prej 70 mijë dollarë amerikanë. Kjo mbështetje synon ndihmën e ekspertëve për revizionin gjinor kooperativ, vizualizimin e rezultateve të revizionit të kryer, si dhe pjesëmarrjen e revizorëve shtetërorë në punëtoritë brenda dhe jashtë vendit, duke përfshirë takime rajonale dhe vizita studimore, për shkëmbimin e përvojave dhe praktikave të mira me ISR-të e tjera. |
| UNDP | Në bashkëpunim me Programin e Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara (UNDP), në vitin 2023 janë organizuar një sërë punëtorish për përsosjen dhe edukimin e vazhdueshëm të punonjësve të Entit Shtetëror të Revizionit. Temat përfshinin revizionin e vlerës për paranë, përgatitjen e Programit Vjetor të Punës së ESHR-së bazuar në Strategjinë Nacionale Zhvillimore, analizën e raporteve financiare dhe analizën e rreziqeve.<br><br>Për zbatimin e revizionit paralel të suksesit "Gatishmëria e vendit për zbatimin e Qëllimeve të Zhvillimit të Qëndrueshëm deri në vitin 2030", është ofruar mbështetja e ekspertëve dhe teknike, në shumë prej 33 mijë dollarë amerikanë. Kjo mbështetje mundësoi edhe pjesëmarrjen e revizorëve shtetërorë në punëtoritë brenda dhe jashtë vendit, duke përfshirë takime rajonale dhe vizita studimore, për shkëmbimin e përvojave dhe praktikave të mira me ISR-të e tjera. |
| NDI – National Democratic Institute | Instituti Demokratik Nacional (NDI), në bashkëpunim me Fondacionin Nacional për Demokraci (NED), me qëllim të forcimit të kapaciteteve të ESHR-së, ofruan mbështetje për shkëmbimin e përvojave dhe praktikave të mira për mbikëqyrjen e mjeteve publike nga pushteti legjislativ, si dhe praktikave të mira të llogaridhënies gjatë tranzicioneve ekzekutive. Në drejtim të sigurimit të llogaridhënies buxhetore, transparencës, kuptimit të raporteve të revizorit dhe metodologjisë dhe qasjes së punës së ESHR-së, u mbajtën një sërë punëtorish në të cilat morën pjesë përfaqësuesit e Komisionit për Financim dhe Buxhet, Shërbimit të Kuvendit, Zyrës Buxhetore të Kuvendit dhe Institutit Parlamentar, për të cilin qëllim u realizuan mjete në shumë prej 15 mijë dollarë amerikanë. |

| | |
|---|---|
| IFES | Fondacioni Ndërkombëtar për Sistemet Zgjedhore në bashkëpunim me USAID-in, me qëllim të rritjes së efektivitetit të punës së ESHR-së në kryerjen e funksioneve të rregullta të revizionit, ka ofruar mbështetje në shumën e përgjithshme prej 75 mijë dollarë amerikanë, mjetet janë të dedikuara për rritjen e profesionalizmit dhe specializimit të revizorëve nëpërmjet trajnimeve dhe certifikimit për Certifikatën Ndërkombëtare për Menaxhimin e Rrezikut nga Korrupsioni, trajnimeve të specializuara për dizajnin grafik dhe Data Science, si dhe për zhvillimin e aftësive komunikuese të punonjësve.<br><br>Përveç kësaj, IFES ofroi mbështetje për zhvillimin e platformës së specializuar për mësimin në internet dhe përgatitjen e e-trajnimeve për revizionin e suksesit, me qëllim të avancimit të punës së ESHR-së dhe futjes së veglave inovative dhe zgjidhjeve softuerike. Revizorët shtetërorë morën pjesë gjithashtu në punëtori brenda dhe jashtë vendit, takime ndërkombëtare dhe vizita studimore për të shkëmbyer përvoja dhe praktika të mira me ISR-të e tjera dhe organizatat ndërkombëtare. |
| WFD | Në kuadër të zbatimit të Strategjisë së Komunikimit të ESHR-së, në bashkëpunim me Fondacionin për Demokraci Vestminster (WFD), është siguruar mbështetja e 66 mijë funtave. Kjo mbështetje është e dedikuar për përmirësimin e komunikimit dhe bashkëpunimit të ESHR-së me institucionet kompetente, Prokurorinë Publike, Kuvendin, organizatat joqeveritare, gazetarët dhe mediat, si dhe të forcojë kapacitetet e ESHR-së për kryerjen e revizioneve, veçanërisht në pjesën e vlerës për paranë dhe dizajnin grafik.<br><br>WFD ofroi edhe mbështetje ekspertësh për kryerjen e dy revizioneve të suksesit: «Efikasiteti i procedurave për ndarjen e së drejtës së shfrytëzimit të lëndëve të para minerale dhe zbatimin e kontratave të lidhura, me vështrim të veçantë për mermerin» dhe «Efikasiteti i masave, politikave dhe projekteve për përmbushjen e kushtet në të cilat funksionojnë konviktet shtetërore të studentëve në RMV dhe zhvillimi i standardit të studentëve". Përveç kësaj, WFD ndihmoi në hartimin e Strategjisë së re të Komunikimit të ESHR-së. |

| | |
|---|---|
| UN WOMEN<br>United Nations Entity for Gender Equality and the Empowerment of Women | 70.000 $ |
| WFD | 52.210 £ |
| NDI<br>NATIONAL DEMOCRATIC INSTITUTE | 15.179 $ |
| UNDP | 33.028 $ |
| IFES International Foundation for Electoral Systems<br>USAID FROM THE AMERICAN PEOPLE | 75.000 $ |

Enti Shtetëror i Revizionit si ISR në Republikën e Maqedonisë së Veriut vazhdimisht bën përpjekje për të arritur bashkëpunim me një numër të madh të organizatave ndërkombëtare për të ofruar mbështetje për aktivitetet e tij.

## 3.5 ZHVILLIMI I QËNDRUESHËM DHE MBROJTJA E MJEDISIT JETËSOR

ESHR-ja vazhdoi me qasjen e përgjegjshme për mbrojtjen e mjedisit jetësor përmes përzgjedhjes së vendosur të mbetjeve të letrës dhe shisheve të plastikës në ambientet e tij, të cilat më pas dorëzohen në përpunim të mëtejshëm dhe trajtim kolektiv. Në këtë mënyrë, ESHR-ja kontribuon në rritjen e ndërgjegjësimit të përgjithshëm për zhvillimin e qëndrueshëm dhe mbrojtjen e mjedisit jetësor.

ESHR-ja, gjatë kryerjes së veprimtarisë së vet, vendos kulturë të sjelljes për të ulur konsumin e letrës. Është vendosur sistemi për kontrollin e materialit të shtypur në formë letre, aplikohet shtypja e dyanshme, si dhe botimi i raporteve të revizorit duke i regjistruar në CD.

Gjatë vitit 2023, në disa raste në ambientet e ESHR-së u organizuan aksione të dhurimit të gjakut, ku punonjësit dhanë kontribut aktiv në ndërgjegjësimin për shëndetin e njerëzve, rëndësinë e mirëqenies njerëzore dhe dhanë mbështetje për solidaritetin e komunitetit.

Në vitin 2023, përmes raporteve të revizorit, ESHR-ja i mbuloi Qëllimet e Zhvillimit të Qëndrueshëm që janë në kuadër të përmbushjes për vendin tonë. Nëpërmjet rekomandimeve konkrete dhe të qarta për institucionet kompetente, ESHR-ja përfshihet në grupin që merr pjesë aktive në mbrojtjen e mjedisit jetësor, përmirësimin e kushteve sociale dhe ekonomike për jetën e njerëzve, uljen e varfërisë dhe i mbështet udhëzimet për zhvillim të qëndrueshëm dhe një të ardhme më të mirë për brezat e ardhshëm. Në vitin 2023, nga të gjithë sektorët, u kryen njëmbëdhjetë revizione të suksesit dhe dy revizione të pajtueshmërisë me çka u përfshin Qëllimet e Zhvillimit të Qëndrueshëm si në vijim:




Revizione të caktuara të suksesit, edhe pse dallohen në lëndën e revizionit, janë të ngjashme me njëri-tjetrin në atë që mbulojnë aspekt të ndryshëm të të njëjtit qëllim.

Në vitin 2023, me revizionin e suksesit "Gatishmëria e Republikës së Maqedonisë së Veriut për zbatimin e Qëllimeve të Zhvillimit të Qëndrueshëm deri në vitin 2030", ESHR-ja ofroi pasqyrë të përgjithshme, ndjekjen e gjendjeve dhe dha rekomandime me të cilat duhet të arrihet progresi më i madh i Republikës së Maqedonisë së Veriut drejt arritjes së Qëllimeve të Zhvillimit të Qëndrueshëm.

# 4

# BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR



# 4.1 BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR

Duke iu qasur zbatimit të qëllimeve strategjike të ESHR-së për periudhën 2023-2027 dhe aktiviteteve për realizimin e tyre gjatë vitit 2023, ESHR-ja po zhvillon dhe përmirëson vazhdimisht sistemin e bashkëpunimit profesional ndërkombëtar me ISR-të e tjera, EUROSAI, INTOSAI dhe organizata të tjera ndërkombëtare në funksion të ruajtjes së pavarësisë, objektivitetit, integritetit dhe cilësisë së revizionit shtetëror, rritjes së ndikimit total të revizionit shtetëror, shkëmbimit të praktikave të mira personale dhe përdorimit të përvojës dhe praktikave të mira të të tjerëve, zhvillimit të vazhdueshëm dhe rritjes së njohurive dhe aftësive të punonjësve të ESHR-së.

Gjatë vitit 2023, ESHR-ja mori pjesë në evenimente të shumta ndërkombëtare (takime, punëtori, konferenca). Të gjithë pjesëmarrësit patën mundësinë të informohen për praktikat më të mira dhe të marrin pjesë në rrjetëzim si mundësi për t'i zgjeruar njohuritë dhe aftësitë në fusha të shumta:

- revizioni i mjedisit jetësor;
- mbështetja e TI-së dhe revizioni i TI-së;
- avancimi i punës së ISR-së;
- borxhi publik;
- revizionet gjinore dhe buxhetimi gjinor;
- revizioni i komunave dhe të tjera.

ESHR-ja është pjesëmarrës aktiv në më shumë grupe operative dhe ndërkombëtare të punës, ndër të cilat

Kontributi i ESHR-së në realizimin e aktiviteteve në grupet e punës dhe programet e INTOSAI-t dhe EUROSAI-t gjatë vitit 2023 ishte zhvilluar në vazhdimësi, ndërsa shkëmbimi i përvojave pozitive dhe mësimeve të nxjerra me ISR-të e tjera është një nga parimet bazë të punës përmes të cilit sigurohet zhvillimi institucional.

Pjesëmarrja në revizionet kooperative me institucionet e tjera supreme të revizionit nga BE-ja dhe më gjerë, mbetet edhe më tutje një nga prioritetet e ESHR-së, duke pasur parasysh faktin se ky lloj bashkëpunimi kontribuon ndjeshëm në forcimin e vazhdueshëm të aftësive të revizorit dhe avancimin e cilësisë së revizioneve të suksesit. Dobitë e bashkëpunimit me ISR-të e tjera janë të shumëfishta, dhe i veçojmë veçanërisht mundësitë që revizorët i kanë për të përmirësuar veten profesionalisht në formën e aktiviteteve kolegjiale, qasjes fleksibile dhe përdorimit të përvojave të pjesëmarrësve të tjerë dhe forcimit të vetëbesimit në kapacitetet e tyre për kryerjen e revizionit të suksesit nga njëra anë dhe promovimin e rezultateve të arritura të ESHR-së nga ana tjetër.

# EUROSAI

## ORGANIZATA EVROPIANE E INSTITUCIONEVE SUPREME TË REVIZIONIT (EUROSAI) KOMITETI I KONTAKTIT

Në takimin e rregullt vjetor të Komitetit të Kontaktit të shefave të Institucioneve Supreme të Revizionit të Bashkimit Evropian, Gjykatës Evropiane të Revizorëve, përfaqësuesve të SIGMA-s dhe Iniciativës për Zhvillim të INTOSAI-t, që u mbajt më 21-22 qershor 2023 në Lisbonë, Portugali, mori pjesë edhe delegacioni i ESHR-së i kryesuar nga kryerevizori shtetëror z. Acevski. Fokusi qendror i këtij takimi ishte "Energjia – Si mund të kontribuojnë Institucionet Supreme të Revizionit për zbatim më të mirë dhe të qëndrueshëm të qëllimeve energjetike deri në vitin 2030". Në takim u prezantuan sfidat dhe përvojat e ISR-ve të vendeve anëtare të BE-së në kryerjen e revizioneve në fushën e energjetikës.

Në margjinat e këtij evenimenti, kryerevizori shtetëror zhvilloi më shumë takime bilaterale me kolegë dhe përfaqësues të ISR-ve nga vendet anëtare dhe kandidatë për anëtarësim në BE dhe ESR, dhe mbi të gjitha me kryerevizorët shtetërorë të ISR Portugali, ISR Slloveni, ISR Sllovaki, ISR Çeki, ISR Mali i Zi etj., ku diskutuan pavarësinë e institucioneve supreme të revizionit dhe ndikimin e tyre në menaxhimin më të mirë të mjeteve publike, rëndësinë e zbatimit të standardeve për kryerjen e revizionit, resurset njerëzore si parakusht për institucionin profesional, vlerën dhe rëndësinë e matjes së rezultateve të punës së ISR-së dhe pjesëmarrjen dhe kontributin e ISR-së brenda EUROSAI-t.

## ORGANIZATA NDËRKOMBËTARE E INSTITUCIONEVE SUPREME TË REVIZIONIT (INTOSAI)

### INICIATIVA PËR ZHVILLIM INTOSAI (IDI)

Pavarësia e institucioneve supreme të revizionit ishte tema e takimit të dytë të Grupit Referent për Përfaqësimin Proaktiv për Pavarësinë e ISR-së në INTOSAI IDI, në Republikën Çeke. Në eveniment morën pjesë 25 përfaqësues të ISR-ve evropiane, ndërsa përfaqësuesit e ESHR-së i prezantuan përvojat e tyre me mekanizmin SIRAM. Mekanizmi i Përfaqësimit të Shpejtë të Pavarësisë së ISR-së (SIRAM) ka për qëllim t'u ndihmojë anëtarëve të INTOSAI-t në dhënien e përgjigjes në kohë dhe efektive ndaj zhvillimeve politike dhe ndryshimeve / reformave ligjore që mund të ndikojnë negativisht në pavarësinë e ISR-së. IDI zhvillon mekanizëm proaktiv të përfaqësimit për pavarësinë e ISR-së.

Në nëntor 2023, delegacioni i ESHR-së mori pjesë në Samitin Global të IDI-së për profesionalizimin e revizorëve të ISR-së, në Londër, Mbretëria e Bashkuar. Kjo konferencë ndërkombëtare iu kushtua PESA-s (Edukimi Profesional i Revizorëve Shtetërorë), i cili ofron qasje në edukimin e vazhdueshëm profesional të revizorëve shtetërorë, por edhe bazë për vendosjen e Qendrës për Edukimin Profesional të Revizorëve Shtetërorë në kuadër të IDI-së.

Në vitin 2023, Enti Shtetëror i Revizionit iu bashkua programit të pionierëve LOTA, i cili ka për qëllim të sjellë teknologjinë më pranë botës së revizionit të ISR-së, duke analizuar proceset e revizionit dhe duke zhvilluar strategji për përdorimin e teknologjisë në revizionet dhe revizionin e përdorimit të teknologjisë nga qeveritë.

## PJESËMARRJA E ESHR-SË NË GRUPET E PUNËS DHE PROJEKTET BRENDA INTOSAI DHE EUROSAI

### Grupi i Projektit EUROSAI mbi Qëllimin Strategjik 1 - Dobitë dhe metodologjia për revizion në kohë reale

Përfaqësuesit e ESHR-së, të udhëhequr nga kryerevizori shtetëror, më 11 maj 2023 në Romë, morën pjesë në takimin e Grupit të Projektit EUROSAI mbi Qëllimin Strategjik 1 - Dobitë dhe metodologjia për revizion në kohë reale, të organizuar nga ISR Itali. Në takim morën pjesë përfaqësuesit e 19 ISR dhe ISR e Italisë si koordinator. Në takim, të pranishmit i ndanë përvojat rreth revizionit në kohë reale, kuptimit, zhvillimit, kontributit dhe nevojës së tij për bashkëpunim në të ardhmen në këtë fushë. Në margjinat, kryerevizori shtetëror zhvilloi takim pune me kryetarin e Gjykatës së Revizionit të Italisë, nga i cili inicioi edhe bashkëpunimin e ardhshëm bilateral, i cili u formalizua në vitin 2024, me nënshkrimin e Memorandumit të Bashkëpunimit.

### Grupi i Projektit EUROSAI mbi Qëllimin Strategjik 2 – Zhvillimi i kapaciteteve institucionale

Më 15 dhe 16 nëntor 2023, ISR-të e Polonisë dhe Suedisë e organizuan konferencën e dytë mbi metodologjinë e revizionit si pjesë e qëllimit të dytë strategjik të EUROSAI – Zhvillimi i kapaciteteve institucionale. Fokusi i kësaj konference ishte metodologjia e revizorit që i mbulon tri fazat e revizionit: përzgjedhjen e revizionit, ekzekutimin dhe komunikimin e rezultateve të revizionit.

Në konferencë u diskutuan temat me vështrim të veçantë për mënyrën e përzgjedhjes së temës së revizorit, identifikimin më të mirë të fushave të revizionit, si dhe sigurimin e cilësisë së lartë në revizion duke analizuar procesin e revizorit dhe veçanërisht ISSAI 140 që është në procesin e revidimit. U prezantuan përvojat dhe praktikat e ndryshme të komunikimit të prezantimit të rezultateve të revizionit dhe ndikimit të tyre. Zëvendëskryerevizori shtetëror, z. Ademi, i prezantoi të arriturat e ESHR-së në komunikimin e rezultateve të revizioneve, të cilat shkaktuan interesim të madh te të pranishmit. Rezultatet e këtyre diskutimeve janë baza për aktivitetet e ardhshme të ISR-së brenda EUROSAI-t në drejtim të zhvillimit të veglave efikase të revizionit.

## GRUPI I PUNËS EUROSAI PËR REVIZIONET E TI-SË DHE GRUPI I PUNËS INTOSAI PËR REVIZIONET E TI-SË

Përfaqësuesit e ESHR-së morën pjesë aktive në të gjitha punëtoritë online të Grupit të Punës EUROSAI dhe INTOSAI për revizionet e TI-së, të organizuara nga ky grup, duke rritur kështu aftësitë dhe njohuritë e tyre në kryerjen e revizioneve të TI-së.

## GRUPI I PUNËS I EUROSAI PËR REVIZIONIN E MJEDISIT JETËSOR

Takimet e Grupit të Punës të EUROSAI-t për revizionin e mjedisit jetësor /WGEA/, të udhëhequr nga ISR e Polonisë, u mbajtën në maj në Poloni dhe në shtator në Republikën Çeke. Temat e grupit të punës në vitin 2023 ishin siguria dhe efikasiteti energjetik, burimet e rinovueshme të energjisë dhe instrumentet e politikave fiskale të gjelbra.

## GRUPI I PUNËS I INTOSAI PËR REVIZIONIN E MJEDISIT JETËSOR

Në grupin e punës të INTOSAI për revizionin e mjedisit jetësor /WGEA/, sekretariati i të cilit është ISR e Finlandës, punonjësit e ESHR-së morën pjesë në punëtoritë online për revizionin e ekonomisë informale, çështjet dhe sfidat, me vështrim të veçantë për QZHQ 14, skanerin e klimës dhe edukimet për hyrje në revizionin e mjedisit jetësor.

## GRUPI I PUNËS INTOSAI PËR BORXHIN PUBLIK

Në periudhën prej 8 deri më 10 maj 2023, përfaqësuesit e ESHR-së morën pjesë në Takimin Vjetor të Grupit të Punës të INTOSAI-t për Borxhin Publik (WGPD) në Kajro, Egjipt. Gjatë eveniment, ESHR-ja, si udhëheqës i projektit, i prezantoi dy projektet e të cilave ishte udhëheqës nga viti 2020 deri në vitin 2022:

- "Punimi kërkimor për përcaktimin e mandateve të institucioneve supreme të revizionit për revizionin e borxhit publik, kapacitetet e tyre institucionale dhe mbështetjen e organizatave rajonale" dhe
- "Përmbledhja e procedurave praktike për kornizën juridike për borxhin publik, miratimi i ngarkimit të shtetit me borxh dhe kompetenca për miratimin e instrumenteve të ngarkimit me borxh".

Evenimenti u organizua nga Sekretariati i WGPD, përkatësisht ISR e Filipineve dhe u organizua nga ISR e Egjiptit. Në takim morën pjesë delegacionet nga 28 vende anëtare të INTOSAI-t. Pjesëmarrja e përfaqësuesve të ESHR-së u mbështet financiarisht nga Fondacioni Ndërkombëtar për Sistemet Zgjedhore (IFES).

# GRUPI I PUNËS I EUROSAI PËR REVIZIONIN E KOMUNAVE

ESHR-ja dha kontribut të rëndësishëm në punën e grupit operativ EUROSAI për revizionin e komunave (TFMA), veçanërisht në zbatimin e planit të veprimit për vitet 2022/23. Me propozim të Sekretariatit të TFMA-së, ESHR-ja e mori rolin e koordinatorit të revizionit kooperativ, në të cilin morën pjesë ISR-të e Shqipërisë, Rumanisë, Polonisë, Sllovakisë, Malit të Zi dhe Turqisë.

Në shtator të vitit 2023, në Shkup u mbajt takimi përfundimtar për prezantimin e rezultateve të revizionit të parë kooperativ të suksesit, me temë "Të ardhurat personale të komunave për ofrimin e shërbimeve cilësore për qytetarët gjatë pandemisë". Pjesëmarrës ishin vendet anëtare të TFMA-së, duke i përfshirë edhe shtatë vendet që morën pjesë në revizion.

Qëllimi i revizionit ishte vlerësimi i ndikimit të Kovid-19 në nivel lokal dhe nëse të ardhurat personale të komunave janë të mjaftueshme për të ofruar shërbime cilësore. Revizioni u fokusua në: на:

- Menaxhimin e krizës së shkaktuar nga KOVID-19;
- Financimin e komunave;
- Shërbimet komunale për qytetarët;
- Planet e rimëkëmbjes pas krizës.

Raporti i përbashkët paraqet analiza krahasuese dhe gjendje të konstatuara nga revizionet e secilit vend, duke shkëmbyer praktika dhe përvoja të mira. Rezultatet dhe përvojat nga ky revizion u transferuan edhe në disa punëtori të organizuara brenda grupit.



## RRJETI I ISR-SË I VENDEVE KANDIDATE DHE KANDIDATËVE POTENCIALË PËR PRANIM NË BE DHE NË GJYKATËN EVROPIANE TË REVIZORËVE

Në takimin e rregullt vjetor të Rrjetit të Institucioneve Supreme të Revizionit të vendeve kandidate dhe kandidatëve potencialë për anëtarësim në Bashkimin Evropian dhe në Gjykatën Evropiane të Revizorëve, i cili u mbajt më 20 qershor 2023 në Lisbonë, fokusi qendror i takimit ishte në Kornizën e rishikuar të bashkëpunimit të Rrjetit dhe realizimi i aktiviteteve të ardhshme për zbatimin e Planit të Punës së Rrjetit për vitet 2022-2025.

## BASHKËPUNIMI BILATERAL DHE RAJONAL ME ISR-TË

### INSTITUCIONI SHTETËROR I REVIZIONIT I SERBISË

Si rezultat i bashkëpunimit afatgjatë të suksesshëm bilateral dhe marrëveshjes së bashkëpunimit të nënshkruar në vitin 2023, e cila përcaktoi aktivitetet dhe fushat e bashkëpunimit, u krijuan parakushtet për kryerjen e revizioneve paralele të suksesit, si dhe shkëmbimin e përvojave në drejtim të përmirësimit të proceseve të revizionit në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe praktikat më të mira të vendeve anëtare të BE-së. Rezultatet e arritura të revizionit të parë paralel të kryer "Zhvillimi i barabartë rajonal me theks të veçantë në demografinë" dhe bashkëpunimi i suksesshëm ndërmjet të dy institucioneve, kontribuan që dy institucionet supreme të revizionit në vitin 2023, të zbatojnë revizionin e ri paralel të suksesit, me temë "Gatishmëria e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe e Republikës së Serbisë për zbatimin e Qëllimeve të Zhvillimit të Qëndrueshëm deri në vitin 2030", e cila u zbatua me mbështetjen e Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara (UNDP). Rezultatet e revizionit kooperativ / paralel u prezantuan në evenimentin promovues të mbajtur më 22 maj 2024, në Shkup, të organizuar nga ESHR-ja me mbështetjen e UNDP-së[1].

REPUBLIC OF SLOVENIA
COURT OF AUDIT

### GJYKATA E REVIZIONIT E REPUBLIKËS SË SLLOVENISË

Në shtator 2023, ESHR-ja dhe Gjykata e Revizionit e Republikës së Sllovenisë nënshkruan Memorandum të Bashkëpunimit duke shprehur gatishmërinë e tyre për të forcuar kapacitetet profesionale dhe për të promovuar revizionin e jashtëm llogaridhënës dhe efektiv. Memorandumi fokusohet në shkëmbimin e përvojave dhe praktikave, me angazhim për komunikim të hapur dhe efektiv për aktivitetet e përbashkëta në të ardhmen.

[1] https://dzr.mk/mk/240522-dzr-domakin-na-promotiven-nastan-za-implementacija-na-celite-za-odrzhliv-razvoj-do-2030

Supreme Audit Office of the Slovak Republic

## INSTITUCIONI SUPREM I REVIZIONIT I SLLOVAKISË

Më 6-7 nëntor 2023, ESHR-ja priti delegacionin e ISR-së së Republikës Sllovake, të udhëhequr nga kryetari i ISR-së, z. Lubomir Andrashi. Gjatë kësaj vizite bilaterale, kryerevizorët shtetërorë nënshkruan Memorandum të Bashkëpunimit, me të cilin shprehën gatishmërinë për vazhdimin e bashkëpunimit profesional dhe teknik në fushat me interes të ndërsjellë. Delegacionet shkëmbyen praktika të mira në pjesën e menaxhimit dhe zhvillimit të resurseve njerëzore, edukimit të vazhdueshëm dhe matjes së rezultateve të punës së ISR-së. Delegacionet realizuan takim me Kryetarin e Kuvendit, z. Talat Xhaferi, si dhe me përfaqësuesin e përhershëm të programit z. Armen Grigorjan nga UNDP-ja.

## INSTITUCIONI SUPREM I REVIZIONIT I BOSNJË E HERCEGOVINËS

Në mars 2023, delegacioni i ESHR-së me ftesë të ISR-së së Bosnjë e Hercegovinës realizoi takim bilateral në Sarajevë, gjatë të cilit u nënshkrua Memorandumi i Bashkëpunimit. Gjatë vizitës bilaterale, delegacionet shkëmbyen përvoja dhe praktika të mira për tema me interes. Në qershor 2023, përfaqësuesit e ESHR-së morën pjesë në tryezën e rrumbullakët të organizuar nga ISR-ja e Bosnjë e Hercegovinës dhe SIGMA me temë «Përfshirja e shoqërisë civile për të rritur të kuptuarit dhe ndikimin e ISR-së».

AUDIT ATHORITY

## INSTITUCIONI SHTETËROR I REVIZIONIT I MALIT TË ZI

Delegacioni i ESHR-së mori pjesë në Konferencën Shkencore të Institucionit Shtetëror të Revizionit të Malit të Zi, të organizuar me rastin e 19-vjetorit të themelimit të institucionit, të organizuar në bashkëpunim me SIGMA-n, kryerevizori shtetëror i prezantoi rezultatet e arritura në pjesën e transparencës dhe llogaridhënies së ESHR-së, duke e theksuar vlerën e shtuar të punës së ESHR-së dhe sistemin efikas të komunikimit me palët e interesuara.

## INSTITUCIONI SUPREM I REVIZIONIT TË SHQIPËRISË

Me ftesë të kryetarit të ISR-së së Republikës së Shqipërisë, kryerevizori shtetëror Maksim Acevski dhe kryerevizori i Republikës së Kosovës morën pjesë në kremtimin e 98-vjetorit të themelimit të institucionit të revizionit të Shqipërisë në Tiranë. Bashkëpunimi i suksesshëm ndërmjet institucioneve të revizionit të Shqipërisë, Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut është shembull i bashkëpunimit të mirë fqinjësor dhe profesional. Një nga aktivitetet e përbashkëta më të rëndësishme është revizioni kooperativ me temë "Barazia gjinore e grave në zonat rurale përmes përfshirjes së tyre në tregun e punës", koordinator i të cilit është ESHR-ja dhe është zbatuar me mbështetjen e UN Women. Bashkëpunimi i suksesshëm midis tre ISR-ve vazhdoi edhe me realizimin e punëtorisë së përbashkët me temën e lidershipit, i cili u mbështet nga ISR-ja e Suedisë.

## ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT

ESHR-ja e priti delegacionin e Zyrës Nacionale të Revizionit të Kosovës. Kjo vizitë bilaterale mundësoi shkëmbimin e praktikave pozitive dhe prezantimin e rezultateve të arritura në revizionin shtetëror ndërmjet të dy institucioneve. Kryerevizorët shtetërorë nënshkruan Memorandum të Mirëkuptimit, i cili parashikon aktivitete të përbashkëta për thellimin e bashkëpunimit dhe forcimin e kapaciteteve të të dy institucioneve. Delegacionet, të udhëhequra nga kryerevizorët shtetërorë, realizuan takim me Kryetarin e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Në takim, delegacionet diskutuan për strukturën organizative të institucioneve të revizionit, bashkëpunimin me Kuvendin dhe praktikën e shqyrtimit të raporteve të revizorit në komisionet parlamentare dhe seancat plenare.

## GJYKATA E REVIZIONIT E REPUBLIKËS SË TURQISË

Me ftesë të Gjykatës së Revizionit të Republikës së Turqisë, delegacioni i ESHR-së, i udhëhequr nga kryerevizori shtetëror dhe zëvendëskryerevizori shtetëror, realizoi vizitë bilaterale në ISR të Republikës së Turqisë në qershor 2023. Gjatë vizitës, u nënshkrua Aneksi i marrëveshjes së bashkëpunimit të vitit 2018, me të cilin u forcua bashkëpunimi, veçanërisht në zbatimin e revizioneve të QZHQ-së, ndryshimet klimatike, sigurinë gjatë furnizimit të ushqimit, ekonominë e gjelbër dhe informale, digjitalizimin dhe përdorimin e inteligjencës artificiale në revizionet.

Në kuadër të vizitës u organizua punëtoria shumëditore për shkëmbimin e njohurive në realizimin e Qëllimeve të Zhvillimit të Qëndrueshëm të KB-së, revizionin financiar dhe prezantimin e standardit të ri INTOSAI për menaxhimin e cilësisë. ISR e Turqisë, si një nga institucionet më të mëdha në INTOSAI, do të vazhdojë t'i mbështetë interesat e ESHR-së në nivel ndërkombëtar dhe në këtë drejtim, ESHR-ja u ftua të marrë pjesë si vëzhgues në aktivitetet e ASOSAI-t. Kjo vizitë u mbështet nga TIKA.

Në tetor 2023, ESHR-ja organizoi takim bilateral me kryetarin e Gjykatës së Revizionit të Turqisë. Me qëllim të intensifikimit të bashkëpunimit dhe avancimit të menaxhimit të mjeteve publike, të dy institucionet u angazhuan për marrëdhënie miqësore dhe bashkëpunim të ndërsjellë, veçanërisht në zbatimin e revizioneve, por edhe vendosjen e Qendrës Edukative Rajonale për shkëmbimin e njohurive dhe praktikave të mira.

## ZYRAT SUPREME TË REVIZIONIT TË REPUBLIKËS SË POLONISË DHE REPUBLIKËS ÇEKE.

Në tetor 2023, kryerevizori shtetëror dhe bashkëpunëtorët e tij realizuan takime bilaterale me kryetarët e Zyrave Supreme të Revizionit të Republikës së Polonisë dhe Republikës Çeke.

Në takim, kryerevizori shtetëror dhe kryetari i ISR i Polonisë, z. Marjan Banash, nënshkroi Memorandum të Bashkëpunimit në të cilin përcaktohen aktivitetet në drejtim të thellimit të bashkëpunimit ndërinstitucional, veçanërisht në pjesën e kryerjes së peer-review në punën e ESHR-së, kryerjes së revizioneve të përbashkëta / paralele dhe organizimit të evenimenteve dhe trajnimeve të përbashkëta me interes të ndërsjellë për ISR-në.

Kryetari i ISR-së së Republikës Çeke dhe njëherazi kryetari i EUROSAI-t, z. Miroslav Kala dhe kryerevizori shtetëror nënshkruan Memorandum të Bashkëpunimit gjatë vizitës bilaterale. Ky memorandum parashikon bashkëpunim të vazhdueshëm profesional dhe teknik për avancimin e menaxhimit të financave publike dhe shkëmbimin e praktikave të mira. Të dy institucionet prezantuan sukseset dhe sfidat e tyre dhe ranë dakord për bashkëpunim të mëtejshëm në kuadër të EUROSAI-t.

Përfaqësuesit e të dy institucioneve shprehën gatishmërinë për intensifikimin e mëtejshëm të bashkëpunimit për zhvillimin profesional dhe shkëmbimin e përvojave.

## KËSHILLI NDËRKOMBËTAR I REVIZORËVE TË NATO-S

Me marrjen e statusit të Republikës së Maqedonisë së Veriut si anëtare e plotfuqishme e NATO-s, ESHR-ja si ISR në Republikën e Maqedonisë së Veriut me përfaqësuesit e vet ftohet dhe merr pjesë në takimin e Këshillit Ndërkombëtar të Revizorëve të NATO-s. Në qershor 2023, ESHR-ja me përfaqësuesit e vet nacionalë bashkë me 29 përfaqësuesit nacionalë nga institucionet kompetente nacionale të revizionit që janë anëtare të NATO-s, morën pjesë në takimin që shqyrtoi Raportin Vjetor të Aktiviteteve për Këshillin Ndërkombëtar të Revizorëve të NATO-s për vitin 2022, por edhe diskutuan mbi çështjet e revizionit me interes të përbashkët për pjesëmarrësit.

# Aktivitetet e tjera ndërkombëtare

## INSTITUTI I AUTORIZUAR I FINANCAVE PUBLIKE DHE KONTABILISTËVE

Me ftesë të Institutit të Autorizuar të Financave Publike dhe Kontabilistëve (CIPFA) nga Londra, Britania e Madhe ((Chartered Institute of Public Finance and Accountancy -CIPFA), në periudhën 26-28 qershor 2023, delegacioni i kryesuar nga kryerevizori shtetëror mori pjesë në Konferencën Vjetore me temë «Financat Publike 2023", në Londër, Britania e Madhe.

Si rezultat i zbatimit të suksesshëm të Programit për Parandalimin e Korrupsionit, nga Instituti i Autorizuar i Financave Publike dhe Kontabilistëve më 24 nëntor 2023, kryerevizori shtetëror z. Acevski u shpall anëtar nderi i institutit.

Në të njëjtën kohë, cilësia e rezultateve të demonstruara nga ESHR-ja dhe bashkëpunimi i përsosur midis CIPFA-s dhe ESHR-së bëri që CIPFA të ofrojë kryerjen e akreditimit të ESHR-së për programin e përmendur që është një nga aktivitetet e parimeve të INTOSAI-t P-12 Vlera dhe Dobitë e ISR-së – duke bërë dallimin në jetën e qytetarëve, parimi 12 - ndërtimi i kapaciteteve duke promovuar të mësuarit dhe shkëmbimin e njohurive.

## QENDRA E EKSELENCËS NË FINANCA

Bashkëpunimi i suksesshëm me Qendrën e Ekselencës në Financa (CEF) nga Sllovenia, në përputhje me Memorandumin e Bashkëpunimit të lidhur, vazhdoi edhe në vitin 2023. E ftuar nga Qendra e Ekselencës në Financa (CEF), në uebinar me temë "Institucionet supreme të revizionet transformohen në organizata që mësojnë", ESHR-ja i ndau përcaktimet strategjike, qëllimet dhe praktikat në drejtim të forcimit të resurseve njerëzore përmes përsosjes së vazhdueshme profesionale dhe edukimit të punonjësve, ndërsa me qëllim të sigurimit të cilësisë së lartë të ekzekutimit të kompetencave të ESHR-së si Institucion Suprem i Revizionit në vend. ESHR-ja përdor strategji formale dhe joformale të shkëmbimit të njohurive për të krijuar kulturë dinamike të të mësuarit, në të njëjtën kohë iniciativat e tilla kontribuojnë në rritjen dhe zhvillimin profesional të punonjësve dhe e përmirësojnë bashkëpunimin, duke forcuar aftësinë për t'u përshtatur me sfidat dhe ndryshimet moderne që ndodhin sektorë të ndryshëm.

Në drejtim të rritjes së njohurive, revizorët shtetërorë morën pjesë në një sërë edukimesh në fushën e revizionit të suksesit, menaxhimit të pronës shtetërore, e të tjera.

## 4.2 AKTIVITETET E PROJEKTIT

### TRUPI I KOMBEVE TË BASHKUARA PËR BARAZINË GJINORE DHE FUQIZIMIN E GRAVE

Enti Shtetëror i Revizionit dhe Trupi i Kombeve të Bashkuara për Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Grave (UN VOMEN) vazhduan zbatimin e Memorandumit të Mirëkuptimit dhe Bashkëpunimit edhe në vitin 2023, me qëllim që të dyja palët të bashkëpunojnë në avancimin e zbatimit të detyrimeve për barazi gjinore në përputhje me ligjet dhe politikat nacionale, si dhe detyrimet e ndërmarra ndërkombëtare dhe promovimin e menaxhimit të përgjegjshëm gjinor të mjeteve publike dhe llogaridhënies përmes zbatimit sistematik të buxhetimit të përgjegjshëm gjinor si vegël të krijimit të politikave.

Në drejtim të përmbushjes së qëllimeve të përcaktuara, UN VOMEN ka ofruar mbështetje për revizorët shtetërorë për pjesëmarrje në punëtoritë brenda dhe jashtë vendit, si dhe mbështetje në zbatimin e revizionit të parë kooperativ gjinor të suksesit. Institucionet supreme të revizorit të Maqedonisë së Veriut, si koordinator dhe ISR-ja e Shqipërisë dhe Kosovës në Shkup, në mars 2023, nënshkruan marrëveshje trepalëshe për revizionin kooperativ të suksesit me temë «Barazia gjinore dhe fuqizimi i grave në zonat rurale përmes përfshirjes së tyre në tregun e punës". Kryerevizorët shtetërorë e theksuan rëndësinë e këtij bashkëpunimi, i cili do të mundësojë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës, që do të përmirësojë përgjegjshmërinë ndaj barazisë gjinore dhe fuqizimin e grave në zonat rurale.

Përfaqësuesit e ESHR-së dhe Sekretariati për Çështje Evropiane (SÇE) nga Maqedonia e Veriut, në shtator 2023, morën pjesë në punëtorinë e organizuar nga Qendra e Ekselencës në Financa (CEF) në Lubjanë, Slloveni. Fokusi i punëtorisë ishte promovimi dhe forcimi i veprimit të përbashkët dhe bashkëpunimit të të gjitha institucioneve të përfshira në gjetjen e mbështetjes dhe mënyrave për të promovuar revizionin gjinor dhe përfshirjen e aspekteve gjinore në politikat kryesore, si dhe rritjen e llogaridhënies dhe transparencës ndaj detyrimeve për barazinë gjinore në pajtim me legjislacionin gjinor të BE-së dhe QZHQ-së, përkatësisht QZHQ 5 – Barazinë Gjinore.

Si pjesë e shkëmbimit të njohurive, pjesëmarrësit u njoftuan me të dhënat dhe statistikat gjinore. Roli i Institucioneve Supreme të Revizionit si organizata të përgjegjshme gjinore u theksua si pjesë e Strategjisë për Barazi Gjinore të Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Revizionit (INTOSAI) dhe përkushtimit për të kontribuar në avancimin e barazisë gjinore.

Punëtoria u organizua në kuadër të Projektit «Shërbimet këshillëdhënëse për përfshirjen e perspektivës gjinore të administratës në Maqedoninë e Veriut në nivel qendror - Fondi për Barazi Gjinore (GEF) në Maqedoninë e Veriut», të financuar nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim Ndërkombëtar për Zhvillim (SIDA), ndërsa të zbatuar nga Trupi i Kombeve të Bashkuara për Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Grave UN WOMEN.

Bashkëpunimi i suksesshëm ndërmjet ESHR-së dhe UN WOMEN vazhdoi me nënshkrimin e Memorandumit të ri dyvjeçar të Mirëkuptimit. Memorandumi i nënshkruar i Mirëkuptimit parasheh më shumë fusha të bashkëpunimit të përbashkët, si në vijim:

- Avancimi në zbatimin e detyrimeve për barazi gjinore në përputhje me ligjet dhe politikat nacionale;
- Promovimi i menaxhimit të përgjegjshëm gjinor të mjeteve publike dhe forcimi i llogaridhënies së përdorimit të mjeteve publike për barazinë gjinore, dhe
- Avancimi i kapaciteteve të ESHR-së në kryerjen e revizioneve të suksesit në fushën e barazisë gjinore dhe përfshirja e perspektivës gjinore në praktikat e revizorit.

Enti Shtetëror i Revizionit mori pjesë në mënyrë aktive në Takimin Vjetor të Grupit Këshillëdhënës në Financimin Transformues të Barazisë Gjinore drejt menaxhimit transparent, gjithëpërfshirës dhe llogaridhënies në Ballkanin Perëndimor, që u mbajt në maj 2023, në Shqipëri.

## PROGRAMI PËR ZHVILLIM I KOMBEVE TË BASHKUARA

Enti Shtetëror i Revizionit me Programin për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara (UNDP) në mars 2022 nënshkroi Memorandum të Mirëkuptimit, i cili përcakton një sërë aktivitetesh që do të zbatohen në dy vitet e ardhshme.

Në bashkëpunim me Programin për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara (UNDP), në vitin 2023 janë organizuar një sërë punëtorish për përsosjen dhe edukimin e vazhdueshëm të punonjësve të Entit Shtetëror të Revizionit. Temat trajtuan revizionin e vlerës për paranë, hartimin e Programit Vjetor të Punës së ESHR-së bazuar në Strategjinë Zhvillimore Nacionale, analizën e raporteve financiare dhe analizën e rreziqeve, etj.

Për zbatimin e revizionit paralel të suksesit «Gatishmëria e vendit për t'i zbatuar Qëllimit e Zhvillimit të Qëndrueshëm deri në vitin 2030», i cili u krye në bashkëpunim me ISR-në e Serbisë, UNDP-ja ofroi mbështetje të ekspertëve dhe teknike. Kjo mbështetje mundësoi edhe pjesëmarrjen e revizorëve shtetërorë në punëtoritë brenda dhe jashtë vendit, duke përfshirë edhe takime rajonale dhe vizita studimore, për shkëmbimin e përvojave dhe praktikave të mira me ISR-të e tjera.

Përfaqësuesit e ESHR-së bashkë me kryerevizorin shtetëror morën pjesë në vizitën studimore në Republikën e Armenisë. Fokusi i vizitës studimore u vendos në strukturën institucionale të revizionit shtetëror, mbikëqyrjen parlamentare, menaxhimin e të ardhurave publike, digjitalizimin dhe mënyrën në të cilën përmes bashkëpunimit ndërkombëtar mund të kontribuohet në forcimin e përgjegjësisë, transparencës dhe llogaridhënies së institucioneve publike. Kjo vizitë pune u organizua dhe u mbështet nga UNDP-ja.

## FONDACIONI PËR DEMOKRACI VESTMINSTER NË VEND

Rezultatet e bashkëpunimit shumëvjeçar të suksesshëm ndërmjet ESHR-së dhe Fondacionit për Demokraci Vestminster (VFD) vazhduan edhe me zbatimin e projektit të ri «Praktikoni Demokracinë», i cili filloi në mars 2023 dhe do të zgjasë deri më 31 mars 2025 dhe është financuar nga Ambasada Britanike në Shkup.

Qëllimi i këtij bashkëpunimi të përbashkët është në drejtim të mbështetjes së institucionit në zbatimin e praktikave transparente dhe të përgjegjshme që do të kontribuojnë në punën e koordinuar dhe të përgjegjshme, duke u fokusuar në:

- Avancimin e praktikave të komunikimit të ESHR-së;
- Zhvillimin e strategjisë së komunikimit të ESHR-së;
- Zhvillimin e aktiviteteve për forcimin e praktikave të Value for Money në punën e ESHR-së;
- Sigurimin e mbështetjes së ekspertëve për revizionet e suksesit për të hartuar raporte të revizorit më me ndikim;
- Mbështetjen për zhvillimin e zgjidhjeve digjitale për reduktimin e korrupsionit përmes ndjekjes së prokurimeve publike në komunat dhe institucionet;
- Zbatimin e aktiviteteve që forcojnë kapacitetet e ESHR-së përmes bashkëpunimit vendas dhe ndërkombëtar.

Gjatë vitit 2023, me mbështetjen e VFD-së, janë realizuar aktivitete të shumta që kanë të bëjnë me zbatimin e aktiviteteve të mbetura për zbatimin e Strategjisë së Komunikimit të ESHR-së për vitet 2020 - 2023, duke u fokusuar në komunikimin dhe bashkëpunimin e ESHR-së me institucionet kompetente dhe organizatat qytetare, si dhe aktivitetet për hartimin e Strategjisë së re të Komunikimit të ESHR-së për vitet 2024-2027.

Duke u nisur nga qëllimet strategjike të përcaktuara në Strategjinë Zhvillimore 2023-2027, Enti Shtetëror i Revizionit si institucion që investon në vazhdimësi në zhvillimin individual të punonjësve, VFD-ja ka ofruar mbështetje në zbatimin e Planit Vjetor për Përsosjen e Vazhdueshme Profesionale për vitin 2024, me qëllim të forcimit të aftësive

të revizorëve shtetërorë për revizion, dhe në të njëjtën kohë mundësoi edhe ndjekjen e trajnimit të specializuar të dizajnit grafik për një revizor shtetëror.

Duke njohur rëndësinë dhe ndikimin e revizioneve të kryera të suksesit, VFD-ja ofroi edhe mbështetje të ekspertëve në kryerjen e revizioneve të suksesit "Efikasiteti i procedurave për dhënien e së drejtës së shfrytëzimit të lëndëve të para minerale dhe zbatimi i kontratave të lidhura, me vështrim të veçantë për mermerin" dhe "Efikasiteti i masave, politikave dhe projekteve për plotësimin e kushteve në të cilat funksionojnë konviktet shtetërore të studentëve në RMV dhe zhvillimi i standardit të studentëve", të cilat janë pjesë përbërëse e këtij raporti.

Me mbështetjen e VFD-së, në vitin 2023, Enti Shtetëror i Revizionit dhe Institucioni Nacional i Revizionit të Britanisë së Madhe (NAO) filluan aktivitetet konkrete për intensifikimin dhe thellimin e bashkëpunimit dhe komunikimit përmes realizimit të aktiviteteve të përcaktuara që kanë të bëjnë me trajnimin e revizorëve shtetërorë për zbatimin e revizionit Value for Money (VfM) – "vlera për paranë".

Mbështetja për vendosjen dhe futjen e metodologjisë së re të revizionit të Value for Money (VfM) për ESHR-në u iniciua në vizitën studimore të ekipit drejtues të ESHR-së në Institucionin Nacional të Revizionit (NAO) dhe Parlamentin e Mbretërisë së Bashkuar në prill 2023. Qëllimi i kësaj vizite studimore ishte shkëmbimi i njohurive, përvojave dhe praktikave të mira mbi mënyrën se si Kuvendi e ushtron rolin e tij mbikëqyrës dhe i shqyrton raportet e revizorit, si dhe prezantimin e kompetencave të Komisionit për Llogaritë Publike.

Në kuadër të projektit "Rritja e kapaciteteve për parashikimin dhe parandalimin e korrupsionit duke përdorur analizën e bazave të mëdha të të dhënave dhe algoritmin e mësimit mekanik", VFD-ja ofroi mbështetje në punën e ESHR-së, përmes zhvillimit të zgjidhjes digjitale të dedikuar për vlerësimin e rreziqeve të mundshme të korrupsionit dhe në të njëjtën kohë parandalimi i korrupsionit në prokurimet publike në nivel lokal. Ky projekt realizohet nga Qendra për Inovacione Sociale Blink 42-21 me mbështetjen e Fondacionit për Demokraci Westminster (VFD), në bashkëpunim me ESHR-në.

Riksrevisjonen

## BASHKËPUNIMI ME ZYRËN E KRYEREVIZORIT TË NORVEGJISË

ESHR-ja, në përputhje me memorandumin e nënshkruar të bashkëpunimit për periudhë 5-vjeçare, bashkëpunon me sukses me Zyrën e Kryerevizorit të Mbretërisë së Norvegjisë. Qëllimi i këtij bashkëpunimi është forcimi i kapaciteteve të ESHR-së për të përmbushur mandatin e saj dhe për të kryer revizione me cilësi të lartë, me çka do të promovohet transparenca, llogaridhënia dhe qeverisja e mirë në menaxhimin e mjeteve publike në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Bashkëpunimi përfshiu sektorë dhe lloje të ndryshme të revizioneve ku Zyra e Kryerevizorit të Norvegjisë ka kapacitete relevante dhe mund t'i shtojë vlerë punës së ESHR-së, veçanërisht në pjesën e revizioneve të suksesit. Dy revizione të suksesit me temë «Efikasiteti i procedurave për dhënien e së drejtës së shfrytëzimit të lëndëve të para minerale dhe zbatimi i kontratave të lidhura, me vështrim të veçantë për mermerin», dhe revizioni i TI-së së suksesit «Efektiviteti i Portalit Nacional për e-shërbimet» zbatohet me mbështetjen e kolegëve nga OAGN-ja.

Në kuadër të aktiviteteve të përcaktuara në pjesën e revizionit të TI-së dhe veglave të TI-së në revizionin financiar, ESHR-ja ka bërë progres të dukshëm në ngritjen e kapaciteteve të veta në këto fusha. Në vitin e kaluar, nga OAGN-ja në ambientet e ESHR-së ka zbatuar trajnime për mënyrën e revizionit të kontrolleve dhe konfigurimeve të softuerëve sistematikë të serverëve kryesorë, si një nga më të përdorurit ndër institucionet publike në vend. Më pas u krye trajnimi dhe u zbatuan testime praktike të konfigurimeve të data-bazës së të dhënave të serverit SQL. Për kriteret janë shfrytëzuar programet e revizionit të përgatitura nga OAGN të bazuar në CIS – Center for Internet security, ndërsa si kritere janë marrë praktikat më të mira dhe standardi ISO 27001.

Përfaqësuesit e ESHR-së në periudhën 08.-12.05.2023 morën pjesë në vizitën studimore në zyrën e OAGH-së. Gjatë vizitës studimore u kryen aktivitetet për komponentët e revizionit të TIK-së dhe TI-së në revizionin financiar, për njohjen me fushat ku përdoren teknikat e revizorit dhe çfarë revidohet prej tyre, kriteret për revizionin, lëndën e revizionit, revizionin e kontrolleve për qasjen në të dhënat, programet e zgjeruara të revizionit, zbatimin e trajnimeve për revizorët financiarë për kontrollet e përgjithshme dhe aplikative, si dhe rrjeti i vendosur i revizorëve financiarë në OAGN.

Në kuadër të vizitës janë realizuar edhe aktivitetet e komponentit për zhvillimin e Laboratorit Inovativ në ESHR dhe janë planifikuar aktivitetet e ardhshme.

Rezultati i këtyre aktiviteteve ishte edhe Hakatoni i parë në ESHR, që u mbajt më 08.06.2023. Tema e hakatonit ishte «Nga grumbullimi efikas i të dhënave deri në revizionin efikas». Në këtë eveniment morën pjesë rreth 50 revizorë, të organizuar në disa ekipe. Pas punës ekipore mbi idenë e rritjes së efikasitetit të revizionit duke përdorur teknologji të reja, secili ekip e prezantoi idenë e tij para komisionit të jurisë të përbërë nga anëtarët e OAGN-së dhe ESHR-së, ndërsa komisioni, shpalli një nga idetë si ide fituese.




Në përputhje me aktivitetet e planifikuara në pjesën e Laboratorit Inovativ, në periudhën 27.-30.11.2023 në Shkup u mbajt punëtoria ku morën pjesë përfaqësuesit e OAGN-së dhe ESHR-së. Si rezultat i kësaj punëtorie, u përgatit UEB aplikacioni për analizën e të dhënave nga Byroja e Prokurimeve Publike, që do t'u ndihmojë ndjeshëm revizorëve gjatë revizionit të prokurimeve publike të subjekteve që janë lëndë e revizionit, dhe i cili ishte edhe një nga idetë e Hakatonit. Për nevojat e UEB aplikacionit u konfiguruan dhe u zbatuan cloud Amazon web services.

Për periudhën e ardhshme është bërë plani dhe programi për vazhdimin dhe thellimin e bashkëpunimit të ndërsjellë duke futur dhe përdorur teknika të reja në procesin e revizionit.

Enti Shtetëror i Revizionit, në bashkëpunim me kolegët e ISR-së së Mbretërisë së Norvegjisë, kryen për herë të dytë vetëvlerësimin e integritetit. Pra, në periudhën 29-30 mars 2023, punonjësit e ESHR-së morën pjesë në punëtorinë e vetëvlerësimit të integritetit (IntoSaint). Një pikë e fortë e vetëvlerësimit është se punonjësit e vlerësojnë organizatën e tyre. Punonjësit e kuptojnë se si funksionon organizata dhe për këtë arsye kanë njohuri të shkëlqyera për rreziqet dhe dobësitë e saj. Rezultatet e vetëvlerësimit identifikuan shumë pak rreziqe dhe dobësi, gjë që tregohet nga vlerësimi i ulët dhe devijimi standard i ulët (0,75 mesatarisht për të gjithë klaserët). ESHR-ja ka vendosur sistem të kontrolleve, prej të cilit lloji më efektiv janë kontrollet e buta.

## INSTITUTI DEMOKRATIK NACIONAL

Në vitin 2023, NDI-ja mbështeti më shumë aktivitete të ESHR-së që kishin për qëllim forcimin e mbikëqyrjes buxhetore parlamentare, veçanërisht përmes intensifikimit të bashkëpunimit ndërmjet Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Entit Shtetëror të Revizionit.

Më 3 - 4 prill, me mbështetjen e Fondacionit Nacional për Demokraci nga SHBA-ja (NED), NDI-ja organizoi punëtori dyditore mbi llogaridhënien dhe transparencën e buxhetit me përfaqësuesit e ESHR-së, deputetët e Komisionit për Financim dhe Buxhet, si dhe punonjësit e Shërbimit Parlamen-

tar, ku të pranishmit patën mundësinë të njihen më shumë me Memorandumin e Bashkëpunimit të lidhur ndërmjet Kuvendit dhe ESHR-së, si dhe me punën dhe aktivitetet e ESHR-së. Punëtoria i përcaktoi edhe mundësitë për bashkëpunim më të fortë në të ardhmen dhe fillimin e aktiviteteve mbikëqyrëse bazuar në raportet përfundimtare të revizorit.

Më 5 maj, ESHR-ja nënshkroi Memorandum të Bashkëpunimit me NDI-në, i cili përcaktonte fushat e bashkëpunimit ndërmjet palëve. Fokusi u vendos në mbështetjen dhe forcimin e kapaciteteve të ESHR-së për bashkëpunim efektiv dhe të rregullt me Kuvendin në ushtrimin e mbikëqyrjes së rregullt parlamentare. Përmes mekanizmit të Partneritetit Demokratik të Dhomës së Përfaqësuesve të SHBA-së, më 5 dhe 6 maj, NDI-ja organizoi takime tematike për përmirësimin e kontrollit fiskal dhe mbikëqyrjen e buxhetit në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Përfaqësuesit me përvojë të Kongresit realizuan takim me përfaqësuesit e Entit Shtetëror të Revizionit, ku diskutuan mbi sfidat me të cilat përballet ESHR-ja në lidhje me shqyrtimin e rregullt dhe veprimin sipas raporteve përfundimtare të revizorit nga ESHR-ja, me theks në pushtetin ligjvënës.

Më 7 qershor, NDI-ja organizoi punëtori online për përfaqësuesit e ESHR-së mbi Praktikat e Llogaridhënies në Tranzicionet Ekzekutive në bashkëpunim me Shërbimin Qeveritar Amerikan të Llogaridhënies (GAO) dhe Qendrën për Tranzicionet Presidenciale të SHBA-së. Në këtë trajnim, ekspertët amerikanë ndanë përvojat relevante gjatë zbatimit të aktiviteteve gjatë periudhës së tranzicionit të pushtetit, me qëllim të garantimit të llogaridhënies, transparencës dhe menaxhimit më efikas të resurseve, administratës dhe financave, duke siguruar kështu stabilitet dhe vazhdimësi në punën e institucioneve.

Me mbështetjen e NED-së, më 30 qershor, NDI-ja zhvilloi edhe punëtorinë njëditore mbi Bashkëpunimin e Kuvendit dhe Entit Shtetëror të Revizionit (ESHR). Në punëtori, punonjësit e Zyrës Buxhetore të Kuvendit (ZBK), Instituti Parlamentar, Departamenti i Revizionit të Brendshëm dhe këshilltarët nga Komisioni për Financim dhe Buxhet patën mundësinë të njihen me punën dhe llojin, strukturën dhe përmbajtjen e raporteve të ESHR-së, dhe u vendosën dhe kontaktet ndërmjet institucioneve për bashkëpunim më intensiv të mëtejshëm. Nëpërmjet Programit të Mbështetjes Parlamentare, të financuar nga Zvicra, NDI-ja organizoi edhe punëtorinë e dytë mbi Transparencën Llogaridhënëse Buxhetore më 18-19 tetor, në të cilin anëtarëve të Komisionit për Financim dhe Buxhet iu prezantua Raporti Përfundimtar për revizionin e kryer të pajtueshmërisë me temën Buxheti Themelor i Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2022 nga kryerevizori shtetëror dhe analiza gjithëpërfshirëse e llogarisë përfundimtare të buxhetit për vitin 2022 nga Zyra Buxhetore e Kuvendit (ZBK).

International Foundation for Electoral Systems

## FONDACIONI NDËRKOMBËTAR PËR SISTEMET ZGJEDHORE

Me Memorandumin e Bashkëpunimit ndërmjet Entit Shtetëror të Revizionit dhe Fondacionit Ndërkombëtar për Sistemet Zgjedhore (IFES) në vendin tonë, të nënshkruar në janar 2023, me mbështetjen financiare të USAID-it, u vendosën themelet e bashkëpunimit të fokusuara në fushën e antikorrupsionit dhe integritetit.

Qëllimi i këtij bashkëpunimi është:

- rritja e efektivitetit të punës së ESHR-së në kryerjen e funksioneve të rregullta të revizorit, veçanërisht në lidhje me menaxhimin e rreziqeve nga korrupsioni, komunikimi / marrëdhëniet me publikun,
- avancimi i digjitalizimit përmes veglave inovative dhe zgjidhjeve softuerike, dhe
- përmirësimi i transparencës dhe llogaridhënies në fushën e financimit politik.

Me qëllim të transparencës dhe llogaridhënies më të madhe, si dhe promovimit sa më të suksesshëm të rezultateve në drejtim të rritjes së ndërgjegjësimit për fushat e korrupsionit dhe gjendjet e konstatuara dhe punën e ESHR-së, punonjësit patën mundësinë të njihen me sfidat më thelbësore në komunikimin me mediat.

Në vitin 2023, bashkëpunimi i suksesshëm i ESHR-së me Institutin e Autorizuar të Financave Publike dhe Kontabilitetit (CIPFA) dhe Fondacionin Ndërkombëtar për Sistemet Zgjedhore (IFES) rezultoi në zbatimin me sukses të Programit për Parandalimin e Korrupsionit. Nga gjithsej 126 punonjës të certifikuar në sektorin publik, 101 punonjës janë nga ESHR-ja që kanë marrë Certifikatë Ndërkombëtare për Menaxhimin e Rreziqeve nga

Korrupsioni dhe nga gjithsej 18 persona, 17 punonjës janë nga ESHR-ja që kanë marrë certifikatat për trajnues.

Si pjesë e këtij programi, programi i specializuar edukativ për parandalimin e korrupsionit i dedikuar për menaxhmentin e ESHR-së, në periudhën 9-13 tetor 2023, mori pjesë në vizitën studimore në Londër, Britania e Madhe. Menaxhimi i rreziqeve nga korrupsioni, planifikimi strategjik, praktikat e revizorit, analiza e të dhënave, vizualizimi i të dhënave, mësimi makinerik, shkëmbimi i praktikave të mira në financat publike janë një pjesë e temave të trajtuara në këtë vizitë studimore. Në kuadër të kësaj vizite studimore, delegacioni realizoi takim edhe me kryerevizorin e ISR-së së Uellsit, z. Adrian Krompton, ku diskutuan mbi veglat novatore për analizën e të dhënave dhe përdorimin e mediave sociale.

Programi për Parandalimin e Korrupsionit u hartua dhe u përgatit si program ambicioz nga Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin (UNODC) dhe Instituti i Autorizuar për Financat Publike dhe Kontabilitetin - CIPFA, ndërsa i mbështetur nga Fondacioni Ndërkombëtar për Sistemet Zgjedhore IFES dhe USAID.

Mbështetje u sigurua edhe për pjesëmarrjen e delegacionit të ESHR-së në Takimin Vjetor të Grupit të Punës të INTOSAI-t për Borxhin Publik, që u mbajt në Egjipt. Enti Shtetëror i Revizionit në këtë eveniment i prezantoi projektet nga viti 2020 deri në vitin 2022 ku ai ishte drejtues i projektit.

Në kuadër të aktiviteteve të përcaktuara të projektit, 7 revizorët shtetërorë e vizituan akademinë e data science me qëllim të përmirësimit të aftësive të tyre analitike, të cilat janë aftësi kryesore për analizën e të dhënave që u mundësojnë atyre të përballen më lehtë me problemet e biznesit duke marrë vendime në mënyrën më efikase. Po ashtu, 3 punonjës të ESHR-së e përfunduan me sukses Akademinë e Dizajnit Grafik, me qëllim të prezantimit sa më të mirë të gjendjeve të konstatuara në raportet e revizorit. Gjithashtu, me mbështetjen e IFES-it dhe me qëllim të përmirësimit të kapaciteteve të ESHR-së për revizion, u zhvillua platforma e re e mësimit online dhe u zhvillua e-trajnimi i parë për revizionin e suksesit.

ESHR-ja mori pjesë aktive edhe në punëtoritë për njoftimin financiar dhe transparencën e partive politike, në të cilat morën pjesë edhe partitë politike, organizatat qytetare, mediat dhe të tjera.



## 4.3 INTEGRIMI NË BE

Në korrik 2022, BE-ja e filloi fazën e hapjes së negociatave aderuese me Republikën e Maqedonisë së Veriut, bazuar në vendimin afirmativ të miratuar nga Këshilli i Evropës në vitin 2020 dhe Kornizën e miratuar për negociata nga korriku 2022, e cila është në përputhje me Metodologjinë e reviduar të negociatave. Me qëllim t'i përgjigjemi në mënyrë adekuate kësaj sfide, punonjësit e Entit Shtetëror të Revizionit morën pjesë në një sërë trajnimesh, takimesh shpjeguese dhe përgatitore, të orientuar drejt mbështetjes dhe përgatitjes për skriningun bilateral. Klasteri i Vlerave Fondamentale, si klasteri i parë dhe më i rëndësishëm, i mbulon pesë kapitujt që lidhen me sundimin e së drejtës:

- Kapitulli 23 - Gjyqësori dhe të drejtat fondamentale;
- Kapitulli 24 - Drejtësia, liria dhe siguria;
- Kapitulli 5 - Prokurimet publike;
- Kapitulli 18 - Statistika;
- Kapitulli 32 - Kontrolli financiar, por edhe;
- Fushat e funksionimit të institucioneve demokratike dhe reforma e administratës publike dhe menaxhimit të financave publike.

Enti Shtetëror i Revizionit bashkëpunon në mënyrë aktive me të gjitha organet shtetërore në drejtim të parandalimit dhe reduktimit të korrupsionit, në kuadër të Protokollit të Bashkëpunimit për Parandalimin dhe Represionin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesave, si dhe merr pjesë në zbatimin e Programit Nacional për miratimin e së drejtës së Bashkimit Evropian (NPAA) përmes aktiviteteve të parashikuara në Kapitullin 23 Gjyqësori dhe të drejtat fondamentale, Fusha - Politika kundër korrupsionit dhe Kapitulli 32 Kontrolli financiar, Fusha - Revizioni i jashtëm, si dhe në punën e organeve dhe trupave të tjerë për parandalimin e korrupsionit.

Enti Shtetëror i Revizionit është pjesë e familjes së organeve të tjera shtetërore që e përbëjnë "Trupin Ndërresor të Koordinimit të Aktiviteteve kundër Korrupsionit". Ky trup ka për detyrë t'i koordinojë aktivitetet e të gjitha organeve kompetente për luftën kundër korrupsionit, për të forcuar bashkëpunimin e ndërsjellë dhe njoftimin reciprok, për të shkëmbyer informacione dhe të dhëna dhe për të zbatuar rekomandimet e përmbajtura në raportet e GREKO-s të Këshillit të Evropës dhe organizatave të tjera ndërkombëtare.

# 5

# REVIZIONET E KRYERA

# REVIZIONET PËRMES NUMRAVE
## PROGRAMI VJETOR PËR PUNËN E ESHR-SË PËR VITIN 2023

| | | |
|---|---|---|
| **80** | **11** | **4** |
| Raportet e revizorit për Revizionin e Rregullshmërisë | Raportet e revizorit për Revizionin e Suksesit | Revizioni i pajtueshmërisë si lloj i veçantë i revizionit |
| **4** | **2** | **100** |
| Raportet e revizorit për zbatimin e rekomandimeve | Revizioni i TI-së | Raportet e revizorit të dorëzuara te subjektet lëndë të revizionit |
| **18** | **10** | **18** |
| Raportet e revizorit të dorëzuara te Prokurori Publik i Republikës së Maqedonisë së Veriut | Raportet e revizorit të dorëzuara te Zëvendëskryetari i Qeverisë i ngarkuar për politika të qeverisjes së mirë | Raportet e revizorit të dorëzuara në Komisionin Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit në përputhje me nenin 85-b nga Kodit Zgjedhor |
| **1** | **100** | **140** |
| Raportet e revizorit të dorëzuara në Drejtorin e të Ardhurave Publike | Raportet e revizorit të dorëzuara në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut | Subjektet e përfshira nga revizioni |
| **957** [13] | **365.025** | **395.961** |
| Gjetjet dhe çështjet në raportet e revizorit | Të ardhurat publike të përfshira nga revizioni (në milionë) | Shpenzimet publike të përfshira nga revizioni (në milionë) |
| **697** | **43** | **1.778** |
| Rekomandimet në raportet e revizorit | Efektet financiare nga revizioni/ mjetet e paguara gjatë revizionit (në milionë) | Vlera tjetër e shtuar e revizionit (në miliona) |

[13] Në numrin e gjetjeve dhe çështjeve në raportet e revizorit përmban edhe 17 çështje të tjera që përsëriten në raportet përfundimtare të revizorit për të gjithë 18 pjesëmarrësit në fushatën zgjedhore për zgjedhjet lokale 2022.

| 30 | 60 | 2.145.513 |
|---|---|---|
| Kontrollet e kryera për të përcaktuar statusin e rekomandimeve të dhëna në raportet përfundimtare të revizorit (follow up) | Raportet e lëshuara për kontrollet e zbatuara për të përcaktuar statusin e rekomandimeve të dhëna në raportet përfundimtare të revizorit (follow up) | Aktiva/Pasiva e reviduara nga Bilanci i Gjendjes (në miliona) |
| **5.003** | **3.643** | **1.001** |
| Tatimet / kompensimet publike të papaguara / më pak të paguara në Buxhetin e shtetit (në miliona) | Kompensimet e papaguara / më pak të paguara në Buxhetin e komunave të reviduara (në miliona) | Përdorimi i paligjshëm i mjeteve (në miliona) |
| **28.262** | **19.950** | **3.844** |
| Shuma totale e prokurimeve publike (në milionë) | Përfshirja e prokurimeve publike me revizionin (në milionë) | Shuma totale e parregullsive të konstatuara në prokurimet publike (në milionë) |
| **15** | **38.872** | **58.057** |
| Prokurimet e kryera për të cilat nuk është zbatuar procedura për prokurimet publike (në milionë) | Regjistrimet korrigjuese në Bilancin e Gjendjes (në miliona) | Gjendjet e konstatuara që ndikojnë në veprimtarinë e subjektit që është lëndë e revizionit dhe investimet kapitale (në miliona) |
| **5.102** | **1.495** | **1.812** |
| Grantet e anuluara/të humbura (në miliona) | Vlera e kërkesës së padisë në proceset gjyqësore në të cilat subjekti lëndë i revizionit shfaqet në rolin e të paditurit dhe paditësit | Provizionet e paguar për fondet e patërhequra nga kreditë/huatë (në miliona) |
| **32** | **62** | **37** |
| Tatimi mbi fitim më pak të llogaritur (në miliona) | Kontributet më pak të llogaritura (në miliona) | Shuma e procedurave të humbura gjyqësore (në miliona) |

# REVIZIONET PËRMES NUMRAVE

**100** RAPORTET E REVIZORIT

## OPINIONE NGA REVIZIONET REVIZIONI I RREGULLSHMËRISË

**79** opinione për raportet financiare
- **31** pa rezervë
- **12** me rezervë
- **30** opinione të pavolitshëm
- **6** refuzim opinioni

**72** opinione për pajtueshmërinë me ligjet dhe rregullat
- **24** pa rezervë
- **18** me rezervë
- **28** opinione të pavolitshme
- **2** refuzim opinioni

## KONKLUZIONET REVIZIONI I PAJTUESHMËRISË / REVIZIONI I SUKSESIT/ REVIZIONI I ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE

- **4** konkluzionet për revizionin e pajtueshmërisë
- **9** konkluzionet për revizionin e suksesit
- **2** konkluzionet për revizionin e TI-së
- **4** konkluzion për revizionin e zbatimit të rekomandimeve (follow up)

## 957 GJETJET DHE ÇËSHTJET E DETEKTUARA NGA REVIZIONET

- **593** revizioni i rregullshmërisë
- **215** revizioni i suksesit
- **122** revizioni i pajtueshmërisë
- **27** revizioni i TI-së

## 140 SUBJEKTE TË PËRFSHIRA ME REVIZION

- **29** revizioni i rregullshmërisë
- **74** revizioni i suksesit
- **13** revizioni i pajtueshmërisë
- **2** revizioni i TI-së
- **18** pjesëmarrësit në fushatën zgjedhore Zgjedhjet Lokale
- **4** revizioni i zbatimit të rekomandimeve

## 37 DOBËSI TË KONSTATUARA NË GJETJET TË PROKURIMET PUBLIKE

**VLERA TOTALE E KONTRATAVE TË DHËNA PËR PROKURIMET PUBLIKE**
28.261.918
në 000 denarë

**PROKURIMET PUBLIKE TË REVIDUARA**
19.950.492
në 000 denarë

**3.844.205** PARREGULLSITË E KONSTATUARA NË PROKURIMET PUBLIKE
në 000 denarë

**14.952** PROKURIME TË KRYERA PËR TË CILËT NUK ËSHTË ZBATUAR PROCEDUR PËR PROKURIME PUBLIKE
në 000 denarë

- dobësi në realizimin e kontratave të lidhura sipas prokurimeve publike
- moszbatimi i procedurave për prokurimet publike
- dobësi në planifikimin e prokurimeve publike
- parregullsi në përgatitjen e dokumentacionit të tenderit / specifikimit teknik
- dobësi në fazën e kontratave të lidhur me ofertuesit e përzgjedhur

[2] Numri i mendimeve për pajtueshmërinë me ligjet dhe rregullat është më i ulët krahasuar me numrin e mendimeve për raportet financiare, duke pasur parasysh se në raportet përfundimtare të revizorit për revizionet e kryera të raporteve financiare dhe revizionin e pajtueshmërisë për llogaritë e të ardhurave të buxhetit të dotacioneve (930) për 8 njësitë e vetëqeverisjes lokale dhe Qytetin e Shkupit, mendimi për pajtueshmërinë me ligjet dhe rregullat sipas shfrytëzuesve është shprehur në raportet e revizorit gjatë revizionit të shfrytëzuesit adekuat të dotacioneve me dedikim.

# TË ARDHURAT DHE SHPENZIMET

**GJITHSEJ 365.025 MILIONË DENARË të ardhura publike të reviduara dhe 395.961 MILIONË DENARË shpenzime publike të reviduara me Programin Vjetor të Punës së ESHR-së për vitin 2023.**

Në krahasim me Programin Vjetor të Punës së ESHR-së për vitin 2022, është arritur një rritje evidente të të ardhurave publike të reviduara në:

- buxhetet e fondeve për 12.765 milion denarë, gjegjësisht 10% më shumë në krahasim të vitit të kaluar;
- shfrytëzuesit e mjeteve nga buxheti i FSSH-së për 685 milionë denarë, gjegjësisht 66% më shumë se vitin e kaluar; dhe
- ndërmarrjet publike për 13.022 milion denarë që është për reth 9 herë më shumë se vitin e kaluar.

Në krahasim me Programin Vjetor të Punës së ESHR-së për vitin 2022, është shënuar rritje totale të shpenzimeve publike të reviduara për 111.122 milion denarë, që paraqet rritje të konsiderueshme për 39%. Janë të konsiderueshme rritjet e shpenzimeve publike të reviduara për llojet e mëposhtme të subjekteve dhe revizioneve:

- buxhetet e fondeve për 13.887 milion denarë, gjegjësisht 12% krahasim të vitit të kaluar:
- shfrytëzuesit e mjeteve nga buxheti i FSSH-së për 706 milionë denarë, gjegjësisht 70% më shumë se vitin e kaluar;
- ndërmarrjet publike për 9.238 milion denarë, që është mbi 6 herë më shumë se vitin e kaluar;
- shpenzimet publike të përfshira me revizionin e suksesit për 118.091 milion denarë, që është për 3 herë më shumë se vitin e kaluar; dhe
- shpenzimet publike të përfshira me revizionin e pajtueshmërisë si lloj i veçantë i revizionit në vlerë prej 47.210 milion denarë, që është rritur për 16 herë në krahasim me vitin e kaluar.

# TË ARDHURAT DHE SHPENZIMET PUBLIKE **TË REVIDUARA**

GJITHSEJ **365.025 MILIONË DENARË** të ardhura publike të reviduara dhe **395.961 MILIONË DENARË** shpenzime publike të reviduara me Programin Vjetor të Punës së ESHR-së për vitin 2023.

| | Të ardhurat publike të reviduara | Shpenzimet publike të reviduara |
|---|---|---|
| Buxheti Qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut | 203.174<br>227.343 | 15.619<br>79.847 |
| Buxhetet e fondeve | 135.804<br>123.039 | 129.629<br>115.742 |
| Buxhetet e NJVL-së | 5.243<br>12.515 | 4.888<br>11.536 |
| Shfrytëzuesit e mjeteve nga buxheti i FSSH-së | 1.730<br>1.045 | 1.720<br>1.014 |
| Pjesëmarrësit në fushatën zgjedhore – Zgjedhjet Lokale | 19<br>766 | 19<br>734 |
| Ndërmarrjet publike | 14.681<br>1.659 | 10.947<br>1.709 |
| Institucionet e tjera / Personat juridikë në të cilët shteti është aksionar dominues | 1.523<br>8.134 | 1.539<br>7.958 |
| Të përfshira nga revizionet e pajtueshmërisë | 0<br>1.685 | 50.446<br>3.236 |
| Të përfshira nga revizionet e suksesit | 2.851<br>35.322 | 181.154<br>63.063 |

Programi Vjetor 2023    Programi Vjetor 2022    në 000.000 denarë

Fushëveprimi i shpenzimeve të reviduara të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2022 është 84%, që është për 2% më shumë në krahasim me vitin e kaluar. Në strukturën e shpenzimeve të reviduara përfshihen shpenzimet me revizionet e rregullshmërisë në shumë prej 146.987 milionë denarë, përkatësisht 63%, shpenzimet me revizionin e suksesit të zbatuara në përputhje me Programet Vjetore të Punës së ESHR-së për vitin 2022 dhe vitin 2023 në shumë të përgjithshme prej 53.754 milionë denarë, përkatësisht 23% dhe shpenzimet me revizionet e pajtueshmërisë në shumë prej 34.025 milionë denarë, përkatësisht 14%.

**PËRFSHIRJA E BUXHETEVE NËPËRMJET SHPENZIMEVE TË REVIDUARA**

| Shpenzimet e reviduara sipas llojeve të buxheteve (në milionë denarë) | Realizimi i buxhetit për vitin 2022 | I reviduar | Pjesëmarrja në |
|---|---|---|---|
| 1 | 2 | 3 | 4 |
| **Shpenzimet e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2022**<br><br>(Llogaria Përfundimtare e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2022 "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut", nr. 272/2023) | 278.596 | 234.766 | 84 |
| **Buxhetet e Njësive të Vetëqeverisjes Lokale** | 37.754 | 4.888 | 13 |

# REKOMANDIMET DHE ZBATIMI I TYRE

Në përputhje me Ligjin për revizionin shtetëror, përfaqësuesi ligjor i subjektit është i detyruar të njoftojë ESHR-në dhe organin kompetent për mbikëqyrjen dhe kontrollin, për masat e ndër-marra në lidhje me gjetjet dhe rekomandimet në raportet e revizorit, brenda 90 ditëve nga dita e marrjes së raportit përfundimtar. ESHR-ja e ndjek zbatimin e rekomandimeve të dhëna në raportet e revizorit në kuadër të kryerjes së revizioneve të rregullta, kontrolleve dhe revizioneve të zbatimit të rekomandimeve, si dhe nëpërmjet informacioneve të marra nga subjektet.

## 2023

**697** GJITHSEJ REKOMANDIMET E DHËNA

▲ **300** REKOMANDIMET PËR TË CILAT KA KALUAR AFATI PREJ 90 DITË PËR DËRGIMIN E INFORMACIONIT KTHYES

▲ **397** REKOMANDIMET PËR TË CILAT NUK KA KALUAR AFATI PREJ 90 DITË PËR DËRGIMIN E INFORMACIONEVE KTHYESE

▲ **111** REKOMANDIMET PËR TË CILAT STATUSI NUK ËSHTË PËRCAKTUAR PAVARËSISHT SE KA KALUAR AFATI PREJ 90 DITË PËR DËRGIMIN E INFORMACIONIT KTHYES

**71%** VEPRUAR SIPAS REKOMANDIMEVE

**189** REKOMANDIMET ME STATUS TË PËRCAKTUAR

**135** REKOMANDIMET SIPAS TË CILAVE JANË NDËRMARRË MASAT

**53** nuk janë të zbatuar

**1** Të pazbatueshme

# 2022

**775** REKOMANDIME TË DHËNË

▲ 775 REKOMANDIMET PËR TË CILAT KA KALUAR AFATI PREJ 90 DITË PËR DËRGIMIN E INFORMACIONIT KTHYES

▲ 131 REKOMANDIMET PËR TË CILAT STATUSI NUK ËSHTË PËRCAKTUAR PAVARËSISHT SE KA KALUAR AFATI PREJ 90 DITË PËR DËRGIMIN E INFORMACIONIT KTHYES

**75%** VEPRUAR SIPAS REKOMANDIMEVE

**644** REKOMANDIMET ME STATUS TË PËRCAKTUAR

**483** REKOMANDIMET SIPAS TË CILAVE JANË NDËRMARRË MASAT

**143** nuk janë të zbatuar

**18** Të pazbatueshme

# 2021

**654** REKOMANDIME TË DHËNË

▲ 654 REKOMANDIMET PËR TË CILAT KA KALUAR AFATI PREJ 90 DITË PËR DËRGIMIN E INFORMACIONIT KTHYES

▲ 46 REKOMANDIMET PËR TË CILAT STATUSI NUK ËSHTË PËRCAKTUAR PAVARËSISHT SE KA KALUAR AFATI PREJ 90 DITË PËR DËRGIMIN E INFORMACIONIT KTHYES

**81%** VEPRUAR SIPAS REKOMANDIMEVE

**608** REKOMANDIMET ME STATUS TË PËRCAKTUAR

**491** REKOMANDIMET SIPAS TË CILAVE JANË NDËRMARRË MASAT

**111** nuk janë të zbatuar

**6** Të pazbatueshme



# 5.1. VLERA E SHTUAR NGA REVIZIONET

Me Programin Vjetor të Punës së Entit Shtetëror të Revizionit për vitin 2023, përcaktohen aktivitetet prioritare në drejtim të arritjes së qëllimeve dhe detyrave për punën e Entit Shtetëror të Revizionit, përkatësisht arritjes së qëllimeve strategjike të institucionit.

Aktivitetet e marra për arritjen e qëllimeve strategjike sigurojnë fushëveprim adekuat të mjeteve publike të revidiuara, rritjen e njohurive dhe aftësive të punonjësve, kryerjen e revizionit të suksesit të programeve dhe projekteve të ndryshme që janë në funksion të arritjes së llogaridhënies dhe menaxhimit të mirë, kontrollimin e rezultateve në lidhje me ekonomizimin, efikasitetin dhe efektivitetin e aktiviteteve të sektorit publik, informimin e palëve të interesuara dhe publikun për situatat e konstatuara në raportet përfundimtare të revizorit dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve të cilat sektori publik ka detyrime ti siguron për personat fizik dhe juridik. Rezultatet kryesore të punës së Entit Shtetëror të Revizionit për vitin 2023 mund të shihen në:

- mbështetjen e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut në përmbushjen e kompetencave të tij përmes identifikimit dhe prezantimit të parregullsive, rasteve të punës kundërligjore dhe rasteve të mundshme të korrupsionit dhe keqpërdorimit të funksionit;
- dhënien e rekomandimeve të qarta dhe efektive për institucionet shtetërore dhe institucionet e tjera nga sektori publik në avancimin e menaxhimit të mjeteve publike;
- dhënien e kontributit në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies në përdorimin e mjeteve publike / mjeteve të tatimpaguesve, dhe në këtë mënyrë edhe përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut përmes ofrimit të shërbimeve me respektimin e parimeve të sigurisë në ofrimin e shërbimeve, vazhdimësinë dhe cilësinë e shërbimit, transparencën, disponueshmërinë dhe shërbimin universal, mbrojtjen e shfrytëzuesve dhe qytetarëve;
- konstatimin e situatave të evazionit tatimor, mospagesës së tatimeve publike dhe kompensimeve në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, me çka ESHR-ja siguron kthimin e mjeteve të investuara nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut në ESHR;
- revizionin e dhënies së kontratave për PP me theks të veçantë në dhënien e kontratave për PP në kushte të krizës energjetike;
- ofrimin e udhëzimeve për mënyrën e planifikimit të investimeve kapitale, sigurimin e mjeteve të nevojshme dhe ndjekjen e realizimit të tyre (me vështrim të veçantë për mjetet e ofruara nga kreditorët ndërkombëtarë) dhe përcaktimin e efekteve të këtyre investimeve;
- ndjekjen e shkallës së ngarkimit me borxh dhe kontributin në mënyrën e menaxhimit të financave publike.

## **REZULTATET KYÇE**
## NGA PUNA E ENTIT SHTETËROR TË REVIZIONIT;

në 000 denarë

VLERA E SHTUAR E REVIZIONEVE

**2.145.513.095**
Totali i aktivës/pasivës

**5.030.418**
Kompensimet/ detyrimet publike/të papaguara/ më pak të paguara/në Buxhetin e shtetit

**3.642.901**
Kompensimet e papaguara më pak të paguara në Buxhetin e komunave të reviduara

**1.001.206**
Përdorimi i mjeteve në kundërshtim me ligjin

**28.261.918**
Shuma totale e prokurimeve publike

**19.950.492**
Përfshirja e PP-së me revizionet

**3.844.205**
Shuma e përgjithshme nga parregullsitë e konstatuara te PP

**43.252**
Efektet financiare nga revizionet /mjete të paguara gjatë revizionit

**14.952**
Prokurimet e kryera për të cilat nuk është zbatuar procedura për PP

**38.871.654**
Evidentimet korrektuese në Bilancet e gjendjes

**58.057.372**
Gjendjet e konstatuara që ndikojnë në veprimtarinë e subjektit që është lëndë e revizionit dhe investimet kapitale

**5.102.327**
Grantet e anuluara/të humbura

**36.914**
Shuma nga procedurat e humbura gjyqësore

**31.764**
Tatimi mbi të ardhurat personale më pak të llogaritura

**1.812.484**
Komisionet e paguar për fondet e patërhequra nga kreditë/huatë

**1.495.383**
Vlera e kërkesës së padisë në proceset gjyqësore në të cilat subjekti lëndë i revizionit shfaqet në rolin e të paditurit dhe paditësit

**61.985**
Kontributet më pak të llogaritura

**1.777.913**
Vlera tjetër e shtuar e revizionit



## 5.2. BUXHETI I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

### 5.2.1. BUXHETI THEMELOR I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT PËR VITIN 2022

Menaxhimi i financave publike është një nga prioritetet kryesore të shtetit, i cili mundëson sigurinë financiare dhe qëndrueshmërinë e financave publike. Duke marrë parasysh rëndësinë ekonomike, sociale dhe politike të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, planifikimi, përgatitja, miratimi dhe realizimi i tij imponohet si domosdoshmëri e menaxhimit profesional dhe ka për qëllim ruajtjen e stabilitetit makroekonomik dhe zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik nacional, si dhe përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Konstatuam se gjatë **planifikimit, përgatitjes dhe miratimit** të Buxhetit për vitin 2022, dokumentet themelore të planit janë miratuar brenda afateve ligjore me vonesë të parëndësishme në miratimin e Vendimit për përcaktimin e prioriteteve strategjike të Qeverisë në vitin 2022.

Kemi bërë analizën e 20% të kërkesave buxhetore të dorëzuara nga shfrytëzuesit buxhetorë të pushtetit qendror në MF dhe kemi konstatuar se përgatitja e Buxhetit për vitin 2022, ashtu si edhe në vitet e kaluara, është bërë në bazë të dokumentacionit jo të plotë të dorëzuar nga shfrytëzuesit buxhetorë, ndërsa Ministria e Financave nuk ka dorëzuar Raport për kërkesat buxhetore të paharmonizuara në Qeveri. Situatat e konstatuara tregojnë për nevojën e përforcimit të vazhdueshëm të aktiviteteve për kompletimin e kërkesave buxhetore nga shfrytëzuesit buxhetorë me planet strategjike, me qëllim të harmonizimit me qëllimet strategjike të Qeverisë dhe avancimin e cilësisë së procesit të përgjithshëm të planifikimit të buxhetit të shtetit.

Buxheti themelor për vitin 2022 (llogaria 637) i **miratuar** në shumë prej 181.941.600 mijë denarë është më i vogël për 29% në krahasim me mjetet e kërkuara nga shfrytëzuesit buxhetorë dhe 7% më i vogël në krahasim me Buxhetin e vitit 2021. Me ribalancin e buxhetit nga korriku 2022 dhe me dy Vendime për rindarjen e mjeteve ndërmjet shfrytëzuesve buxhetorë të pushtetit qendror dhe ndërmjet fondeve nga nëntori 2022, u bënë ndryshime në projeksionet fiskale iniciale për Buxhetin për vitin 2022, me çka Buxheti i sapomiratuar prej 196.000.184 mijë denarë është për 8% më i madh në krahasim me sa ishte planifikuar fillimisht. Rritjet në pjesën e të ardhurave janë me qëllim të optimizimit të burimeve të financimit të deficitit buxhetor, ndërsa rritjet në pjesën e shpenzimeve synojnë realizimin e një pjese të masave të Qeverisë për tejkalimin e pasojave nga kriza energjetike.

Lartësia e mjeteve buxhetore që planifikohen çdo vit në Buxhet për shfrytëzues të caktuar buxhetorë rregullohet me ligje të tjera materiale. Kemi konstatuar që edhe në vitin 2022 financimi i tyre nuk është në shumat e përcaktuara me ligj:

## PUSHTETI GJYQËSOR

në 000 denarë




Mjetet e miratuara për financimin e **Pushtetit Gjyqësor** në shumë prej 2.336.087 mijë denarë paraqesin 0,3% të BPV-së dhe ato janë për 63% më pak se limiti i përcaktuar me ligj dhe më pak për gati 925.000 mijë denarë se nevojat e shprehura në kërkesën buxhetore.

## PROKURORIA PUBLIKE

në 000 denarë




Mjetet e miratuara për Prokurorinë Publike në shumë prej 642.832 mijë denarë paraqesin 0,21% nga mjetet e Buxhetit për vitin 2022, përkatësisht dy herë më pak se mjetet e përcaktuar me ligj dhe janë për 61% më pak se nevojat e shprehura në kërkesën buxhetore.

**Nënprogrami OA - Zhvillimi i barabartë rajonal**: është e nevojshme të sigurohet të paktën 1% e BPV-së dhe ato të realizohen përmes programeve vjetore të parashikuara në buxhetet e Ministrisë së Vetëqeverisjes Lokale dhe Byrosë së Zhvillimit Rajonal. Për realizimin e këtij programi në vitin 2022 janë miratuar mjetet në shumë prej 0,09% të BPV-së, që nuk paraqet ndryshim të dukshëm në krahasim me vitin 2021, kur ai ishte 0,07%.

Me revizionin e **menaxhimit** të Buxhetit të RMV-së, kemi konstatuar se Ministria e Financave e kryen projeksionin e Buxhetit në përputhje me Metodologjinë GFS të FMN-së, si tabelë për paraqitjen e të ardhurave dhe shpenzimeve sipas llojeve dhe për përcaktimin e deficitit të shtetit në bazë të parave të gatshme. Buxheti është projektuar për të gjithë shfrytëzuesit buxhetorë dhe fondet, për të gjitha llojet e llogarive në dispozicion të shfrytëzuesve, përkatësisht për llogaritë e buxhetit themelor, për aktivitetet vetëfinancuese, për donacionet dhe për huat, pa pushtetin lokal.

Projeksionet e të ardhurave të buxhetit për vitin 2022 bazohen në realizimin e të ardhurave në vitet e mëparshme dhe efektet e reformave të planifikuara në sferën tatimore dhe pensionale.

**Deficiti buxhetor** në nivel të Buxhetit Qendror, sipas treguesve makroekonomikë themelorë të publikuar nga MF-ja për vitin 2022 është 5,1% të BPV-së dhe ai është 0,8% mbi përqindjen e projektuar prej 4,3%, të parashikuar në Strategjinë Fiskale për vitet 2022 - 2024 (me perspektiva deri në vitin 2026). Krahasuar me vitin 2021, pjesëmarrja e deficitit buxhetor në BPV është zvogëluar për 0,3%, që tregon për stabilizimin dhe zvogëlimin, por megjithatë pjesëmarrja e tij në BPV për vitin 2022 është në nivel më të lartë krahasuar me vitet para krizës shëndetësore-ekonomike dhe sipas parashikimeve në strategjinë fiskale, pritet që ai nëpërmjet zvogëlimit të vazhdueshëm në vitet e ardhshme, në vitin 2026, të arrijë 2,2% të BPV-së. Trendi i lëvizjes së deficitit buxhetor si përqindje e BPV-së në periudhën 2013-2022 është paraqitur në pasqyrën grafike:

PJESËMARRJA NË PËRQINDJE E DEFICITIT BUXHETOR NË BPV PËR PERIUDHËN 2013-2022




Gjithsej **të ardhurat dhe të hyrat** në vitin 2022 janë realizuar në shumë prej 202.023.891 mijë denarë, përkatësisht për 10,86% më pak në krahasim me vitin 2021, që më së shumti vjen si pasojë e zvogëlimit të ngarkimit me borxh jashtë vendit (61,89%) dhe ngarkimit me borxh në vend (36,55%).

| Опис | Të ardhurat e planifikuara Buxheti 2022 | Të ardhurat e realizuara në Buxhetin 2022 | Struktura e të ardhurave të realizuara në Të ardhurat totale të Buxhetit për vitin 2022 | Të ardhurat e realizuara në Buxhetin 2021 | Struktura e të ardhurave të realizuara në Të ardhurat totale të Buxhetit për vitin 2021 | Realizimi i diferencës 2022/2021 | Rritje/ulje 2022/2021 (%) | Planifikimi/ realizimi i diferencës 2022 | Realizimi/ planifikimi 2022 (%) |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Te ardhurat tatimore | 139.479.000 | 139.074.197 | 68,84% | 122.823.942 | 54,20% | 16.250.255 | 13,23% | 404.803 | -0,29% |
| Të ardhura jotatimore | 5.557.000 | 7.975.217 | 3,95% | 6.219.043 | 2,74% | 1.756.174 | 28,24% | -2.418.217 | 43,52% |
| Të ardhurat kapitale | 2.150.000 | 2.219.926 | 1,10% | 1.919.813 | 0,85% | 300.113 | 15,63% | -69.926 | 3,25% |
| Transfertat dhe donacionet | 39.798.816 | 15.184.119 | 7,52% | 14.425.017 | 6,37% | 759.102 | 5,26% | 24.614.697 | -61,85% |
| Huamarrja e brendshme | 26.620.000 | 14.680.857 | 7,27% | 23.136.066 | 10,21% | - 8.455.209 | -36,55% | 11.939.143 | -44,85% |
| Huamarrja jashtë vendit | 61.500.000 | 21.983.196 | 10,88% | 57.561.838 | 25,40% | - 35.578.642 | -61,81% | 39.516.804 | -64,25% |
| Të ardhura nga shlyerja e huasë | 500.000 | 906.379 | 0,45% | 543.098 | 0,24% | 363.281 | 66,89% | -406.379 | 81,28% |
| GJITHËSEJ | 275.604.816 | 202.023.891 | 100% | 226.628.817 | 100% | -24.604.926 | -10.86% | 73.580.925 | -26,70% |

në 000 denarë

Të ardhurat tatimore në vitin 2022 janë realizuar mbi 13% më shumë krahasuar me vitin 2021 dhe kanë pjesëmarrje prej 68,84% në totalin e të ardhurave të Buxhetit Themelor për vitin 2022, në dallim nga viti 2021 kur pjesëmarrja e tyre ishte 54%, që tregon përmirësimin e strukturës së të ardhurave me rritjen e pjesëmarrjes së të ardhurave tatimore, të paraqitur në tabelën e mëposhtme:



Të hyrat totale nga **ngarkimi me borxh** në vend dhe jashtë vendit në vitin 2022 përfshijnë 18% të totalit të të ardhurave të Buxhetit Themelor për vitin 2022.




Të hyrat totale nga **ngarkimi me borxh** në vend dhe jashtë vendit në vitin 2022 përfshijnë 18% të totalit të të ardhurave të Buxhetit Themelor për vitin 2022.

Të hyrat në bazë të **ngarkimit me boxh në vend** në vitin 2022 prej 14.680.857 mijë denarë janë 40% nga gjithsej të hyrat në bazë të ngarkimit me borxh të shtetit, që është 37% më pak në krahasim me vitin 2021 dhe është për shkak të të hyrave më pak të realizuara nga obligacionet shtetërore të lëshuara në vitin 2022.

Të hyrat në bazë të **ngarkimit me borxh jashtë vendit** në shumë prej 21.983.196 mijë denarë paraqesin rënie për 62% në krahasim me vitin 2021, kur ka pasur edhe të hyra nga euroobligacioni i lëshuar i shtetit në tregun ndërkombëtar të kapitalit.

**Shpenzimet dhe të dalat në Buxhetin për vitin 2022** janë 192.180.442 mijë denarë dhe janë për 9,11% më pak në krahasim me vitin 2021. Shpenzimet e planifikuara, struktura, realizimi, rritja ose zvogëlimi i tyre në krahasim me shpenzimet dhe të dalat nga viti 2021 janë paraqitur në tabelën e mëposhtme:

## SHPENZIMET DHE DALJET E PLANIFIKUARA DHE TË REALIZUARA NË VITIN 2022

në 000 denarë




Në kuadër të shpenzimeve dhe të dalave të veçanta, është shënuar rritje në të gjitha shpenzimet krahasuar me vitin 2021, me ç'rast rritje më të ndjeshme kanë shpenzimet kapitale për 33% dhe rezervat dhe shpenzimet e padefinuara për 57%. Rënia më e madhe prej 73% krahasuar me vitin 2021 është shënuar në shpenzimet e shlyerjes së kryegjësë si rezultat i shlyerjes së plotë të euroobligacionit të tretë gjatë vitit 2021, i cili ishte lëshuar në vitin 2014.

Pjesëmarrja e llojeve të veçanta të shpenzimeve dhe të dalave të tjera në krahasim me totalin e shpenzimeve dhe të dalave të kryera në Buxhetin Themelor për vitin 2022 është paraqitur në grafikun e mëposhtëm:

## STRUKTURA E SHPENZIMEVE DHE DALJEVE TË BUXHETIT THEMELOR PËR VITIN 2022




Për mbulimin e **deficitit të Fondit të SPIMV-së** për pagesën e pensioneve, i cili në vitin 2022 ishte 22% nga gjithsej burimet e mjeteve për pagesën e pensioneve, nga Buxheti i RMV-së janë transferuar mjete në shumë prej 14.850.580 mijë denarë, 7% më pak krahasuar me vitin 2021. Struktura e burimeve të mjeteve për pensionet në vitin 2022 edhe më tej e imponon nevojën për mbështetjen financiare të Fondit të SPIMV-së për pagesën e pensioneve në shtet me mjetet e Buxhetit.

Si **transfere rrjedhëse për NJVL-të** përmes ministrive kompetente janë realizuar dotacione në shumë prej 23.364.851 mijë denarë, që paraqet 12% të totalit të shpenzimeve të Buxhetit Themelor të RMV-së për vitin 2022. Krahasuar me vitin 2021, këto dotacione janë rritur për 10%. Pjesëmarrjen më të madhe në transfere prej 86% kanë bllok-dotacionet e paguara në shumë prej 20.041.118 mijë denarë, dotacionet nga TVSH-ja marrin pjesë me 12%, ndërsa pjesëmarrja e dotacioneve me dedikim është 2%.

**Shpenzimet për subvencionet dhe transferet** në vitin 2022 marrin pjesë me 15,9% të buxhetit themelor dhe janë realizuar në shumë të përgjithshme prej 30.580.982 mijë denarë dhe në krahasim me vitin 2021 janë rritur për 8%. Pjesëmarrje më të madhe në totalin e shpenzimeve për subvencionet dhe transferet kanë shpenzimet për transfere të ndryshme, në shumë prej 27.065.402 mijë denarë, me 89%, nga të cilat pjesa më e madhe (31%) u takojnë shpenzimeve nga programi P1 - Masat për t'u përballur me krizën e Kovid-19.

**Shpenzimet kapitale** në Buxhetin Themelor për vitin 2022 janë realizuar në shumë prej 22.360.256 mijë denarë, që paraqet 11,64% nga gjithsej shpenzimet e Buxhetit Themelor. Për shpenzimet kapitale për periudhën 2018-2022, kemi konstatuar se kanë trend evident të rritjes nga viti në vit, të paraqitur në grafikun e mëposhtëm:

në 000 denarë

## SHPENZIMET KAPITALE NË PERIUDHËN 2018-2022




Struktura e shpenzimeve kapitale në tri vitet e fundit tregon rritje të investimeve dhe mjeteve jofinanciare, të cilat në vitin 2022 arrijnë 10.678.725 mijë denarë dhe më së shumti janë realizuar përmes Ndarjes së Qeverisë, nënprogrami P1 - Masat për t'u përballur me krizën e Kovid-19 dhe masat e tjera kundër krizës. Mbi 69% të mjeteve të paguara në bazë të vendimeve të Qeverisë janë të dedikuara për SHA për prodhimin e energjisë elektrike ESM për t'u përballur me situatën e krizës në furnizimin me energji elektrike (6.449.000 mijë denarë), një pjesë është për SHA Ekonomia e Ujërave për servisimin e obligimeve për energjinë elektrike, ndërsa një pjesë për ndihmën financiare të pakthyeshme për t'u përballur me përkeqësimin e gjendjes financiare të SHA për komunikacionin postar «Posta e Maqedonisë së Veriut».

Kemi konstatuar se 7.007.000 mijë denarë, përkatësisht 41% të shpenzimeve kapitale nuk janë paguar për qëllimin për të cilin janë planifikuar dhe ato paraqesin shpenzime për sigurimin e sasive shtesë të energjisë elektrike, prokurimin e resurseve themelore për prodhimin e energjisë elektrike për rregullimin e borxheve të mbetura, pagesave të kredive, pagesave të rrogave dhe shpenzimeve të tjera. Për shkak të situatave të tilla, revizioni tregon se shpenzimet kapitale janë shpenzime që synojnë rritjen e mjeteve të përhershme, të mirave të qëndrueshme si rrugët, shkollat, spitalet, ujësjellësit, konviktet e studentëve, objektet sportive, pajisjet shëndetësore, harduerët, softuerët, të cilat krijojnë kushte më të mira për qytetarët dhe kontribuojnë në zhvillimin e ekonomisë, prandaj është e nevojshme që baza për ndarjen e mjeteve nga programet e Qeverisë të korrespondojë me qëllimet e theksuara.

Në Ligjin për borxhin publik rregullohet se për realizimin e buxhetit, MF-ja në emër të Republikës së Maqedonisë së Veriut mund të ngarkohet me borxh deri në shumën maksimale të nevojshme për financimin e deficitit buxhetor dhe rifinancimin e detyrimeve të borxhit shtetëror për vitin rrjedhës dhe dy vitet e ardhshme fiskale të përcaktuara në buxhet dhe në Strategjinë Fiskale.

**Borxhi publik** më 31.12.2022 ishte 7.702,9 milionë euro, ndërsa më 31.12.2021 ishte 7.135,3 milionë euro, që tregon rritje në shumë absolute prej 567,6 milionë euro, përkatësisht 8%. Pavarësisht rritjes së borxhit publik si shumë absolute, gjendja e borxhit publik në krahasim me BPV-në më 31.12.2022 ishte 57,1% dhe është për 3,9% më i vogël në krahasim me vitin 2021, në kushtet kur BPV-ja në vitin 2022 është për 10% më e madhe në krahasim me vitin e mëparshëm.

Situata e **borxhit shtetëror** më 31.12.2022 ishte 6.581 milionë euro dhe përkundër situatës së borxhit shtetëror vitin e kaluar i cili ishte në shumë prej 6.080 milionë euro, është rritur në shumë prej 501 milionë euro. Konstatuam se situata e borxhit shtetëror më 31.12.2022 ishte 48,7% e BPV-së, ndërsa në vitin 2021 kur ishte 52% e BPV-së.

Trendi i pjesëmarrjes së borxhit shtetëror dhe publik në BPV për periudhën 2013-2021 është paraqitur në grafikun e mëposhtëm:

## GJENDJA E BORXHIT SHTETËROR DHE PUBLIK SI PËRQINDJE NGA BPV NË PERIUDHËN 2013-2022




Subjektet në përputhje me nenin 9 të Ligjit për evidencën dhe paraqitjen e detyrimeve, janë të detyruara që në bazë mujore përmes Sistemit Elektronik për Paraqitjen dhe Evidencën e Detyrimeve (SEPED) në MF t'i paraqesin detyrimet në përputhje me evidencën e tyre të kontabilitetit, më së voni deri më datën 10 të muajit, për muajin e mëparshëm. Në vitin 2022, nga gjithsej 1.382 subjekte, në SEPED kanë dorëzuar të dhëna 1.205 subjekte, me detyrime të maturuara të papaguara në shumë të përgjithshme prej 25.829.001 mijë denarë, që është për 1.669.043 mijë denarë ose 6,9% më shumë në krahasim me vitin 2021. Pjesëmarrjen më të madhe në totalin e detyrimeve kanë ndërmarrjet publike dhe shoqëritë tregtare në pronësinë shtetërore me 37,82%, institucionet shëndetësore publike, komunat me 20.23%, si dhe ndërmarrjet publike komunale me 18%. Situata e detyrimeve të paraqitura të maturuara dhe të papaguara për periudhën 2018-2022 është paraqitur në grafikun e mëposhtëm:

## DETYRIMET E RAPORTUARA, TË MATURUARA DHE TË PAPAGUARA PËR PERIUDHËN 2018-2022



Të dhënat për detyrimet e papaguara dhe të maturuara të subjekteve janë paraqitur në njoftimin për realizimin e buxhetit të shtetit, si pjesë e Llogarisë Përfundimtare të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, e cila i përmban të dhënat nga Raporti për detyrimet e paraqitura.

Lidhur me paqëndrueshmërinë financiare të NJVL-së, konstatuam se në dhjetor 2022, nga gjithsej 81 komuna, 14 komuna kanë llogari të bllokuara. Shuma e përgjithshme e urdhëresave të dorëzuara për përmbarim në MF është 1.517.873 mijë denarë ose 37% nga gjithsej detyrimet e paraqitura të komunave, nga të cilat në vitin 2022 janë paguar detyrimet në shumë prej 186.428 mijë denarë. Nga shuma e mbetur për përmbarim 1.331.446 mijë denarë ose 77% janë në bazë të kryegjësë, 247.982 mijë denarë, përkatësisht 18% janë në bazë të kamatës dhe 61.851 mijë denarë, përkatësisht 5% janë për shpenzimet e tjera, që tregon përqindje të lartë të ngarkimit me borxh të komunave në kushtet kur realizimi i të ardhurave shënon trend në rënie.

Në nenin 39 të Ligjit për financimin e njësive të vetëqeverisjes lokale rregullohet se nëse llogaria e komunës është e bllokuar më shumë se gjashtë muaj ose për periudhë prej gjashtë muaj vazhdimisht çdo muaj ose shuma totale e detyrimeve të papaguara mbi 60 ditë kalon 80% (deri në gusht 2022) nga të ardhurat e realizuara të buxhetit themelor të komunës në vitin e mëparshëm, kryetari i komunës është i detyruar të miratojë vendim për shpalljen e paqëndrueshmërisë financiare dhe për të ta njoftojë Këshillin e Komunës, MF-në, Ministrinë e Vetëqeverisjes Lokale dhe BNJVL-në. Deri në periudhën e revizionit, nuk është shpallur paqëndrueshmëria financiare për asnjë komunë, ashtu që komunat mund të gjenerojnë detyrime të reja në baza të ndryshme dhe të fillojnë projekte të reja kapitale, gjë që ndikon në përkeqësimin e mëtejshëm të likuiditetit të tyre dhe situatës së përgjithshme financiare, e me këtë edhe mundësinë për nevojën shtesë për ndarjen e mjeteve nga Buxheti si mbështetje financiare për to dhe të dala të mjeteve buxhetore.

Raporti përfundimtar i revizorit është në dispozicion në faqen e internetit të ESHR-së në linkun e mëposhtëm: https://dzr.mk/sites/default/files/2023-08/KRI_Osnoven_budzet_RSM_2022.pdf



## 5.2.2. EFIKASITETI I MASAVE DHE POLITIKAVE PËR SERVISIMIN E BORXHIT PUBLIK

Revizioni me temë "Efikasiteti i masave dhe politikave për servisimin e borxhit publik" si revizion i suksesit është kryer në përputhje me Programin Vjetor të Punës së Entit Shtetëror të Revizionit për vitin 2023.

Qëllimi i revizionit të kryer ishte t'i përgjigjet pyetjes: «A janë masat dhe politikat për servisimin e borxhit publik efikase dhe në funksion të pagesës në kohë dhe të saktë të detyrimeve, me shpenzimin më të ulët dhe rrezikun më të pranueshëm?»

Revizioni u fokusua në vlerësimin e aktiviteteve dhe zbatimin e funksioneve të sistemit dhe proceseve për servisimin e borxhit publik.

Me revizionin ishin përfshirë masat dhe politikat për servisimin e borxhit publik, përkatësisht shpenzimet për servisimin e detyrimeve të borxhit publik të paraqitura në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitet 2021, 2022 dhe 2023.

Është hartuar korniza sistematike gjithëpërfshirëse juridike dhe institucionale për menaxhimin e borxhit publik.

Për procesin e servisimit të borxhit publik janë dhënë vlerësime pozitive nga BE-ja dhe FMN-ja.

Me Ligjin për realizimin e buxhetit, i cili miratohet çdo vit, parashihen dispozita me të cilat realizohen mjetet për servisimin e borxhit publik pavarësisht nga alokimi i planifikuar buxhetor për këtë qëllim.

Zbatimi i procedurave në procesin e servisimit të borxhit publik dhe vendosjes së veprimtarisë elektronike bankare me BPRMV-në mundësojnë pagesën në kohë dhe të saktë të detyrimeve të maturuara për servisimin e borxhit publik.

Në periudhën e krizës shëndetësore, energjetike dhe ekonomike, Ministria e Financave, megjithë kushteve të pafavorshme të tregut (shkallët e larta të kamatës), siguroi mjete nga kreditorët zyrtarë për mbështetjen buxhetore me shkallë më të ulëta të kamatës se tregu.

Revizioni konstatoi se në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë së Veriut nuk janë paraqitur nevojat reale bruto për financimin e shtetit. Të ardhurat nga letrat me vlerë afatshkurtra të emetuara për rifinancimin e borxhit nuk janë prezantuar si të ardhura nga ngarkimi me borxh nga emetimi i bonove të thesarit afatshkurtra dhe të dalat si shpenzime për shlyerjet e kryegjësë për borxhin e brendshëm. Këto pagesa janë për detyrimet e paraqitura si borxh publik (kryegjëja) dhe për kamatat që nuk ishin paraqitur si detyrime. Të ardhurat dhe të dalat e përcaktuara për rifinancimin e borxhit nga bonot shtetërore të thesarit për vitet 2021, 2022 dhe 2023 janë si në vijim:

32.081.518
mijë denarë
2021

32.951.956
mijë denarë
2022

34.893.631
mijë denarë
2023

Politika fiskale nëpërmjet financimit të deficitit buxhetor ka ndikim të rëndësishëm në nivelin dhe qëndrueshmërinë e borxhit publik. Gjendja e borxhit publik më 31.12.2023 e shprehur në përqindje është 58,26% e BPV-së, të llogaritur sipas projeksioneve të BPV-së të Ministrisë së Financave, ndërsa sipas të dhënave të publikuara për BPV-në nga Enti Shtetëror i Statistikës në mars 2024 për tremujorin e katërt të vitit 2023, llogaritja e borxhit publik në shprehur në përqindje është 62,01% të BPV-së. Nga totali i borxhit publik, 53% e BPV-së është borxhi shtetëror dhe 9% e BPV-së është borxhi i garantuar dhe i pagarantuar. Informacionet e theksuara janë paraqitur në tabelën.

# LLOGARITJA E BORXHIT PUBLIK SIPAS BPV-SË PËR VITIN 2023 TË PUBLIKUAR NGA ENTI SHTETËROR I STATISTIKËS DHE SIPAS PROJEKSIONEVE TË BPV-SË NGA MINISTRIA E FINANCAVE

| Përshkrimi | gjendja e borxhit 31.12.2023[3] në milionë denarë | % e BPV-së sipas ESHS-së | % e BPV-së sipas projeksioneve të MF-së |
|---|---|---|---|
| Borxhi shtetëror | 446.217.0 | 53.08% | 53.8% |
| Borxhi i garantuar | 70.781.6 | 8.42% | 7.91% |
| Borxhi i pagarantuar | 4.285.0 | 0.51% | 0.48% |
| Borxhi publik | 521.283.6 | 62.01% | 58.26% |
| BPV-ja sipas metodës së prodhimit, çmimet aktuale – Enti Shtetëror i Statistikës | 840.611 | | |
| BPV-ja sipas treguesve makroekonomikë të Ministrisë së Financave[5] | 894.727 | | |

Revizioni thekson se edhe pse ende nuk janë tejkaluar rregullat fiskale të përcaktuara me Ligjin për buxhete, për shkak të nivelit të arritur të borxhit publik në këtë moment, menaxhimi i kujdesshëm i financave publike përmes nivelit të qëndrueshëm të borxhit publik dhe politikës fiskale me nivelin e duhur të deficitit buxhetor është i nevojshëm në të ardhmen.

Në periudhën nga viti 2025 deri në vitin 2028, çdo vit maturojnë për pagesë euroobligacionet e emetuara nga periudha paraprake, gjë që mund të shkaktojë pasiguri në arritjen e efikasitetit të servisimit të borxhit për shkak të rritjes së nevojave për financimin e shtetit. Të dhënat për euroobligacionet në periudhën e theksuar janë prezantuar në tabelën.

[3] https://www.stat.gov.mk/PrikaziSoopstenie.aspx?rbrtxt=31

[4] https://finance.gov.mk/%d1%81%d0%be%d1%81%d1%82%d0%be%d1%98%d0%b1%d0%b0%d0%bd%d0%b0%d0%b4%d0%be%d0%bb%b3-2/

[5] https://finance.gov.mk/%d0%b8%d0%bd%d0%b4%d0%b8%d0%ba%d0%b0%d1%82%d0%be%d1%80%d0%b8-%d0%b8-%d0%bf%d1%80%d0%be%d0%b5%d0%ba%d1%86%d0%b8%d0%b8/

## TË DHËNAT PËR EUROOBLIGACIONET QË MATUROJNË NË PERIUDHËN 2025-2028

| Euroobligacioni | Shuma sipas prospektit | Viti | Maturimi | Periudha e maturimit | Të ardhura | Shuma e zbritur | Shkalla kamatare | Kamata vjetore | Gjithsej kamata |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 |
| Euroobligacioni 6 | 500.000.000 | 2018 | 2025 | 7 | 492.210.000 | 98.442% | 2.750% | 13.757.000 | 96.250.000 |
| Euroobligacioni 7 | 700.000.000 | 2020 | 2026 | 6 | 689.892.000 | 98.556% | 3.675% | 25.725.000 | 154.350.000 |
| Euroobligacioni 8 | 700.000.000 | 2021 | 2028 | 7 | 689.024.000 | 98.432% | 1.625% | 11.375.000 | 79.625.000 |
| Euroobligacioni 9 | 500.000.000 | 2023 | 2027 | 4 | 495.115.000 | 99.023% | 6.960% | 34.800000 | 139.200.000 |

Sipas vlerësimit të FMN-së të theksuar në Programin e Reformës së Menaxhimit të Financave Publike 2022-2025 "borxhi vlerësohet i qëndrueshëm në skenarin themelor. Megjithatë, nga perspektiva e likuiditetit, nevojat për financim e tejkalojnë pragun e rrezikut të lartë në skenarin themelor.»

Në Sektorin për Menaxhimin e Borxhit Publik nuk është arritur niveli i plotësimit të vendeve të punës në përputhje me numrin e parashikuar optimal të të punësuarve.

Revizioni thekson se sipas udhëzimeve të FMN-së dhe Bankës Botërore për menaxhimin efikas të borxhit publik, është e nevojshme të krijohen kushtet adekuate duke tërhequr dhe mbajtur kuadro kompetente për këtë fushë.

Edhe pse janë ndërtuar kapacitetet dhe janë kryer trajnimet, luhatja e kuadrit dhe mosplotësimi i vendeve të punës mund të pasqyrohet negativisht në qëndrueshmërinë e rezultateve të arritura. Ky është një nga rreziqet më të larta operative me të cilat po përballet ministria në këtë moment dhe që në afat të gjatë mund të këtë pasoja negative në procesin e përgjithshëm të servisimit të borxhit publik.

Për t'i tejkaluar situatat, efektet dhe rezultatet e theksuara, kemi dhënë rekomandime që rrjedhin nga rezultatet e revizionit të kryer dhe janë në funksion të përmirësimit dhe avancimit të procesit të përgjithshëm të servisimit të borxhit publik.

## 5.2.3. RROGAT DHE SHTESAT E RROGAVE TË NËPUNËSVE ADMINISTRATIVË NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT

Administrata publike funksionale është parakusht për qeverisje demokratike efektive dhe transparente. Administrata publike ushtron kompetencat e përcaktuara në ligjet që kanë për qëllim realizimin dhe zbatimin e politikave publike të Qeverisë.

Zbatuam revizionin e pajtueshmërisë me temë **"Rrogat dhe shtesat e rrogave të nëpunësve administrativë në Republikën e Maqedonisë së Veriut".**

Konkluduam se rrogat dhe shtesat e rrogave të nëpunësve administrativë për periudhën nga viti 2021 deri në vitin 2023 janë në përputhje me rregullativën ligjore relevante, dokumentet strategjike dhe politikat e përcaktuara, por nevojiten aktivitete me të cilat do të tejkalohen situatat dhe dobësitë e konstatuara.

Revizioni ishte zbatuar në MSHIA dhe MF, ndërsa për të marrë informacione dhe të dhëna më të gjera lidhur me kornizën juridike dhe strategjike, kompetencat dhe ekipimin e kuadrit, dorëzuam pyetësorë në 14 ministri dhe 22 institucione, duke përfshirë edhe institucionet ku pyetje të caktuara lidhur me marrëdhënien e punës së nëpunësve administrativë rregullohen me ligje të veçanta.

Duke filluar nga viti 2014, punonjësit në administratën publike në varësi nga institucioni në të cilin janë të punësuar janë:

- **Nëpunës shtetërorë** - të punësuar në organet e pushtetit shtetëror dhe lokal dhe të punësuar në organet e tjera shtetërore dhe
- - **Nëpunës publikë** - të punësuar në institucionet që kryejnë veprimtari në fushën e arsimit, shkencës, shëndetësisë, kulturës, punës dhe mbrojtjes sociale dhe mbrojtjes së fëmijëve, sportit, fondeve, institucioneve publike, ndërmarrjeve publike të themeluara nga RMV-ja dhe komunat .

Rrogat e punonjësve në sektorin publik rregullohen me:

- Ligjin për të punësuarit në sektorin publik - i rregullon parimet e përgjithshme për të punësuarit në sektorin publik.
- Ligjin për nëpunësit administrativë - i rregullon rrogat, shtesat dhe kompensimet e rrogave.
- ligje të veçanta, marrëveshje kolektive, rregullore, vendime - të përfaqësuar nga një numër i madh institucionesh në sektorin publik për rregullimin e rrogave dhe shtesave.

Për të ndërtuar administratë publike efikase në çdo vend, nevojitet ekzistimi i rregullativës ligjore që rregullon statusin e saj, të drejtat dhe obligimet e punonjësve, i cili do të mundësojë profesionalizimin e administratës, integritet më të mirë, mbrojtje nga korrupsioni, nepotizmi dhe depolitizimi i saj.

**Konstatuam se korniza ligjore ekzistuese nuk siguron vendosjen e sistemit të unifikuar dhe koherent të rrogave për punonjësit e sektorit publik në mënyrë efikase dhe ekonomike.**

**Strategjitë për riorganizimin e institucioneve në sektorin publik, përmes të cilave Qeveria** në vazhdimësi, **një periudhë të gjatë** zbaton procesin e avancimit të kapacitetit të tyre administrativ, **nuk janë efikase për shkak të realizimit jo në kohë të aktiviteteve të planifikuara:**



## REALIZIMI I QËLLIMEVE TË PARAPARË ME STRATEGJITË PËR RIORGANIZIMIN E INSTITUCIONEVE NË SEKTORIN PUBLIK




Devijimi nga dinamika e paraparë e miratimit të kornizës ligjore dhe metodologjike për reformën e papenguar të administratës publike e ngadalëson procesin e harmonizimit të legjislacionit nacional me të drejtën evropiane, pamundëson realizimin në kohë, të plotë dhe efikas të aktiviteteve të mëvonshme dhe e anulon vendosjen e sistemit të unifikuar dhe koherent të rrogave për punonjësit në sektorin publik.

Për të avancuar efikasitetin në menaxhimin e resurseve njerëzore dhe cilësinë e punës së institucioneve në sektorin publik, në MSHIA u vendos Sistemi Informativ për menaxhimin e resurseve njerëzore përmes **katër moduleve, i cili nuk u përdor në përputhje me qëllimin për të cilin është krijuar.**

## SHFRYTËZIMI I SISTEMIT INFORMATIV PËR MENAXHIMIN E RESURSEVE NJERËZORE PRAN MSHIA




Shkalla e shfrytëzimit të sistemit informativ vë në pikëpyetje justifikimin e prokurimit të tij dhe justifikimin e shpenzimeve për mirëmbajtjen e tij, nuk mundëson marrjen e evidencave statistikore përmbledhëse në nivel të gjithë sektorit publik dhe ndikon në menaxhimin efikas të resurseve njerëzore.

Procesi i planifikimit të punësimeve të nevojshme nuk është efikas dhe **nuk u mundëson institucioneve t'i punësojnë resurset e nevojshme njerëzore në kohën e duhur.**

Për shkak të mosdorëzimit të planit vjetor të punësimit brenda afatit të përcaktuar me ligj ose mosveprimit sipas udhëzimeve të dorëzuara, në periudhën janar - qershor 2023, nga gjithsej 1.334 institucione, 387 përkatësisht 29% e tyre nuk kanë marrë mendim pozitiv, prandaj shkalla e realizimit të planit të punësimit për vitin 2021 është vetëm 19,5% e totalit të punësimeve të planifikuara, ndërsa në vitin 2022 janë realizuar vetëm 16,4%.

## REALIZIMI I PLANEVE PËR PUNËSIME



**Nga punësimet e përgjithshme** të 3.384 personave në 36 institucione që janë lëndë e revizionit në periudhën nga viti 2021 deri në shtator 2023, **70% janë realizuar me procedurë jotransparente – pa shpalljen e konkursit publik** në kundërshtim me Ligjin për të punësuarit në sektorin publik për shkak të punësimit të tyre nëpërmjet Agjencive të Punësimeve të Përkohshme ose transferimit.

- 1.023 persona janë të punësuar në kohë të pacaktuar, përkatësisht 30%,
- 468 persona janë të punësuar në kohë të caktuar, përkatësisht 13%,
- 1.424 persona janë të punësuar përkohësisht, mbi 43% dhe
- 480 persona janë të punësuar me transferim nga organi tjetër, përkatësisht 14%.

**Kontrolli i llogaritjeve** sa për pagesën e rrogave, shtesave, tatimeve dhe kontributeve për 756 subjekte me gjithsej 84.235 të punësuar, kryhet çdo muaj nga gjashtë persona të punësuar në departamentin për kontrollin e pagesës së rrogave në MF në formularët në formë të shkruar dhe elektronike. **Në MF nuk ekziston sistemi për kontrollin softuerik të llogaritjeve, gjë që e vështirëson kontrollin dhe krijon rrezikun e gabimeve të mundshme në pagesën e rrogave.**

Kemi konstatuar se ka dallime në lartësinë e rrogave për të njëjtat vende pune në institucione të ndryshme **për shkak të përcaktimit të ndryshëm të vlerës së pikës** për llogaritjen e rrogave:

- për nëpunësit shtetërorë: Qeveria përcakton çdo vit me vendim;
- për nëpunësit publikë: çdo vit me vendim e përcakton themeluesi me propozimin e funksionarit kompetent dhe
- për nëpunësit administrativë në gjyqësor dhe prokurorinë publike, diplomacinë, administratën doganore dhe tatimore, shërbimet inspektuese, trupat rregullatorë dhe Bankën Popullore: rrogat rregullohen me ligj dhe me marrëveshje kolektive.

Si rezultat i kësaj, ka dallime të konsiderueshme në **bruto rrogat bazë të paguara për të njëjtin vend pune në institucione të ndryshme**, **ku** rrogat në ministritë janë në nivelin më të ulët në krahasim me institucionet e tjera:

### SHUMA E BRUTO RROGËS PËR TË NJËJTIN VEND PUNE NË INSTITUCIONE TË NDRYSHME

| Vendi i punës | Ministria | Institucionet e tjera |
|---|---|---|
| këshilltar shtetëror | 69.000 | deri në 108.000 |
| udhëheqësi i sektorit | 67.000 | deri në 125.000 |
| ndihmësudhëheqës sektori | 59.000 | deri në 110.000 |
| udhëheqës departamenti | 53.000 | deri në 100.000 |
| këshilltar | 47.000 | deri në 85.000 |
| bashkëpunëtor i lartë | 44.000 | deri në 82.000 |
| bashkëpunëtor | 43.000 | deri në 79.000 |

Gjendjet e theksuara nuk janë në përputhje me nënqëllimin 2.4. - Vendosja e sistemit të unifikuar dhe koherent të rrogave në sektorin publik nga Strategjia për Reformën e Administratës Publike 2023-2030.

Edhe pse Ligji për pagesën e rrogave mundëson rritje mujore deri në 50% të shkallës së arritur të rritjes së shpenzimeve të jetesës në muajin rrjedhës në krahasim me muajin paraprak, me revizion kemi konstatuar se në periudhën nga viti 2021 deri në 2023, pavarësisht se është rritur shkalla e shpenzimeve të jetesës, e me këtë edhe e drejta e rritjes së rrogave, institucionet nuk kanë zbatuar rritje mujore të rrogave në përputhje me shkallën e arritur të rritjes së shpenzimeve të jetesës në muajin rrjedhës në krahasim me muajin paraprak, në kuadër të mjeteve të siguruara.

Ligji për nëpunësit administrativë dhe Ligji për realizimin e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut u mundësojnë nëpunësve administrativë të drejtën të paguajnë shtesa të rrogës **si % e rrogës bazë: për kushtet e veçanta -30%, për përshtatjen në tregun e punës në lartësinë prej 15% dhe për punën gjatë natës, me ndërrime, gjatë pushimit javor dhe në ditë festash në lartësinë prej 15%. Konstatuam se në** periudhën 2021-2023 në **36 institucionet e përfshira** janë paguar këto lloje të shtesave të rrogave, të paraqitura në grafikun e mëposhtëm:

SHTESAT E RROGAVE TË PAGUARA SIPAS INSTITUCIONEVE




Shtesa për punë jashtë orarit paguhet në 26 institucione, ndërsa shtesa për përshtatjen në tregun e punës nuk paguhet në asnjë institucion, pavarësisht se është paraparë me nenin 91 të Ligjit për nëpunësit administrativë.

Janë dhënë rekomandimet për ndërmarrjen e masave dhe aktiviteteve për realizimin e qëllimeve të përcaktuara strategjike dhe tejkalimin e dobësive të konstatuara, në drejtim të sigurimit të vlerësimit të punës së punonjësve në sektorin publik dhe mbajtjes së tyre.

## 5.2.4. MENAXHIMI I PRONËS SHTETËRORE

Kemi kryer revizionin e suksesit me temë "Menaxhimi i pronës shtetërore" për t'iu përgjigjur pyetjes **"Nëse institucionet kompetente menaxhojnë dhe ekonomizojnë pronën e paluajtshme shtetërore – objektet afariste dhe banesore të shtetit në mënyrë efikase?"**



Kemi vlerësuar se rregullativa ligjore ekzistuese, masat dhe aktivitetet e ndërmarra nga Qeveria dhe institucionet e tjera kompetente nuk mundësojnë menaxhimin dhe ekonomizimin efikas të pronës së paluajtshme shtetërore – objekteve afariste dhe banesore të shtetit.

Rregullativa ligjore ekzistuese ka vendosur sistem me kompetenca të kufizuara ndërmjet institucioneve lidhur me vendimmarrjen, menaxhimin, disponimin dhe evidentimin e pronës së paluajtshme shtetërore të paraqitur në grafikun e mëposhtëm:



**Qeveria** vendos për dhënien dhe ndërprerjen e shfrytëzimit të përkohshëm ose të përhershëm të sendeve kompetente të organeve shtetërore, personave juridikë të themeluar nga shteti, komunave, komunave në Qytetit të Shkupit, Qytetit të Shkupit, shoqatave dhe fondacioneve të qytetarëve, si dhe për prokurimin e pronës së re, shitjen e pronës që nuk përdoret përgjithmonë dhe për dhënien me qira.

**SHANEHBHA** është **kompetente për ekonomizimin e hapësirës banesore dhe hapësirës afariste me rëndësi për Republikën, veçanërisht për mirëmbajtjen investuese dhe rrjedhëse të saj,** lidhjen e kontratave të qirasë, shitjen e banesave dhe hapësirave afariste, mbajtjen e evidencës unike të hapësirave banesore dhe afariste, ndërtimin e hapësirës banesore dhe afariste për të cilat RMV-ja është investitor.

**SHAEHA** i kryen veprimtaritë që kanë të bëjnë me ekonomizimin e hapësirës afariste në kuptim të mirëmbajtjes investuese të saj dhe mirëmbajtjes rrjedhëse dhe përmirësimit të kushteve për shfrytëzimin e hapësirës afariste, lidhjen e kontratave për dhënien me qira të hapësirës afariste, shitjen dhe mbajtjen e evidencës unike të hapësirës afariste.

**SHPPP** mban evidencë të brendshme të paluajtshmërive të përdorura nga Qeveria dhe kujdeset për mirëmbajtjen dhe rikonstruksionin rrjedhës të objekteve që përdoren nga organet e administratës shtetërore, objektet përfaqësuese dhe rezidenciale.

Me revizionin e kryer konstatuam se **Rregullativa Ligjore:**

- **Nuk parasheh detyrimin për përgatitjen dhe miratimin e dokumenteve strategjike për menaxhimin e pronës shtetërore**, për këtë arsye **Qeveria e RMV-së nuk ka miratuar strategji nacionale** për menaxhimin, përdorimin, mirëmbajtjen, tjetërsimin e pronës së paluajtshme shtetërore dhe as strategji shtetërore në fushën e banimit, edhe pse ka obligim ligjor për të. **SHANEHBHA dhe SHAEHA** nuk kanë përgatitur: dokumente strategjike me prioritete dhe qëllime afatgjata, aktivitete **dhe resurse në dispozicion dhe programe për depozitim të investimeve.**
- **Nuk rregullon mënyrë të barabartë të veprimit** për institucionet kompetente. Në mungesë të planifikimit strategjik, **nuk janë miratuar akte, procedura / udhëzime / doracakë** për proceset e punës në lidhje me menaxhimin e pronës së paluajtshme **në nivel shtetëror për përcaktimin e nevojës** për pronës të paluajtshme, blerjen, shfrytëzimin dhe ndërprerjen e nevojës për shfrytëzimin e pronës së paluajtshme. SHANEHBHA dhe SHAEHA me akte dhe rregullore të brendshme **kanë rregulluar pjesërisht proceset** për kushtet, mënyrën dhe procedurën e dhënies me qira të hapësirës afariste që ekonomizojnë.
- **Nuk parashikon evidencë të centralizuar, përkatësisht regjistër gjithëpërfshirës të pronës së paluajtshme shtetërore me të dhënat financiare dhe jofinanciare, as nuk është caktuar organi ose trupi kompetent për vendosjen e tij.** Evidenca e pronës së paluajtshme mbahet në SHPPP, SHANEHBHA, SHAEHA, por edhe në çdo organ shtetëror të cilit Qeveria me vendim i ka dhënë të drejtën e shfrytëzimit të përkohshëm ose të përhershëm të regjistruar në Kadastrën e Paluajtshmërive. Ka pronë shtetërore që nuk shpërndahet nëpër institucionet e veçanta dhe për të cilën nuk mbahet evidencë tjetër përveç në AKP.

**Aktivitetet e institucioneve kompetente për menaxhimin dhe ekonomizimin e pronës së paluajshme shtetërore.**

Qeveria e cila disponon me pronë të paluajtshme në pronësi shtetërore, me vendim mund t'ua japë në shfrytëzim të përkohshëm ose të përhershëm, me ose pa kompensim, organeve shtetërore, personave juridikë të themeluar nga shteti, komunave, komunave në Qytetin e Shkupit, Qytetit të Shkupit, shoqatave dhe fondacioneve të qytetarëve.

- **Vendimet** e Qeverisë nuk kanë përmbajtje të unifikuar që do të ofrojë të dhëna dhe informacione të plota për institucionet nga të cilat është marrë, përkatësisht të cilave u jepet e drejta e shfrytëzimit të pronës, mënyra e pranim-dorëzimit, me qëllim të evidentimit të tij adekuat dhe ndjekjes në rast të ndryshimeve të përdoruesve.

Si rezultat i kësaj, kemi përcaktuar veprim të ndryshëm në **9 ministri** gjatë evidentimit të hapësirës afariste që shfrytëzojnë:

- nga gjithsej 1.214 objekte që i shfrytëzojnë, për 1.002 objekte ose 83% kanë siguruar vendim nga Qeveria për të drejtën e shfrytëzimit, ndërsa për 212 objekte, përkatësisht **17% nuk kanë siguruar vendim**;
- 49% e objekteve në shfrytëzim janë të evidentuara në kontabilitet, 29% janë të evidentuara jashtë evidencës së bilancit, ndërsa 22% të tjera të objekteve nuk janë evidentuar fare. Arsyet e mosevidentimit të objekteve në evidencën e kontabilitetit janë paraqitur në përqindje në grafikun e mëposhtëm:

## ARSYET E MOSEVIDENTIMIT NË KONTABILITET TË OBJEKTEVE TË SHFRYTËZUARA NGA MINISTRITË




- Katër ministri kanë shprehur nevojën për hapësirë shtesë për punonjësit dhe ruajtjen e pajisjeve të shpenzuara, ndërsa tri ministri kanë objekte / pjesë të objekteve që nuk i shfrytëzojnë (hapësirë boshe), as nuk kanë nevojë t'i shfrytëzojnë ato.
- në periudhën prej vitit 2019 deri më 30.10.2023 **në bazë të dhënies me qira të hapësirës vetëm për nevojat e dy ministrive, janë paguar mjete në shumë të përgjithshme prej 47.918 mijë denarë, përkatësisht 779 mijë euro**, që paraqet të dala të konsiderueshme të mjeteve buxhetore.

**SHANEHBHA dhe SHAEHA**

- kanë vendosur **"evidencë të vetme"** të hapësirës afariste, në aplikacionin softuerik me të dhënat financiare dhe jofinanciare, informacionet për lokacionin, sipërfaqen, nëse ajo është dhënë me qira, dhe të dhënat e tjera teknike dhe kadastrale, **por jo gjithmonë edhe të dhënat për gjendjen fizike dhe funksionale të objekteve,** edhe pse aplikacioni softuerik e mundëson këtë;
- është vendosur **evidenca materiale** për objektet, **por të dhënat nuk janë përditësuar dhe harmonizuar** me të dhënat që përmbahen në "evidencën e vetme" dhe me **evidencat ndihmëse** të mbajtura nga njësitë e veçanta organizative, sipas qyteteve.
- **akoma është evidentuar prona që është tjetërsuar ose së cilës i është hequr e drejta e shfrytëzimit**, e cila në përputhje me të dhënat në evidencat ndihmëse **është prishur** dhe e ngjashme, ndërsa për të edhe pse realisht **nuk ekziston**, akoma bëhen shpenzimet e sigurimit.



Hapësira afariste - ish-barakë prej 181 m2, e cila është akoma në evidencën e SHANEHBHA, edhe pse ajo fizikisht nuk ekziston.

**SHANEHBHA ekonomizon 1.163 objekte afariste**, nga të cilat filiale Shkupi me 413, Manastiri me 405, Kumanova me RE Kriva Pallankë - 151 objekte, ndërsa 198 objektet e tjera i disponojnë nëntë filialet e tjera, me ç'rast 51% e objekteve të SHANEHBHA nuk janë dhënë me qira.

Të dhënat nga evidenca ndihmëse tregojnë **se 51% e hapësirës afariste trajtohet si e "kontestueshme"** për shkak të kontesteve të pazgjidhura pronësore-juridike, shfrytëzimit të paligjshëm ose të drejtave të regjistruara në mënyrë të pabazë të pronësisë së personave të tjerë juridikë dhe fizikë, objekteve të rrënuara, si dhe objekteve që janë tjetërsuar ose për të cilat është përjashtuar e drejta e ekonomizimit dhe mbahen akoma në evidencën e Shoqërisë.

**SHANEHBHA** ekonomizon edhe **banesat zyrtare** për të cilat u është dhënë **e drejta e shfrytëzimit personave të zgjedhur dhe të emëruar**, si dhe personave zyrtarë që kryejnë detyra të veçanta në organet shtetërore. Deri në vitin 2023, nga gjithsej 86 shfrytëzues të banesave zyrtare, **33 shfrytëzues nuk i plotësojnë kushtet për shfrytëzimin e banesave të dhëna zyrtare. Kontrolli i shfrytëzimit** të banesave zyrtare nuk është bërë pas vitit 2019.

**SHAEHA ekonomizon 1.171 objekte** përmes Drejtorisë dhe dy qendrave rajonale me njësi pune nëpër disa qytete të vendit, prej të cilave 288 objekte ekonomizohen nga qendra rajonale Shkupi dhe RE Manastir me 257, me ç'rast 43% e objekteve nuk janë dhënë me qira. Funksionaliteti i hapësirës afariste të padhënë me qira, që është në dispozicion të SHAEHA, është paraqitur në grafikun e mëposhtëm.

%

GJENDJA FUNKSIONALE E HAPËSIRËS AFARISTE TË PADHËNË ME QIRA TË SHAEHA



| | |
|---|---|
| **Sistemi i njoftimit, monitorimit dhe evalvimit të menaxhimit dhe ekonomizimit të pronës së paluajtshme shtetërore** | Nuk janë bërë analiza të mjaftueshme për të identifikuar hapësirën afariste jofunksionale, për alternativat e mundshme të tjetërsimit dhe informimin e Qeverisë për veprimin e mëtejshëm me të. |



SHANEHBHA – Objekti në Shkup



SHANEHBHA – Objekti në Prilep

Mungon mekanizmi efikas për shpërndarjen e informacioneve ndërmjet institucioneve kompetente, për sigurimin e të dhënave relevante për identifikimin në kohë të problemeve dhe zbatimin e vendimeve korrigjuese për menaxhimin efikas të pronës së paluajtshme.

Shoqëritë nuk kanë vendosur sistem efikas për të informuar publikun: **faqet e internetit nuk përmbajnë** të dhëna të plota dhe të përditësuara për të gjithë hapësirën afariste që është e lirë për t'u dhënë me qira.

Raportet vjetore për punën e shoqërive **nuk përmbajnë të dhëna për gjendjen fizike dhe funksionale të hapësirës afariste,** si dhe informacione për problemet me të cilat përballen shoqëritë, gjë që e pamundëson Qeverinë e RMV-së të miratojë vendime konkrete.

Me kërkesë të Komisionit për Sistemin Ekonomik dhe Politikën Ekonomike Rrjedhëse pranë Qeverisë, në vitin 2019 nga SHANEHBHA janë dorëzuar të dhënat për gjendjet me hapësirën e lirë afariste, nevojën e deklaruar për hapësirë nga organet shtetërore, dhe informacione të tjera, për të cilat Qeveria e RMV-së më tutje nuk ka miratuar konkluzione me detyra konkrete të Shoqërive, të cilat do të kontribuojnë në ekonomizimin racional dhe efikas të hapësirës afariste shtetërore.

Në raport theksuam se duke filluar nga viti 2025, MF-ja do të ketë për detyrë që Qeverisë t'i propozojë Program Vjetor për shitjen e mjeteve jofinanciare, e cila do të jetë kompetente për menaxhimin e tyre, përkatësisht përdorimin e mjeteve, mirëmbajtjen, shitjen dhe dhënien me qira të tyre. Gjithashtu, MF-ja do të ketë për detyrë të përgatisë bilanc të konsoliduar të gjendjes së shtetit dhe të komunave, si pjesë përbërëse e Llogarisë Përfundimtare të Buxhetit të Shtetit. Në këtë drejtim, MF-ja ka filluar aktivitetet për vendosjen e Sistemit të Integruar Informativ për Menaxhimin e Financave Publike (IFMIS), i cili duhet të përmbajë edhe modul që do të lehtësonte përgatitjen e bilancit të theksuar të gjendjes, për çka nevojitet koordinimi më i madh i aktiviteteve ndërmjet organeve shtetërore dhe institucioneve që përdorin dhe disponojnë pronën shtetërore për të ofruar informacione të plota, të sakta dhe relevante për të.

## 5.2.5. REALIZIMI I INVESTIMEVE KAPITALE TË FINANCUARA PËRMES BUXHETIT TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT, FONDEVE TË BE-SË DHE MJETEVE NGA INSTITUCIONET E TJERA FINANCIARE NDËRKOMBËTARE NË KOMPETENCË TË PUSHTETIT QENDROR DHE TË VETËQEVERISJES LOKALE




Revizioni me temë "**Realizimi i investimeve kapitale të financuara përmes** Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, fondeve të BE-së dhe mjeteve nga institucionet e tjera financiare ndërkombëtare në kompetencë të pushtetit qendror dhe të vetëqeverisjes lokale" si revizion i suksesit është kryer në përputhje me Programin Vjetor të Punës së Entit Shtetëror të Revizionit për vitin 2023. Qëllimi i revizionit të kryer ishte t'i përgjigjet pyetjes **«A siguron struktura ekzistuese dhe realizimi i investimeve kapitale në Republikën e Maqedonisë së Veriut rritje të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse dhe cilësi më të mirë të jetës për qytetarët?»**

Me revizionin e suksesit janë përfshirë efektet e planifikimit dhe realizimit të shpenzimeve kapitale në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe projektet e investimeve publike të parapara në dokumentet programore të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut në sektorët e mëposhtëm:

- Sektori i Transportit,
- Sektori i Mjedisit Jetësor,
- Sektori i Shëndetësisë,
- Sektori i Bujqësisë - Ekonomisë së Ujërave, dhe
- Projekti për ndërtimin e rrugës infrastrukturore të Korridorit 8 dhe Korridorit 10d.

Revizioni ka vlerë të shtuar edhe përmes informimit të Kuvendit për mënyrën e menaxhimit të investimeve kapitale, si dhe për ekspozimin e financave publike ndaj rreziqeve fiskale që lidhen me alokimin dhe shpenzimin e parave publike për investimet kapitale.

Struktura dhe realizimi i investimeve kapitale në Republikën e Maqedonisë së Veriut kanë rreziqe të larta fiskale për realizimin e tyre dhe vihet në pikëpyetje përmbushja e qëllimit strategjik të Qeverisë për realizimin e rritjes së qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse dhe cilësisë më të mirë të jetës së qytetarëve.

Shpenzimet kapitale të paraqitura në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë së Veriut nuk janë të plota dhe nuk ofrojnë pasqyrë të qartë dhe objektive të shumës së investimeve publike në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Në Buxhetin nuk janë paraqitur investimet publike nga NP për Rrugët Shtetërore, gjë që nuk është në përputhje me metodologjitë më të reja për statistikën qeveritare dhe ka efekt në paraqitjen jo të plotë të investimeve kapitale në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Në pjesën narrative të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitet 2021, 2022 dhe 2023, theksohet se Buxheti i propozuar është në përputhje me rregullin e artë në financat publike, sipas të cilit: "shpenzimet kapitale janë më të larta se deficiti buxhetor, përkatësisht theksohet se do të huazohet vetëm për financimin e projekteve investuese". Ky rregull përmbushet vetëm në vitin 2023, në të cilin shpenzimet kapitale të realizuara janë më të mëdha se vlera e deficitit buxhetor.

në 000 denarë

## KORRELACIONI I SHPENZIMEVE KAPITALE DHE DEFICITIT SIPAS VITEVE

Burimi: Ministria e Financave




Sistemi i menaxhimit të investimeve publike nuk është vendosur, ndërsa procesi i planifikimit, prioritizimit dhe alokimit të mjeteve në Buxhetin e Investimeve Publike nuk është përcaktuar në mënyrë adekuate me Ligjin aktual për buxhete në mënyrë që të alokohen mjetet publike për investimet me prioritet më të lartë.

Në shtator 2022, u miratua Ligj i ri sistematik që i ndjek trendet dhe rekomandimet e institucioneve financiare ndërkombëtare.

Janë duke u zhvilluar reformat gjithëpërfshirëse në menaxhimin e financave publike, ndërsa në Programin për Reformën e Menaxhimit të Financave Publike 2022-2025 parashihen masat për forcimin e menaxhimit të investimeve publike me qëllim të përmirësimit të planifikimit, alokimit dhe realizimit të projekteve infrastrukturore publike me futjen graduale të reformave me të cilat do të përmirësohet efikasiteti i praktikave të menaxhimit të investimeve publike.

Edhe pse janë të planifikuara, ende nuk janë vendosur njësitë organizative për t'i mbështetur projektet infrastrukturore në Zyrën e Kryetarit të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe për ndjekjen në Kabinetin e Zëvendëskryetarit të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, përgjegjës për çështjet ekonomike, koordinimin e resorëve ekonomikë dhe investimet.

Nuk ka mbikëqyrje në të gjithë portofolin e investimeve publike në nivel nacional, për këtë arsye rreziku i përgjithshëm fiskal në realizim nuk ndiqet dhe nuk menaxhohet për të ndërmarrë masa korrigjuese në kohë dhe për të reduktuar mundësitë e implikimeve financiare në të ardhmen.

Sistemi i menaxhimit nuk është unik dhe i plotë, përkatësisht ai është i fragmentuar sipas projekteve dhe sipas mënyrës së financimit.

Nuk ka bazë të vetme të dhënash të projekteve nga e cila mund të shihen investimet publike dhe projektet strategjike që janë në realizim, vlera e tyre, dinamika e realizimit, mënyra e financimit, lloji i ndërtimit dhe të dhëna dhe informacione të tjera që do të shërbenin për vlerësimet dhe analizat për nevojat e shtetit.

Nga njëzet e katër (24) projektet e revidura me vlerë prej 3,950 miliardë euro, për nëntëmbëdhjetë (19) projekte janë lidhur kontrata të ndërtimit në vlerë prej 2,744 miliardë euro, ndërsa për pesë (5) projekte, edhe pse përgatitjet kanë filluar disa vite më parë ende nuk ka të lidhur kontrata të ndërtimit. Kontratat e lidhura për (19) nëntëmbëdhjetë projektet kanë vlerë të përgjithshme prej 2,744 miliardë euro, ndërsa realizimi është 941,8 milionë euro. Vetëm (1) një projekt nga ato të revidiuarat ka përfunduar. Nga nëntëmbëdhjetë (19) projektet për të cilat janë lidhur kontrata, për gjashtë (6) ka ngecje për shkak të:

- për (4) katër projekte janë ndërprerë kontratat, nga të cilat për (3) tre ka arbitrazh ndërkombëtar dhe kërkesë për dëmshpërblim në shumë të përgjithshme prej 45,5 milionë euro, dhe
- për (2) dy projekte ka pasiguri për shkak të afatit të skaduar të ndërtimit dhe nuk janë lidhur anekse të reja të kontratave ekzistuese të ndërtimit.

Projekt i ndërtimit të stacionit
të pastrimit për ujërat
e zeza të qytetit të Shkupit

Vlera indikative
**136 milion euro**

Studimi i fizibilitetit
**viti 2019**

Vlera e re e vlerësua
dhe kontrata e lidhur
**185,70 milion euro**
mars 2023

Realizimi i kontratës
**10 milion euro**

## Projektet në IPA II sektori **mjedisi jetësor dhe veprimet klimatike**

| PROJEKTET | VLERA VLERËSUESE NË MILIONA EURO | | KONTRATAT E LIDHUR NË MILIONA EURO | REALIZIMI I KONTRATËS NË MILIONA EURO | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| „Ndërtimi i stacionit pastrues për ujërat e zeza dhe rehabilitim dhe mbindërtim i rrjetit të kanalizimit në Komunën e Manastirit" | 27,86 | plan për prokurime publike 2023 | 0 | 0 | | |
| "Ndërtimi i stacionit pastrues për ujërat e zeza dhe rehabilitim dhe mbindërtim i rrjetit të kanalizimit në Komunën e Tetovës" | 30,12 | kontratë bilaterale, dhjetorë 2023 | 0 | 0 | | |
| „Rehabilitimi dhe zgjerimi i rrjetit të kanalizimit për Komunën e Kërçovës" | 16,07 | kontrata e lidhur, dhjetorë 2023 | 16,07 | 0 | | |
| "Përmirësimi i infrastrukturës për mbledhjen e ujrave të zeza në qytetin e Shkupit" | 9,68 | kontrata e lidhur në vitin 2017 | 9,68 | 7,10 | **ARBITRAZHI** ndërkombëtar viti 2022 | KËRKESË ? |
| „Vendosja e sistemeve rajonale integruese dhe të vetëmbajtura për menaxhimin me mbeturinat për rajonin lindor dhe verilindor" | 26,10 | plan për prokurime publike 2023 | 0 | 0 | | |

## SEKTORI I TRANSPORTIT

### Projektet në IPA II

Koridori Xd "Ndërtimi i segmentit të ri rrugorë Gradsko Drenovë si pjesë nga rruga e Koridorit Xd"

Kontrat e lidhur (vitin 2017)
**24,74 milion euro**

afati për ndërtimin **korrik 2023**

Realizimi i kontratës
**16,80 milion euro**

pasiguri për shkak të afatit të skaduar të ndërtimit nuk janë lidhur anekse të reja

Koridori VIII „Ndërtimi i segmentit të ri hekurudhorë kufiri në Kriva Pallankë me Republikën e bullgarisë si pjesë nga Koridori VIII, faza e 3"

Vlera e vlerësuar
**560 milion euro**

Vlera e re e vlerësuar me analizën GAP, informacioni i Qeverisë qershor 2023

Ndërtimi i Koridorit VIII drejt lindjes, infrastruktura hekurudhore - faza 1

Kontratat e lidhura me kontraktuesin e parë, marrëveshje për ndërprerje me kontraktuesin e parë dhe kontrat me kontraktuesin e dytë **78,20 milion euro**

Realizimi i kontratës **58,73 milion euro**

Ndërtimi i Koridorit VIII drejt lindjes, infrastruktura hekurudhore - faza 2

Kontratë e lidhur (viti 2022)
**155 milion euro**

Realizimi i kontratës
**17,77 milion euro**

Koridori X - Projekti për përmirësimin e prugës hekurudhorë të Koridorit X

**12,78 milion euro**
Projekt i realizuar

## SEKTORI I TRANSPORTIT

Ndërtimi i Autostradës 2,
segmenti rrugorë Kërçovë Ohër
Koridori VIII drejt perendimit



Kontrata e lidhur **589,18 milion euro**
Realizimi i kontratës **466,47 milion euro**



### Ndërtimi i rrugës ekspres Rankovc - Kriva Pallank (Koridori lindor VIII)

në milion euro

| | Kontrata e lidhur | Realizimi i kontratës | |
|---|---|---|---|
| Lot 1 | 49,58 | 26,17 | 53% |
| Lot 2 | 37,73 | 33,95 | 90% |

### TEN-T - projekt për autostradë nga Shkupi deri në kufirin me Kosovën

në milion euro

| | Kontrata e lidhur | Realizimi i kontratës | |
|---|---|---|---|
| Faza 1 | 29,72 | 14,40 | 48% |
| Faza 2 | vlera e vlerësuar 197,98 | ka kontratë të lidhur | |

### Ndërtimi i rrugës rajonale P2138 në lidhje me rrugën rajonale P2134 me vendbanim Sonçev Grad

**6,70 milion euro**
Projekt i realizuar

Ndërtimi i rrugës është përfunduar para 6 vite nuk është lëshuar në përdorimpër shkak të ndryshimeve të pamiratuara gjatë ndërtimit dhe mosvazhdimi i afatit të lejës për ndërtim.

### Ndërtimi i infrastrukturës Koridori 8 dhe Koridori 10 d

| Kontrata e lidhur | Realizimi i kontratës | |
|---|---|---|
| 1.319,02 | 206,67 | 16% |

në milion euro

## SEKTORI I SHËNDETËSISË

Projekti „Rehabilitimi i institucioneve shëndetësor në Republikën e Maqedonisë" Faza II (komponenta 1 dhe komponenta 2)

| PROJEKTI | KONTRATA E LIDHUR NË MILION EURO | REALIZIMI I KONTRATËS NË MILION EURO | | | KËRKESA NË MILION EURO |
|---|---|---|---|---|---|
| Komponenta 1 - Ndërtimi dhe modernizimi i Qendrës Klinike Nëna Terez | 95,50 | 0 | kontrata e ndërprerë gusht 2018 | ARBITRAZHA ndërkombëtare viti 2022 dhe 2023 | 23,50 |
| Komponenta 2 - Ndërtimi i spitalit rajonal në Shtip | 42,62 | 12,99 | kontrata e ndërprerë qershor 2023 | ARBITRAZHA ndërkombëtare viti 2024 | 22,00 |
| Rikonstruim, ridedikim, adaptim dhe mbidërtim i ISHP Spitali i Përgjithshëm Kërçovë faza e parë dhe e dytë | 7,86 | 2,97 | kontrata e ndërprerë nëntor 2023 | Projekti në ngecje për shkak të kontratës së ndërprerë | |

## SEKTORI I EKONOMISË SË UJËRAVE

në milion euro

| | Kontrata e lidhur | Realizimi i kontratës | |
|---|---|---|---|
| Ndërtimi i Pendës Konsko | 44,98 | 36,29 | 81% |
| Penda Reçani | 31,39 | 6,74 | 21% |
| SHM Ravën Reçicë | 14,85 | 12,15 | 82% |

## PROJEKTET NGA SEKTORI I MJEDISIT JETËSOR

Projekti për ndërtimin e Stacionit të Pastrimit të ujërave të zeza në Qytetin e Shkupit është investimi më i madh në fushën e mjedisit jetësor, për të cilin janë siguruar mjete në shumë prej 196 milionë euro nga shteti, dhe janë ndarë mjetet e BE-së në vlerë prej 69,7 milionë euro.

Edhe pse janë siguruar mjetet, përgatitja e këtij projekti ka filluar në vitin 2007. Në vitin 2014, studimi i fizibilitetit për ndërtimin e Stacionit të Pastrimit të ujërave të zeza në Qytetin e Shkupit është përmirësuar dhe përditësuar, por edhe pas 10 vite projekti nuk është gati për realizimin fizik.

Menaxhimi i këtij projekti strategjik nuk është efikas, nuk është arritur qëllimi për zbatimin e obligimeve ligjore dhe arritjen e standardeve, veçanërisht në pjesën e Direktivës për shkarkimin dhe pastrimin e ujërave të zeza komunale (91/271/EEC) dhe Direktivës për ujin e pijshëm (98/83/EEC)

## PROJEKTET NË IPA II NGA SEKTORI I MJEDISIT JETËSOR DHE AKSIONEVE KLIMATIKE DHE TRANSPORTIT

Në Programin Shumëvjeçar të Veprimit për Republikën e Maqedonisë së Veriut për mjedisin jetësor dhe aksionet klimatike dhe transportin në periudhën IPA II (2014-2020), janë programuar (7) shtatë projekte të mëdha me vlerë mbi 10 milionë euro, nga të cilat (2) dy projekte në fushën e transportit dhe (5) pesë projekte në fushën e mjedisit jetësor.

Për këto projekte me vlerë të përgjithshme prej 715,5 milionë euro, me kontratat bilaterale të lidhura ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Republikës së Maqedonisë së Veriut, është ndarë ndihmë financiare në shumë prej 179,7 milionë euro.

Pas (10) dhjetë vite të periudhës programore, ka filluar realizimi i (3) tre projekteve të cilat janë ndërprerë ose kanë dinamikë të ngadalshëm dhe për të cilat janë deklaruar shpenzime në shumë të përgjithshme prej 29 milionë euro.

Për (2) dy nga (3) tre projektet që kanë filluar të realizohen, ka edhe rreziqe fiskale shtesë nga arbitrazhi ndërkombëtar, përkatësisht për përmirësimin e infrastrukturës për grumbullimin e ujërave të zeza në Qytetin e Shkupit, ka filluar edhe procedura e arbitrazhit, ndërsa për ndërtimin e aksit rrugor Gradsko Drenovë, Korridori Xd., ekziston pasiguria për realizimin e plotë dhe rreziku nga arbitrazhi.

Për projektin Rehabilitimi dhe zgjerimi i rrjetit të kanalizimit në Kërçovë ka kontratë aktive për ndërtim e cila është nënshkruar në janar të vitit 2023, realizimi i kontratës ka filluar zyrtarisht në mars të vitit 2023, afati i fundit për deklarimin e shpenzimeve është tetori i vitit 2024, por përqindja e realizimit deri në ditën e revizionit shprehet në përqindje 2%.

Për (4) katër projektet e programuara në kuadër të këtij programi, ekziston pasiguri e madhe për realizimin e projekteve dhe rreziku i humbjes së mjeteve nga granti për shkak të moskryerjes së procedurave të tenderit dhe moslidhjes së kontratave, si:

- Ndërtimi i stacionit të pastrimit për ujërat e zeza dhe rehabilitimi dhe përmirësimi i rrjetit të kanalizimit në Komunën e Manastirit;
- Ndërtimi i stacionit të pastrimit dhe zgjerimi i rrjetit të kanalizimit në Komunën e Tetovës;
- Sistemi i integruar i vetëqëndrueshëm i menaxhimit të mbetjeve në Rajonin Lindor dhe Verilindor; dh

- Ndërtimi i linjës së re hekurudhore Kriva Pallankë në kufi me Republikën e Bullgarisë si pjesë e Korridorit VIII, faza 3.

Nga ky program deri në ditën e revizionit janë anuluar 79 milionë euro nga mjetet e BE-së, ndërsa ekziston paqartësi e madhe për përdorimin e ndihmës financiare të mbetur për faktin se Programi përfundon në fund të vitit 2026.

Përqindja e ulët e përthithjes së mjeteve për projektet e mëdha infrastrukturore tregon se ka probleme në kapacitetin administrativ për t'i menaxhuar fondet strukturore të BE-së në lidhje me Kapitullin 22 - Politika Rajonale, ndërkohë që ka rreziqe fiskale për Buxhetin e shtetit dhe Buxhetin e komunave për shkak të humbjes së mjeteve në emër të granteve për financimin e projekteve në fushën e transportit dhe mjedisit jetësor.

### PROJEKTET NGA SEKTORI I TRANSPORTIT

Për qëllimet e zhvillimit të rrjetit të transportit ndërmjet BE-së dhe vendeve të Evropës Juglindore, janë planifikuar investime në infrastrukturën rrugore dhe hekurudhore, të cilat duhet të kontribuojnë në zhvillimin e qëndrueshëm dhe të barabartë në aspektin ekonomik, integrimin hapësinor, ndikimin në mjedisin jetësor dhe aspektet sociale, si dhe kohezionin social.

- Projektet për ndërtimin e Korridorit VIII të infrastrukturës hekurudhore në lindje faza 1 dhe 2 kanë filluar në vitin 1996 dhe ende nuk janë përfunduar. Vlera e këtyre projekteve është rritur dhe janë paguar provizione për mjetet e patërhequra në shumë prej 4,6 milionë euro për shkak të kushteve të paplotësuara për efektivitetin e huas në periudhë shtatëvjeçare, gjë që ka shkaktuar menaxhim joefikas të këtyre projekteve strategjike.



- Për projektin e ndërtimit të Korridorit VIII të infrastrukturës hekurudhore në lindje, faza 3, faza e planifikimit dhe përgatitjes së projektit po zgjat shumë dhe ekziston rreziku i madh i humbjes së mjeteve të grantit IPA në shumë prej 60,765 milionë euro dhe implikimeve fiskale të ardhshme për shkak të nevojës për sigurimin e mjeteve shtesë nga Buxheti i shtetit.

Njëkohësisht, theksojmë se vlera e projektit është rritur, sipas vlerës në kontratën bilaterale ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Republikës së Maqedonisë së Veriut, është 340 milionë euro, dhe deri në ditën e revizionit, vlera llogaritet në 560 milionë euro. Situata e theksuar bart rrezik të lartë fiskal nga aspekti ekonomik.

- Për projektin për ndërtimin e Autostradës 2, aksi rrugor Kërçovë - Ohër, vlera e kontratës për ndërtim me aneksin nr. 3 është vlerësuar në 589 milionë euro, ndërsa vlera fillestare ishte 411 milionë euro. Projekti nuk ka përfunduar edhe pas 10 vite, ndërsa realizimi financiar është në 466,4 milionë euro. Afati i përfundimit të projektit ka kaluar më 31.12.2023 dhe ka paqartësi të madhe për shkak të paraqitjes së rreziqeve të larta juridike dhe financiare që lidhen me ecurinë e këtij projekti. Në prill të vitit 2024 është miratuar Ligji për realizimin e projekteve infrastrukturore për ndërtimin e aksit rrugor Milladinovci-Shtip dhe aksit rrugor Kërçovë-Ohër, në përputhje me të cilin do të lidhet Aneksi numër 6 i Kontratës për ndërtimin e autostradës, aksit rrugor Kërçovë-Ohër me afatin e fundit për ndërtim më 31.12.2026.



- Projekti i aksit të dytë rrugor TEN-T Projekti për autostradën nga Shkupi deri në kufirin me Kosovën nuk ka filluar, ai është planifikuar për disa vite, dhe vlera e parashikuar prej 112 milionë euro është rritur në 198 milionë euro për 10,5 km autostradë.
- Për projektin – Ndërtimi i rrugës rajonale R2138 në lidhje me rrugën rajonale R2134 me vendbanimin Sonçev Grad revizioni konstatoi se në rrjedhë dhe pas përfundimit të ndërtimit ekzistojnë një sërë lëshime për të cilat rruga ende nuk është lëshuar në përdorim. Një veprim i tillë nuk është në përputhje me parimin e menaxhimit të mirë, pamundësia për të shfrytëzuar një investim publik për të cilin janë shpenzuar fondet publike, dhe e cila është në interes të qytetarëve.
- Për ndërtimin e Korridorit infrastrukturor 8 dhe Korridorit 10d në gjatësi prej 108 km dhe vlerë të llogaritur prej 1,319 miliardë euro, është miratuar ligj i veçantë që rregullon kushtet dhe mënyrën e ndërtimit.

Me analizë krahasuese të kostos së ndërtimit të Korridorit 8 dhe 10d konstatuam se në planin pesëvjeçar të Komunitetit të Transportit nga prilli 2022 vlera treguese e theksuar për këto seksione është 585 milionë euro ose 475 milionë euro pa seksionin Bukojçan-Kërçovë, dërsa vlera treguese e ndërtimit sipas analizës cost benefit/ Analiza e ekspertëve konsultativë, mendimi për arsyetimin/ përfitueshmërinë për ndërtimin e Korridorit VIII dhe Korridorit Xd i përgatitur më 27 dhjetor 2022 nga Fakulteti i Ndërtimtarisë është 1.275 milion euro. Çmimi i vlerës së parashikuar në kontratë është në kuadër të analizës cost benefit.

Projekti i theksuar është planifikuar të financohet plotësisht nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut. Për ndërtimin aplikohet FIDIC i kuq i modifikuar, nuk ka projekt themelor, prandaj edhe vlera e parashikuar e projektit është e pasigurt. Ka paqartësi në financimin e këtij projekti për shkak të mungesës së buxhetimit shumëvjeçar për projektet strategjike dhe mungesës së financimit të projektit.

## PROJEKTET NGA SEKTORI I SHËNDETËSISË

Projektet në fushën e shëndetësisë, ndërtimi i Qendrës Klinike në Shkup, si dhe ndërtimi i Spitalit Rajonal në Shtip janë anuluar për shkak të ndërprerjes së kontratave të huave dhe kontratave të ndërtimit.
Për shkak të anulimit të këtyre projekteve për të cilat janë lidhur kontrata sipas rregullave të FIDIC, në shkurt 2016 për ndërtimin e Spitalit Rajonal në Shtip dhe në maj 2017 për ndërtimin e Qendrës Klinike në Shkup ka rreziqe të larta fiskale për financat publike.
Vlera e parashikuar e kontratave të ndërtimit për Spitalin Rajonal në Shtip është 42,6 milionë euro, ndërsa për Qendrën Klinike në Shkup është 95,5 milionë euro.

Për shkak të ndërprerjes së kontratës për ndërtimin e Qendrës Klinike në Shkup dhe anulimit të projektit gjatë viteve 2022 dhe 2023, është iniciuar arbitrazhi me kërkesat në shumë prej 23,5 milionë euro nga konsorciumi i kontraktuesve, dhe për shkak të ndërprerjes së kontratës për ndërtimin e Spitalit Rajonal në Shtip, projekt me rëndësi të madhe për qytetarët, në janar të vitit 2024 arbitrazhi është iniciuar nga kontraktuesi me kërkesa në shumë prej 22 milionë euro.

Kjo situatë ka si efekt mosarritjen e qëllimeve strategjike të përcaktuara me strategjinë nacionale të shëndetësisë për shkak të anulimit të ndërtimit të projekteve strategjike në shëndetësinë terciare, gjë që ndikon në cilësinë e jetës së qytetarëve.



Ndërtimi i objektit të ri shëndetësor në Kërçovë ka filluar para më shumë se 25 vite. Ndërtimi gjatë viteve 2014 dhe 2020 është riaktivizuar. Vlera e parashikuar e projektit është 16 milionë euro, por për shkak të dinamikës së dobët të realizimit të kontratës me kontraktuesin në gjysmën e dytë të vitit 2023, kontrata u ndërpre.

## PROJEKTET NGA SEKTORI I EKONOMISË SË UJËRAVE

Ndërtimi i tre projekteve kapitale në ekonominë e ujërave nuk ka përfunduar, edhe pse aktiviteti për realizimin e projekteve ka filluar në tetor të vitit 2015, përkatësisht në dhjetor 2016.

Për tre projektet Diga Konsko, Gjevgjeli, Diga e Reçanit në Orizarska Reka, Koçani dhe HMS Raven – Reçicë, Pollog me vlerë totale të kontratës prej 91 milionë euro, nuk janë krijuar kushtet për fillimin e ndërtimit, është zbatuar procedura për prokurimin publik të punimeve dhe është lidhur kontrata për kryerjen e punimeve të ndërtimit. Kontratat janë lidhur edhe pse nuk ka pasur leje ndërtimi për ndërtimet infrastrukturore, nuk është zgjidhur shpronësimi, ka pasur nevojë për projektim shtesë, prandaj edhe pas shtatë vite nga kontratat e lidhura, ndërtimet nuk kanë përfunduar.

Për tejkalimin e situatave të konstatuara kemi dhënë rekomandime me qëllim të ndërmarrjes së masave dhe aktiviteteve nga institucionet kompetente, si dhe në funksion të menaxhimit efikas të investimeve publike me qëllim të përfundimit të projekteve strategjike dhe arritjes së efekteve pozitive në ekonomi, duke përmirësuar kështu cilësinë e jetës së qytetarëve dhe mbrojtjen e mjedisit jetësor, përkatësisht arritjen e qëllimeve për zhvillim të qëndrueshëm.



# 5.3. MBROJTJA

## 5.3.1. MINISTRIA E MBROJTJES

Ministria e Mbrojtjes e Republikës së Maqedonisë së Veriut është organ i administratës shtetërore kompetent dhe përgjegjës për funksionimin efektiv të sistemit nacional të mbrojtjes, mbështetjen e gjithanshme të Armatës së Republikës së Maqedonisë së Veriut, planifikimin strategjik të mbrojtjes, menaxhimin efikas të resurseve të mbrojtjes, zhvillimin e aftësive ushtarake për zbatimin e misioneve të mbrojtjes, bashkëpunimin ndërkombëtar të mbrojtjes, integrimin në NATO, pjesëmarrjen në politikën evropiane të sigurisë dhe mbrojtjes dhe kontributin e vazhdueshëm në operacionet ndërkombëtare.

Me revizionin e kryer në Ministrinë e Mbrojtjes të raporteve financiare për vitin 2022, kemi lëshuar 4 raporte ku janë konstatuar situatat që tregojnë për mospërputhje të transaksioneve financiare me rregullativën ligjore relevante, udhëzimet dhe politikat e vendosura dhe në të njëjtën kohë është lëshuar raporti i veçantë që ka shkallë të klasifikimit.

Në Raportet Përfundimtare të Revizorit të Revizorit të Autorizuar Shtetëror të viteve 2011, 2013 dhe 2017 njoftohet në vazhdimësi **për shprehjen joobjektive të vlerës së tokës, pyjeve, objekteve ndërtimore dhe pajisjeve.** Ndonëse ESHR-ja në vazhdimësi jep rekomandime për tejkalimin e situatave, konstatuam se ato nuk kanë ndryshuar as në vitin 2022.

Република Северна Македонија
Министерство за одбрана

Pra: në evidencën financiare mjetet themelore kanë vlerë aktuale prej 1.422.999.880 mijë denarë, vlera e cila bartet çdo vit duke filluar nga viti 1999.

Kemi konstatuar se edhe pse Ministria ka vendosur **evidencë materiale për tokën, objektet ndërtimore** (listën pronësore, të dhënat e sipërfaqes, lokacionin, qëllimin, etj.) dhe **pajisjet, ajo nuk ka informacione relevante për vlerën e tyre, për këtë arsye nuk është vendosur evidenca financiare.**

Gjatë vitit 2022, me 6 vendime të Qeverisë së RMV-së, MM-së i janë ndarë sende të paluajtshme në shfrytëzim të përhershëm, të cilat janë evidentuar në evidencën materiale, por jo edhe në evidencën financiare, për shkak të mungesës së të dhënave për vlerën e tyre.

Pas rekomandimit të revizorit të autorizuar shtetëror, për vlerësimin e pronës së paluajtshme në tetor 2019, MM ka dorëzuar kërkesë në Byronë e Ekspertizës Gjyqësore, në periudhën 2019-2022, për të kryer vlerësimin e vlerës së objekteve. Byroja e Ekspertizës Gjyqësore ka vlerësuar vetëm një pjesë të objekteve ndërtimore që Ministria i jep me qira.

Përpjekjet që RMV-ja i bëri për anëtarësim në NATO, por edhe përpjekjet rrjedhëse për anëtarësim në Bashkimin Evropian, imponuan nevojën për ndryshimet si në modernizimin e pajisjeve, ashtu edhe në përmirësimin e kushteve për Armatën sipas standardeve të NATO-s. Për këtë qëllim, para disa vitesh Qeveria siguron rregullisht mjete përmes:

- nënprogramit 5B - Ndërtimi dhe rikonstruksioni i objekteve dhe infrastrukturës - qëllimi - përmirësimi i kushteve për funksionimin dhe kryerjen e detyrave të punës së Ministrisë dhe Armatës;
- nënprogramit VA - Integrimi në NATO;
- 1A - Modernizimi i Ministrisë.




Kemi konstatuar se mjetet e shpenzuara në shumë të përgjithshme prej 7.979.735 mijë denarë ose 129,5 milionë euro Ministria i paraqet **vetëm si shpenzime kapitale, e jo edhe si rritje të vlerës së mjeteve të përhershme.**

Ministria disponon me aplikacion softuerik për evidencën e mjeteve dhe materialeve të përhershme të Ministrisë dhe Armatës me të dhënat për sasinë e mjeteve dhe materialeve, lokacionin ku ndodhen ato, pa të dhënat për vlerën e tyre. Në mars të vitit 2021 është lidhur kontratë për përmirësimin e modulit për punë materiale në shumë prej 472 mijë denarë, e cila duhet të mundësojë futjen e treguesve vlerësues të të gjitha mjeteve, por edhe pas pranimit cilësor-sasior të përmirësimit deri në ditën e kryerjes së revizionit, ai akoma nuk është vënë në funksion.

**Nga muaji maj 2022, në Ministri kanë filluar aktivitetet për përcaktimin e vlerës së mjeteve të prokuruara në pesë vitet e fundit, i cili aktivitet akoma vazhdon.**

Revizori i autorizuar shtetëror njofton një periudhë më të gjatë përmes raporteve të tij të revizorit për aktivitetet e Ministrisë për vendosjen dhe implementimin e softuerit - Sistemi Informativ Logjistik - SIL (mjetet sigurohen nga donacioni) i cili sipas konceptimit është aplikacion softuerik me të dhënat në lidhje me planifikimin, programimin, buxhetimin dhe realizimin afatgjatë, afatmesëm dhe vjetor në Ministri dhe Armatë, e cila zgjidhje edhe në vitin 2022 akoma nuk është funksionale.

Me revizionin e kryer kemi konstatuar situata që kanë të bëjnë me: rezervat e materialeve, pjesët rezervë dhe inventarin e imët, obligimet ndaj furnitorëve dhe kërkesat nga blerësit, me ç'rast theksojmë se ndër të tjera Ministria nuk ka ofruar të dhëna të vlefshme për rezervat në fund të periudhës raportuese, obligimet janë shprehur në shumë më të vogël se 28.619 mijë denarë dhe nuk janë kërkesa të evidentuara në shumë prej 818 mijë denarë.

Në raport janë paraqitur situatat që i referohen edhe punës së Qendrës Mjekësore Ushtarake – QMU, ku kemi konstatuar se Ministria realizon të ardhura në bazë të pagesës së pjesëmarrjes nga personat fizikë dhe juridikë për shërbimet shëndetësore të kryera në mbrojtjen shëndetësore primare dhe mbrojtjen shëndetësore specialistike-konsultative. Dispozitat e kontratës së lidhur për ofrimin e shërbimeve shëndetësore në mbrojtjen shëndetësore primare dhe mbrojtjen shëndetësore specialistike-konsultative për personat fizikë dhe juridikë, të vlefshme nga 01.01.2019 deri më 31.12.2023 ndërmjet FSSH-së dhe QMU-së, nuk janë në përputhje me nenin 68-a të Ligjit për sigurim shëndetësor dhe në të njëjtën kohë janë përcaktuar kushtet lidhur me mënyrën e disponimit dhe pagesës së mjeteve në para të gatshme dhe mënyrën e financimit të veprimtarisë së QMU-së.

Në pjesën e të ardhurave të realizuara nga Ministria në bazë të aktiviteteve nga ofrimi i shërbimeve hotelierike, të hotelit dhe rekreative për personat e brendshëm dhe të jashtëm, dhënien me qira të objekteve dhe aktiviteteve të tjera, ndër të tjera kemi konstatuar se mjetet monetare të arkëtuara në para të gatshme nuk paguhen në afatin e përcaktuar me ligj, përkatësisht kjo bëhet me vonesë deri në një muaj, që është në kundërshtim me aktet ligjore.






# 5.4. QËLLIMET E ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM TË KOMBEVE TË BASHKUARA

## 5.4.1. GATISHMËRIA E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT PËR REALIZIMIN E QËLLIMEVE TË ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM DERI NË VITIN 2030

Kemi kryer revizionin e suksesit me temë **"Gatishmëria e Republikës së Maqedonisë së Veriut për realizimin e Qëllimeve të Zhvillimit të Qëndrueshëm deri në vitin 2030"**, si revizion paralel me RLR-në e Republikës së Serbisë, për t'iu përgjigjur pyetjes **"A janë institucionet dhe organet e Republikës së Maqedonisë së Veriut të gatshme t'i realizojnë Qëllimet e Zhvillimit të Qëndrueshëm deri në vitin 2030?"**

Fushëveprimi dhe dëshmitë që i kemi siguruar nëpërmjet zbatimit të metodologjisë dhe teknikave të revizorit, na japin bazën për të shprehur konkluzionin e mëposhtëm:

Pavarësisht kornizës së mirëpërcaktuar strategjike dhe institucionale për zbatimin e detyrimeve të Agjendës 2030, për shkak të disa dobësive në: strukturën menaxhuese, procedurat, kapacitetet administrative, komunikimin dhe informimin, financimin dhe sistemin e monitorimit,

**institucionet dhe organet e Republikës së Maqedonisë së Veriut janë pjesërisht të përgatitura për realizimin e Qëllimeve të Zhvillimit të Qëndrueshëm deri në vitin 2030.**

Korniza strategjike ekzistuese e vendit i mbulon relativisht mirë aspektet kryesore të zhvillimit të qëndrueshëm. Duke pasur parasysh se Strategjia Nacionale për Zhvillimin e Qëndrueshëm (SNZHQ) nuk është rishikuar dhe përshtatur plotësisht në përputhje me qëllimet dhe treguesit e Agjendës 2030, në fazën e përgatitjes është Strategjia Zhvillimore Nacionale. Dokumentet strategjike sektoriale pasqyrojnë kryesisht udhëzimet dhe parimet e parashikuara nga QZHQ-të, prandaj pajtueshmëria e planifikimit strategjik të zhvillimit me QZHQ-të është në nivelin 83%, përkatësisht 95% nëse merret parasysh edhe zbatimi i 55 konventave ndërkombëtare të ratifikuara.



## MBULIMI I QZHQ-VE TË VEÇANTA NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT




Korniza e vendosur organizative dhe zbatuese për arritjen e zhvillimit të qëndrueshëm e përfaqëson qasjen e integruar, por funksionalitetin e saj e pengojnë në masë të mjaftueshme kapacitetet e dobëta administrative, mungesa e të gjitha trupave dhe procedurave mbështetëse të parapara me kompetenca dhe përgjegjësi të përcaktuara qartë. Mungon komunikimi dhe koordinimi i rregullt institucional në nivele të ndryshme të aktiviteteve qeveritare **për identifikimin dhe ndërlidhjen e qëllimeve / targeteve** në drejtim të integrimit të politikave ndërsektoriale, ndërsa ndryshimet e shpeshta në menaxhimin e **Këshillit Nacional** ndikojnë në vazhdimësinë dhe konsistencën e menaxhimit drejt arritjes së qëllimeve strategjike.

VENDOSJA E KANALEVE TË KOMUNIKIMIT DHE INFORMIMIT TË PALËVE TË INTERESUARA




Mungesa e kanaleve efikase për komunikim dhe informim janë arsyeja kryesore për përfshirjen e pamjaftueshme të palëve të interesuara dhe ndërgjegjësimin publik, konsiderojnë të anketuarit nga hulumtimi i zbatuar. Pra, vetëm 5% e tyre deklaruan se janë vendosur kanale të komunikimit dhe informimit të palëve të interesuara dhe publikut, ndërsa efikasitetin e tyre e vlerësojnë si të pjesshëm, 77% e tyre konsiderojnë se nuk u janë dhënë mundësi të mjaftueshme për pjesëmarrjen aktive në procesin e përshtatjes së kornizës nacionale me QZHQ-të.

Mënyra ekzistuese e financimit nuk ofron pasqyrë të qartë se sa nga mjetet buxhetore të planifikuara dhe të realizuara janë të orientuara në funksion të arritjes së qëllimeve të veçanta dhe nënqëllimeve të zhvillimit të qëndrueshëm dhe nuk mundëson ndjekjen efikase të rezultateve të aktiviteteve të financuara.

**Strategjia për Mobilizimin e Mjeteve dhe Partneriteteve për Kornizën e Bashkëpunimit për Zhvillim të Qëndrueshëm (KBZHQ)** paraqet bazë të mirë që i përcakton qëllimet e përbashkëta sasiore dhe qasjet cilësore për mobilizimin e mjeteve dhe partneriteteve për periudhën pesëvjeçare të KBZHQ-së, por mjetet në dispozicion nuk përdoren në tërësi prej vitesh. Në vitin 2021, Agjencitë e KB-së në Republikën e Maqedonisë së Veriut kanë pasur mjete në shumë të përgjithshme prej 44,9 milionë dollarë, nga të cilat janë shfrytëzuar 35,6 milionë dollarë, përkatësisht 79%, ndërsa në vitin 2022, nga 37,4 milionë dollarë në dispozicion, 31,3 milionë dollarë janë përdorur, përkatësisht 84%.

## MJETET E SIGURUARA DHE TË SHPENZUARA PËR VITET 2021 DHE 2022




Ndjekja dhe rishikimi i progresit të Republikës së Maqedonisë së Veriut drejt arritjes së qëllimeve për zhvillim të qëndrueshëm nga Agjenda 2030 bëhet përmes më shumë dokumenteve:

- Analiza për t'i përcaktuar mangësitë,
- Vlerësimi i shpejtë i integruar,
- Rishikimi nacional vullnetar dhe
- raportet vjetore nga Komiteti i Përbashkët Drejtues.

Nga korniza globale e treguesve, 155 ose (63%) janë në dispozicion për Republikën e Maqedonisë së Veriut, dhe shumica e tyre rrjedhin nga programi i punës i Entit Shtetëror të Statistikës, ndërsa treguesit e tjerë sigurohen nga institucionet tjera relevante. Sistemi i pavendosur për mbledhjen dhe ndjekjen e të dhënave nga më shumë institucione, nuk e lehtëson procesin e njoftimit si mbështetje të mekanizmit të llogaridhënies. Në këtë drejtim, mungon platforma në faqen e internetit të Entit Shtetëror të Statistikës, e cila do të mundësojë monitorimin e vazhdueshëm të të dhënave dhe meta-data informacioneve dhe burimeve të informacioneve për QZHQ-të, si dhe treguesve.

Suksesi lidhur me arritjen e qëllimeve për zhvillim të qëndrueshëm sipas treguesve është vendosur në linkun e mëposhtëm:

https://dashboards.sdgindex.org/profiles/north-macedonia.





# 5.5. SISTEMI SHËNDETËSOR

## 5.5.1. FONDI I SIGURIMIT SHËNDETËSOR I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Enti Shtetëror i Revizionit kreu revizionin e raporteve financiare bashkë me revizionin e pajtueshmërisë së Fondit të Sigurimit Shëndetësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2022, me ç'rast përcaktoi më shumë situata, si në vijim:

- dobësi në funksionimin e sistemit të **TI-**së së Fondit për shkak të mungesës së strategjisë së TI-së, mungesës së kuadrit të TI-së dhe strukturës së vjetëruar të serverit, gjë që rezultoi me sulm kibernetik në sistemin e TI-së së Fondit;
- me qëllim që **ISHP-të** të mund të ofrojnë shërbime shëndetësore që janë deficitare për shkak të terapisë dhe metodave të shtrenjta të mjekimit, ekziston mundësia ligjore në kuadër të kompensimit kontraktues vjetor të përfshihet kompensimi i kushtëzuar për prokurimin për gjeneratat e reja të barnave për trajtimin e sëmundjeve të caktuara. Mjetet e ndara për kompensimin e kushtëzuar në vitin 2022 janë 1.721.002 mijë denarë për 24 ISHP dhe ato shënojnë rritje të vazhdueshme, të paraqitura në detaje në grafikun e mëposhtëm.



në 000 denarë

KOMPENSIMI I KUSHTËZUAR PËR PERIUDHËN 2017 - 2022




Realizimi i kompensimit të kushtëzuar në ISHP nuk ndiqet plotësisht nga Fondi dhe nuk janë kryer kontrolle financiare për shpenzimin me dedikim të mjeteve, për prokurimin dhe evidencën e barnave dhe për shërbimet e kryera shëndetësore për vitin 2022. Situatat e konstatuara tregojnë dobësi në planifikimin, realizimin dhe kontrollin e kompensimit të kushtëzuar dhe ndikojnë në arritjen e qëllimeve për të cilat është miratuar kompensimi i kushtëzuar;

- në procedurën e dërgimit të personave të siguruar për mjekim jashtë vendit, ka dobësi dhe parregullsi, me ç'rast nuk ofrohet mbrojtja juridike adekuate e kërkesave dhe nuk është vendosur kontrolli dhe sistemi i ndjekjes së suksesit të mjekimit jashtë vendit. Kërkesat për paradhëniet e bëra për mjekim jashtë vendit nuk janë evidentuar plotësisht dhe nuk janë vendosur kontrolle adekuate për të konfirmuar faturat nga spitalet e huaja, gjë që ka rezultuar me padi;
- aktivitetet e kontrollit për kryerjen e shërbimeve shëndetësore në institucionet shëndetësore nuk janë vendosur ose zbatuar në mënyrë adekuate, për këtë arsye nuk sigurohet konfirmimi i plotë i faturave për shërbimet shëndetësore të kryera. Mosekzistimi i sistemit të vetëm të integruar për lëshimin e fletudhëzimeve, raporteve të mjekut dhe llogaritjeve për shërbimet shëndetësore të kryera, të cilat janë bazë për përgatitjen e faturave / raporteve mujore, krijon rrezik për lëshime dhe gabime. Në kushtet e kapaciteteve të kufizuara të kuadrit, nuk ekziston mundësia e kontrollit të plotë të ISHP-ve të cilave në vitin 2022 u janë paguar gjithsej 3.362.245 mijë denarë. Sipas të dhënave të paraqitura për kontrollet e kryera në vitin 2022 në pjesën e mbrojtjes shëndetësore spitalore, përcaktuam se parregullsi janë konstatuar në 80 nga gjithsej 86 kontrollet, ku shumica e kontrolleve janë kryer në ISHP, edhe pse kjo nuk ka ndikim të rëndësishëm në lartësinë e kompensimit të paguar nga Fondi, në dallim nga kontrollet në ISHP, të cilat duhet të sigurojnë konfirmimin e llojit dhe vëllimit të shërbimeve shëndetësore të faturuara, gjë që ndikon në lartësinë e kompensimit të paguar. Raportet për kontrollet e kryera i janë dorëzuar komisionit për dënimet kontraktuese, por nuk ka informacione të plota për veprimin sipas tyre dhe për dënimet e shqiptuara kontraktuese;

- në bazë të faturave për barna me recetë të lëshuara gjatë vitit 2022, në barnatoret e ISHP-së janë paguar gjithsej 2.818.726 mijë denarë, me ç'rast kontrollet sistematike dhe manuale në procesin e përshkrimit dhe lëshimit të barnave nuk janë vendosur dhe zbatuar në mënyrë adekuate dhe ekziston rreziku nga pagesa e faturave me receta në llojin dhe vëllimin e ndryshëm nga ai real. Pas konstatimit të recetave të dyfishta të faturuara nga revizioni, Fondi ka ndërmarrë aktivitete për kontrollet sistematike nga të cilat janë zbuluar gjithsej 65.609 receta të kontestuara të lëshuara në periudhën prej vitit 2021 deri në vitin 2023 në vlerë të përgjithshme prej 6.138 mijë denarë. Konstatuam se pas rikontrollit të kërkuar të recetave të kontestuara në vitin 2022, janë evidentuar letra të regjistruara dhe është bërë zvogëlimi i faturave nga barnatoret për vetëm 4% të shumës totale të kontestuar. Gjithashtu, janë ndërmarrë aktivitete në drejtim të inkorporimit të kontrolleve të caktuara të reja sistematike në recetat e faturuara dhe është bërë ndryshimi i aktit intern, i cili ka rritur mostrën përfaqësuese për kontrollin manual të recetave, por këto kontrolle edhe më tutje kanë fushëveprim të kufizuar dhe nuk janë mjaftueshëm efikas, duke pasur parasysh se mesatarisht në muaj lëshohen mbi 2 milionë receta. Ndonëse që nga viti 2021 kanë filluar aktivitetet për vendosjen e sistemit të e-Recetës i cili duhet të mundësojë kontroll të plotë në procesin e lëshimit të recetave dhe barnave dhe faturimit në Fond, ai deri në ditën e revizonit nuk është zbatuar;
- statusi juridik pronësor i një pjese të objekteve ndërtimore dhe tokës është e parregulluar, vlera e pronës së paluajtshme nuk është përcaktuar plotësisht dhe ai nuk është evidentuar plotësisht në librat afariste;
- në zbatimin e procedurave dhe realizimin e kontratave për prokurimet publike, janë konstatuar parregullsi, përkatësisht një pjesë e kontratave nuk janë lidhur brenda afatit të përcaktuar me ligj, ndërsa në prokurimin e pajisjeve dhe shërbimeve për sistemin e TI-së së Fondit nuk ka konkurrencë të mjaftueshme.

Në pjesën **Theksimi i çështjeve të pasigurisë dhe vazhdimësisë**, revizioni zbuloi për:

- mungesën e informacioneve të plota për kërkesat lidhur me kontributin e papaguar për sigurimin shëndetësor dhe arkëtimin jashtëzakonisht të pasigurt të kërkesave që ishin paraqitur më 31.12.2008;
- pasigurinë për rezultatin përfundimtar të proceseve gjyqësore në të cilat Fondi paraqitet si i paditur dhe paditës;
- çmimet referente jo të përditësuara për shërbimet shëndetësore që bien në ngarkesë të Fondit.

Në pjesën **Çështjet kryesore të revizorit**, njoftojmë për mënyrën e pagesës për shërbimet e kryera në institucionet shëndetësore, duke theksuar se nuk është siguruar blerja reale e shërbimeve të parapara me Ligjin për sigurim shëndetësor. Fondi, brenda buxhetit të përcaktuar, në vend që t'i kompensojë shërbimet shëndetësore të kryera, detyrohet të sigurojë mjete për funksionimin e plotë të të gjitha ISHP-ve, ku 2/3 e tyre kanë status të paqëndrueshëm, për shkak të vëllimit të realizuar dukshëm më të ulët të shërbimeve krahasuar me kompensimin e kontraktuar.

Në pjesën **Çështje të tjera**, njoftojmë se lista e barnave në ngarkesë të Fondit nuk është përditësuar, ndërsa Strategjia Nacionale për e-Shëndetësi nuk është miratuar.

[6] Sipas Raportit Vjetor të Fondit për vitin 2022, janë realizuar gjithsej 25.013.389 receta;

## 5.5.2 INSTITUCIONET SHËNDETËSORE PUBLIKE

3 SHËNDET I MIRË DHE MIRËQENIE

Me Programin Vjetor të Punës së Entit Shtetëror të Revizionit për vitin 2023 ishin mbuluar tri institucionet shëndetësore publike në fushën e mbrojtjes shëndetësore sekondare dhe terciare:

- ISHP Spitali Klinik dr. Trifun Panovski Manastir,
- ISHP Klinika Universitare për Sëmundjet e Syve dhe
- ISHP Klinika Universitare për Sëmundjet e Fëmijëve.

Me revizionet e kryera të raporteve financiare dhe revizioneve të pajtueshmërisë për vitin 2022 të ISHP-ve të përmendura paraprakisht, janë konstatuar situatat të cilat më së shumti përsëriten edhe në raportet e mëparshme vjetore të institucioneve të tjera shëndetësore publike dhe kanë të bëjnë me:

- parregullsitë në regjistrimin e zbatuar të mjeteve dhe obligimeve;
- parregullsitë në evidentimin dhe ndjekjen e shpenzimit të barnave dhe materialeve të tjera mjekësore;
- dallimet në participimin e llogaritur dhe të arkëtuar, përkatësisht aktivitetet e pandërmarra për arkëtimin në kohë të kërkesave për shërbimet shëndetësore të kryera dhe plotësinë e pasiguruar të të ardhurave për shërbimet shëndetësore të kryera;
- dobësitë në organizimin e orarit të punës, që mundëson caktimin joadekuat të kohëzgjatjes së orarit të punës dhe lartësisë së kompensimeve që do t'u paguhen punonjësve të caktuar, si dhe pagesa joadekuate e rrogës dhe kompensimeve të rrogës;
- nuk ofrohen terminet e detyrueshme ligjore për kryerjen e shërbimeve shëndetësore përmes Termini Im;
- mossigurimin e respektimit konsekuent të dispozitave të Ligjit për prokurimet publike në procedurat për dhënien e kontratave për prokurimet publike dhe ndjekjen e realizimit të kontratave të lidhura dhe
- dobësitë në kontrollet e brendshme në një pjesë të proceseve të punës në ISHP.

Në pjesën **Theksimi i çështjeve të pasigurisë dhe vazhdimësisë**, revizioni njoftoi për:

- Akceleratorin e prokuruar linear nga Ministria për nevojat e ISHP Spitali Klinik Manastir në vitin 2012 në shumë prej 100.015 mijë denarë, i cili deri në ditën e kryerjes së revizionit nuk është vënë në përdorim për shkak se nuk ka kuadër adekuat dhe pajisje shtesë të nevojshme për funksionimin e tij.
- Në ISHP KU për Sëmundjet e Fëmijëve janë regjistruar midis 130 dhe 140 pacientë të sëmurë me fibrozë cistike dhe mjetet e siguruara deri në nëntor 2023 janë të mjaftueshme për blerjen e terapisë vetëm për 15 pacientë. Revizioni është i mendimit se në kushtet e buxhetit të kufizuar dhe numrit të kufizuar të pacientëve të cilëve u jepet terapia, ekziston rreziku i subjektivizmit në përzgjedhjen e pacientëve që do të përfshihen në terapi, për këtë arsye është e nevojshme që Klinika në bashkëpunim me Fondin dhe Ministrinë të ndërmarrë aktivitete për sigurimin e mjeteve për përfshirjen e kësaj terapie për të gjithë pacientët për të cilët ka dëshmi se i plotësojnë kriteret mjekësore, të konfirmuara nga këshilli mjekësor dhe kolegjiumi profesional;
- Më 31.12. 2022, ISHP-të e reviduara kanë kërkesa të paarkëtuara nga Ministria e Shëndetësisë për shërbimet shëndetësore të kryera në kuadër të programeve të mbrojtjes shëndetësore në shumë prej 148.753 mijë denarë, që rrjedhin në periudhën nga viti 2009 deri në vitin 2022. Kjo që ishte theksuar ka ndikim në gjendjen financiare të ISHP-së dhe cilësinë e shërbimeve të ofruara për qytetarët dhe krijon rrezik të parashkrimit të kërkesave, për këtë arsye revizioni tregon se është e nevojshme që ISHP-ja në bashkëpunim me Ministrinë të gjejnë zgjidhje për tejkalimin e situatës me kërkesat e paarkëtuara.

Në pjesën **Çështje të tjera**, revizioni njoftoi se:

Pavarësisht ekzistimit të obligimit ligjor të Ministrisë së Shëndetësisë për vendosjen e Sistemit Nacional për Punën Materialo-Financiare dhe të Kontabilitetit dhe Sistemin Qendror për regjistrimin e orarit të punës për nevojat e institucioneve shëndetësore publike, ato nuk janë në funksion. Është e nevojshme të ndërmerren aktivitete për rishqyrtimin e këtyre zgjidhjeve ligjore dhe mundësive për zbatimin dhe funksionalitetin e tyre.

Është e nevojshme të ndërmerren aktivitete nga ministri i Shëndetësisë për miratimin e aktit që do të përcaktojë llojin e shpenzimeve që mund të përfshihen në kompensim me rastin e lidhjes së kontratës për kryerjen e pandërprerë të veprimtarisë shëndetësore ndërmjet ISHP-së në përputhje me nenin 221 të Ligjit për mbrojtje shëndetësore, duke pasur parasysh se ISHP të ndryshme e rregullojnë këtë proces në mënyra të ndryshme.



## 5.5.3 SHFRYTËZIMI I SHËRBIMEVE SHËNDETËSORE PËR DIAGNOSTIKIMIN RADIOLOGJIK ME REZONANCË MAGNETIKE

3 SHËNDET I MIRË DHE MIRËQENIE

Enti Shtetëror i Revizionit kreu revizionin e suksesit me temë **«Shfrytëzimi i shërbimeve shëndetësore për diagnostikimin radiologjik me rezonancë magnetike»** për t'iu përgjigjur pyetjes «Nëse personave të siguruar u janë në dispozicion në kohë dhe në mënyrë cilësore shërbimet shëndetësore për diagnostikimin radiologjik me rezonancë magnetike-RM»? në periudhën 2019 - 2022.

Kemi konstatuar se përkundër progresit të arritur në sigurimin e shtatë aparateve të reja për RM në shëndetësinë publike në tre vitet e fundit, ato **nuk janë përdorur sa duhet**, ndërsa politikat e miratuara dhe masat dhe aktivitetet e ndërmarra nga institucionet kompetente dhe institucionet shëndetësore jo gjithmonë sigurojnë shërbime shëndetësore të disponueshme dhe me cilësi të lartë me RM për personat e siguruar.




Vëllimi i shërbimeve në 2022 është afërsisht në të njëjtin nivel me vitin 2017, megjithëse numri i aparateve për RM në shëndetësinë publike është dyfishuar nga 7 në 14, i paraqitur në grafikun e mëposhtëm.

Mesatarja vjetore e 2,800 shërbimeve të kryera për aparat, është nën mesataren e vendeve evropiane, e cila lëviz nga 4 deri në 9 mijë incizime në vit për aparat.

Në listën elektronike janë publikuar gjithsej 110.466 termine të lira për RM, nga të cilat janë caktuar 83%, ndërsa janë shfrytëzuar 56%, përkatësisht janë kryer 61.987 kontrolle për të cilat është lëshuar raporti specialistik. Ka lëshime të konsiderueshme në numrin e termineve të publikuara në raport me ato të përcaktuara, si rezultat i defekteve të aparateve për RM dhe reduktimit të kuadrit në dispozicion, si dhe për shkak të krizës së Kovid-19 në vitet 2020 dhe 2021.

Është vendosur praktikë për dërgimin e pabazuar dhe të pajustifikuar për incizimin me RM nga specialistët, për të cilat nuk janë ndërmarrë masash sanksionuese nga Ministria e Shëndetësisë. Situatat e tilla ndikojnë që personat e siguruar jo gjithnjë të mund të caktojnë termine për kontroll dhe t'i ushtrojnë të drejtat e tyre nga sigurimi i detyrueshëm shëndetësor në shëndetësinë publike, prandaj jo rrallë shfrytëzojnë shërbimet në shëndetësinë private, për të cilat institucionet kompetente nuk kanë të dhëna.

Një pjesë e ISHP-ve nuk kanë vendosur sistem qendror për arkivimin e incizimeve - sistemin PAKS, për arsye se nuk mund të konfirmohet numri i përgjithshëm i incizimeve të kryera, veçanërisht pasi nuk janë vendosur kontrolle efikase për procesin e incizimit dhe evidentimit. Vetëm në tri ISHP bëhen incizime me RM për të gjitha llojet e diagnostikimit, ndërsa në të tjerat, për shkak të kuadrit të trajnuar në mënyrë të pamjaftueshme dhe/ose spiraleve (antenave) në mënyrë të parregullt, bëhen vetëm incizime të caktuara.

Sipas të dhënave të marra nga Termini Im, në periudhën nga viti 2019 deri në maj 2023 janë evidentuar gjithsej 92.533 kontrolle, ku përfshihen kontrollet e kryera me raport të lëshuar dhe kontrollet për të cilat nuk është lëshuar raport, në termin të rregullt dhe pa termin, sipas ISHP-ve të paraqitur në grafikun e mëposhtëm:

## VËLLIMI I SHËRBIMEVE/ NUMRI I APARATEVE PËR PERIUDHËN 2017-2022



| | IU Radiologjia | SHSH Shkup-POL. ÇAIR | SK Manastir | SPQ 8-te Shtatori Shkup | SK Shtip | KU Shën Naumi Ohrid Shkup | SK Tetove | SS Shen Erazmo Ohër | SP Strumicë | SP Prilep |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Kontroll në termin të rregullt me raport të lëshuar | 15.654 | 19.154 | 8.988 | 2.876 | 6.102 | 3.984 | 2.872 | 1.042 | 1.315 | 0 |
| Kontrollë prioritare, emergjente dhe shërbimi me raport të lëshuar | 12.436 | 11 | 1.846 | 226 | 911 | 2.166 | 746 | 600 | 80 | 0 |
| Kontrollë në termin të rregullt dhe patermina për të cilat nuk është lëshuar raport | 2.323 | 33 | 4.313 | 3.582 | 164 | 633 | 14 | 271 | 179 | 12 |

Sipas të dhënave të Termini Im, nuk është lëshuar raport për 12% të numrit të përgjithshëm të kontrolleve të kryera, nga të cilat 90% u referohen tri ISHP-ve dhe një ISHP nuk ka shkruar asnjë raport në Termini Im. Këto ISHP nuk kryejnë sinkronizim të vazhdueshëm dhe të plotë të të dhënave nga softueri i brendshëm spitalor me Termini Im, për këtë arsye një pjesë e raporteve të specialistëve të lëshuara janë hartuar jashtë Termini Im.

Nga numri i përgjithshëm i kontrolleve të evidentuara në Termini Im, 21% janë realizuar jashtë termineve të rregullta si kontrolle prioritare, urgjente dhe të servisit, nga të cilat pjesa më e madhe ose 86% janë realizuar në tri ISHP në Shkup dhe Manastir të cilat kanë rritje të numrit të pacientëve mbi këtë bazë. Në kushtet e rritjes së presionit në këto ISHP, ekziston rreziku që kontrollet me RM të kryhen me kohëzgjatje më të shkurtër se sa duhet, gjë që ndikon në cilësinë e shërbimeve shëndetësore.

Për periudhën nga viti 2019 deri në maj 2023, nga ISHP-të janë marrë të dhënat për gjithsej 114.181 shërbime të kryera për incizim me RM në shumë të përgjithshme prej 747.873 mijë denarë (rreth 12 milionë euro) dhe llogari të faturuara në Fondin e Sigurimit Shëndetësor për 100.662 pako të shërbimeve shëndetësore në shumë të përgjithshme prej 666.658 mijë denarë (rreth 10,8 milionë euro), ndërsa për të njëjtën periudhë të dhënat nga Termini Im tregojnë gjithsej 92.533 shërbime të kryera me RM.

Për periudhën nga viti 2019 deri në maj 2023, nga ISHP-të janë marrë të dhënat për gjithsej 114.181 shërbime të kryera për incizim me RM në shumë të përgjithshme prej 747.873 mijë denarë (rreth 12 milionë euro) dhe llogari të faturuara në Fondin e Sigurimit Shëndetësor për 100.662 pako të shërbimeve shëndetësore në shumë të përgjithshme prej 666.658 mijë denarë (rreth 10,8 milionë euro), ndërsa për të njëjtën periudhë të dhënat nga Termini Im tregojnë gjithsej 92.533 shërbime të kryera me RM.

Shërbimet e kryera si veprimtari shtesë nuk caktohen përmes listës elektronike dhe nuk evidentohen në Termini Im. Çmimet për këto shërbime janë për 47% më të larta se çmimet e shërbimeve të kryera për të huajt dhe për kryerjen e tyre nuk dorëzohen raporte me shkrim nga punonjësit shëndetësorë në institucion.

Në bazë të mirëmbajtjes dhe servisimit të aparateve, ISHP-të kanë paguar 75.495 mijë denarë (rreth 1,2 milionë euro) për gjithsej 49 ndërhyrje, sipas modelit të aparatit të paraqitur në grafikun e mëposhtëm:

| | NUMRI I APARATEVE | NUMRI I DEFEKTEVE | NUMRI I SERVISEVE TË RREGULLT | % E PJESËMARRJES SË SHPENZIMEVE PËR MIRËMBAJTJE DHE SERVISIM |
|---|---|---|---|---|
| **SIEMENS** | 4 | 25 | 4 | 57% |
| **PHILIPS** GYROSCAN | 1 | 10 | / | 10.1% |
| **GE SIGNA** | 3 | 9 | / | 32.5% |
| **PHILIPS** INGENIA | 1 | / | 1 | 0,4% |

Një pjesë e ISHP-ve planifikojnë dhe zbatojnë rregullisht procedurat, ndërsa një pjesë lidhin kontrata për mirëmbajtjen dhe servisimin e aparateve dhe prokurimin e pjesëve rezervë vetëm pas defektit të konstatuar, i cili ndikon në disponueshmërinë e shërbimeve me RM.

Në bazë të kontratave të lidhura për kryerjen e shërbimeve shëndetësore në 4 ISHP, të cilat nuk kanë kuadër të tyre për leximin e incizimeve RM, janë paguar 9.156 mijë denarë. Ka dallime të theksuara në mënyrën e angazhimit dhe lartësinë e kompensimit për mjekët, si dhe mungesë të kontrolleve dhe parregullsi në mënyrën e përcaktimit dhe konfirmimit të angazhimit dhe pagesave për të, gjë që ndikon në shpenzimin ekonomik dhe racional të mjeteve publike.

Për tejkalimin e gjendjeve të theksuara janë dhënë rekomandime për ndërmarrjen e masave dhe aktiviteteve nga institucionet kompetente, ndërsa në funksion të sigurimit të përdorimit efikas, disponueshmërisë dhe cilësisë adekuate të shërbimeve shëndetësore me rezonancë magnetike.





# 5.6. SISTEMET E INFORMACIONEVE, SIGURIA DHE MBROJTJA E TË DHËNAVE

## 5.6.1. EFIKASITETI I PORTALIT NACIONAL PËR E-SHËRBIME

**Portalit Nacional për e-shërbime",** për t'iu përgjigjur pyetjes "Nëse me digjitalizimin e shërbimeve, për qytetarët do të sigurohen shërbime efikase, të plota, cilësore dhe elektronike me çmime më të uléta?»

Portalit Nacional për e-shërbime", për t'iu përgjigjur pyetjes "Nëse me digjitalizimin e shërbimeve, për qytetarët do të sigurohen shërbime efikase, të plota, cilësore dhe elektronike me çmime më të ulëta?"

Me revizionin e zbatuar dhe metodologjinë e aplikuar të revizorit, dëshmitë e mbledhura të revizorit, kemi fituar siguri të arsyeshme se organet dhe institucionet kompetente janë pjesërisht të përkushtuara në aktivitetet për transformimin digjital dhe mundësimin e shërbimeve elektronike për qytetarët. Procesi i digjitalizimit të shërbimeve është i ngadalshëm, përkatësisht 140 ligje bashkë me Ligjin për procedurën e përgjithshme administrative ende nuk janë në përputhje me pakon e ligjeve të digjitalizimit.

Institucionet dhe organet kompetente kanë mungesë të kuadrit me përvojë të kualifikuar të TI-së, gjë që sjell rritjen e rrezikut për realizimin e aktiviteteve në fushën e digjitalizimit. Institucionet nuk i përditësojnë të dhënat, përkatësisht një pjesë e personave të nominuar për operatorë dhe verifikues të shërbimeve elektronike në katalogun e shërbimeve nuk janë më në institucione, ndërsa një pjesë janë evidentuar me adresa elektronike private. Institucione të caktuara zhvillojnë në mënyrë të pavarur e-zgjidhje, pa i integruar ato me portalin nacional për e-shërbime, gjë që rezulton me përdorimin joracional të resurseve. Interesimi i dobët i qytetarëve, promovimi i pamjaftueshëm i portalit dhe shërbimeve elektronike nëpërmjet mediave dhe rrjeteve sociale, çmimet e barabarta të dokumenteve elektronike dhe në formë letre shkaktojnë që për dy vite numri i përdoruesve të regjistruar të Portalit Nacional të rritet për 70.000, ndërsa numri i kërkesave të parashtruara për shërbime elektronike është rritur për 40.000, ose vetëm 0,556 kërkesa të parashtruara për përdorues të regjistruar. Përafërsisht 65.000 shërbime elektronike janë realizuar përmes Portalit Nacional për 4 vjet.



## NUMRI MESATAR I KËRKESAVE SIPAS SHFRYTËZUESIT TË REGJISTRUAR




Duke i marrë parasysh mjetet financiare të investuara në zhvillimin dhe mirëmbajtjen e Portalit Nacional në shumë prej 829.167 mijë denarë nga Buxheti dhe projektet IPA, numri i përdoruesve të regjistruar (112.657) të Portalit dhe numri i 64.700 e-shërbimeve të kërkuara rezultoi se çmimi i një e-shërbimi të realizuar përmes Portalit Nacional është 12.815 denarë.

Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës nuk ka ndërmarrë aktivitete për informimin e qytetarëve dhe komunitetit të biznesit për digjitalizimin e proceseve në institucionet dhe shërbimet elektronike që ofrohen përmes Portalit Nacional.

Obligimet e marra për identifikimin dhe eliminimin e pengesave dhe barrierave në disponueshmërinë dhe standardet e disponueshmërisë në internet nuk janë zbatuar plotësisht, ndërsa personat me shikim të dëmtuar nuk janë në gjendje t'i përdorin shërbimet elektronike përmes Portalit Nacional për e-shërbime.

NUMRI TOTAL I BILETAVE TË SHËRBYER SIPAS ZYRAVE TË ETU-SË




Gjithashtu, qendrat ETU jashtë Shkupit nuk i kanë arritur qëllimet e parapara, duke pasur parasysh se shërbejnë nga 0,9 deri në 146 qytetarë në muaj në qendër, përkatësisht 0,2 deri në 24,33 qytetarë për punonjës në qendër në muaj.

Qasja e vështirë e personave me aftësi të kufizuar, 9.568 dokumentet elektronike të lëshuara me certifikatat e skaduara, si dhe mungesa e monitorimit për kënaqësinë e përdoruesve ndikon në cilësinë dhe disponueshmërinë e shërbimeve elektronike, si dhe përdorimi i Portalit Nacional për e-shërbime nga qytetarët është në nivel të ulët.

Për t'i tejkaluar gjendjet e konstatuara, kemi dhënë rekomandime me qëllim të përshpejtimit të procesit të digjitalizimit në vend, futjes së një numri më të madh të shërbimeve elektronike, sinkronizimit të profileve të përdoruesve të qytetarëve nga portale të ndryshme me Portalin Nacional, promovimit më të madh të ekzistimit dhe mënyrës së disponueshmërisë së Portalit Nacional për e-shërbime, pranimi më i gjerë i dokumenteve elektronike dhe shfrytëzimi më i madh i Portalit Nacional si sistem qendror për njoftim unik.

### 5.6.2. EFIKASITETI I MASAVE TË NDËRMARRA NGA ORGANET KOMPETENTE PËR MBROJTJEN E SISTEMEVE KRITIKE TË INFORMACIONEVE

Kemi kryer revizionin e sistemeve të informacioneve si revizion i suksesit me temë "Efikasiteti i masave të ndërmarra nga organet kompetente për mbrojtjen e sistemeve kritike të informacioneve" për t'iu përgjigjur pyetjes «**Nëse masat e ndërmarra nga organat kompetente sigurojnë mbrojtje efikase dhe të plotë të sistemeve kritike të informacioneve?**»

Me revizionin e zbatuar dhe metodologjinë e aplikuar të revizorit, dëshmitë e mbledhura të revizorit, kemi fituar siguri të arsyeshme se organet dhe institucionet kompetente nuk sigurojnë mbrojtje efikase dhe të plotë të sistemeve kritike të informacioneve. Njëherazi, mungesa e rregullativës juridike në vend në fushën e sigurisë së rrjeteve dhe sistemeve të informacioneve, si dhe nevoja për të harmonizuar direktivën e BE-së NIS2, nuk i detyron institucionet të marrin përgjegjësi për masat e menaxhimit të rreziqeve, caktimin e roleve dhe përgjegjësive për sigurinë kibernetike, detyrimin për të njoftuar pas incidenteve, si dhe planet e përgatitura dhe të testuara për vazhdimësinë e shërbimeve të tyre.

Mungesa e dokumenteve strategjike si grup aktivitetesh dhe masash nuk siguron mjedis digjital të sigurt, rezistues dhe të besueshëm që ndikon që shteti të jetë vend i sigurt për veprimin online dhe punë me kapacitetet e avancuara njerëzore dhe teknike.

ПStrategjia Nacionale e fundit e TIK-së është e vlefshme deri në vitin 2017, ndërsa Strategjia Nacionale e fundit e Sigurisë Kibernetike është e vlefshme deri në vitin 2022. Pavarësisht se janë përgatitur, Draft-Strategjia Nacionale e TIK-së dhe Draft-Strategjia Nacionale e Sigurisë Kibernetike janë ende në procedurë të harmonizimit ndërinstitucional. Subjekteve u mungojnë dokumentet e miratuara të zhvillimit, strategjitë, planet e veprimit për menaxhimin e rreziqeve të TI-së.

Aktet ligjore dhe nënligjore për përcaktimin e kritereve dhe hartimin e regjistrit me operatorët e infrastrukturës kritike (VIS dhe KII) si dhe përcaktimin e masave dhe standardeve minimale të sigurisë për mbrojtjen e sistemeve të tyre të informacioneve nuk janë miratuar.

Në periudhën e reviduar nga viti 2020 deri në vitin 2022, si dhe deri në ditën e njoftimit të revizorit, ndër të tjera, kemi konstatuar se:

- mungon rregullativa për paraqitjen e detyrueshme të incidentit të sigurisë kompjuterike nga institucionet në MKD-CIRT;
- metoda e pamundësimit të qasjes në rrjetin e internetit të pajisjeve të infektuara dhe me qëllim të keq që janë të lidhura përmes operatorëve të internetit dhe që janë burimi i softuerëve me qëllim të keq, nuk është e rregulluar;
- nuk janë emëruar personat për sigurinë e informacioneve në institucionet, si dhe numri i mjaftueshëm i punonjësve, me të cilën minimizohet rreziku i zbulimit në kohë të kërcënimeve ndaj sigurisë së informacioneve në nivel të pranueshëm, si dhe ndërmarrjen e masave për mbrojtjen ndaj tyre;
- mungon trajnimi i vazhdueshëm profesional për kërcënimet më të reja për sigurinë e informacioneve, si dhe testimi për të kontrolluar ndërgjegjësimin, ndër të tjera, dhe për t'i identifikuar sulmet e mashtrimit të përdoruesve përmes dërgimit të mesazhit të rremë;
- nuk ka ekipe të formuara për t'iu përgjigjur incidenteve të sigurisë kompjuterike në numër të mjaftueshëm;
- nuk kryhet analiza e rreziqeve me propozim-masa sipas prioritetit të rreziqeve për reduktimin, zbutjen, transferimin ose minimizimin e tyre në nivel të pranueshëm, me kornizë të saktë kohore për zbatimin e tyre;
- nuk kryhet analiza e vazhdueshme, me qëllim të shqyrtimit të situatës reale dhe përcaktimit të masave dhe rekomandimeve për ngritjen e nivelit të sigurisë, kryerjen e revizioneve të rregullta për zbulimin e ga-

bimeve dhe dobësive të sigurisë, zhvillimin dhe testimin periodik të planeve të sigurisë së informacioneve në institucionet;

- mosfunksionimi i Këshillit Nacional për Sigurinë Kibernetike vë në pikëpyetje efektivitetin, efikasitetin dhe rëndësinë në përballjen me sfidat moderne dhe të ardhshme për sigurinë kibernetike të sistemeve të informacioneve;
- resurset njerëzore për parandalimin dhe përballjen me incidentet e sigurisë së TIK-së janë të pamjaftueshme, ndërkohë që 40% e institucioneve nuk kanë emëruar person përgjegjës për sigurinë e informacioneve.

Për t'i tejkaluar situatat e konstatuara, kemi dhënë rekomandime për të siguruar numër të mjaftueshëm të personelit njerëzor të edukuar dhe mbrojtje efikase dhe të plotë të sistemeve kritike të informacioneve.





## 5.7. GJYQËSORI DHE SUNDIMI I SË DREJTËS

### 5.7.1. KOMISIONI SHTETËROR PËR ANKESA PËR PROKURIME PUBLIKE

**Komisioni Shtetëror vendos për ligjshmërinë e veprimeve dhe lëshimeve për të ndërmarrë veprime, si dhe për vendimet si akte të veçanta juridike të miratuara në procedurat e prokurimeve publike dhe për dhënien e kontratave për koncesione dhe partneritet privat publik.**



Kemi kryer revizionin e raporteve financiare të Komisionit Shtetëror për Ankesa për Prokurime Publike për vitin 2022, për llogaritë e buxhetit themelor, bashkë me revizionin e pajtueshmërisë, për të cilat kemi shprehur mendim pozitiv.

Në vitin 2022, Komisioni Shtetëror ka vepruar sipas 837 lëndëve, nga të cilat 93%, përkatësisht 784 janë zgjidhur, ndërsa pjesa tjetër është transferuar për zgjidhje në vitin 2023, për shkak të dokumentacionit jo të plotë.

Lëndët e zgjidhura në vitin 2022, sipas llojit të vendimit të miratuar nga Komisioni Shtetëror, janë paraqitur në grafikun numër 1:

## STRUKTURA E LËNDËVE TË ZGJIDHURA NË VITIN 2022




Vendimet e Komisionit Shtetëror janë përfundimtare dhe të gjitha palët janë të detyruara t'i respektojnë dhe t'i zbatojnë.

Pas vendimeve të Komisionit Shtetëror mund të iniciohet kontest para Gjykatës Administrative, përkatësisht të parashtrojnë ankesë në Gjykatën e Lartë Administrative.

Veprimi i gjykatave kompetente kundër vendimeve të miratuara të Komisionit Shtetëror në vitin 2022 është paraqitur në Grafikun.

## VEPRIMI I GJYKATAVE KOMPETENTE SIPAS PROCEDURAVE PËR PROKURIME PUBLIKE




Nëse operatorët ekonomikë, paditë/ankesat e të cilëve janë miratuar nga Gjykata Administrative dhe Gjykata e Lartë Administrative, iniciojnë procedurë për kompensimin e dëmit (fitimit të humbur), situatat e tilla në të ardhmen do të çojnë në daljen e mjeteve nga Buxheti i shtetit, gjë që tregon se nevoja për vëmendjen e duhur gjatë miratimit të aktvendimeve nga Komisioni Shtetëror pas padive të dorëzuara nga operatorët ekonomikë.

## 5.7.2. PROCESI I DHËNIES SË KONTRATAVE TË PROKURIMEVE PUBLIKE

Enti Shtetëror i Revizionit ka kryer revizionin e pajtueshmërisë me temë "Procesi i dhënies së kontratave të prokurimeve publike", në SHA ESM Elektranat në Maqedoninë e Veriut, SHA TEC Negotinë, ISHP 8 Shtatori, ISHP Spitali Special për Ortopedi dhe Traumatologji "Shën Erazmo" – Ohër dhe Komuna e Manastirit.

Lëndë e revizionit ishte procesi i dhënies së kontratave të prokurimeve publike në periudhën 2021 dhe 2022 subjekteve të lartpërmendura, me qëllim që të konstatohet nëse ai është zbatuar në përputhje me Ligjin për prokurime publike dhe aktet nënligjore.

Me fushëveprimin dhe dëshmitë që janë siguruar nëpërmjet zbatimit të teknikave dhe metodologjisë së revizionit, fituam bindje të arsyeshme të shprehim konkluzion se përveç dobësive të konstatuara në **planifikimin** e nevojave për prokurim publik dhe vlerën e tyre në nivel vjetor dhe **në nivel të procedurës së prokurimit publik** në pjesën e mënyrës së formulimit të lëndës së PP, përcaktimin e kushteve dhe kritereve proporcionale në dokumentacionin e tenderit për vlerësim dhe në pjesën e **transparencës** për procedurat e zbatuara nëpërmjet publikimit të njoftimeve për fazat e veçanta të procedurës dhe ndryshimet e marrëveshjeve nëpërmjet lidhjes së anekseve, procesi i dhënies së kontratave të prokurimeve publike, në të gjitha aspektet materiale është në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fushën e prokurimit publik, në subjektet lëndë të revizionit, me përjashtim të SHA ESM Elektrana e Maqedonisë së Veriut, ku shprehim konkluzion të pavolitshëm për shkak të rëndësisë së kushteve të përcaktuara.

Procesi fillon me miratimin e planit të prokurimeve publike, i cili i përmban nevojat totale për prokurimet në vitin aktual sipas llojeve të mallrave, shërbimeve dhe punëve, dhe në të cilin është caktuar lënda e prokurimit, fillimi i pritshëm i procedurës, vlera e parashikuar e kontratës dhe lloji i procedurës për prokurimin publik, i cili pasohet nga zbatimi i prokurimeve publike të planifikuara dhe përfundon me dhënien e kontratës. Procedura duhet të kryhet në përputhje me dispozitat ligjore në drejtim të sigurimit të përdorimit ekonomik, efikas dhe efektiv të mjeteve publike, konkurrencës dhe trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë.

Në pjesën e planifikimit vjetor të prokurimeve publike kemi përcaktuar se:

- Planet vjetore për prokurimet publike për vitet 2021 dhe 2022 nga subjektet e përfshira me revizionin në formën e përcaktuar janë publikuar në SEPP në kohën e duhur. Organet kontraktuese gjatë vitit kanë bërë ndryshime dhe plotësime në to, të cilat janë publikuar në SEPP.



- Vlerësimi i vlerës së prokurimeve publike gjatë hartimit të planeve vjetore kryhet kryesisht mbi bazën e të dhënave historike, dhe jo mbi bazën e kontrollit të mëparshëm të tregut.
- Në vitin aktual, organet kontraktuese nuk kanë publikuar shpallje për zbatimin e një pjese të procedurave të planifikuara, si dhe për një pjesë të procedurave që u janë shtuar planeve vjetore me ndryshimet dhe plotësimet.

Ndryshimet e shpeshta të PJPP-së dhe moszbatimi i një pjese të konsiderueshme të procedurave të planifikuara në një pjesë të subjekteve tregojnë për përcaktimin joadekuat të prioriteteve dhe nevojave të OK-së, si dhe menaxhimin joadekuat të mjeteve të nevojshme.

Lidhur me mënyrën e zbatimit të procedurave të prokurimeve publike, kemi konstatuar situatat e mëposhtme:

- Në rastet kur oferta më e volitshme është me çmim më të lartë se shuma e mjeteve të përcaktuara në vendimin e prokurimit publik, organet kontraktuese kanë ndryshuar vendimin dhe kanë siguruar mjete shtesë të nevojshme për zbatimin e kontratës, por nuk kanë bërë analizë për të përcaktuar nëse është ekonomikisht më e pagueshme të lidhet kontratë ose të përsëritet procedura..
- Lënda e prokurimit nuk përshkruhet gjithmonë në mënyrë të qartë, të plotë dhe neutrale dhe të formuar në atë mënyrë që u ofron qasje ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në procedurën e prokurimit publik.
- Kushtet, kriteret dhe informacionet e tjera të domosdoshme për mënyrën e zbatimit të procedurës në dokumentacionet e tenderit nuk përshkruhen gjithmonë në mënyrën e plotë, të saktë dhe precize dhe janë në proporcion me lëndën e prokurimit.
- Në raste të caktuara, organet kontraktuese nuk kanë ndërmarrë aktivitete për t'iu përgjigjur pyetjeve të operatorëve ekonomikë, për t'i informuar operatorët ekonomikë për ndryshimet në kërkesat e dokumentacionit të tenderit, si dhe për të kryer vazhdim proporcional të afatit të fundit për parashtrimin e ofertave në rastin e ndryshimeve dhe plotësimeve në dokumentacionin e tenderit, që ndikon në konkurrencën dhe trajtimin e barabartë të operatorëve ekonomikë.
- Në një pjesë të procedurave, Komisioni për Prokurime Publike nuk ka vlerësuar ofertat në përputhje me kushtet dhe kriteret e përcaktuara në dokumentacionin e tenderit.
- Komisioni për Prokurime Publike nuk u ka dërguar njoftim ofertuesve, oferta e të cilëve është përzgjedhur si më e volitshme, si dhe kandidatëve/ofertuesve që janë refuzuar ose atyre, oferta e të cilave nuk është përzgjedhur si më e volitshme, me arsyetim të detajuar për arsyet e miratimit të vendimit.

Duke analizuar të dhënat nga SEPP-ja për vitet 2021 dhe 2022, konstatuam se organet kontraktuese të reviduara kanë dorëzuar gjithsej 290 njoftime për gjithsej 2.925 anulime, nga të cilat 520 për procedura dhe 2.405 për pjesë të procedurave të prokurimeve publike. Duke pasur parasysh se në të njëjtën periudhë, në SEPP janë publikuar gjithsej 9.292 anulime të procedurave dhe pjesëve të procedurave nga të gjitha organet kontraktuese përdorues të sistemit, pjesëmarrja e anulimeve të procedurave dhe pjesëve të procedurave të subjekteve të reviduara në anulimet e përgjithshme janë 31%. Kemi konstatuar se një pjesë e organeve kontraktuese, gjatë periudhës së vlefshmërisë së kontratës së prokurimit publik, lidhin anekse të tyre që ndryshojnë kushtet e dokumentacionit të tenderit dhe specifikimin teknik, si dhe anekset për të cilat kushtet dhe mënyra e lidhjes së tyre nuk janë theksuar qartë dhe saktë në dokumentacionin e tenderit.

Për tejkalimin e situatave të konstatuara janë dhënë rekomandime me qëllim të ndërmarrjes së masave dhe aktiviteteve nga personat kompetentë dhe organet kontraktuese në funksion të përmirësimit të situatave që kanë të bëjnë me sigurimin e konkurrencës, shfrytëzimin ekonomik dhe efikas të mjeteve dhe transparencë më të madhe në prokurimet publike.

## 5.7.3. GJYKATA E LARTË ADMINISTRATIVE

Enti Shtetëror i Revizionit ka kryer revizionin e raporteve financiare bashkë me revizionin e pajtueshmërisë së **Gjykatës së Lartë Administrative** Shkup për vitin 2022, për llogarinë e buxhetit themelor për të cilën kemi shprehur mendim të parezervë për realitetin dhe objektivitetin e raporteve financiare për vitin 2022 dhe për pajtueshmërinë me rregullativën ligjore, udhëzimet dhe politikat e përcaktuara.

Në pjesën Theksimi i çështjeve të pasigurisë dhe vazhdimësisë, revizioni theksoi disa situata që kanë të bëjnë me:

- Mungesën e mendimit nga Këshilli për Shërbimin Gjyqësor lidhur me Rregulloren për Sistemimin e Brendshëm dhe Organizimin e Vendeve të Punës së Gjykatës së Lartë Administrative.
- Nivelin e mjeteve të siguruara për Buxhetin Gjyqësor, i cili në vitin 2022 është 0,29% në vend të 0,8% të përcaktuar me ligj të bruto prodhimit vendor.
- Vendet e paplotësuara, vakante për gjykatës nga korriku 2022 që mund të kenë ndikim në zgjidhjen e lëndëve gjyqësore.
- Menaxhimin e lëvizjes së lëndëve në gjykatë, përkatësisht numri i lëndëve në punë shënon trend të rënies, e me këtë edhe numri i lëndëve të pazgjidhura. Është bërë analiza e numrit të lëndëve në punë, lëndëve gjyqësore të zgjidhura dhe të tjerave të pazgjidhura për periudhën 2020-2022, të cilat janë paraqitur në tabelën e mëposhtme.

| Përshkrimi | 2020 | 2121 | 2022 |
|---|---|---|---|
| Numri i lëndëve në punë | 4.478 | 4.297 | 3.656 |
| Lëndë të zgjidhura | 3.331 | 3.502 | 2.884 |
| Lëndë të pazgjidhura | 1.147 | 795 | 772 |

## 5.7.4. AVOKATI I POPULLIT I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Enti Shtetëror i Revizionit ka kryer revizionin e raporteve financiare të Avokatit të Popullit për vitin 2022, bashkë me revizionin e pajtueshmërisë për llogarinë e buxhetit themelor, për të cilat kemi shprehur mendim të parezervë për realitetin dhe objektivitetin e raporteve financiare dhe për pajtueshmërinë me rregullativën ligjore, udhëzimet dhe politikat e përcaktuara.

Në pjesën Çështje të tjera, theksuam situata të caktuara që kanë të bëjnë me:

- Harmonizimin dhe saktësimin shtesë të rregullave ligjore që e rregullojnë statusin, të drejtat dhe obligimet e punonjësve të Avokatit të Popullit.
- Rolin e Avokatit të Popullit si raportues nacional për trafikimin e qenieve njerëzore nuk parashikohet nga Ligji për Avokatin e Popullit si pjesë e mandatit të tij.
- Procedurën e saktësuar në mënyrë të pamjaftueshme për zgjedhjen dhe emërimin e zëvendësve të Avokatit të Popullit, e cila mundëson mosveprimin brenda afateve të arsyeshme dhe e anulon procedurën për zgjedhjen dhe emërimin e zëvendësve të Avokatit të Popullit.





# 5.8. MJEDISI JETËSOR

## 5.8.1. MINISTRIA E MJEDISIT JETËSOR DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR

Në përputhje me Programin Vjetor të Punës për vitin 2023, kemi kryer revizionin e raporteve financiare bashkë me revizionin e pajtueshmërisë së Ministrisë së Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor për llogaritë e buxhetit themelor, të ardhurat personale dhe aktivitetet vetëfinancuese, për vitin 2022, me ç'rast shprehëm mendim të pavolitshëm.

Me revizionin e kryer konstatuam më shumë situata, ndër të tjera, edhe:

- Për vitin 2022 në Ministri, nuk është zbatuar regjistrimi në fund të periudhës raportuese si aktivitet për harmonizimin e situatës faktike me situatën e kontabilitetit të mjeteve dhe detyrimeve.
- Nuk janë evidentuar objektet afariste dhe nuk është bërë konfirmimi i gjendjeve fillestare të mjeteve materiale dhe jomateriale, mjeteve materiale në përgatitje, rezervave të materialeve, pjesëve rezervë dhe inventarit të imët.
- Për realizimin e Programit të Menaxhimit të Ujërave për vitin 2022, nuk është vendosur sistemi objektiv dhe real i përzgjedhjes së projekteve, mungojnë kriteret dhe rregullat e qarta për realizimin e tyre.
- Në Ministri nuk është emëruar personi i autorizuar për mbikëqyrje dhe nuk është bërë kontrolli i plotë i realizimit të puneve gjatë pagesës së mjeteve për dotacionet me dedikim të komunave në bazë të mjeteve nga kompensimi për prodhimin e energjisë nga lëndët djegëse fosile.
- Arkëtimi i kompensimit për të drejtën e ujit në përputhje me Kontratat e lidhura me ofruesit e shërbimeve të ujit nuk është bërë me dinamikën e planifikuar. Pra, për periudhën nga viti 2020 deri në shtator të vitit 2023, me bartësit e shërbimeve të ujit janë lidhur kontrata për kompensimin e paarkëtuar në shumë prej 112.663 mijë denarë. Konstatuam se deri në shtator të vitit 2023, nga gjithsej 49.188 mijë denarë të llogaritur/të maturuar, janë arkëtuar kompensime në shumë prej 23.090 mijë denarë, ose 47%. Për arkëtim mbetet edhe shuma e kompensimeve të paarkëtuara në shumë prej 89.573 mijë denarë.

- Një pjesë e hapësirës afariste dhe pajisjeve në dispozicion të Ministrisë nuk është e siguruar.
- Nevoja për forcimin e kapaciteteve dhe punësimin e kuadrit profesional në Departamentin e Laboratorit me qëllim të akreditimit të metodave për emisionet në ajër, si dhe në pjesën e përdorimit, mirëmbajtjes dhe servisimit të vazhdueshëm të pajisjeve.
- Ministria realizon të ardhura në baza të ndryshme, si: regjistrimi i mjeteve motorike dhe mjeteve lundruese, A-leja e integruar ekologjike dhe B-leja e integruar ekologjike në zonën e mbrojtur dhe kompensimi për qeset e biodegradueshme (nga viti 2021). Konstatuam mungesën e lidhshmërisë së të dhënave nga institucionet e përfshira në procesin e llogaritjes dhe arkëtimit të kompensimeve dhe arkëtimit jo të plotë të tyre. Pra, për 17 subjekte që posedojnë A-leje të integruar ekologjike dhe janë të evidentuara në Regjistër, nuk janë lëshuar aktvendime për kompensimin vjetor për posedimin e A-lejes së integruar ekologjike, për shkak të së cilës janë realizuar më pak të ardhura në buxhetin e Ministrisë mbi këtë bazë në shumë të përgjithshme prej 2.812 mijë denarë. Në vitin 2023, për të gjitha 17 subjektet juridike, Ministria ka dorëzuar aktvendime në mënyrë retroaktive për vitet 2018, 2019, 2020, 2021 dhe 2022, sipas të cilave pesë subjekte juridike kanë paguar mjete në shumë prej 1.197 mijë denarë në llogarinë e Ministrisë.

Kemi njoftuar për situatat që kanë ndikim në punën e Ministrisë, përkatësisht se duhet respektuar afatet e parapara gjatë ndjekjes së dinamikës së realizimit në përgatitjen e dokumenteve të planit dhe realizimin e plotë të aktiviteteve të dakorduara për mirëmbajtjen e pajisjeve në stacionin e pastrimit në fshatin Jegunovcë.

Gjithashtu, njoftuam për gjendjen me pagesën e mjeteve në bazë të kontratave të lidhura për restitucion në përputhje me të cilat në vitin 2022 janë paguar mjete nga Buxheti i Ministrisë në shumë të përgjithshme prej 67.254 mijë denarë, përkatësisht kompensim të shpenzimeve për koncesionarët për shkak të ndërprerjes me marrëveshje të kontratave të koncesionit për përdorimin e ujit për prodhimin e energjisë elektrike nga hidrocentralet e vogla të vendosura në zonat e mbrojtura të Parkut Nacional Mali Shar dhe për MHEC Dvorce, të vendosur në zonën e parë më të gjerë të mbrojtur të burimit të Rashçes.

Në pjesën Çështje të tjera konstatuam:

- mungesën e dispozitave për rregullimin e lartësisë së rrogave të këshilltarëve të posaçëm në institucionet e veçanta, përfshirë edhe Ministrinë e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor,
- nevojën për të forcuar bashkëpunimin institucional duke shkëmbyer të dhëna në lidhje me përmirësimin e vazhdueshëm të sistemeve ekzistuese për ndjekjen dhe njoftimin e ndryshimeve klimatike, në të cilat rol të rëndësishëm luan edhe Ministria;
- nevojën për të përcaktuar Metodologji për konstatimin e kritereve për shpërndarjen e dotacioneve kapitale,
- sistemin joadekuat të vendosur për arkëtimin e kompensimeve për zotërimin e A-lejes së integruar ekologjike, për këtë arsye parashikohet përgatitja dhe miratimi i Metodologjisë për llogaritjen e kompensimit për posedimin e lejes së integruar ekologjike, sipas së cilës thjeshtë do të bëhet llogaritja e saj.



# 5.9. TRAFIKU, TRANSPORTI DHE KOMUNIKACIONI

## 5.9.1. MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE LIDHJEVE

Është kryer revizioni i raporteve financiare bashkë me revizionin e pajtueshmërisë për vitin 2022 të llogarisë së buxhetit themelor të Ministrisë së Transportit dhe Lidhjeve. Me revizionin e kryer janë konstatuar këto situata:

- janë evidentuar mjetet jomateriale për zgjidhje ideore dhe studim fizibiliteti për të cilat nuk sigurohen dokumente të rregullta dhe të besueshme si bazë për evidentimin e tyre në librat afaristë;
- nuk janë evidentuar mjetet materiale në librat afaristë si: hapësira afariste / lokalet që janë caktuar me vendime të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe për të cilat nuk është bërë parashikimi i vlerës, si dhe hapësira afariste Kapiteneria e Portit të Ohrit për të cilin është në rrjedhë procedura e regjistrimit të së drejtës së pronësisë;
- në librat afaristë të llogarisë së mjeteve materiale në përgatitje, janë evidentuar ndërtimet e financuara nëpërmjet Programeve për ndërtimin e shtigjeve të këmbësorëve dhe ndërtimin e plazheve dhe programe të tjera, të cilat kanë përfunduar dhe janë në përdorim prej disa vitesh, por për ta nuk është bërë pranim-dorëzimi me komunat ku ato janë ndërtuar;

Për tejkalimin e situatave të konstatuara, revizioni ka dhënë rekomandime për ndërmarrjen e masave dhe aktiviteteve.

Krahas situatave të theksuara, në pjesën Theksimi i çështjeve të pasigurisë dhe vazhdimësisë, revizioni i theksoi edhe situatat që kanë ndikim në punën e ministrisë, si:

- Ministria e Transportit dhe Lidhjeve në bazë të Kontratës së lidhur më 29.08.2000 ndërmjet Qeverisë (përmes MTL) dhe Bankës Eksport-Import SHA Shkup ka deponuar mjete monetare në shumë prej 100.000 mijë denarë.

  Gjatë vitit 2018, nga kërkesat nga masa falimentuese e Bankës Eksport-Import SHA Shkup, në bazë të aktvendimit të Gjykatës Themelore Shkup II, janë ndarë mjetet monetare në shumë prej 2.583 mijë denarë dhe janë kthyer në llogarinë e MTL-së, ndërsa për pjesën tjetër të kërkesave në shumë prej 62.500 mijë denarë, ka pasiguri rreth arkëtimit të tyre.

Në pjesën Çështje të tjera, revizioni i theksoi edhe situatat që kanë ndikim në punën e ministrisë, si:

- në gusht 2018, me Vendim të Qeverisë së RMV-së për transferimin e aksioneve, për shkak të ndarjes së pronësisë së Opera-

torit të Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike (SHA MEPSO) nga Qeveria e RMV-së, Ministria u bë pronare e Operatorit të Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike (SHA MEPSO), me çka për herë të parë një ministri shfaqet në rolin e pronarit të ndërmarrjes shtetërore. Me Ligjin e ri për energjetikë [7] bëhet ndarja e menaxhimit të personit juridik që ushtron veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike dhe personit juridik që kryen transmetimin e energjisë elektrike, të cilin e ka kryer i njëjti subjekt (Qeveria e RMV-së), për shkak të së cilës nuk ka pasur pavarësi efektive. Pra, me nenin 72 të Ligjit për energjetikë përcaktohet se MTL-ja është e pavarur në miratimin e vendimeve për zgjedhjen e organeve mbikëqyrëse dhe organeve menaxhuese dhe nuk mund të pranojë udhëzime nga Qeveria e RMV-së ose ndonjë organ tjetër shtetëror.

- Revizioni tërheq vëmendjen se dispozitat e nenit 72 të Ligjit për energjetikë sipas të cilit MTL-ja bëhet pronare e operatorit të sistemit të transmetimit të energjisë elektrike janë në kundërshtim me nenin 27[8] të Ligjit për organizimin dhe punën e organeve të administratës shtetërore, për faktin se fusha e energjetikës, në përputhje me ligjin me të njëjtin emër, është në kompetencë të Ministrisë së Ekonomisë;
- mjetet e parashikuara në Buxhetin e RMV-së për subvencionimin e shërbimit publik për transportin e pasagjerëve në komunikacionin hekurudhor nuk janë të mjaftueshme për t'i mbuluar shpenzimet e shërbimeve të transportit të transportuesit në pronësi shtetërore, për këtë arsye vihet në pikëpyetje ofrimi i shërbimit cilësor me interes publik - transporti në komunikacionin hekurudhor;
- Me Programin Vjetor për financimin e infrastrukturës [9] hekurudhore të miratuar nga Qeveria e RMV-së, janë paraparë mjetet në shumë prej 320.000 mijë denarë, të planifikuara në Buxhetin e MTL-së në programin për investime në infrastrukturën hekurudhore, të cilat janë më pak se mjetet e përcaktuara në nenin 118 të Ligjit për sistemin hekurudhor, ku është rregulluar që financimi i infrastrukturës hekurudhore, përveç dhe nga burime të tjera, të bëhet edhe me mjetet e siguruara në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë së Veriut në shumë prej të paktën 0,3% të të ardhurave tatimore të planifikuara në Buxhetin qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin aktual.

## TË ARDHURAT TATIMORE TË PLANIFIKUARA NË BUXHETIN QENDROR TË RMV-SË PËR VITIN 2022

në 000 denarë

| Të ardhurat tatimore 2022 | 0.3% | Programi Vjetor | Mjete më pak të planifikuara |
|---|---|---|---|
| 135.033.217 | 405.100 | 320.000 | -85.100 |
| 141.677.637 rebalancë | 425.033 | 320.000 | -105.033 |

[7] Ligji për ndryshim dhe plotësim të ligjit për energjetik 96/19 dhe 236/22

[8] MTL i kryen punët që kanë të bëjnë me: komunikacionin rrugorë dhe infrastrukturën rrugore; komunikacionin hekurrudhor dhe infrastrukturën hekurrudhore; komunikacionin ajror dhe infrastrukturën ajrore; lundrimi në brendësi; komunikacionin dhe infrastrukturën postare; llojëve tjera të transportit dhe infrastruktura e cila është e domosdoshme për kryerjen e transportit (teleferik dhe skilift, etj.); punët ndërtimore dhe komunale, infrastruktur adekuate, rregullimin e hapsirës dhe menaxhimi me tokën ndërtimore në pronësi të Republikës dhe kryen edhe punë tjera të caktuara me ligj dhe këto dispozita,

[9] G.Zyrtare e RMV-së nr..94/22, 258/22

## 5.9.2. NP PËR RRUGËT SHTETËRORE

Është kryer revizioni i raporteve financiare bashkë me revizionin e pajtueshmërisë për vitin 2022 në NP për Rrugët Shtetërore, gjatë të cilit shprehëm **opinion të pafavorshëm** për realitetin dhe objektivitetin e raporteve financiare për vitin 2022 dhe për pajtueshmërinë me rregullativën ligjore, udhëzimet dhe politikat e vendosura.

Për një pjesë të rrugëve shtetërore, ndërtimi, rikonstruksioni ose rehabilitimi i të cilave është në proces, me revizion konstatuam **mungesë të qasjes sistematike dhe analitike dhe përgatitje të pamjaftueshme në planifikimin, projektimin, ndërtimin dhe rikonstruksionin e tyre**, gjë që shkaktoi rritje të vlerës së kontratave të lidhura dhe prolongimin e afatit për ndërtimin/rikonstruksionin e akseve rrugore. Pra, për shkak të punimeve të paparashikuara dhe shtesë, ishin bërë ndryshime dhe plotësime në projektet themelore - variacionet, numri i të cilave varion nga një deri në 42 ndryshime në mënyrë adekuate sipas projekteve, si dhe vazhdime të afatit për ndërtimin e akseve rrugore nga tetë muaj deri në gjashtë vjet. Më së shumti variacione, vazhdimi më i madh i afatit dhe rritja e vlerës së kontratës prej 45% (187 milionë euro) ka në ndërtimin e aksit rrugor Kërçovë-Ohër.

Sipas shumës së mjeteve të investuara dhe gjatësisë së aksit rrugor që po ndërtohet, projekti më i madh është ndërtimi i **aksit rrugor Kërçovë-Ohër**, gjatësia e së cilës është 56,7 km, dhe shuma e së cilës deri në dhjetor 2022 ishte 31.597.364. mijë denarë (përafërsisht 512 milionë euro), përkatësisht **për ndërtimin e 1 km të këtij aksi rrugor deri në fund të vitit 2022 janë investuar 557.273 mijë denarë (përafërsisht 9 milionë euro)**. Deri në nëntor 2023, mjetet e investuara arrijnë shumë prej përafërsisht 575 milionë euro.



Aktivitetet e punimeve për sanimin e rrëshqitjes së dheut në aksin rrugor Kërçovë-Ohër



Mbikalimi i aksit rrugor Kërçovë-Ohër

Në maj të vitit 2014 filloi ndërtimi i aksit rrugor Kërçovë-Ohër. Për këtë qëllim, në janar 2014 u lidh kontrata për hua ndërmjet bankës nga RP e Kinës (huadhënësi) dhe NP për Rrugët Shtetërore (huamarrësi) në shumën prej 505 milionë dollarë, ndërsa në dhjetor 2019 u lidh kontrata për hua shtesë në shumën prej 180 milionë dollarë, me huamarrjen totale për këtë projekt në shumën prej 685 milionë dollarë. Për këtë projekt konstatuam se pjesa më e madhe e aksit rrugor është trasuar, janë ndërtuar 25 mbikalime, me çrast akse të ndryshme rrugore janë në fazë të ndryshme të ndërtimit.

**Arsyet kryesore për dinamikën e ngadalshme** të ndërtimit të aksit rrugor Kërçovë-Ohër janë: mangësitë e projektit, shpronësimi i vonuar për shkak të marrëdhënieve të pazgjidhura pronësore juridike, nevoja për zhvendosjen e objekteve të infrastrukturës mbitokësore dhe nëntokësore, miratimi i deponive të reja në terren, si dhe numri i pamjaftueshëm i kuadrit teknik, mekanizimit dhe pajisjeve të ofruara nga kontraktuesi (nënkontraktuesit).

Akset rrugore në vijim për nga madhësia janë: mbindërtimi dhe zhvillimi i **rrugës - Rankovcë-Kriva Pallankë**, me mjetet e investuara në shumë të përgjithshme prej 2.774.354 mijë denarë (përafërsisht 45 milionë euro) dhe gjatësi prej 25,5 km, ndërsa sipas çmimit të shpenzimit për 1 km më pas për nga madhësia është **autostrada Shkup-Bllacë** me shumë prej 362.978 mijë denarë (përafërsisht 5,9 milionë euro).

Nga revizioni është konstatuar se, 21 projekte për ndërtimin, rehabilitimin dhe rikonstruksionin e akseve rrugore dhe ndërtimin dhe instalimin e sistemit elektronik për arkëtimin në pikëpagesat rrugore, në shumë prej 14.430.650 mijë denarë (përafërsisht 234 milionë euro), **edhe pse janë vënë në përdorim dhe janë përdorur, nuk njihen siç duhet si pasuri të paluajtshme në evidencën e kontabilitetit të ndërmarrjes.** Këto mjete gjenerojnë të ardhura, pa u njohur shpenzimet adekuate, përkatësisht nuk është llogaritur dhe njohur shpenzimi i amortizimit për to në periudhën e mëparshme dhe në vitin aktual 2022. Shkak për këtë situatë është pranimi teknik i pazbatuar për shkak të marrëdhënieve të pazgjidhura pronësore juridike gjatë shpronësimit të tokës, rrugëve lokale të ndërtuara që nuk u janë dorëzuar komunave, ndërtimit dhe mosdorëzimit të autostradës Demir Kapi-Smokvicë me Ministrinë e Financave dhe alokimi joadekuat i investimeve sipas projekteve.

Konstatuam se në periudhën nga viti 2015 deri në vitin 2022 janë investuar në projekte dhe ndërtime të papërfunduara, shpenzime në bazë të kamatave, provizione të njëhershme dhe provizione për mjete të patërhequra, shpronësime dhe shpenzime tjera të panjohura, në shumë të përgjithshme prej 1.924.211 mijë denarë (përafërsisht 31 milionë euro), për të cilat, për shkak të informacioneve të pamjaftueshme dhe/ose dokumentacionit adekuat, **nuk dihet nevoja për prokurimin e tyre dhe vlera e përdorimit të tyre**, gjë që vë në pikëpyetje justifikimin e tyre.

Për 96% të objekteve ndërtimore ose 61.303.043 mijë denarë, konstatuam se paraqesin objekte infrastrukturore të linjës, të cilat për shkak të vështirësive në sigurimin e lejeve për shfrytëzim nga Ministria e Transportit dhe Lidhjeve, **nuk janë evidentuar në kadastrën e objekteve infrastrukturore** në Agjencinë e Kadastrës së Patundshmërive.

Gjatë revizionit kemi konstatuar bazë tatimore të llogaritur gabimisht dhe më pak tatim mbi fitim të llogaritur dhe të paguar për vitin 2022 në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë së Veriut në shumën prej 27.525 mijë denarë, me çrast nga NP për Rrugët Shtetërore janë ndërmarrë aktivitete dhe në fund të vitit 2023, shuma është paguar plotësisht në llogarinë e thesarit.

> Mjetet e paguara në llogarinë e NP për Rrugët Shtetërore në bazë të kompensimit të taksës rrugore nga regjistrimi i mjeteve motorike janë transferuar në mënyrë jo të plotë tek komunat. Në të njëjtën kohë, në periudhën 2016-2022, për 63% më pak janë ndarë mjete për komunat, përkatësisht nuk janë ndarë 3.580.588 mijë denarë ose përafërsisht 58 milionë euro.




Nga revizioni është konstatuar se sistemi elektronik i arkëtimit në pikëpagesat rrugore është funksional gjatë gjithë vitit në 7 pika, në 6 muajt e fundit të vitit 2022 edhe në 2 pika, ndërsa 5 pika nuk kanë vendosur arkëtimin elektronik të pikëpagesës rrugore. Njëkohësisht, me analiza është konstatuar se mesatarisht vetëm 13% e totalit të të ardhurave të realizuara nga pikëpagesat rrugore në vitin 2022 janë me aplikimin e arkëtimit elektronik përmes përdorimit të kartelës smart dhe pajisjes M-tag. Duke pasur parasysh se përdorimi i kartelës elektronike dhe pajisjes M-tag për arkëtimin në pikëpagesat rrugore ofron shërbim të përmirësuar dhe efikas për arkëtimin e tyre, i cili mundëson funksionimin e sistemit të unifikuar dhe plotësisht të ndërveprueshëm për pikëpagesat rrugore në autostradat në të gjithë vendin, me revizionin është paraqitur nevoja për promovim më të madh të mundësisë së përdorimit të tij.

## 5.9.3. NP PËR MIRËMBAJTJEN DHE MBROJTJEN E RRUGËVE MAGJISTRALE DHE RAJONALE

Me revizionin e kryer në NP për Mirëmbajtjen dhe Mbrojtjen e Rrugëve Magjistrale dhe Rajonale, shprehëm **opinion me rezervë** për realitetin dhe objektivitetin e raporteve financiare për vitin 2022 dhe **opinion të pafavorshëm** për harmonizimin me rregullativën ligjore, udhëzimet dhe politikat e vendosura.

NP për Mirëmbajtjen dhe Mbrojtjen e Rrugëve Magjistrale dhe Rajonale për 12 vjet në vazhdimësi, përkatësisht nga viti 2012 deri në ditën e njoftimit për revizionin e kryer, veprimtarinë publike për të cilën është themeluar e kryen me llogari të bllokuar me vendime ekzekutive për arkëtimin e detyrimeve të papaguara. Kryerja e veprimtarisë së ndërmarrjes realizohet në kuadër të limiteve mujore, përkatësisht minimumit të mjeteve monetare mbi të cilat nuk mund të zbatohet përmbarimi, të përcaktuara me aktvendimet e Gjykatës Themelore Shkupi II Shkup. Me aktvendimin e fundit të miratuar më 14.06.2021, i cili është ende në fuqi, limiti mujor për funksionimin e NP-së është përcaktuar në shumën prej 231.000 mijë denarë.

Me revizionin konstatuam se ndër vite NP-ja ka trend të rritjes së detyrimeve ndaj furnitorëve në vend si rezultat i rritjes së aktivitetit në pjesën e mirëmbajtjes dhe mbrojtjes së rrugëve shtetërore, për shkak të ndërtimit të akseve të reja rrugore, rritjes së shpenzimeve për prokurimin e naftës dhe derivateve të naftës, si dhe rritjes së çmimeve të mallrave dhe shërbimeve.

Detyrimet ndaj furnitorëve në vitin 2018 janë në shumë totale prej 479.607 mijë denarë, ndërsa në vitin 2022 janë në shumë prej 965.533 mijë denarë, gjegjësisht kanë trend të rritjes. Gjithashtu trend të rritjes kanë edhe detyrimet sipas vendimeve ekzekutive të cilat në vitin 2018 janë 324.393 mijë denarë, ndërsa në 2022 467.416 mijë denarë.



Me revizionin theksojmë se kjo mënyrë e funksionimit të NP-së, e cila nuk është në gjendje t'i paguajë rregullisht detyrimet e maturuara, ndikon në rritjen e detyrimeve sipas vendimeve ekzekutive dhe në rritjen e borxhit të kamatave, gjë që ndikon negativisht në stabilitetin financiar dhe likuiditetin e ndërmarrjes.

Për harmonizimin e të dhënave, i siguruam të dhënat nga bartësi i qarkullimit pagesor, ku konstatuam se sipas të dhënave të tyre, llogaria e NP-së është bllokuar për detyrimet sipas vendimeve ekzekutive në shumë të përgjithshme prej 663.115 mijë denarë që është për 195.699 mijë denarë shumë më të madhe e detyrimeve në krahasim me ato të evidentuarat në evidencën e kontabilitetit të NP-së (467.416 mijë denarë). Për dallimin e konstatuar nuk kemi marrë arsyetim dhe dëshmi për të shpjeguar arsyet që kanë çuar në të, për këtë arsye nuk është konfirmuar vërtetësia dhe objektiviteti i shumës së evidentuar të detyrimeve sipas vendimeve ekzekutive në Bilancin e Gjendjes më 31 dhjetor 2022.

Kemi konstatuar se ndërmarrja ka objekte ndërtimore dhe mjete pune në shumë prej 2.196.489 mijë denarë të cilat për shkak të kryerjes së veprimtarisë janë të ekspozuara ndaj rreziqeve dhe për to personi përgjegjës nuk ka kryer procedurë për sigurimin e pronës dhe mjeteve të ndërmarrjes kundër zjarrit dhe fatkeqësive të tjera elementare, të cilat mund të shkaktojnë dëme në pronën dhe mjetet e ndërmarrjes. Në lidhje me të lartpërmendurën, konstatuam se në periudhën nga qershori deri në dhjetor 2021 ishin prokuruar 15 mjete motorike të ngarkesave të pajisura me pajisje speciale për heqjen e borës, ndërsa tashmë në dhjetor 2021, një nga mjetet, pas 150 km e njëzet ditë të kaluar, ishte djegur. Njëkohësisht, theksojmë se mjeti nuk kishte sigurim kasko, nuk ishte shfrytëzuar garancia e dhënë nga fabrika, ndërsa nga periudha kur kishte ndodhur zjarri deri në inicimin e padisë për kompensimin e dëmit nga dërgimi i produktit të parregullt dhe kompensimit për përfitimin e humbur, kaloi një periudhë dyvjeçare.

Gjatë revizionit të rezervave kemi konstatuar se nuk është kryer verifikimi në shufrën matëse për matjen e nivelit të lëngut të përdorur gjatë marrjes së karburantit. Gjithashtu, furnizimi me karburant i mjeteve bëhet me pompa, matësat e të cilave nuk janë verifikuar një kohë të gjatë. Me përjashtim të dy cisternave nëntokësore, karburanti merret në të ashtuquajturat kontejnerët plastikë dhe metalikë mbitokësorë. Kur përdorin karburantin, punonjësit e derdhin në tuba dhe kova. Nga kontrolli në terren i kryer me revizion, u konstatua se kjo mënyrë e marrjes, ruajtjes, menaxhimit dhe lëshimit të karburanteve e kërcënon sigurinë dhe shëndetin e qytetarëve dhe ndikon negativisht në mjedisin jetësor.

Me inspektimin e kryer në librat afaristë të NP-së dhe vizitën në terren në filialet, seksionet dhe pikat dimërore, konstatuam se pajisjet e shpenzueshme nuk janë të ndara, një pjesë e tyre përdoret për pjesët rezervë ose asgjësohet si mbetje pa zbatuar procedurën ligjore adekuate. Nga totali i mjeteve të shpenzuara, 90% janë mjete dhe makineri ndërtimore që ndodhen në filialet dhe seksionet e ndërmarrjes dhe përdoren për pjesët rezervë, pa sigurimin e pëlqimit nga Qeveria. Në të njëjtën kohë, mënyra e përdorimit të pajisjeve për pjesët rezervë nuk rregullohet me akt intern, për këtë arsye ekziston rreziku i përdorimit të pakontrolluar dhe joadekuat i pjesëve.

Me revizionin e kryer janë konstatuar edhe situata të tjera, parregullsi dhe mospërputhje të natyrës së ndryshme, të cilat ndikojnë në punën e NP-së. Për tejkalimin e situatave të konstatuara janë dhënë rekomandimet për ndërmarrjen e masave dhe aktiviteteve nga personat dhe organet kompetente në funksion të përmirësimit të gjendjes.





# 5.10. ENERGJETIKA

## 5.10.1. ZHVILLIMI I SISTEMIT TË GAZIFIKIMIT NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT

7 ENERGJI E PËRBALLUESHME DHE E PASTËR

Gazifikimi në Republikën e Maqedonisë së Veriut është proces i filluar, qëllimi kryesor i të cilit është përmirësimi i efikasitetit energjetik, mbrojtja e mjedisit jetësor dhe sigurimi i stabilitetit ekonomik dhe energjetik. Për t'i përmbushur qëllimet e Strategjisë së Zhvillimit të Energjetikës deri në vitin 2040, të cilat parashikojnë gjendje tranzicioni nga qymyri në sektorin energjetik plotësisht të dekarbonizuar, me çka gazi natyror bëhet gjithnjë e më i rëndësishëm.

Ndikimi i pafavorshëm i krizës energjetike në vitet 2021 dhe 2022 mbi qytetarët dhe ekonominë ishte një nga arsyet pse Enti Shtetëror i Revizionit në Programin Vjetor të Punës të planifikojë dhe realizojë revizionin e pajtueshmërisë me temë **"Zhvillimi i sistemit të gazifikimit në Republikën e Maqedonisë së Veriut"**. Revizioni është kryer në SHA për kryerjen e veprimtarisë energjetike për transmetimin e gazit natyror NOMAGAS Shkup në pronësi shtetërore, si pasardhës juridik i SHA GA - MA Shkup dhe SHA për kryerjen e veprimtarive energjetike Resurset Energjetike Nacionale, në pronësi shtetërore. Revizioni e përfshin periudhën nga viti 2019 deri në shtator 2023, por disa fusha, çështje, ngjarje dhe analiza janë mbuluar para vitit 2019 dhe më pas deri në ditën e njoftimit për revizionin e kryer.

Revizioni i përfshin çështjet që lidhen me **kornizën juridike dhe zhvillimin e rrjetit të gazsjellësit dhe gazifikimit në vend, si dhe bashkimin e shoqërive aksionare të gazifikimit** NER dhe GA-MA dhe strukturën organizative të shoqërisë së re - NOMAGAS.

Procesi i planifikimit të gazifikimit në territorin e të gjithë vendit filloi në vitin 2010, me hartimin e studimit të fizibilitetit në nivel nacional, ndërsa zbatimi i tij filloi pas pesë vite, përkatësisht në vitin 2016. Nga analiza e kryer konstatuam se pjesa më e madhe e projekteve të parashikuara nga studimi i fizibilitetit kanë filluar, por ndërtimi i tyre po zhvillohet me dinamikë të ngadalshme dhe ka devijime në lidhje me kornizën e planifikuar kohore, vendndodhjen e tubacioneve, si dhe mjetet e planifikuara financiare për ndërtim. **Mungon plani afatgjatë për zhvillimin e sistemit të transmetimit të gazit natyror, i cili ka ndikim në aktivitetet e ardhshme për zgjerimin dhe përmirësimin e sistemit të transmetimit të gazit natyror, si dhe ndërlidhjen e tij me vendet e tjera.**

Me revizion konstatuam se gazsjellësi funksional në vend është ndërtuar në vitet e nëntëdhjeta të shekullit të kaluar dhe përbëhet nga një gazsjellës magjistral që gjendet në kufirin lindor në lokalitetin Deve Bair dhe që shtrihet nëpër Kriva Pallankë, Kratovë dhe Kumanovë deri në Shkup, si dhe rrjetet e gazsjellësit në qytetet e theksuara.

Gjatësia e gazsjellësit magjistral është 98 km, ndërsa bashkë me bllok-stacionet e tij dhe pikat lidhëse për tubacionet e shpërndarjes është pothuajse **130 km.** Gjatësia totale e rrjeteve të gazsjellësit të qytetit, nga ku furnizohen me gaz natyror fabrikat, ndërmarrjet, spitalet, shkollat, komunat, ZZHIT dhe objektet e tjera, është pothuajse **80 km**. Vlera e prokurimit të rrjetit funksional të gazsjellësit është përafërsisht 71 milionë euro, nga të cilat pjesa më e madhe, ose 49%, është investimi në gazsjellësin magjistral dhe shpërndarës Deve Bair - Shkup dhe 26% bien në ndërtimin e rrjetit të gazsjellësit të qytetit në Shkup.

Në periudhën e kaluar, **shfrytëzimi i gazsjellësit magjistral është i pamjaftueshëm** dhe nëpër qytetet e vendit nuk ka rrjet të shpërndarjes së vendosur formalisht. Konsumatorët janë të lidhur drejtpërdrejt në rrjetin e transmetimit dhe gazi natyror përdoret vetëm në industri dhe në objektet publike, por jo edhe në amvisëri.

Me revizion konstatuam se pas 13 viteve nuk ka përfunduar plotësisht ndërtimi i gazsjellësve magjistralë dhe një pjesë e tyre ende nuk janë vënë në përdorim.



**Ndërtimi i rrjetit të gazsjellësit**

- Gazsjellësi ekzistues
- LOT 1-61 km Kleçovci - BS5 i ndërtuar
- LOT 1-36 km BS5 – Negotinë me SKMRR Shtip dhe SKMRR Negotinë
- LOT 2-92 km Negotinë (Kavadar) – Manastir
- LOT 5- 78 km Shkup-Tetovë-Gostivar
- LOT 5-34 km Gostivar-Kërçovë, Leja e ndërtimit
- Ndërveprimi me Greqinë (DESFA)
- LOT 3 dhe 4 Projekti bazë

Pra, në periudhën prej vitit 2014 deri në vitin 2023, për ndërtimin e gazsjellësve magjistralë LOT1-61 km, LOT 1 - 36 km, LOT 2 dhe LOT 5, janë lidhur kontrata dhe anekse të kontratave, si dhe kontrata për punimet e paparashikuara dhe shtesë në shumën totale prej rreth 156,4 milionë euro. Pjesa më e madhe e tyre edhe pse janë ndërtuar, ende nuk janë vënë në përdorim. Shkak për këtë situatë janë dobësitë në pjesën e regjistrimit të së drejtës së pronësisë së objekteve infrastrukturore të linjës, por edhe zgjidhja e ngadalshme e lëndëve të shpronësimeve për të cilat janë paguar përafërsisht 2 milionë euro në periudhën 2018-2022.

Në raport theksuam se janë konstatuar dobësi në ndjekjen e zbatimit të kontratave të ndërtimit dhe mbikëqyrjen e ndërtimit të gazsjellësve magjistralë, si dhe në mënyrën e mirëmbajtjes së rrjetit të gazsjellësit.

Për akset rrugore që nuk janë ndërtuar, por për të cilat janë prokuruar materiale dhe pjesë rezervë, kemi konstatuar menaxhim joadekuat të rezervave të tyre, që paraqet rrezik për shpenzimin joracional të mjeteve publike. Pra, revizorët kanë konstatuar ekzistimin e rezervave të materialeve dhe pjesëve rezervë, në vlerë të përgjithshme prej përafërsisht 1,6 milionë euro, të cilat janë pro-



Tubat për ndërtimin e rrjetit shpërndarës të gazit natyror dhe mbylljen e unazës rreth Shkupit



Hapësira e mbyllur e magazinës në NOMAGAS

kuruar para vitit 2019 dhe ato nuk shfrytëzohen, me çka vihet në pikëpyetje nevoja e prokurimit të tyre, si dhe mundësia që ato të vjetërohen dhe të bëhen të papërdorshme. Janë prokuruar pjesë rezervë dhe materiale me vlerë për përfundimin e unazës së gazsjellësit rreth Qytetit të Shkupit, i cili për shkak të koordinimit të pamjaftueshëm me shërbimet kompetente të Qytetit të Shkupit nuk ka përfunduar dhe është ndërtuar rruga e re në atë vend, kjo është arsyeja pse unaza e gazsjellësit rreth qytetit për t'u mbyllur në të ardhmen do të duhet të bëhen aktivitete dhe shpenzime shtesë.

Me revizion i theksojmë situatat që kanë të bëjnë me zgjidhjen e kontestit afatgjatë ndërmjet Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe SHA për qarkullim me naftë dhe derivate të naftës Shkup, përmes blerjes së aksioneve të SHA në GA-MA, për të cilën u miratua ligji dhe u vlerësua kapitali i GA-MA. Është konstatuar se vlera e llogaritur prej 65,5 milionë euro nuk është evidentuar sipas kontabilitetit në librat tregtarë të GA-MA, as si kryegjë kapitale është regjistruar në Depozitarin Qendror të Letrave me Vlerë të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Pa i kontestuar angazhimet për zgjidhjen e kontestit ndërmjet shtetit dhe SHA për qarkullim me naftë dhe derivate të naftës Shkup, i kushtojmë vëmendje mënyrës në të cilën ishte kryer transaksioni për transferimin e mjeteve monetare dhe blerjen e aksionit në shumë prej përafërsisht 32,7 milionë euro. Pra, në fund të vitit 2019, nga Buxheti i shtetit, mjetet monetare për blerjen e aksionit u transferuan në llogarinë me dedikim të NER në bankën vendase, ndërsa transaksioni u realizua pasi kishte kaluar një vit e tetë muaj, përkatësisht në fund të gushtit 2021, i cili kishte ndikim në Buxhetin e shtetit dhe pasqyrohet negativisht në një pjesë të qëllimeve dhe parimeve buxhetore themelore të parashikuara nga Ligji për buxhetet.

Në pjesën tjetër të përmbajtjes së raportit, i theksojmë nevojat për zhvillimin e sistemit të shpërndarjes së gazit natyror në vend, vetëfinancimin e plotë të veprimtarisë - transmetimin e gazit natyror dhe realizimin e aktiviteteve të ardhshme për ndërlidhje me vendet fqinje.



## 5.11. EKONOMIA

### 5.11.1. EFIKASITETI I PROCEDURAVE PËR DHËNIEN E SË DREJTËS SË SHFRYTËZIMIT TË LËNDËVE TË PARA MINERALE DHE REALIZIMIN E KONTRATAVE TË LIDHURA, ME VËSHTRIM TË VEÇANTË PËR MERMERIN

Është kryer revizioni i suksesit me temë **"Efikasiteti i procedurave për dhënien e së drejtës së shfrytëzimit të lëndëve të para minerale dhe realizimin e kontratave të lidhura, me vështrim të veçantë për mermerin"** për t'iu përgjigjur pyetjes "Nëse politikat dhe masat dhe aktivitetet e ndërmarra nga organet kompetente ofrojnë siguri për dhënien efikase të koncesioneve dhe mbikëqyrjen e realizimit të kontratave të lidhura për shfrytëzimin e lëndëve të para minerale për të siguruar shfrytëzimin e tyre optimal?"

Lëndët e para minerale janë të mira me interes të përgjithshëm dhe si resurs kryesor për zhvillimin e përgjithshëm ekonomik dhe shoqëror, është i domosdoshëm shfrytëzimi i tyre optimal në përputhje me parimet e zhvillimit të qëndrueshëm dhe të mbrojtjes së mjedisit jetësor.



Shfrytëzimi i lëndëve të para minerale fitohet (koncesionari) duke marrë koncesion të dhënë nga Qeveria (koncedenti) në përputhje me procedurat e përcaktuara. Për shfrytëzimin e lëndëve të para minerale në vitin 2022, janë dhënë gjithsej 348 koncesione për 257 koncesionarë, në sipërfaqe totale prej 333,73 km2, që paraqet 1,3% të territorit të përgjithshëm të vendit, nga të cilat 29 koncesione janë për shfrytëzimin e mermerit.

Korniza institucionale për përcaktimin dhe zbatimin e politikave dhe procedurave për dhënien e koncesioneve për shfrytëzimin, mbikëqyrjen dhe kontrollin e shfrytëzimit të lëndëve të para minerale dhe arkëtimin e kompensimeve të koncesionit e përbëjnë:




Për shfrytëzimin e lëndëve të para minerale, koncesionari është i detyruar të paguajë: kompensim vjetor për shfrytëzimin e hapësirës dhe për sasinë e shfrytëzuar (të shitur) të lëndëve të para minerale.

Për shfrytëzimin e lëndëve të para minerale për periudhën 2018-2022 janë arkëtuar gjithsej 2.781.024 mijë denarë, përkatësisht 45 milionë euro kompensime të koncesionit, nga të cilat: 287.307 mijë denarë kompensim për shfrytëzimin e hapësirës, 2.487.581 mijë denarë kompensim për sasinë e shfrytëzuar të lëndëve të para minerale dhe 6.136 mijë denarë në bazë të kamatës në të dyja bazat.

Me revizionin e kryer dhe dëshmitë e ofruara, kemi fituar siguri të arsyeshme se masat dhe aktivitetet e ndërmarra nga institucionet kompetente nuk sigurojnë gatishmëri dhe besueshmëri të plotë për realizimin e shfrytëzimit optimal të lëndëve të para minerale, arkëtimin gjithëpërfshirës dhe në kohë të kompensimeve të koncesionit dhe sistemin efikas të mbikëqyrjes mbi realizimin e kontratave të lidhura.

Aktivitetet tona të revizorit ishin të orientuara në më shumë fusha, gjatë të cilave konstatuam më shumë situata, si në vijim:

**Sistemi i menaxhimit të procesit të dhënies dhe heqjes së të drejtës së shfrytëzimit të lëndëve të para minerale:**

- Në nivel nacional, prej më shumë se 11 vite nuk është miratuar strategjia afatgjate për shfrytëzimin dhe menaxhimin optimal të lëndëve të para minerale, ndërsa aktivitetet për përgatitjen e saj kanë filluar në vitin 2022, me afat të miratimit deri në prill 2024.
- Rregullativa ligjore që e trajton fushën në fjalë u nënshtrohet ndryshimeve dhe plotësimeve të shpeshta, ndërsa dispozita të caktuara nuk janë mjaftueshëm të qarta dhe të sakta, gjë që krijon paqartësi në zbatimin e tyre.
- Bazat e të dhënave të ME-së dhe kadastra e lëndëve të para minerale të mbajtura nga Enti Gjeologjik nuk ofrojnë pasqyrë të qartë dhe të plotë të situatave me lëndët e para minerale në bazë të së cilave do të kryhen analiza me qëllim të mbajtjes së politikës aktive në lidhje me shfrytëzimin optimal të lëndëve të para minerale.

**Kompensimet e koncesionit:**

- Sistemi i pagesës së kompensimeve të koncesionit zbatohet pa rregulluar mënyrën e komunikimit të ndërsjellë dhe shkëmbimit të të dhënave ndërmjet institucioneve kompetente dhe pa përcaktuar qartë marrëdhëniet dhe kompetencat reciproke, gjë që krijon dobësi në ndjekjen e papenguar dhe të plotë të pagesës dhe ndërmarrjen në kohë të masave dhe aktiviteteve për arkëtimin e kompensimeve të paarkëtuara nga koncesionarët.
- Lartësia e kompensimeve për shfrytëzimin e hapësirës e përcaktuar në shtet është përcaktuar në nivel të ulët, ndërsa mënyra e përcaktuar e llogaritjes së kompensimeve për sasitë e shfrytëzuara nuk i pasqyron çmimet reale të tregut/shitjes të realizuara nga koncesionarët dhe ai nuk kontribuon për ngarkesën e drejtë dhe të barabartë për koncesionarët.
- Kompensimet e realizuara në dobi të shtetit nga shfrytëzimi i mermerit më cilësor në shumë prej 103.248 mijë denarë ose 1,7 milionë euro për periudhën 2018-2022 janë 1% nga të ardhurat e realizuara nga shitja e koncesionarit.
- Për periudhën 2018-2022 janë konstatuar më pak kompensime të koncesionit të arkëtuara në shumë të përgjithshme prej 21.050 mijë denarë, përkatësisht 341 mijë euro, nga të cilat: 9.804 mijë denarë në bazë të hapësirës, 5.421 mijë denarë në bazë të lëndëve të para minerale të shfrytëzuara dhe në shumë prej 5.825 mijë denarë në bazë të kamatës së llogaritur, por të paarkëtuar dhe kompensimit të paarkëtuar sipas procesverbaleve të DAP-së.

në 000 denarë

KOMPENSIMET PËR SHFRYTËZIMIN E HAPËSIRËS (PA KAMATË) PËR PERIUDHËN 2018-2022

| Kompensimet e koncesonit për hapësirë | 2018 | 2019 | 2020 | 2021 | 2022 | Вкупно |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Kompensimi i llogaritur i koncesionit | 54.950 | 54.609 | 48.697 | 62.389 | 71.251 | 291.896 |
| Gjithsej kompensimet e arkëtuara: | 54.518 | 53.714 | 48.687 | 62.656 | 67.732 | 287.307 |
| Kompensimet e arkëtuara pas afatit të përcaktuar | 24.704 | 22.184 | 11.865 | 32.488 | 33.096 | 124.337 |
| Përqindja e kompensimeve të arkëtuara pas afatit të përcaktuar | 44,96% | 40,62% | 24,36% | 52,07% | 46,45% | 42,60% |
| Kompensimet e paarkëtuara | 698 | 1.164 | 795 | 23 | 7.124 | 9.804 |
| Përqindja e kompensimeve të paarkëtuara | 1,27% | 2,13% | 1,63% | 0,04% | 10,00% | 3,36% |
| Më shumë kompensime të arkëtuara nga koncesionarët që kanë paguar kompensim | 266 | 269 | 785 | 290 | 3.605 | 5.215 |

Për të njëjtën periudhë, jo në kohë, përkatësisht pas skadimit të afatit të përcaktuar me ligj janë arkëtuar gjithsej 1.174.809 mijë denarë, përkatësisht 19 milionë euro në bazë të kompensimit të koncesionit për hapësirën dhe sasinë e shfrytëzuar të lëndëve të para minerale.

## KOMPENSIMET PËR SHFRYTËZIMIN E LËNDËVE TË PARA MINERALE

në 000 denarë




- Në periudhën raportuese të revizionit nga shuma e përgjithshme e kompensimeve të paarkëtuara janë paguar 8.392 mijë denarë për kompensimet e koncesionit dhe kamata, ndërsa në bazë të rekomandimeve të dhëna nga revizioni paraprak është arkëtuar kamata në shumë të përgjithshme prej 6.136 mijë denarë që vlen për periudhën 2016-2022, e cila paraqet vlerë të shtuar në realizimin e të ardhurave buxhetore.
- Teknikat e përdorura të minierës për ndërmarrjen e masës së dobishme dhe mungesa e masave për ripërdorimin e zgjyrës së mermerit kanë ndikim në shkallën e shfrytëzimit të lëndëve të para minerale, rritje të prodhimit të zgjyrës që krijojnë efekte negative në mjedisin jetësor.
- Me incizimin aerofotogrametrik të kryer nga eksperti/topografi i hapësirës së përcaktuar të koncesionit, në 2 koncesione konstatuam nxjerrjen e lëndëve të para minerale jashtë lejes së shfrytëzimit në pronësi të koncesionarëve në hapësirë totale prej 9.989 m2, gjë që krijon rrezik që koncesionarët mos ta llogarisin dhe paguajnë kompensimin për sasitë e shfrytëzuara jashtë fushës së shfrytëzimit.

Për tejkalimin e situatave të konstatuara, u kemi dhënë rekomandime institucioneve kompetente që duhet të sigurojnë përmirësim në pjesën e kornizës juridike dhe strategjike, menaxhimin e procesit të dhënies dhe heqjes së të drejtës së shfrytëzimit të lëndëve të para minerale, funksionalitetin dhe efektivitetin e procedurave për dhënien/heqjen e koncesioneve për lëndët e para minerale, arkëtimin e kompensimeve të koncesionit, mbikëqyrjen e realizimit të kontratave të lidhura dhe kontrollin mbi punën e koncesionarëve me qëllim të ruajtjes në mënyrë optimale të lëndëve të para minerale në përputhje me parimet e zhvillimit të qëndrueshëm.



# 5.12. VEPRIMTARITË KOMUNALE PUBLIKE

## 5.12.1. NDËRMARRJET PUBLIKE NË NIVEL LOKAL

Është kryer revizioni i raporteve financiare bashkë me revizionin e pajtueshmërisë për vitin 2022 në:

- NPK "Komunalec" dhe NPK "Ujësjellësi dhe Kanalizimi" të themeluara nga Komuna e Prilepit,
- NPK "Standard" e themeluar nga Komuna e Dibrës,
- NPVK "Komunalec" e themeluar nga Komuna e Strumicës,
- NPK "Ujësjellësi" e themeluar nga Komuna e Manastirit dhe
- NP "Rrugë urbane dhe ndërurbane" e themeluar nga Qyteti i Shkupit.

Me revizionin e kryer të raporteve financiare dhe revizionin e pajtueshmërisë së ndërmarrjeve publike janë konstatuar situata të caktuara, ndër të cilat, më të rëndësishme janë:

Janë konstatuar dobësi në mënyrën e udhëheqjes së kontabilitetit, përkatësisht në NPK "Komunalec" Prilep nuk bëhet njohja e efekteve të transaksioneve/ngjarjeve kur ato ndodhin, por në periudhën kur detyrimet janë paguar, ndërsa NPK "Standard" Dibër, aplikon trajtim joadekuat të kontabilitetit për mjetet e marra për përdorim të përhershëm pa kompensim.

NPK "Ujësjellësi" Manastir dhe NPK "Standard" Dibër nuk hartojnë raport gjashtëmujor për punën e NP-së, gjë që e zvogëlon transparencën gjatë informimit për llojin dhe vëllimin e kryerjes së veprimtarisë, si dhe për punën e tyre financiare.

Në ndërmarrjet e revidiuara publike janë konstatuar parregullsi në lidhje me vlerësimin e pozicioneve të bilancit në raportet financiare, përkatësisht vlerësimin joreal të mjeteve jomateriale, ndërsa për një pjesë të objekteve dhe tokave të evidentuara ndërtimore nuk janë rregulluar të drejtat e pronësisë.

Obligimi ligjor për lidhjen e kontratave me shfrytëzuesit e shërbimeve të ujit të pijshëm dhe me ofruesin e shërbimit për ujin e dorëzuar, nuk respektohet plotësisht nga NPK "Ujësjellësi dhe Kanalizimi" Prilep, NPK "Standard" Dibër dhe NPK "Ujësjellësi" Manastir.

Për grumbullimin dhe transportimin e mbeturinave komerciale, kontrata të lidhura me NPK "Komunalec" Prilep kanë 59% të përdoruesve aktivë - personave fizikë, ndërsa vetëm 6% e personave juridikë, gjë që vështirëson arkëtimin e shërbimeve të kryera.

Në NPK "Ujësjellësi dhe Kanalizimi" Prilep, NPVK "Komunalec" Strumicë, NPK "Ujësjellësi" Manastir

dhe NP "Rrugë urbane dhe ndërurbane" Shkup, mënyra e llogaritjes dhe pagesës së rrogave nuk është harmonizuar me rregullat ligjore në fuqi, ndërsa në NPK "Standard" Dibër, neto rrogat për punonjësit paguhen me para në dorë, përmes arkëtares.

Parregullsi në angazhimin e personave me kontratë në vepër janë konstatuar në NPK "Standard" Dibër dhe NP "Rrugë urbane dhe ndërurbane" Shkup.

Ekziston gjendja e humbjes së ujit në sistemin e furnizimit me ujë prej 57% në NPK "Ujësjellësi dhe Kanalizimi" Prilep, 32% në NPK "Komunalec" Strumicë, 81% në NPK "Standard" Dibër dhe 59% në NPK "Ujësjellësi" Manastir, si rezultat i rrjetit të vjetër dhe të rrënuar të ujësjellësit, përshkueshmërisë së rezervuarit, lidhjes dhe konsumimit të paligjshëm, pasaktësisë së matësve të ujit, konsumimit të pafaturuar, ujitjes së sipërfaqeve të gjelbra publike për të cilat nuk janë vendosur matësa, etj. NPK "Standard" Dibër nuk ka marrë të ardhura për 512.460 m3 ujë të pijshëm të furnizuar për Komunën e Qendër Zhupës.




Për shkak të mosshlyerjes në kohë të detyrimeve për kompensim për shfrytëzimin e ujit dhe për shkarkimin në ujë nga NPK "Ujësjellësi dhe Kanalizimi" Prilep - 15.925 mijë denarë, NPK "Komunalec" Strumicë - 11.105 mijë denarë dhe NPK "Ujësjellësi" Manastir - 2.296 mijë denarë, janë realizuar më pak të ardhura në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë së Veriut në shumë prej 29.326 mijë denarë. NPVK «Komunalec» Strumicë nuk i shlyen detyrimet ndaj SHA Ekonomia e Ujërave për sasinë e dorëzuar të ujit për furnizim me ujë e cila në fund të vitit 2022 arrin 43.546 mijë denarë.

Si rezultat i shlyerjes jo në kohë të detyrimeve për kompensim për mirëmbajtjen e pastërtisë publike nga NPK "Standard" Dibër dhe NPK "Komunalec" Prilep, janë realizuar më pak të ardhura në buxhetin e Komunës së Dibrës në shumë prej 2.830 mijë denarë) dhe buxhetin e Komunës së Prilepit në shumë prej 21.902 mijë denarë. ЈКП „Стандард" Дебар ја извршува дејноста за отстранување на отпадоци и смет, обработка и депонирање на комунален и цврст отпад и депонирање на индустриски отпад без дозвола за управување со отпад.

NPK "Standard" Dibër e ushtron veprimtarinë e largimit të mbetjeve dhe mbeturinave, përpunimin dhe deponimin e mbetjeve komunale dhe të ngurta dhe deponimin e mbetjeve industriale pa leje për menaxhimin e mbetjeve.

Në NPK "Ujësjellësi dhe Kanalizimi" Prilep dhe NP "Rrugë urbane dhe ndërurbane" Shkup, rikonstruksioni dhe ndërtimi i instalimeve lokale të ujësjellësit dhe kanalizimit, përkatësisht rrugëve bëhet pa dokumentacion të projektit / ose jashtë dokumentacionit të projektit dhe pa leje ndërtimi.

Në regjistrin e vetëm tregtar dhe në regjistrin e personave të tjerë juridikë në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut nuk është bërë regjistrimi i kryegjësë themelore të NPVK "Komunalec" Strumicë, NPK "Standard" Dibër, NPK "Ujësjellësi" Manastir dhe NP "Rrugë urbane dhe ndërurbane" Shkup, ndërsa në NPK "Komunalec" Prilep ka mospërputhje ndërmjet vlerës së kontabilitetit të kryegjësë themelore dhe asaj të regjistruar në Regjistrin Qendror.

Ndërmarrjet e reviduara publike nuk ndërmarrin masa në kohë për arkëtimin e kërkesave dhe nuk bëhet vlerësimi i shkallës së arkëtueshmërisë për shkak të vlerësimit të duhur të tyre në pozicionet e bilancit në përputhje me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit.

Në NPVK "Komunalec" Strumicë, NPK "Standard" Dibër, NPK "Ujësjellësi" Manastir dhe NPK "Komunalec" Prilep ka parregullsi në pjesën e regjistrimit të mjeteve dhe detyrimeve, situatë kjo që është aktuale prej vitesh dhe nuk mundëson harmonizimin ndërmjet evidencës së kontabilitetit dhe situatës faktike.

Në NPK "Ujësjellësi dhe Kanalizimi" Prilep, NPVK "Komunalec" Strumicë, NPK "Standard" Dibër dhe NPK "Ujësjellësi" Manastir janë konstatuar dobësi në zbatimin e Ligjit për prokurime publike dhe shpenzimin joracional të mjeteve publike në lidhje me: specifikimin teknik, plotësinë dhe besueshmërinë e dokumentacionit që vërtetojnë aftësinë e ofertuesve/nënkontraktuesve, realizimin e kontratave kornizë pa nënshkrimin e kontratave të veçanta dhe procedurave të pazbatuara të prokurimeve publike.

Në programet vjetore dhe kontratat e lidhura të NP "Rrugë urbane dhe ndërurbane" Shkup nuk janë planifikuar detyrimet e marra nga viti paraprak, kështu që themeluesi, përkatësisht porositësi nuk i pranon aktivitetet e realizuara, të cilat për vitet 2021 dhe 2022 arrijnë në 68.213 mijë denarë, që ndikon në likuiditetin e ndërmarrjes.

Në NPK "Ujësjellësi dhe Kanalizimi" Prilep, NPVK "Komunalec" Strumicë, NPK "Ujësjellësi" Manastir, NPK "Komunalec" Prilep dhe NP "Rrugë urbane dhe ndërurbane" Shkup mungon / nuk funksionon njësia e revizionit të brendshëm si mekanizëm për përmirësimin e punës së subjektit, ndërsa në NPK "Standard" Dibër dhe NPK "Ujësjellësi" Manastir nuk ka miratuar procedura me shkrim në lidhje me rrjedhën e dokumentacionit, ndarjen e detyrave dhe përgjegjësive të personave të përfshirë në proceset dhe sistemin për ndjekjen dhe kontrollin gjatë pranimit dhe lëshimit të dokumentacionit të kontabilitetit, miratimin dhe pagesën e tij. Në NPK "Ujësjellësi" Manastir mungojnë politikat e sigurisë së informacioneve, si dhe janë konstatuar mangësi në funksionalitetin e softuerit aplikativ për evidencën financiare të kontabilitetit dhe në sistemin "biling".

Në pjesën Theksimi i çështjeve të pasigurisë dhe vazhdimësisë, janë theksuar situatat në lidhje me aktivitetet investuese të NPK "Ujësjellësi" Manastir për sanimin dhe zgjerimin e sistemit të ujësjellësit dhe kanalizimit me mjete nga Banka Kreditore për Rindërtim dhe Zhvillim, me ç'rast në fund të vitit 2022, detyrimet për borxhin kryesor janë 88.917 mijë denarë, ndërsa për kamatë - 11.074 mijë denarë.

Ekziston nevoja për angazhim më të madh të ndërmarrjes publike NPK "Ujësjellësi dhe Kanalizimi" Prilep dhe themelueses, Komunës së Prilepit, në drejtim të komercializimit të mbetjeve teknologjike dhe metanit të prodhuar gjatë pastrimit të ujërave të zeza urbane, gjë që do të përmirësonte rentabilitetin e ndërmarrjes.





Fundërresë në fusha të thata



Rezervuari i depozitimit të metanit

NPK "Standard" Dibër është në bllokadë të përhershme që nga viti 2010 dhe për shkak të minimumit mujor të përcaktuar të mjeteve në shumë prej 2.282 mijë, funksionimi i saj është përcjellë me ulje të likuiditetit dhe aftësisë paguese që kanë ndikim në mbarëvajtjen e proceseve, duke shprehur detyrime ndaj furnitorëve dhe pamundësinë e shlyerjes së tyre në kohë.

NPK "Komunalec" Prilep, në bazë të urdhrit për përmbarim, ka për obligim të paguajë borxhin kryesor dhe kamatat në shumë prej 5.972 mijë denarë për prokurimin e automjeteve të përdorura – fshirëseve të cilat asnjëherë nuk janë vënë në funksion dhe do të ndikojë më tej në punë.





# 5.13. PUNË DHE POLITIKË SOCIALE

## 5.13.1. FONDI I SIGURIMIT PENSIONAL DHE INVALIDOR I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Është kryer revizioni i raporteve financiare bashkë me revizionin e pajtueshmërisë për vitin 2022 në Fondin e Sigurimit Pensional dhe Invalidor të Maqedonisë së Veriut, ku janë konstatuar këto situata:

- nuk janë tejkaluar situatat në lidhje me mjetet e pandara në llogarinë e pagesës nga kontributi i arkëtuar për SPI, të cilat Fondi nuk mund t'i përdor, ndërsa personat e siguruar nuk mund t'i ushtrojnë të drejtat nga SPI-ja;
- mungon lidhshmëria elektronike midis arkivit të Komisionit për Vlerësimin e Aftësisë për Punë në Fond dhe Komisionit për Revizion në MPPS, ndërsa plotësimi i vendeve të zbrazëta me mjekë specialistë është i vështirë, gjë që nuk siguron realizimin me kohë dhe kompetent të kompetencave të Komisionit;
- mungon kuadri profesional dhe i trajnuar aktuarial dhe largimi permanent i punonjësve nga Sektori i TI-së dhe revizioni i brendshëm, që ndikon në zhvillimin e kapaciteteve të parashikueshme aktuariale dhe pensionale, funksionimi i sistemit të informacioneve dhe përditësimi i të gjitha sistemeve të vendosura dhe efektiviteti i sistemit të kontrolleve të brendshme.
- sistemi i kontrolleve të brendshme në procesin e ushtrimit të të drejtave nga SPI-ja dhe procesi i pagesës së të ardhurave pensionale rregullohet me më shumë akte dhe procedura të veçanta interne, prej të cilave një pjesë nuk janë përditësuar plotësisht në përputhje me sistemin elektronik që është në përdorim.
- mungon ndarja e plotë e kompetencave dhe përgjegjësive të punonjësve të përfshirë në proceset, për këtë arsye ekziston rreziku i parregullsive në procedurën e njohjes së të drejtave nga SPI-ja, si dhe rreziku i pagesës së pensionit pas skadimit të së drejtës së përcaktuar me ligj.



Në pjesën Theksimi i çështjeve të pasigurisë dhe vazhdimësisë, revizion zbulon, ndër të tjera, edhe për:

- strukturën dhe nivelin e të ardhurave të realizuara në periudhën raportuese, deficitin në pagesën e të ardhurave pensionale, si dhe pasiguritë sipas funksionimit të Fondit lidhur me lëvizjet inflatore dhe lëvizjet e pafavorshme demografike, janë si më poshtë:




Të ardhurat burimore, respektivisht të ardhurat nga kontributi i arkëtuar për SPI-në në vitin 2022 janë rritur për 11,63% në krahasim me vitin paraprak 2021 dhe në vitin 2022 arrijnë 54.943.420 mijë denarë, që paraqet pjesëmarrje prej 64.54% në totalin e të ardhurave të realizuara. Shpenzimet për beneficionet sociale (pagesa e të ardhurave pensionale bashkë me kontributin për sigurimin shëndetësor të pensionistëve, transferet në shtyllën e dytë pensionale dhe pensionin invalidor) në vitin 2022 arrijnë 87.607.370 mijë denarë për gjithsej 335.743 shfrytëzues të të ardhurave pensionale, përkatësisht deri në dhjetor 2022, pagesat janë për 9,8% më të larta në krahasim me vitin 2021.

Fondi, përkundër rritjes së të ardhurave në bazë të kontributeve nga SPI-ja, ka mungesë (deficit) të mjeteve për pagesën e shpenzimeve për beneficionet sociale, për këtë arsye janë transferuar mjete nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut në lartësi prej 31.022.110 mijë denarë në vitin 2022. Pjesëmarrja e këtyre mjeteve në totalin e të ardhurave të Fondit për tre vitet e fundit ka tendencë stagnimi, përkatësisht rënie në krahasim me vitin 2021 dhe arrin 33,58%, nga të cilat 22% janë për mbulimin e deficitit aktual për pagesën e pensioneve, që është paraqitur në grafikun:




- mekanizmat e pamjaftueshëm për arkëtimin e detyrueshëm të dëmeve të konstatuara për shkak të pagesës së pabazuar të pensioneve që rrjedhin nga vitet e kaluara për të cilat janë evidentuar kërkesa nga qytetarët, ndërsa përqindja e ulët e kthimit të mjeteve më të paguara tregon pasiguri për arkëtimin e tyre në periudhën e ardhshme dhe
- mjetet e tërhequra në mënyrë të pabazuar nga llogaria e Fondit nga përmbaruesit në bazë të urdhrave të përmbarimit, në të cilat si debitorë paraqiten shfrytëzuesit e pensioneve dhe aktivitetet e ndërmarra nga Fondi në lidhje me zbatimin e urdhrave të përmbarimit.



## 5.13.2. AGJENCIA E PUNËSIMIT E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Kemi kryer revizionin e raporteve financiare bashkë me revizionin e pajtueshmërisë së Agjencisë së Punësimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2022, ku nga revizioni janë konstatuar situatat e mëposhtme:

Në pjesën e kompensimit monetar në rast të papunësisë kemi konstatuar se janë paguar mjete në vitin 2022 në lartësi prej 1.407.710 mijë denarë, që paraqet 42,62% nga gjithsej shpenzimet e APRMV-së, ndërsa në krahasim me vitin 2021, shuma e paguar shënon rënie për 116.247 mijë denarë.

Mjetet e paguara për kompensimin monetar për periudhën 2019-2022 në bazë të së drejtës së fituar janë prezantuar në pasqyrën grafike të mëposhtme:



Duke pasur parasysh pjesëmarrjen e madhe të këtyre shpenzimeve në punën e APRMV-së, kontrolluam funksionimin e procedurës së ushtrimit të së drejtës së kompensimit monetar në një ekzemplar të përzgjedhur të lëndëve për vitin 2022, ku konstatuam se në një pjesë të lëndëve të analizuara dokumentacioni është i paplotë, përkatësisht konstatohet mungesa e një pjese të dokumentacionit të kërkuar, ndërsa një pjesë e dokumentacionit sigurohet ose përgatitet pas skadimit të afatit të përcaktuar me ligj.

Në pjesën e masave aktive të punësimit për realizimin e gjithsej 14 programeve dhe masave të punësimit të parapara me PO në vitin 2022, janë paguar gjithsej 1.420.003 mijë denarë, përkatësisht 43% nga gjithsej shpenzimet e APRMV-së. Kjo shumë shënon rritje në krahasim me vitet 2020 dhe 2021, për 148.902 mijë denarë në krahasim me vitin 2020, ose në krahasim me gjithsej shpenzimet e APRMV-së për këtë periudhë, ka rritje prej 4%.

Ndarja e shpenzimeve sipas programeve dhe masave është paraqitur në grafikun e mëposhtëm:




Duke analizuar masat e veçanta, konstatuam se për tri masa - Subvencionimi i rrogave, Punësimi dhe rritja e subjekteve juridike dhe Puna praktike, për të cilat janë paguar gjithsej 468.126 mijë denarë në UO [18] dhe PO [19] nuk përfshihen dispozitat në bazë të të cilave do të hartohen rang-listat e personave të cilëve do t'u miratohen mjetet dhe personat që do të refuzohen në rast të numrit më të madh të kandidatëve të paraqitur, me ç'rast aprovohet praktika e miratimit të aplikimeve sipas parimit i pari i arritur, i pari i shërbyer. Gjatë ndarjes së mjeteve, parimi i zhvillimit të barabartë rajonal të tetë rajoneve të planit nuk është zbatuar në mënyrën e përcaktuar në UO dhe PO. Njëkohësisht konstatuam se për një pjesë të rajoneve të planit paguhet shumë më e madhe e mjeteve në krahasim me përqindjet e përcaktuara për pjesëmarrje në përputhje me Vendimin për klasifikimin e rajoneve të planit sipas shkallës së zhvillimit. Zakonisht, shuma e paguar për rajonet e planit nga pjesa qendrore dhe lindore e vendit është më e ulët se shuma e përcaktuar për shkak të numrit të pamjaftueshëm të aplikacioneve, ndërsa shuma e paguar për rajonin e planit të Shkupit dhe rajonet e planit në pjesën perëndimore të vendit është më e lartë se shuma e përcaktuar, me ç'rast në raste të veçanta tejkalimi është dyfish më i madh se kuota e përcaktuar me vendim.

[18] Udhëzimet operative

[19] Plani operativ

Në pjesën e punës administrative të APRMV-së, i konstatuam situatat e mëposhtme:

- dobësi në pjesën e regjistrimit të pajisjeve dhe harmonizimin e të dhënave në evidencën e kontabilitetit me gjendjen aktuale në lidhje me rezervat e materialeve;
- nuk është vendosur mekanizmi i kontrollit për ndjekjen e kërkesave bazuar në të ardhurat e realizuara nga kontributi i papaguar i punësimit dhe nuk është vendosur komunikimi ndërinstitucional për evidencën e detyrimit të llogaritur për pagesën e të gjitha obligacioneve;
- pagesa e shtesës së rrogës për shkak të rritjes së vëllimit të punës për të cilën nuk ka bazë adekuate ligjore dhe pa kritere të përcaktuara për përzgjedhjen e punonjësve që e marrin këtë shtesë;
- angazhimi i personave të punësuar në periudhë të caktuar kohore për kryerjen e detyrave të rregullta të punës, në të cilat janë tejkaluar edhe limitet kohore për angazhimin e tyre;
- konstatuam se kontrollet interne në lidhje me përdorimin me dedikim dhe të ligjshëm të mjeteve të ndara për masat aktive të punësimit janë të dobëta, me ç'rast në CV të caktuara nuk bëhet kontrollimi dhe miratimi nga personat përgjegjës të profaturave dhe faturave të dorëzuara që kanë të bëjnë me prokurimet e materialeve / pajisjeve dhe shërbimeve. Me aktivitetet e revizorit kemi konstatuar se një pjesë e mjeteve janë shpenzuar me dedikim për prokurimet që nuk kanë të bëjnë me biznes-planet e dorëzuara te shfrytëzuesit e mjeteve.

Në pjesën Theksimi i çështjeve të pasigurisë dhe vazhdimësisë njoftuam se nuk është respektuar dispozita e Ligjit për punësimin e personave invalidë, në përputhje me të cilën nga Buxheti i RMV-së duhet të paguhen mjete monetare në llogarinë e Fondit të Veçantë, në bazë të TVSH-së së paguar dhe taksave doganore nga shoqëritë mbrojtëse, kështu që Agjencia nuk i siguron plotësisht mjetet financiare që me ligj i takojnë për përmirësimin e kushteve për punësimin dhe punën e personave invalidë.

Në pjesën Çështje të tjera, ndër të tjera, konstatuam edhe parregullsi në pjesën e kornizës juridike që siguron kushte për ushtrimin e të drejtave nga PN-ja që kontribuojnë në aplikimin e pabarabartë në praktikë, të cilat i referohen mënyrës së llogaritjes së lartësisë së PN-së gjatë punës me orar të paplotë të punës dhe kushtet për ndërprerjen e së drejtës për PN.





# 5.14. ARSIMI

## 5.14.1. EFEKTIVITETI I MASAVE PËR TË PARANDALUAR LARGIMIN E KUADROVE PROFESIONALE DHE ME ARSIM TË LARTË




Kemi kryer revizionin e suksesit me temë **"Efektiviteti i masave për parandalimin e largimit të kuadrove profesionale dhe me arsim të lartë"** për t'iu përgjigjur pyetjes **"A i ka planifikuar, zbatuar dhe monitoruar Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut masat dhe aktivitetet e Strategjisë Nacionale të Rrjetëzimit dhe bashkëpunimin me kuadrot profesionale dhe me arsim të lartë 2013-2020, në mënyrën që mund të kontribuojë në parandalimin e largimit të kuadrove me arsim të lartë?»**

Me revizionin e kryer dhe metodologjinë e aplikuar të revizorit, me dëshmitë e mbledhura të revizorit, kemi fituar bindje të arsyeshme se aktivitetet e Qeverisë si bartëse e politikave të menaxhimit të migracionit nuk janë mjaft efektive për të reduktuar largimin e kuadrit me arsim të lartë nga shteti.

Në dekadat e fundit, migracionet ndërkombëtare në mbarë botën kanë parë rritje të vazhdueshme, ndërsa sot vëllimi i tyre është më i madh se kurrë.

Tendenca drejt rritjes së emigrimit të kuadrove profesionale me arsim të lartë, si dhe shkencëtarëve të rinj nga fakultetet e caktuara, nënkupton ndryshime në cilësinë e fuqisë punëtore dhe uljen e nivelit të kapitalit njerëzor, dhe rrjedhimisht, edhe efekte negative në fushën e zhvillimit ekonomik të vendit dhe veprimtarisë kërkimore dhe shkencore.



Sipas të dhënave të Entit Shtetëror të Statistikës, numri i qytetarëve të Maqedonisë që kanë shkuar jashtë vendit në periudhën 2013-2022 është 7.861 persona, ndërsa numri i tyre sipas viteve është paraqitur në Grafikun.

## QYTETARËT E SHPËRNGULUR NGA RMV-JA




Të dhënat e ESHS-së për strukturën arsimore të personave të larguar nga vendi tregojnë se në periudhën 2015-2022 emigruan nga vendi gjithsej 719 persona me arsim të lartë, të paraqitur sipas viteve në Grafikun 2.

## QYTETARËT E SHPËRNGULUAR ME ARSIM TË LARTË



Të dhënat e marra nga organizatat / institucionet ndërkombëtare dhe nga vendet e pranimit të personave të përmendur mundësojnë vlerësim më real të vëllimit dhe strukturës së shpërnguljes nga Republika e Maqedonisë së Veriut [21]. Si të dhëna më gjithëpërfshirëse për numrin e personave të shpërngulur në vende të caktuara të pranimit / origjinës, mund të veçohen ato të Kombeve të Bashkuara dhe Bankës Botërore (vlerat numerike të të cilave zakonisht përkojnë). Ato tregojnë se numri i përgjithshëm i qytetarëve të Maqedonisë që qëndrojnë në vendet e pranimit në mbarë botën ka shënuar rritje të vazhdueshme në dekadën e fundit.

## QYTETARËT E SHPËRNGULUR NGA RMV-JA




Raporti i IOM-it për vitin 2020 tregon se sipas shkallës së emigrimit në vitin 2019, Republika e Maqedonisë së Veriut është në grupin e njëzet vendeve në botë me emigracionin më të madh jashtë vendit [25].

Sipas vlerësimeve të Bankës Botërore, pothuajse 40% e kuadrit me arsim të lartë janë nga Republika e Maqedonisë së Veriut është larguar nga vendi, ndërsa Indeksi i largimit të intelektualëve të Global Economy, tregon se Republika e Maqedonisë së Veriut është në vendin e pestë (nga 41 vendet evropiane [27]).

Pavarësisht kësaj, shteti nuk ka strategji aktive, përkatësisht nuk është miratuar dokument i ri strategjik pas skadimit të periudhës së vlefshmërisë së Strategjisë Nacionale të Rrjetëzimit dhe bashkëpunimit me kuadrot profesionale dhe me arsim të lartë 2013-2020.

Qeveria ka miratuar Rezolutë për politikën e migracionit, me qëllim të veçantë strategjik që synon uljen e intensitetit të emigracionit të përhershëm jashtë vendit, me fokus të veçantë për personat me arsim të lartë, por nuk është vendosur monitorimi i zbatimit të masave dhe aktiviteteve të tij, ndërsa miratimi i dokumenteve të reja strategjike është pa vlerësim dhe evalvim të rezultateve të dokumenteve paraprake.

---

[21] Migracionet në RMV – Profili i vendit 2021

[25] IOM, Migration Report 2020, UN Migration, Geneva, 2019, p. 27.

[27] https://documents1.worldbank.org/curated/en/657051570692065211/pdf/Migration-and-Brain-Drain.pdf, pg62

[15] https://www.theglobaleconomy.com/rankings/human_flight_brain_drain_index/Europe/

Strategjia Nacionale e Rrjetëzimit, bashkëpunimit dhe parandalimit të largimit të kuadrove profesionale dhe me arsim të lartë 2013-2020 është i vetmi dokument strategjik për politikat publike në të cilin adresohet drejtpërdrejt çështja e "largimit të intelektualëve", e cila nuk është publikuar në Gazetën Zyrtare dhe në ueb-faqen e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, ndërsa mungesa e dokumentacionit mbështetës për mënyrën e planifikimit dhe hartimit të Strategjisë, nuk ofron të dhëna të besueshme për përfshirjen e të gjitha institucioneve relevante në hartimin e dokumentit strategjik.

Strategjia përcakton qëllimet dhe masat prioritare që synojnë uljen e largimit të kuadrit me arsim të lartë, por për zbatimin e masave është miratuar Plani i Veprimit për vitin 2013/2014 me aktivitete, afate për realizim, mjete financiare, burime të financimit, trupa kompetentë për zbatimin e qëllimeve dhe treguesve të suksesit.

Konstatuam shkallë të ulët të zbatimit të masave dhe aktiviteteve të Planit të Veprimit, që vjen si pasojë e koordinimit të pamjaftueshëm të institucioneve / trupave kompetentë bartëse për masat dhe aktivitetet dhe grupin e paformuar të punës (njësinë e projektit) në kuadër të MASH-it, i cili duhet të vendos sistem nacional për ndjekjen dhe menaxhimin më të lehtë të lëvizjes së individëve me arsim të lartë nga vendi.

Nuk është vendosur sistemi funksional për ndjekjen dhe menaxhimin e emigracionit intelektual në Republikën e Maqedonisë së Veriut, për shkak të rrjetit ose bazës së të dhënave të pavendosur të personave me arsim të lartë nga Maqedonia që jetojnë dhe punojnë jashtë vendit dhe analizës së pakryer të situatave me migrimin e kuadrit me arsim të lartë, me numrin e emigrantëve, profilin arsimor, profilin e moshës, adresimin e arsyeve të emigracionit.

Ndahen bursa për ciklin e dytë dhe të tretë të studimeve jashtë vendit pa bërë analizë dhe përcaktim se cilat programe studimore janë me interes publik për shtetin dhe do të jenë lëndë e bursimit, ndërsa MASH-i nuk ka vendosur sistem efikas për ndjekjen nëse studentët kanë përmbushur detyrimet e tyre në përputhje me konkursin e shpallur dhe kontratat e lidhura.

Në bazë të analizës së kryer, revizioni përcaktoi dallime të konsiderueshme midis numrit të kuotave të miratuara dhe numrit të studentëve të regjistruar, gjë që tregon mungesë të analizave për krijimin real të politikës së regjistrimit, që synon harmonizimin e ofertës dhe kërkesës dhe në korrelacion me politikat e zhvillimit ekonomik të shtetit.

Mosfunksionimi i ueb-portaleve nauka.mk dhe patent.mk pamundëson që ato të përdoren si mjet për ofrimin e informacioneve për rezultatet e veprimtarisë hulumtuese shkencore, inovacionet, transferimin e njohurive universitare në treg në kompanitë dhe patentat e regjistruara (shpikjet inovative).

Monitorimi i zbatimit të masave dhe aktiviteteve nga Strategjia nuk është vendosur dhe as nuk janë vlerësuar efektet e zbatimit të masave.

**Vlerësimet nga analiza e kryer e ekspertit të angazhuar për nevojat e revizionit tregojnë se në periudhën 2013-2021 nga shteti migrojnë mesatarisht rreth 2.500 kuadro me arsim të lartë në vit, për të cilët shteti ka investuar mesatarisht 5 miliardë denarë çdo vit, ose gjithsej 44,7 miliardë denarë për periudhën e analizuar. Largimi i kuadrove me arsim të lartë i kushton shtetit 0,8% të BPV-së vjetore.**

**Efekti total i shpenzimit oportun në krahasim me BPV-në e humbur që nuk gjenerohet për shkak të emigracionit vjetor të popullsisë totale nga vendi vlerësohet në 5,15% të BPV-së në nivel vjetor. Nëse kësaj i shtohet edhe investimi real i humbur në arsim në këto kuadro, i cili mesatarisht arrin në 3,19% në vit të BPV-së, efekti total negativ ekonomik pasqyron humbje totale prej 8,34% të BPV-së në nivel vjetor.**

Rekomandimet e dhëna në këtë raport u referohen aktiviteteve që MASH-i dhe Qeveria duhet t'i ndërmarrin për t'i eliminuar shkaqet e parregullsive të identifikuara, situatat e konstatuara ose rreziqet e mundshme të paraqitura në këtë raport në vazhdim, përmes masave në kohë për krijimin e politikave që të zvogëlojë largimin e kuadrove me arsim të lartë nga shteti, zbatimin e masave, monitorimin e zbatimit dhe njoftimin për shkallën e realizimit të masave.

Për revizionin në fjalë, Zyra e Kryetarit të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, me shkrim i ka dorëzuar Entit Shtetëror të Revizionit, Mendim lidhur me Draft-Raportin e revizorit të autorizuar shtetëror, i cili na njofton se nuk kanë vërejtje për Draft-Raportin dhe konfirmimin e gjetjeve, konkluzioneve dhe rekomandimeve. Ata na informojnë gjithashtu se Raporti do të merret seriozisht në konsideratë gjatë hartimit të politikave për të parandaluar largimin e kuadrove me arsim të lartë.

## 5.14.2. EFIKASITETI I MASAVE, POLITIKAVE DHE PROJEKTEVE PËR PËRMBUSHJEN E KUSHTEVE NË TË CILAT FUNKSIONOJNË KONVIKTET SHTETËRORE TË STUDENTËVE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT DHE ZHVILLIMI I STANDARDIT TË STUDENTËVE

Enti Shtetëror i Revizionit kreu revizionin e suksesit me temë **"Efikasiteti i masave, politikave dhe projekteve për përmbushjen e kushteve në të cilat funksionojnë konviktet shtetërore të studentëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe zhvillimi i standardit të studentëve"** për t'iu përgjigjur pyetjes "A ndërmarrin masa dhe aktivitete institucionet kompetente në Republikën e Maqedonisë së Veriut për përmirësimin e vazhdueshëm të standardit të studentëve?"

Mjetet e përgjithshme që janë realizuar në përputhje me Programin për financimin, realizimin dhe zhvillimin e veprimtarisë standardi i studentëve për vitin 2022 janë në shumë prej 1.397.455 mijë denarë (rreth 22,6 milionë euro), si:



## KORNIZA JURIDIKE PËR REALIZIMIN E VEPRIMTARISË STANDARDI I STUDENTËVE

Standardi i studentëve në RMV brenda kornizës ligjore që rregullon këtë fushë është i lidhur drejtpërdrejt me Ligjin për standardin e studentëve, Ligjin për shujtën e subvencionuar, Ligjin për arsimin e lartë dhe Ligjin për inspektimin arsimor. MASH-i nuk ka vendosur Regjistrin e konvikteve të studentëve, përkatësisht nuk është bërë verifikimi i konvikteve të studentëve siç parashikohet nga LSS-ja, ndërsa aktet nënligjore zbatohen pjesërisht ose aspak nuk zbatohen në punën e MASH-it dhe KSHS-së. Nuk është miratuar urdhëresa për masat dhe kriteret për stimulimin e studentëve të talentuar dhe për dhënien e bursave për studentët që arrijnë rezultate mbi mesataren në studime. Mbikëqyrja inspektuese nuk kryhet në periudhën 2020-2022, edhe pse ISHA-ja ka kompetenca të mbikëqyrë dhe të inspektojë të paktën një herë në vit zbatimin e ligjeve, rregullave të tjera dhe akteve të përgjithshme në konviktet e studentëve, dhe veçanërisht në procesin e akomodimit të studentëve në konvikte. Mënyra e vendosur për subvencionimin e shujtës studentore nga MASH-i përmes pagesës së llogarive transaksionale të studentëve nuk mundëson të konfirmohet se mjetet e paguara për vitin 2022 në shumë prej 701.482 mijë denarë (rreth 11,37 milionë euro) ose 50,2% nga mjetet totale për standardin e studentëve përdoren ekskluzivisht për qëllimin. Gjatë vitit 2023, MASH-i ka miratuar ndryshime në LSS në përpjekje për të reduktuar mundësinë e veprimit të tillë nga përdoruesit e mjeteve. Ndryshimet e shpeshta dhe dokumentet strategjike jo të plota në lidhje me standardin e studentëve çojnë në faktin se shteti nuk ka drejtim konciz dhe të trasuar të politikave që duhet të merren për të arritur rezultate të dukshme dhe të qëndrueshme. E theksuara e imponon nevojën e ndërmarrjes së aktiviteteve shtesë për hartimin e dokumentit të veçantë strategjik për standardin e studentëve.

## BURSAT E STUDENTËVE

MASH-i ka vendosur disa masa për bursimin e studentëve, sipas të cilave, në konkursin për vitin 2022/23 janë paraparë 3.105 bursa. Nga ky numër, 2.509 bursa janë miratuar gjatë vitit 2022, ndërsa duke qenë se ekziston edhe mundësia e vazhdimit të bursimit të miratuar të njëhershëm, numri i përgjithshëm i studentëve me bursë është 6.179 studentë, përkatësisht një nga 7,7 studentë në vend i është dhënë bursa. Mbi këtë bazë, gjatë vitit 2022, MASH-i ka paguar shumë prej 235.849 mijë denarë. Rezultatet e krahasimit të lartësisë së bursave të paguara për studentë në vendin tonë në krahasim me vendet fqinje janë paraqitur në tabelën e mëposhtme:



Masat për bursimin e studentëve i vlerësuam si adekuate, por ka vend për përmirësim në pjesën e harmonizimit të bursimit me interesin për të studiuar në programet studimore, përkatësisht disa programe studimore në të cilat ka numër të madh studentësh të regjistruar të përfaqësuar pa arsye nga më se një grup studentësh, gjë që redukton mundësinë e bursimit për studentët e regjistruar në programet studimore për të cilat ka interes të ulët për të studiuar.

Бројот на студенти кои аплицирале за стипендија и на кои им е одобрена истата е прикажан во следната табела:

| | 2019/20 | 2020/21 | 2021/22 | 2022/23 |
|---|---|---|---|---|
| Bursat e shpallura me konkurs | 3.075 | 3.075 | 3.075 | 3.105 |
| Studentët e aplikuar me konkurs | 4.480 | 4.331 | 4.704 | 5.451 |
| Bursat e miratuara | 2.697 | 3.026 | 1.907 | 2.942 |
| Bursat e pamiratuara | 1.783 | 1.305 | 1.907 | 2.942 |

**Për të studiuar në një nga 100 universitetet e para në botë në vitin 2022 janë paguar mjete në shumë prej 188.361 mijë denarë, të cilat kanë pjesëmarrje prej 44,4% në totalin e mjeteve për bursa. Në të njëjtën kohë, shuma maksimale e paguar nga MASH-i për një student është deri në 40.000 dollarë në vit dhe mjete shtesë për qëndrim në lartësi prej rreth 45.000 denarë në muaj për 10 muaj. Kemi konstatuar se një numër i madh i studentëve me bursë nuk i respektojnë kushtet kontraktuese dhe nuk kthehen në vend pas përfundimit të studimeve, por gjithashtu nuk ka sistem të vendosur për angazhimin e këtyre personave në vend.**



## AKOMODIMI, FUNKSIONIMI, FINANCIMI DHE INVESTIMET NË KONVIKTET E STUDENTËVE

Të drejtën e akomodimit dhe të ushqimit në konviktin shtetëror të studentëve kanë studentët e rregullt që studiojnë jashtë vendbanimit të tyre. Regjistrimi dhe pranimi në KSHS bëhet me konkurs të shpallur nga MASH-i, ndërsa rangimi dhe përzgjedhja e studentëve nga lista e aplikantëve bëhet sipas disa kritereve që i referohen gjendjes materiale të studentit dhe familjes së tij të ngushtë, suksesit në studime dhe vitit të studimeve. Në konkurs shpallen të gjitha kapacitetet e disponueshme, të ndara sipas konvikteve, me ç'rast aplikantët kanë mundësinë të zgjedhin konviktin e preferuar. Kapaciteti dhe plotësimi i KSHS-së është paraqitur në tabelën e mëposhtme:

# KAPACITETI DHE PLOTËSIMI SIPAS KSHS-SË PËR VITIN AKADEMIK 2022/2023

| KONVIKTET SHTETËRORE TË STUDENTËVE | Kapacitetet e disponueshme / Të shpallura | Plotësimi dhe akomodimi i studentëve | Plotësimi dhe akomodimi i nxënësve | Përqindja e plotësimit |
|---|---|---|---|---|
| KSHS "Goce Dellçev | 1.186 | 1.163 | / | 98.3% |
| KSHS "Stiv Naumov" - ndërtesa 1 dhe 2 | 620 | / | / | / |
| KSHS "Stiv Naumov" - ndërtesa 3 | 601 | 454 | / | 75.5% |
| KSHS "Stiv Naumov" - barakat e reja | 138 | 138 | / | 100% |
| KSHS "Kuzman Josifovski Pitu" | 490 | / | / | / |
| **Gjithsej KSHS Shkup** | **3.035/1.925** | **1.755** | **/** | **91.1%** |
| KSHS "Koço Racin" | 385 | 284 | / | 73.7% |
| KSHS "Nikolla Karev" | 242 | 118 | 91 | 48.7% |
| KSHS "N. H. Orde Çopella" | 335 | 19 | 165 | 54.9% |
| KSHS "Tome Stefanovski Seniq" | 370 | 229 | 48 | 74,8% |
| KSHS "Pellagonia" | 997 | 997 | / | 100% |
| KSHS "Vëllezërit Milladinov" | 236 | 68 | 195 | 111.4% |
| **GJITHSEJ** | **5.681/4.490** | **3.470** | **499** | **77.28%/88.39%** |

Zvogëlimi i kapaciteteve të akomodimit në konviktet e studentëve është rezultat i mbylljes së ndërtesës 1 dhe 2 të KSHS Stiv Naumov në vitin 2019/2020, për shkak të kushteve joadekuate të qëndrimit dhe rinovimit të planifikuar, si dhe mbylljes së KSHS Kuzman Josifovski Pitu, që është vënë jashtë përdorimit nga muaji maj 2022.



### KUSHTET NË KONVIKTET E STUDENTËVE

Objektet që i përdorin KSHS-të janë kryesisht të vjetra dhe nuk i plotësojnë nevojat e jetesës moderne, ndërsa kapacitetet e reduktuara të akomodimit dhe kushtet e pabarabarta të ofruara nga konviktet e studentëve janë vendimtare për shkallën e shfrytëzimit dhe interesin e studentëve për akomodim në KSHS të caktuara, por edhe pakënaqësi të studentëve për sa i përket ushqimit në konviktet e studentëve, gjë që imponon nevojën e ndërmarrjes së aktiviteteve që synojnë përmirësimin e kushteve në konviktet e studentëve dhe sigurimin e standardit më të lartë jetesor dhe studimit për studentët në shtet.



KSHS Shkup – KSHS Goce Dellçev



KSHS Stiv Naumov – ndërtesa 3

Në këtë drejtim, eksperti i pavarur ka bërë analizë të përshtatshmërisë së çmimit të përcaktuar për akomodim, i cili si burim themelor i të ardhurave të KSHS-së nuk ka ndryshuar që nga viti 2008 dhe arrin në 6.820 denarë në muaj për 10 muaj të vitit, nga të cilat MASH-i merr pjesë me 50% të çmimit, ndërsa pjesën tjetër e paguajnë studentët. Me analizën e kryer konstatuam se ajo nuk ofron nivel të kënaqshëm të qëndrueshmërisë financiare për konviktet që përballen me pamundësinë e servisimit në kohë të detyrimeve dhe rritjen e borxhit të konvikteve të studentëve, gjë që tregon nevojën për përcaktim real të çmimit ekonomik për akomodimin dhe ushqimin për studentët në KSHS.

Revizioni në bashkëpunim me ekspertin e pavarur të angazhuar, ka zbatuar edhe anketë të kënaqshmërisë së studentëve me kushtet në konviktet e studentëve. Më pas, anketës iu përgjigjën 286 studentë, përkatësisht rreth 8,25% e numrit të përgjithshëm të studentëve të akomoduar në konvikte, dhe studentët iu përgjigjën pyetjeve me notat nga 1 deri në 5. Rezultatet e anketës janë paraqitur në tabelën e mëposhtme:

| Sa jeni të kënaqur me kushtet e mëposhtme në konviktin e studentëve ku po qëndroni? | Vlerësimi mesatar |
|---|---|
| Ushqimi (cilësia, shumëllojshmëria, sasia) | 2.64 |
| Higjiena (sanitaritë, pastërtia, disponueshmëria e ujit të nxehtë) | 2.41 |
| Mobiljet (gjendja fizike, funksionaliteti) | 3.33 |
| Dhomat e banimit (metra katrore, pajisja, kushtet e tjera fizike) | 2.98 |
| Pajisjet teknike (printeri, fotokopjuesi, kompjuteri, TV) | 1.67 |
| Interneti (stabiliteti, shpejtësia, forca e sinjalit) | 1.81 |
| Kushtet/atmosfera e mësimit (izolimi i zërit, respektimi i rregullave të shtëpisë, hapësira e përshtatshme) | 2.53 |
| Dhomat e përbashkëta (mensa, salla e leximit/biblioteka, oborri) | 3.07 |
| Kushtet sportive dhe rekreative (rekuizita dhe hapësira për sport dhe rekreacion) | 2.12 |
| Aktivitetet kulturore dhe argëtuese në konviktin e studentëve | 2.46 |
| Ngrohja dhe ftohja e dhomave | 2.58 |
| Siguria e objekteve dhe studentëve | 2.80 |

Në fushën e investimeve, theksojmë se Projekti i Efikasitetit Energjetik i cili planifikon rikonstruksion të thellë të të gjitha KSHS-ve në vend ka filluar nga MASH-i. Njëkohësisht, për këtë projekt është dhënë kredi dhe grant në lartësi të përgjithshme prej 24.785.067 euro, por ka pasiguri sa i përket mjaftueshmërisë së mjeteve të siguruara për realizimin e plotë të këtij projekti siç është planifikuar. Në lidhje me zgjerimin e kapaciteteve të KSHS-së, gjatë revizionit përfundoi ndërtimi i KSHS-së Tetovë me kapacitet për 300 studentë, por ende nuk është bërë procesverbali për pranimin teknik, për këtë arsye theksojmë se pranimi i studentëve të bëhet pas përfundimit të plotë të procedurës për lëshimin në përdorim të këtij objekti në mënyrën e përcaktuar në rregullat ligjore të kësaj fushe.

Nga revizioni i kryer miratuam konkluzion se masat dhe aktivitetet për zhvillimin e standardit studentor që ndërmerren nga organet kompetente nuk janë mjaft efikase dhe ekonomike për të arritur nivelin e qëndrueshëm të pavarësisë financiare të konvikteve të studentëve, akomodimit adekuat dhe ushqimit, si dhe realizimin e projekteve për rikonstruksionin dhe zgjerimin e kapaciteteve të KSHS-së.

Në fushën e bursimit për studentët janë vendosur disa masa të përshtatshme, por ato nuk janë harmonizuar me interesin për të studiuar në programet studimore dhe për shkak të aplikimit në më shumë se një grup bursash, dokumentacionit të vëllimshëm dhe parregullsive në përcaktimin e plotësimit të kushteve, një pjesë e bursave nuk janë dhënë, por është vendosur mënyra e bursimit për studim jashtë vendit që nuk siguron shfrytëzim efikas të mjeteve të paguara dhe përfitimeve për shtetin.

Institucioneve kompetente u janë dhënë rekomandime për t'i eliminuar efektet e parregullsive të konstatuara ose rreziqeve të mundshme, duke ndërmarrë masa dhe aktivitete në kohë për zhvillimin e standardit të studentëve, përmirësimin e kushteve në të cilat funksionojnë KSHS-të, akomodimin dhe ushqimin adekuat për studentët, rikonstruksionin dhe zgjerimin e kapaciteteve të KSHS-së, si dhe në pjesën e bursimit dhe mbështetjes për studentët e talentuar.

## 5.14.3. UNIVERSITETI "SHËN CIRILI DHE METODI" SHKUP

Gjatë vitit 2023, Enti Shtetëror i Revizionit kreu revizionin e raporteve financiare bashkë me revizionin e pajtueshmërisë për vitin 2022 në Universitetin "Shën Cirili dhe Metodi" Shkup - Rektorati në llogarinë e buxhetit themelor dhe llogaritë për mjetet nga aktivitetet vetëfinancuese: Personale, Qendra e Kongreseve, Funksionet Integruese dhe Konferenca Ndëruniversitare.



Me revizionin u konstatuan situatat e mëposhtme:

- Evidentimi i parealizuar i tokës në librat e punës së Rektoratit.
- Nuk është vendosur ndjekja e arkëtimit të të ardhurave të realizuara nga dhënia me qira e banesave të doktorantëve, shpenzimet për të studiuar në ciklin e tretë të studimeve - studimet e doktoraturës dhe shitja e formularëve.
- Kemi konstatuar parregullsi në mënyrën e përgatitjes së një pjese të faturave për shërbimet e pansionit dhe restorantit dhe arkëtimin e kryer me para të gatshme, si dhe mosharmonizimi i të dhënave për praninë e personalit të angazhuar nga operatori ekonomik në Qendrën e Kongreseve.
- Të ardhurat e realizuara në bazë të funksioneve integruese nuk janë të plota për shkak të njoftimit të padorëzuar për të ardhurat e realizuara nga njësitë organizative në Universitetin "Shën Cirili dhe Metodi" Shkup.
- Anëtarësimi i papaguar nga anëtarët e Konferencës Ndëruniversitare të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Në pjesën Theksimi i çështjeve të pasigurisë dhe vazhdimësisë, është bërë paraqitja, ndër të tjera, edhe në pjesën e:

- pasigurisë për përfundimin dhe vënien në përdorim të ndërtimit të nisur të objekteve brenda kampit të Universitetit "Shën Cirili dhe Metodi" Shkup, të cilat janë të dedikuara për Fakultetin e Arsimit Fizik, Sportit dhe Shëndetit dhe Fakultetin e Shkencave Informatike dhe Inxhinierisë Kompjuterike, si dhe ndërtimin e sallës sportive nga Agjencia e Rinisë dhe Sportit;;
- zbatimit të kontratës së lidhur ndërmjet Fondit për Inovacione dhe Zhvillim Teknologjik dhe Akcelerator UKM me qëllim të financimit të projekteve të propozuara përmes Instrumentit të Mbështetjes - grante të bashkëfinancuara për vendosjen, funksionimin dhe investimet e akseleratorëve afaristë - teknologjikë.





# 5.15. VETËQEVERISJA LOKALE DHE ZHVILLIMI I BARABARTË RAJONAL

## 5.15.1. NJËSITË E VETËQEVERISJES LOKALE




Gjatë vitit 2023 është bërë revizioni i raporteve financiare bashkë me revizionin e pajtueshmërisë për vitin 2022, në tetë njësi të vetëqeverisjes lokale: Strumicë, Prilep, Dibër, Vrapçishtë, Novaci, Rosoman, Zhelinë dhe Shuto Orizarë, ku janë konstatuar situatat e mëposhtme:

Në komunat e revizuara, si Komuna e Dibrës, Komuna e Zhelinës dhe Komuna e Shuto Orizarës janë konstatuar dobësi në procesin e buxhetimit dhe devijimit të konsiderueshëm ndërmjet të ardhurave dhe shpenzimeve të planifikuara dhe të realizuara për shkak të moskryerjes ose kryerjes joadekuate të ndryshimit dhe plotësimit / ribalancit të buxhetit. Në Komunën e Prilepit, Komunën e Dibrës dhe Komunën e Vrapçishtit nuk janë miratuar programe për aktivitetet për të cilat kompetente është komuna, mungon pjesëmarrja e qytetarëve në hartimin e buxhetit dhe transparenca në informimin publik. Komuna e Zhelinës gjatë vitit 2022 punoi me llogari të bllokuar, përdori pagesat me llogaritje në arkëtimin e kërkesave dhe pagesës së detyrimeve, gjë që kontribuon që qarkullimi pagesor të kryhet jashtë sistemit të thesarit, gjë që është në kundërshtim me rregullat ligjore.

Në komunat e revizuara, si Komuna e Prilepit, Komuna e Strumicës, Komuna e Dibrës dhe Komuna e Rosomanit janë konstatuar dobësi në administrimin e taksave dhe kompensimeve komunale. Komuna e Strumicës nuk realizon të ardhura në bazë të taksës komunale për paraqitjen e reklamave, shpalljeve dhe konkurseve në vendet publike.

Në Komunën e Prilepit dhe Komunën e Dibrës janë konstatuar dobësi në mënyrën dhe procedurën e dhënies me qira të pronës komunale.

Dobësi në administrimin e tatimeve mbi pronë dhe tatimeve mbi trashëgimi dhe dhuratë janë të pranishme në Komunën e Dibrës, Komunën e Vrapçishtit, Komunën e Novacit, Komunën e Rosomanit dhe Komunën e Zhelinës dhe i referohen vlerës joreale të përcaktuar në treg të pronës së paluajtshme.

CNë buxhetin e Komunës së Prilepit për vitin 2022 janë paguar më pak mjete në shumë prej 10.100 mijë denarë në bazë të kompensimit për mirëmbajtjen e pastërtisë publike, ndërsa Komuna e

Dibrës, Komuna e Novacit, Komuna e Rosomanit dhe Komuna e Zhelinës nuk realizojnë të ardhura mbi këtë bazë.

Në Komunën e Dibrës, Komunën e Prilepit dhe Komunën e Strumicës janë konstatuar parregullsi në lidhje me zbatimin e kompetencës për menaxhimin e gjelbërimit, përkatësisht mungesën e Strategjisë për zhvillimin e gjelbërimit dhe Programit Vjetor për ngritjen dhe mirëmbajtjen e gjelbërimit, si dhe të ardhura të parealizuara në bazë të kompensimit për mirëmbajtjen e gjelbërimit publik të qytetit.

Në komunat e reviduara janë konstatuar dobësi në procedurat për përcaktimin e statusit juridik të objekteve të ndërtuara pa leje lidhur me mosrespektimin e afateve të përcaktuara me ligj dhe në lidhje me mosdorëzimin e raporteve vjetore në Ministrinë e Transportit dhe Lidhjeve për shfrytëzimin e mjeteve të realizuara nga kompensimi mbi këtë bazë, të cilat duhet të përdoren me dedikim për miratimin e dokumentacionit urbanistik të planit me të cilin bëhet përputhja me objektet pa leje dhe për rregullimin infrastrukturor të hapësirës në të cilën ndodhen ato.

Komuna e Prilepit, Komuna e Strumicës, Komuna e Dibrës, Komuna e Shuto Orizarës, Komuna e Vrapçishtit dhe Komuna e Novacit nuk i respektojnë dispozitat ligjore me rastin e angazhimit të personave përmes agjencive private të punësimit, kontratat për të drejtën e autorit dhe kontratat në vepër, ndërsa në Komunën e Dibrës dhe Komunën e Shuto Orizarës janë konstatuar parregullsi edhe në pagesën e kompensimit për pjesëmarrje në mbledhjet e këshilltarëve.

Në Komunën e Prilepit, Komunën e Strumicës, Komunën e Dibrës, Komunën e Zhelinës, Komunën e Rosomanit, Komunën e Vrapçishtit dhe Komunën e Novacit janë konstatuar parregullsi në mënyrën e pagesës së mjeteve për klubet sportive, shoqatat e qytetarëve, fondacionet, nxënësit e talentuar dhe beneficionet sociale, pa programe të miratuara dhe kritere të përcaktuara saktë për ndarjen e mjeteve për mbrojtje sociale, sport, arsim dhe mbështetje të organizatave civile në shumë të përgjithshme prej 55.268 mijë denarë.

Komuna e Prilepit dhe Komuna e Rosomanit e kanë subvencionuar ndërmarrjen publike komunale pas kërkesave dhe dokumentacionit jo të plotë për vëllimin e kryer të aktiviteteve në shumë prej 64.619 mijë denarë.

Mosrespektimi i dispozitave të kontratave për partneritet privat publik për rikonstruksion, modernizim dhe mirëmbajtje të ndriçimit publik në Komunën e Dibrës në vlerë prej (88.800 mijë denarë), Komunën e Novacit (45.578 mijë denarë), Komunën e Zhelinës (72.951 mijë denarë) dhe Komunën e Vrapçishtit (94.798 mijë denarë) nga partneri privat për sigurimin e dokumentacionit për vendosjen e ndriçimit publik, garancitë bankare dhe nga komunat për moskryerjen e aktiviteteve kontrolluese dhe përcaktimin e efektit të kursimit të energjisë.

Gjatë kryerjes së aktiviteteve për ndërtimin / rikonstruksionin e rrugëve urbane dhe ndërurbane, rrjeteve të ujësjellësit dhe kanalizimit, komunat e reviduara nuk i respektojnë dispozitat e Ligjit për ndërtim, në lidhje me sigurimin e lejes së ndërtimit të objekteve që bien në kategorinë e dytë të ndërtimeve, aktivitetet ndërtimore kryhen pa projekt të përgatitur dhe dokumentacion të projektit vetëm në bazë të specifikimit teknik / llogaritjes dhe nuk ka pranim-dorëzim të objekteve të ndërtuara.

Parregullsi janë konstatuar edhe në mënyrën e evidentimit të kërkesave, përcaktimit të strukturës së tyre të kohës, ndërsa për kërkesat tatimore që nuk janë arkëtuar brenda afatit të përcaktuar nuk llogaritet dhe arkëtohet kamatë dhe nuk ndërmerren masa për arkëtimin e tyre.

Në komunat e reviduara ka parregullsi në zbatimin e regjistrimit të pronës dhe detyrimeve, situatë kjo aktuale prej vitesh dhe nuk mundëson harmonizimin e gjendjes së mjeteve dhe detyrimeve ndërmjet gjendjes faktike të konstatuar nga regjistrimi dhe evidenca e kontabilitetit. Prona në pronësi të komunave nuk është e evidentuar plotësisht në librat afariste, ndërsa për pjesën më të madhe të pronës së paluajtshme nuk është ofruar dëshmi e pronësisë nga komunat.



Pa dokumentacion mbështetës adekuat për riparimin e kryer dhe mirëmbajtjen e ndriçimit publik, rikonstruksionin dhe ndërtimin e rrugëve urbane dhe ndërurbane dhe ndërtimin e çerdheve për fëmijë, për të cilat Komuna e Prilepit ka paguar mjete në shumë prej 51.313 mijë denarë. Janë bërë shpenzime pa dokumentacion mbështetës për derivatet e konsumuara, mëditjet për udhëtimet zyrtare, shërbimet në restorant, riparimin dhe servisimin e automjeteve të pasagjerëve dhe transportin e njerëzve, Komuna e Dibrës ka shpenzuar 1.266 mijë denarë, ndërsa Komuna e Vrapçishtit 3.831 mijë denarë.

Në komunat e revidoara janë konstatuar dobësi në procedurat e prokurimeve publike, në pjesën e: specifikimit teknik dhe llogaritjes, sasive të paketuara për pozicionet e veçanta (Komuna e Prilepit dhe Komuna e Zhelinës), dokumentacionit të tenderit dhe kriteret për përzgjedhjen e ofertës më të volitshme (Komuna e Novacit), parregullsive në realizimin e kontratave (Komuna e Prilepit, Komuna e Strumicës, Komuna e Zhelinës dhe Komuna e Rosomanit) dhe prokurimet e paraportuara nën pragun e vlerës në evidencën tremujore (Komuna e Strumicës).

Pa procedurë të prokurimit publik janë prokuruar mallra dhe shërbime dhe janë kryer punë, për të cilat janë paguar mjete në shumë të përgjithshme prej 10.122 mijë denarë (Komuna e Rosomanit, Komuna e Strumicës, Komuna e Vrapçishtit dhe Komuna e Shuto Orizarës).

Në komunat e revidoara, si Komuna e Prilepit, Komuna e Strumicës, Komuna e Dibrës, Komuna e Zhelinës, Komuna e Vrapçishtit dhe Komuna e Novacit janë konstatuar dobësi në sistemin për menaxhim dhe kontroll financiar, sa u përket procedurave të shkruara, ndarjes së detyrave dhe mekanizmave të përcaktuar të kontrollit në proceset e punës, si dhe revizioni i brendshëm i pavendosur / jofunksional në Komunën e Prilepit, Komunën e Shuto Orizarës dhe Komunën e Rosomanit.

Në Komunën e Shuto Orizarës, Komunën e Vrapçishtit dhe Komunën e Rosomanit nuk është emëruar kontabilist përgjegjës, në Komunën e Zhelinës janë konstatuar parregullsi në hartimin e raportit vjetor dhe transparencës në njoftim, ndërsa në Komunën e Vrapçishtit nuk është vendosur evidenca e kontabilitetit dhe nuk mbahen librat afariste.

Në pjesën Theksimi i çështjeve të pasigurisë dhe vazhdimësisë janë theksuar situatat që, ndër të tjera, i referohen: Pas Kontratës së huas ndërmjet Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim dhe Republikës së Maqedonisë së Veriut, në vitin 2016 Ministria e Financave dhe Komuna e Zhelinës kanë lidhur kontrata për nën-hua nr. 02 për rikonstruksionin e rrugëve lokale, objekteve shkollore dhe nr. MSIP/41 për: rikonstruksionin e rrugëve dhe ndërtimin e kanalizimit atmosferik, për çka gjatë viteve 2022 dhe 2023 kanë arritur këstet në shumë të përgjithshme prej 4.401 mijë denarë, gjë që do të ndikojë më tej në likuiditetin e buxhetit të komunës.

Gjatë vitit 2022, Komuna e Novacit nuk ka realizuar të ardhura në bazë të kompensimit të koncesioneve në shumë të përgjithshme prej 48.349 mijë denarë, për shkak të vonesës së pagesës që ka ndikim në realizimin e të ardhurave të planifikuara në buxhetin e Komunës, të cilat për vitin 2022 shënojnë realizim prej 65%.



## 5.15.2. BARAZIA GJINORE E GRAVE NGA MJEDISET RURALE PËRMES PËRFSHIRJES SË TYRE NË TREGUN E PUNËS

5 BARAZI GJINORE

Enti Shtetëror i Revizionit në përputhje me Programin Vjetor të Punës për vitin 2023 zbatoi revizionin e suksesit me temë **"Barazia gjinore e grave nga mjediset rurale përmes përfshirjes së tyre në tregun e punës"**. Qëllimi i revizionit ishte të përcaktonte nëse janë zhvilluar masat, politikat për përfshirjen e grave nga mjediset rurale në tregun e punës.

Revizioni u zbatua si revizion kooperativ me RSR të Shqipërisë dhe RSR të Kosovës, me mbështetjen e Agjencisë së Kombeve të Bashkuara për Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Grave "UN Women".

Aktivitetet e zbatuara të revizorit dhe dëshmitë e siguruara të revizorit mundësuan të shprehim këtë konkluzion: Masat dhe aktivitetet për barazi gjinore të grave nga mjediset rurale përmes përfshirjes së tyre në tregun e punës që ndërmerren nga institucionet shtetërore kompetente nuk janë mjaft efikase dhe efektive me qëllim të përfshirjes së grave nga mjediset rurale në tregun e punës dhe mbajtjes në mjediset rurale.

Pra, në Strategjitë Nacionale të Punësimit dhe Planet e Veprimit nuk janë parashikuar qëllimet, treguesit, masat dhe aktivitetet e veçanta të përshtatura për nevojat e grave nga mjediset rurale për përfshirjen e tyre në tregun e punës. Gratë nga mjediset rurale dhe përfshirja e tyre në tregun e punës nuk janë pjesë e prioriteteve dhe qëllimeve strategjike të Qeverisë.

Të dhënat për realizimin e Planeve Operative për programet aktive dhe masat e punësimit dhe shërbimet në tregun e punës nuk përmbajnë të dhëna për shfrytëzuesit e masave të ndara sipas mjediseve rurale dhe urbane, për këtë arsye nuk është e mundur të përcaktohet pjesëmarrja e grave nga mjediset rurale në këto programe dhe masa.

Masat e punësimit dhe trajnimet e realizuara gjatë kësaj periudhe janë të përgjithshme, ato janë të dedikuara për të gjithë burrat dhe gratë në vend, por në to nuk përfshihet perspektiva gjinore dhe nuk janë përshtatur me nevojat dhe specifikat e grave në mjediset rurale.

Masa Investimet në Infrastrukturën Publike Rurale nga Programi IPARD e cila duhet të kontribuojë në përmirësimin e infrastrukturës në mjedisin rural dhe kushteve për përfshirjen e grave dhe vajzave në arsim dhe në tregun e punës, si dhe në shërbimet shëndetësore, për shkak të mungesës së kapaciteteve në Agjencinë për Mbështetje Financiare në Bujqësi dhe Zhvillim Rural, nuk është e akredituar.



Gjendja me infrastrukturën. mjedisi rural f. Furkë, Dojran





**Pajisja e prokuruar për prodhimin e dhallës nga masa 115 - Mbështetja për anëtaren aktive femër në ekonominë familjare bujqësore f. Rëzhaniçinë – Komuna e Petrovecit**

Në vitin 2019 u prezantua për herë të parë masa e përgjegjshme gjinore 115 - Mbështetja për anëtaren aktive femër në ekonominë familjare bujqësore, ndërsa në vitin 2022 u shpall edhe thirrja e dytë publike. Konstatuam se në vitin 2022 ishin parashtruar 66% më pak kërkesa për mbështetje financiare në krahasim me vitin 2019, ndërsa qëndrimet dhe perceptimet e grave janë se vonesat në pagesat e mjeteve për masën që nga thirrja e parë ka ndikuar në uljen e numrit të grave që nuk kanë parashtruar kërkesë në thirrjen e dytë.

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave nuk ka bërë analizë të efektit të zbatimit të masës 112 – Ndihma për bujqit e rinj për fillimin e veprimtarisë bujqësore, përkatësisht ndikimi i saj në forcimin, rritjen e numrit të bujqve të rinj që kanë filluar veprimtari bujqësore dhe statusin e tyre nga aspekti gjinor.

Nuk janë miratuar zgjidhje të veçanta ligjore për të mbështetur zonat pothuajse tërësisht të braktisura ose zonat në fazën e shpopullimit serioz në Republikën e Maqedonisë së Veriut, të cilat formojnë territor gjeografik me madhësi të konsiderueshme nga territori i përgjithshëm i vendit (deri në 4%). Sipas të dhënave të Entit Shtetëror të Statistikës në vend, nga gjithsej 1.781 vendbanime, 12% ose 205 vendbanime nuk kanë asnjë banor, 12% ose 218 vendbanime kanë deri në 10 banorë, 38% ose 684 vendbanime kanë deri në 100 banorë.

Në vitin 2023 u miratua Programi për përdorimin e mbështetjes financiare të pakthyeshme për gratë që ushtrojnë veprimtari bujqësore dhe kanë statusin e bujkeshave individuale të siguruar, me të cilin fitojnë të drejtën e kompensimit për mëmësi gjatë parandalimit të ushtrimit të veprimtarisë bujqësore për shkak të lindjes, me çka kontribuon në sigurimin social të grave që ushtrojnë veprimtari bujqësore.

Investimi në objektet e kujdesit për fëmijët e moshës parashkollore në mjediset rurale është bazë e mirë për mbajtjen e popullatës së re në mjediset rurale, por kemi konstatuar se nuk është bërë analizë gjithëpërfshirëse për nevojën ndaj mjediseve rurale, afateve kohore, institucioneve kompetente dhe mjeteve të nevojshme financiare.

Në vend ekzistojnë pesë institucione publike për akomodimin e pleqve dhe ato ndodhen në mjediset urbane. Strategjia për Barazi Gjinore 2021 - 2027, në qëllimin e përmirësimit të cilësisë së punës për gratë, është paraparë treguesi - ndërtimi i shtëpive të pleqve në mjediset rurale, por nuk parashikohen aktivitete për arritjen e qëllimit, përkatësisht nuk është përcaktuar në sa dhe në cilat mjedise rurale do të ndërtohen shtëpi.

Në drejtim të tejkalimit të situatave të konstatuara u kemi dhënë rekomandime personave përgjegjës të institucioneve, me zbatimin e të cilave pritet përmirësimi dhe mënjanimi i mangësive në organizimin dhe funksionimin e institucioneve kompetente dhe në procesin e përfshirjes së grave nga mjediset rurale në tregun e punës.

**"Duhet të eliminohen stereotipet dhe diskriminimi, pushteti ekzekutiv dhe legjislativ duhet të ofrojnë kushte për përfshirjen e vazhdueshme të grave rurale në tregun e punës. Ajo dëshiron, mund dhe di si të sigurojë të ardhmen e saj, të bëhet sipërmarrëse e suksesshme, të ndërtojë një të nesërme më të mirë për veten, familjen dhe përparimin e përgjithshëm shoqëror".**



# 5.16. PARTITË POLITIKE DHE FUSHATAT ZGJEDHORE

## 5.16.1. PARTITË POLITIKE – PUNA E RREGULLT

Revizioni shtetëror, në përputhje me Ligjin për revizion shtetëror, përfshin edhe dhënien e vlerësimit të masave të ndërmarra nga subjektet që janë lëndë e revizionit, në lidhje me situatat e konstatuara dhe rekomandimet e dhëna të përmbajtura në raportin përfundimtar të revizorit.

Në përputhje me Programin Vjetor të Punës së Entit Shtetëror të Revizionit për vitin 2023, kemi kryer revizionin e zbatimit të rekomandimeve të dhëna të përmbajtura në Raportin Përfundimtar të Revizorit për revizionin e kryer të raporteve financiare bashkë me revizionin e pajtueshmërisë së partive politike LSDM, BDI, VMRO-DPMNE dhe Alternativa, në llogarinë e punës së rregullt.

Konstatuam se 50% e rekomandimeve të dhëna akoma nuk janë zbatuar, 33% janë zbatuar, ndërsa 17% e rekomandimeve të dhëna janë në proces të zbatimit.

Statusi i zbatimit të rekomandimeve dhe vlerësimi i kryer i përshtatshmërisë së masave të ndërmarra tregon se subjektet kanë ndërmarrë aktivitete dhe masa për një pjesë të rekomandimeve të dhëna, por ka nevojë për aktivitete shtesë për të cilat janë dhënë udhëzime për veprim në periudhën e ardhshme për zbatimin e plotë të rekomandimeve.

СДСМ

ALTERNATIVA

## 5.16.2. FUSHATA ZGJEDHORE - ZGJEDHJET LOKALE 2022

Enti Shtetëror i Revizionit është kompetent për ndjekjen e financimit të fushatës zgjedhore nëpërmjet sistemit të njoftimit financiar të vendosur me Kodin Zgjedhor dhe aktet nënligjore. Në përputhje me metodologjinë e përcaktuar në bazë të Ligjit për revizion shtetëror dhe standarde ndërkombëtare të revizionit, Enti Shtetëror i Revizionit kryen revizion të rregullshmërisë (revizioni financiar bashkë me revizionin e pajtueshmërisë) të Raportit Financiar Total me specifikimin e shpenzimeve për të ardhurat dhe shpenzimet në fushatën zgjedhore (raporti financiar i fushatës zgjedhore).

Учесниците во изборниот процес имаат обврски да спроведуват активности кои меѓу другото се однесуваат и на:

- regjistrimit tek organet kompetente,
- regjistrimit të llogarive të transaksionit
- respektimit të afateve për hapjen dhe mbylljen e llogarisë së transaksionit dhe hartimin dhe dorëzimin e raporteve tek organet kompetente për të ardhurat dhe shpenzimet e realizuara në procesin zgjedhor.

Në Raportet Përfundimtare, revizori i autorizuar shtetëror njofton për: situatat e konstatuara, parregullsitë dhe paligjshmëritë në funksionimin, financimin dhe realizimin e shpenzimeve, situatat që kanë ndikim në funksionimin në periudhën e ardhshme dhe dobësitë sistematike të rregullativës ligjore.

Në përputhje me Programin Vjetor të Punës së Entit Shtetëror të Revizionit për vitin 2023, janë kryer revizionet e raporteve financiare të të ardhurave dhe shpenzimeve të 18 pjesëmarrësve në fushatën zgjedhore për zgjedhjet lokale 2022 për zgjedhjen e kryetarit të Komunës së Mavrovës dhe Rostushës dhe Komunës së Qendër Zhupës dhe për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Komunës së Tetovës, për: 14 parti politike [16]; 2 koalicione [17] dhe 2 kandidatë të pavarur [18] të mbështetur nga "grup votuesish".

Janë konstatuar situata që nuk janë në përputhje me dispozitat e Kodit Zgjedhor te një pjesë e pjesëmarrësve në fushatën zgjedhore, ndërsa kanë të bëjnë me:

- me PEPR nga RM Tetovë, nuk janë hartuar dhe dorëzuar tek organet kompetente raportet e parapara me ligj: Raporti me specifikimin e shpenzimeve për të ardhurat dhe shpenzimet e llogarisë së transaksionit për fushatën zgjedhore nga dita e hapjes deri në përfundimin e rrethit zgjedhor, Raporti financiar për fushatën zgjedhore, si dhe 2 (dy) raporte me ekzemplarin për donacionet e marra në llogarinë e transaksionit për financimin e fushatës zgjedhore;
- Grupin e votuesve Agon Zaimi nuk ka hartuar dhe dorëzuar tek organet kompetente Raport me specifikimin e shpenzimeve për të ardhurat dhe shpenzimet e llogarisë së transaksionit për fushatën zgjedhore nga dita e hapjes deri në përfundimin e rrethit zgjedhor dhe Raport financiar për fushatën zgjedhore;
- Partinë Demokratike të Turqve të Maqedonisë për Zgjedhjet Lokale të fushatës zgjedhore të vitit 2022 për zgjedhjen e kryetarit të Komunës së Qendër Zhupës në raportin e përgjithshëm financiar nuk i ka paraqitur të ardhurat dhe shpenzimet për reklamimin e paguar politik në bazë të kontratave për asignacion, të paguar nga Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve dhe nuk ka hartuar dhe dorëzuar tek organet kompetente Raport me specifikimin e shpenzimeve për të ardhurat dhe shpenzimet e llogarisë së transaksionit për fushatën zgjedhore nga dita e hapjes deri në përfundimin e rrethit zgjedhor.

---

[16] Aleanca për Shqiptarët, Lëvizja Besa, Partia Demokratike Shqiptare PDSH, Partia Demokratike e Turqve të Maqedonisë-PDTM, VMRO-DPMNE, Lëvizja për Bashkim Kombëtar e Turqve-LBKT, BDI, Alternativa, Integra Partia Konservatore Maqedonase, E Majta, PEPR nga RM Tetovë

[17] "Më e mira për komunën time" për zgjedhjet lokale 2022 për Komunën e Mavrovës dhe Rostushës dhe Komunën e Qendër Zhupës dhe "Më e mira për komunën time" për zgjedhjet e anëtarëve të Këshillit të Komunës së Tetovës

[18] Elmedina Abdullahi për anëtarë të Këshillit në Komunën e Tetovës dhe Agon Zaimi për anëtarë të Këshillit në Komunën e Tetovës

Fushata zgjedhore mund të financohet nga mjetet e llogarisë së rregullt të partisë politike, anëtarësimi i partisë politike, donacionet për partinë politike, donacionet e personave fizikë në lartësi prej 3.000 euro në kundërvlerë me denarë, personat juridikë në lartësi prej 30.000 euro në kundërvlerë me denarë dhe kredi të partisë politike të dedikuara për fushatën zgjedhore. Me qëllim të përmbushjes së obligimeve ligjore të radiodifuzerëve, mediave të shtypit dhe mediave elektronike (portaleve) në pjesën e publikimit të reklamimit të paguar politik, në procesin zgjedhor, mjetet financiare sigurohen nga mjetet e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, ndërsa paguhen nga Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve.

Nga analiza e kryer e gjithsej burimeve të financimit të fushatës zgjedhore është konstatuar se ajo është financuar me mjete në shumë të përgjithshme prej 19.377 mijë denarë. Nga analiza e të ardhurave sipas llojeve të burimeve të financimit, konstatuam se 60% e mjeteve për financimin e fushatës zgjedhore janë siguruar nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut të paguar nga Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve, ndërsa 40% janë mjete të siguruara nga burime të tjera të financimit.

## BURIMET E FINANCIMIT TË FUSHATËS ZGJEDHORE - ZGJEDHJET LOKALE 2022

во 000 денари




Nga gjithsej shpenzimet prej 19.377 mijë denarë në fushatën zgjedhore, 17.774 mijë denarë, përkatësisht 92%, janë shpenzuar për reklama për pjesëmarrësit në të. Mjetet e siguruara nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut, përkatësisht shpenzimet e llogaritura në lidhje me detyrimet e llogaritura për reklamimin e paguar politik të publikuar në shpenzimet për reklama marrin pjesë me 65%, ndërsa 35% të mjeteve për reklama sigurohen nga burimet e tjera.

## SHPENZIMET PËR FUSHATËN ZGJEDHORE - ZGJEDHJET LOKALE 2022

во 000 денари



# 6

## DOBËSITË SISTEMORE



# 6. DOBËSITË SISTEMORE

Enti Shtetëror i Revizionit kreu edhe vlerësimin e shkallës së pajtueshmërisë së akteve ligjore dhe nënligjore dhe jep rekomandime për ndryshimin, plotësimin dhe harmonizimin e tyre.

Në këtë pjesë, theksojmë një pjesë të dobësive kryesore të konstatuara sistemore për të cilat ka nevojë për të ndërmarrë aktivitete nga organet kompetente të pushtetit ekzekutiv / legjislativ për tejkalimin e tyre.

## BUXHETI DHE SISTEMI FINANCIAR

### Ligji për buxhete

Harmonizimi i një pjese të neneve në Ligjin për buxhete, zbatimi i të cilit do të fillojë nga 1 janari 2025, përveç dispozitave nga neni 121, në të cilin theksohen përjashtimet, si:

- në nenin 35 të plotësohet paragrafi 3, në drejtim të përcaktimit të dokumentacionit buxhetor për Propozim-buxhetin e komunës;
- në nenin 76 të plotësohet paragrafi 3 në përputhje me të cilin shfrytëzuesit buxhetorë amë do të duhet t'i dorëzojnë rregullisht të gjitha kontratat e koncesioneve në kompetencë të tyre dhe në komunën në territorin e së cilës ndodhet koncesioni, si dhe paragrafi 5 që Ministria e Ekonomisë do të duhet t'i dorëzojë rregullisht të gjitha kontratat për partneritetet private publike dhe në komunën në territorin e së cilës ndodhet koncesioni,
- në nenin 94 të ndryshohet dhe plotësohet:
  - paragrafi 3, në të cilin duhet të rregullohet Propozim-Llogaria Përfundimtare e Buxhetit të Shtetit, i dorëzohet vetëm Këshillit Fiskal, jo edhe Entit Shtetëror të Revizionit;
  - paragrafi 4 në të cilin do të rregullohet që Enti Shtetëror i Revizionit të kryejë revizionin e Llogarisë Përfundimtare të Buxhetit, ndërsa pjesa për veprimin sipas rekomandimeve të dhëna duhet të fshihet;
  - paragrafi 6 në të cilin pjesa mbi refuzimet e mundshme të rekomandimeve të veçanta të revizorit duhet të fshihet;
  - paragrafi 7 duhet të ndryshohet dhe të rregullohet që Kuvendi e shqyrton Raportin Përfundimtar të revizorit të autorizuar shtetëror për revizionin e

kryer të Llogarisë Përfundimtare të Buxhetit, duke përcaktuar afatin për të, dhe

- ndryshimi i paragrafit 8 në përputhje me të cilin Propozim-Llogaria Përfundimtare e Buxhetit të komunës duhet t'i dorëzohet Këshillit të Komunës për miratim, e jo MF-së, dhe
- harmonizimi i paragrafëve 9, 10 dhe 11 të ligjit të përmendur dhe dispozitave të nenit 33 të Ligjit për financimin e njësive të vetëqeverisjes lokale.

## Ligji për të punësuarit në sektorin publik dhe Ligji për buxhete

Në përputhje me nenin 30 të Ligjit për buxhete, Qeveria e dorëzon në Kuvend Propozim-buxhetin më së voni deri më 15 nëntor të vitit aktual, i cili duhet të miratohet më së voni deri më 31 dhjetor, ndërsa në përputhje me nenin 20-b të Ligjit për të punësuarit në sektorin publik, funksionari që e udhëheq institucionin është i detyruar që më së voni deri më 1 shtator të vitit aktual të hartoj propozim-plan të punësimit për vitin e ardhshëm dhe bashkë me propozim-kërkesën buxhetore ta dorëzojë për marrjen e pëlqimit në MF dhe ministritë kompetente. Duke marrë parasysh afatet e përcaktuara në këtë mënyrë, revizioni vë në dukje nevojën e rishqyrtimit të afateve për planifikimin dhe miratimin e planeve të punësimit në Ligjin për të punësuarit në sektorin publik, përkatësisht në kushtet që buxheti i shtetit akoma nuk është miratuar, në drejtim të planifikimit real të punësimeve në institucionet në sektorin publik dhe realizimit të tyre në përputhje me mjetet e siguruara financiare.

# PARTITË POLITIKE DHE SISTEMET ZGJEDHORE

## Ligji për financimin e partive politike

Në Ligjin për financimin e partive politike nevojitet:

- rregullimi shtesë i nenit 14 të Ligjit për financimin e partive politike, lidhur me miratimin e udhëzimeve më konkrete për rregullimin e mënyrës së pagesës, pagesës dhe evidentimit të anëtarësimit si burim i financimit të partive politike me qëllim të uniformitetit në mënyrën e evidentimit të tyre të kontabilitetit dhe konfirmimin mbi limitin e përcaktuar me ligj për çdo anëtar veç e veç, duke marrë parasysh financimin e fushatës zgjedhore për një proces të caktuar;
- saktësimi shtesë i nenit 15 të Ligjit për financimin e partive politike, lidhur me përcaktimin e kushteve dhe kufizimeve kur partia politike pranon donacione të pronës së paluajtshme si lloj i mjetit material.

## Kodi Zgjedhor

Të rishqyrtohen dhe të saktësohen në mënyrë shtesë dispozitat nga neni 83 paragrafi 2 të Kodit Zgjedhor në pjesën e financimit të fushatës zgjedhore me mjete nga llogaria e rregullt e partisë politike.

Të rregullohet në mënyrë shtesë neni 76-d i Kodit Zgjedhor duke përcaktuar kritere të matshme në pjesën e sigurimit dhe ndarjes së mjeteve nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut të dedikuara për reklamimin e paguar politik.

Është e nevojshme të përcaktohen dispozitat që do të rregullojnë nëse koalicioni ose partia politike mund të mbështesë kandidat të pavarur - grup votuesish dhe t'i përdor mjetet e ndara për

reklamimin e paguar politik për kandidatin e pavarur - grup votuesish, nëse është e mundur në çfarë kushtesh dhe në çfarë mënyre dhe nëse me mbështetjen e tillë ai ka të drejtë t'i përdor edhe mjetet që i takojnë si kandidat i pavarur.

Të rregullohet mënyra në të cilën donatorët do të vërtetojnë/konfirmojnë se nuk janë "persona të lidhur" me radiodifuzerët, mediat e shtypit dhe mediat elektronike (portalet e internetit) kur financojnë ose japin donacione për partitë politike.

Nevoja e rregullimit ligjor të dispozitave nga neni 85 të Kodit Zgjedhor, në pjesën e mënyrës së veprimit për rastet kur Raportin e Përgjithshëm Financiar paraqiten teprica e mjeteve të siguruara në llogarinë e fushatës zgjedhore, si dhe detyrimet e papaguara.

Përcaktimi i obligimit për dorëzimin e raportit për panot dhe billbordet e përdorura reklamuese nga komunat në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe Qytetin e Shkupit.

Nevoja për rregullimin shtesë të kushteve dhe kritereve që duhet t'i plotësojnë mediat elektronike për të pasur mundësinë që të aplikojnë për reklamimin politik në KSHZ.

Të ndërmerren aktivitete për rregullimin shtesë në pjesën e caktimit të organit kompetent për ndjekjen dhe njoftimin e përfaqësimit mediatik zgjedhor të mediave elektronike (portaleve të internetit).

Të rishqyrtohet nevoja për plotësimin e nenit 76-d paragrafi 11 të Kodit Zgjedhor në drejtim të parashikimit të vendosjes së sistemit ndërveprues për shkëmbimin dhe kontrollin e të dhënave për aktivitetin e banderolave në të cilat do të përfshihen të gjitha palët e interesuara.

Ekziston nevoja për të rregulluar mënyrën e organizimit, pagesës, ndjekjes dhe njoftimit tek organet kompetente për përfaqësimin në internet të kryer nga pjesëmarrësit në fushatën zgjedhore përmes rrjeteve sociale.

Përcaktimi i kritereve të qarta dhe precize për ndarjen e mjeteve buxhetore të dedikuara për reklamimin e paguar politik në mediat elektronike (portalet e internetit).

Rishqyrtimi i afatit të përcaktuar të fundit për pagesën e donacioneve, përkatësisht është e nevojshme të përcaktohet që donacionet të paguhen më së voni deri në ditën e përfundimit të fushatës zgjedhore.

Rregullimi shtesë i Kodit Zgjedhor në pjesën e dënimeve dhe dispozitave të kundërvajtjes, për të parashikuar gjoba edhe për mediat elektronike (portalet elektronike) në rast të mosdorëzimit të Raportit për hapësirën reklamuese të përdorur nga secili pjesëmarrës në fushatën zgjedhore dhe mjetet e paguara që kërkohen mbi këtë bazë.

## NJËSITË E VETËQEVERISJES LOKALE

### ▲ Ligji për taksa komunale

- Taksa komunale për shfrytëzimin e rrugëve urbane dhe ndërurbane me mjetet motorike arkëtohet nga personat juridikë të autorizuar për regjistrimin e automjeteve dhe e paguajnë në llogarinë adekuate të pagesës në kuadër të llogarisë së thesarit të komunës. Në zgjidhjen ligjore ekzistuese nuk është përcaktuar afati në të cilin personat juridikë duhet të paguajnë taksën e arkëtuar në llogarinë e komunës dhe nuk kanë obligim që t'i njoftojnë komunat, komunat në Qytetin e Shkupit dhe Qytetin e Shkupit, për numrin e automjeteve të regjistruara në varësi të kapacitetit kub dhe për shumën mujore të mjeteve të grumbulluara në mënyrë të veçantë dhe kumulative.

- Taksa komunale për përdorimin dhe mirëmbajtjen e ndriçimit publik arkëtohet nga shoqëria tregtare kompetente për shpërndarjen e energjisë elektrike dhe është e detyruar ta paguajë në llogarinë adekuate të pagesës në kuadër të llogarisë së thesarit të komunës. Në zgjidhjen ligjore ekzistuese nuk është përcaktuar se në çfarë afati duhet të bëhet pagesa, nuk është përcaktuar obligimi i shoqërisë tregtare që e arkëton taksën nga pronarët e njehsorëve, që t'i njoftojë komunat, komunat në Qytetin e Shkupit dhe Qytetin e Shkupit për numrin e obligacioneve sipas kategorive (numrit të njehsorëve) në pajtim me numrin tarifor, si dhe për të ardhurat e arkëtuara dhe kërkesat e paarkëtuara mbi këtë bazë.

## Ligji për financimin e njësive të vetëqeverisjes lokale

Me Ligjin për financimin e njësive të vetëqeverisjes lokale, për financimin e kompetencave të bartura në arsim, kulturë, mbrojtjen e hershme të fëmijëve dhe mbrojtjen e pleqve në komunat janë futur bllok-dotacionet. Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut miraton Urdhëresë për metodologjinë për përcaktimin e kritereve për ndarjen e bllok-dotacioneve me propozim të ministrisë kompetente, e cila bazohet në formulën duke përdorur tregues adekuat të nevojave për secilin program. Urdhëresat janë identike çdo vit dhe nuk i pasqyrojnë nevojat dhe standardet reale, gjë që vë në pikëpyetje cilësinë e shërbimeve të kompetencave të bartura dhe servisimin e rregullt të detyrimeve. Për këto arsye, është e nevojshme të ridefinohet mënyra dhe të përcaktohen kriteret për bllok-dotacionet për komunat me formulë të qartë, transparente, efikase dhe funksionale që do të përfshijë të gjitha llojet e shpenzimeve me vlera dhe madhësi reale, me qëllim që të vendoset sistemi optimal, ekonomik dhe efikas për financimin e kompetencave të bartura të komunave.

## Ligji për tatime mbi pronë

Revizioni e thekson pasigurinë në pjesën e zbatimit të nenit 39 të Ligjit për tatime mbi pronë që nga miratimi i tij në vitin 2004, në pjesën e obligimit për harmonizimin e regjistrit të pronës së paluajtshme të mbajtur nga komunat, komunat në Qytetin e Shkupit dhe Qyteti i Shkupit me regjistrin që mbahet nga Agjencia e Kadastrës së Patundshmërive, ndërsa më së voni deri më 31 dhjetor të vitit, të dhënat nga gjendja e regjistrave duhet të dorëzohen në Regjistrin Qendror dhe në Drejtorinë e të Ardhurave Publike. Për zbatimin e kësaj zgjidhjeje ligjore nevojiten saktësime shtesë të përcaktuara në Ligj, si dhe lidhje softuerike të organeve kompetente.

Në Ligjin për tatime mbi pronë janë përcaktuar kompetencat e DAP-së për ushtrimin e mbikëqyrjes mbi punën e organeve të komunës, organeve të komunave në Qytetin e Shkupit dhe organeve të Qytetit të Shkupit, por pa përcaktuar qartë mënyrën në të cilën DAP-ja do t'i zbatojë aktivitetet në lidhje me kompetencat e marra nga komunat. Gjithashtu, nuk është paraparë rregullimi shtesë i Ligjit përmes miratimit të aktit nënligjor për të.

## Ligji për zjarrfikje

Në përputhje me nenin 49 për financimin e aktiviteteve të Njësive Territoriale kundër Zjarrit, Qyteti i Shkupit dhe komunat kanë mundësi të realizojnë të ardhura shtesë nga dënimet monetare të arkëtuara për kundërvajtjet e kryera në fushën e mbrojtjes nga zjarret dhe shpërthimet, kontributet vullnetare dhe mjetet tjera nga shoqëritë e sigurimit, fondacionet, personat juridikë dhe fizikë të dedikuar për avancimin e mbrojtjes dhe të ardhurave nga burimet personale për shërbimet e kryera. Qyteti i Shkupit dhe komunat nuk realizojnë të ardhura nga këto baza, përveç të ardhurave nga shoqëritë e sigurimit në shumë prej 2% të premive të arkëtuara për sigurimin e mjeteve motorike dhe sigurimin e përgjegjësisë nga përdorimi i mjeteve motorike për të cilat nuk kanë njohuri për lartësinë e mjeteve që duhet të paguhen dhe as nuk ka obligim ligjor për t'u siguruar për plotësinë dhe saktësinë e mjeteve të paguara.

## ▲ Ligji për veprim me objekte të ndërtuara pa leje

Pas dhënies së pëlqimit urbanistik, njësia e vetëqeverisjes lokale ka për detyrë që në afat prej pesë ditë pune të hartojë konkluzion për pagesën e kompensimit për përcaktimin e statusit juridik të objektit pa leje, ndërsa detyrimi për pagesën e kompensimit bëhet në afat prej dhjetë ditë pune nga dita e marrjes së konkluzionit ose të anuluar në dymbëdhjetë këste mujore, duke lidhur kontratë për pagesë të anuluar. Në zgjidhjen ligjore ekzistuese nuk përcaktohet afati i ngritjes së konkluzionit pas hartimit të tij dhe ndjekjes së afatit për arkëtimin e tij, gjë që ndikon në arkëtimin e kompensimit për përcaktimin e statusit juridik të objekteve të ndërtuara pa leje, e cila paraqet të ardhura të komunës.

MJEDISI
JETËSOR

## ▲ Ligji për ujërat

Në nenin 214 të Ligjit për ujëra parashikohet llogaritja e vlerës variabile të kompensimit për shkarkimin në ujëra, e cila duhet të përcaktohet në lejen e shkarkimit në ujëra në bazë të "njësisë së dëmit", ndërsa llogaritet nga personi që shkarkon ujëra të zeza të patrajtuara në recipient. Qeveria, me propozimin e ministrit të Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor, duhet të përcaktojë mënyrën e llogaritjes së "njësisë së dëmit" në përputhje me sasinë e ujit të shkarkuar, i cili shkarkohet në ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore, si dhe mënyrën e pagesës së vlerës variabile të kompensimit për shkarkimin në ujëra. Duke pasur parasysh se nuk është miratuar akti nënligjor në fjalë, në lejet e shkarkimit në ujëra nuk është caktuar vlera variabile e kompensimit dhe ajo nuk llogaritet dhe arkëtohet. Për këto arsye, e theksojmë nevojën e propozimit dhe miratimit të aktit nënligjor për rregullimin e mënyrës së llogaritjes së vlerës variabile të kompensimit për shkarkimin në ujëra, duke krijuar kushte për zbatimin e tij përmes përfshirjes në lejet dhe arkëtimin e tij.

SHOQËRITË
TREGTARE

## ▲ Ligji për të punësuarit në sektorin publik

Me nenin 2 të Ligjit për të punësuarit në sektorin publik theksohen institucionet që përfshihen në grupin e punëdhënësve në sektorët publikë dhe përcakton se çfarë nënkuptohet me të punësuarit në sektorin publik, me ç'rast dispozita nuk u referohet të punësuarve në shoqëritë tregtare të themeluara nga Qeveria.

### ▲ Ligji për shoqëritë tregtare

Të drejtat dhe detyrimet e Anëtarit Ekzekutiv të Këshillit të Drejtorëve rregullohen në nenin 350, 365 dhe 366 të LSHT-së, nenin 54 dhe 55 të Ligjit për marrëdhënie pune, për të cilat është lidhur kontrata menaxheriale për rregullimin e marrëdhënieve ndërmjet shoqërisë tregtare dhe Anëtarit Ekzekutiv.

Shpërblimi i drejtorit ekzekutiv është i rregulluar në nenin 365 paragrafi 2 të LSHT-së në përputhje me të cilin Anëtarët Ekzekutivë kanë të drejtën e rrogës, përkatësisht kompensimit mujor, të drejtën e sigurimit të jetës dhe llojit tjetër të sigurimit, kompensimit të shpenzimeve të udhëtimit dhe shpenzimeve të tjera dhe të drejta të tjera.

Paragrafi 3 i nenit 365 e parashikon edhe këtë: "Për punën e Anëtarëve Ekzekutivë të Këshillit të Drejtorëve, anëtarëve të Këshillit Drejtues, përkatësisht drejtorit, Kuvendi mund me vendim t'u miratojë edhe pjesëmarrjen në fitim. Pjesëmarrja, si rregull, konsiston në pjesëmarrjen me një pjesë të fitimit vjetor të shoqërisë (pagesa në para, aksione, bonuse ose mënyrë tjetër)." Mënyra e lartpërmendur e përcaktimit të rrogës, përkatësisht pjesëmarrja në ndarjen e fitimit të Anëtarëve Ekzekutivë në SHA, të cilët janë në pronësi të plotë të shtetit, pa kritere të veçanta të përcaktuara, lë hapësirë për caktimin dhe veprimin subjektiv të tyre, prandaj theksojmë nevojën e rishqyrtimit të nenit 365 të LSHT-së dhe kufizimin e zbatimit të tij në shoqëritë në pronësi shtetërore.

## PUNË DHE POLITIKË SOCIALE

### ▲ Ligji për kontributet për sigurimin e detyrueshëm social

Sistemi i përcaktimit, kontrollit dhe arkëtimit të kontributit nuk bazohet në integrimin dhe shkëmbimin e përditësuar dhe të plotë të të dhënave ndërmjet Drejtorisë së të Ardhurave Publike dhe institucioneve në sistemin e sigurimit të detyrueshëm social, FSPIRM, FSSHM dhe APRMV siç parashikohet nga nenet 21 dhe 23 të ligjit. Drejtoria e të Ardhurave Publike ka për detyrë t'i dorëzojë informacionet e parapara me ligj në institucionet me kontratën e lidhur në mënyrë të ndërsjellë, por DAP-ja dorëzon informacione vetëm për kontributet e arkëtuara dhe për lartësinë e kontributit të papaguar nga obligacionet që kanë dorëzuar përllogaritje dhe kanë për detyrë ta paguajnë, por jo edhe për detyrimin e llogaritur për të paguar të gjitha obligacionet siç parashikohet në përputhje me këtë ligj.

### ▲ Ligji për sigurimin pensional dhe invalidor

Zgjidhjet ligjore nga neni 130 paragrafi 6 nuk e rregullojnë pezullimin e marrëdhënies së punës në kushtet kur jepet pensioni i përkohshëm invalidor, prandaj personat e siguruar të cilëve u ndërpritet pensioni i përkohshëm mbeten të pambrojtur në aspektin e të drejtave dhe detyrimeve të marrëdhënies së punës. Fondi në disa raste ka parashtruar iniciativa për ndryshimet në Ligjin për SPI në drejtim të ndryshimit të dispozitave ligjore që rregullojnë të drejtën e pensionit të përkohshëm.

## Ligji për punësimin dhe sigurimin në rast të papunësisë (LPSRP)

Kemi konstatuar parregullsi në ligj dhe në ligje të tjera, si në vijim:

- me nenin 67 të LPSRP-së rregullohen kushtet në të cilat personat e papunë nuk mund të marrin kompensim monetar (KM) në bazë të ndërprerjes së marrëdhënies së punës, të cilat nuk janë plotësisht në harmonizim me Ligjin për marrëdhënie pune në pjesën e anulimit të kontratës së punësimit;
- me nenin 68 të LPSRP-së nuk është rregulluar saktësisht mënyra e llogaritjes së lartësisë së KM-së gjatë punës me orar pune jo të plotë të llogaritur në orar pune të plotë, e cila si e drejtë parashikohet nga neni 66 alineja 2 të të njëjtit ligj, që kontribuon për mënyrë të ndryshme të veprimit;
- me nenin 77 të LPSRP-së rregullohet aplikimi i ndërprerjes së të drejtës së kompensimit monetar ndaj personit të papunë nëse dërgohet nga Agjencia për themelimin e marrëdhënies së punës, por nuk saktësohet në mënyrë plotësuese kushti nëse personi:
    - "refuzon të paraqitet te punëdhënësi" i cili është caktuar në vendin e punës me përgatitje të duhur profesionale ose ka deklaruar se pranon punësim edhe në shkallë më të ulët të përgatitjes profesionale;
    - "refuzon të themelojë marrëdhënie pune te punëdhënësi" për të cilën punëdhënësi pajtohet dhe i plotëson kushtet e punësimit, por edhe nëse kushtet e punësimit janë të përshtatshme për personin e papunë;
    - angazhohet për kryerjen e punëve me kontratë në vepër dhe përcaktohet statusi i tyre;
- me ligjin material nuk rregullohet saktësisht nëse bujqit individualë dhe kategoritë e tjera të personave kanë të drejtë të KM-së të cilët nuk janë tatimpagues për pagesën e kontributeve për sigurimin e detyrueshëm në rast të papunësisë, ndërsa në përputhje me Ligjin për kontributet nga sigurimi i detyrueshëm social janë tatimpagues për kontributet për SPI dhe SSH.
- ligji nuk përmban dispozita me të cilat do të rregullohen të drejtat e Agjencisë për të kërkuar kthimin e mjeteve monetare (si dhe përcaktimin e afatit për kthimin e mjeteve në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë së Veriut / nënllogarinë e Agjencisë.

ARSIMI

## Ligji për arsim të lartë

Me dispozitat e Ligjit (neni 97 paragrafi 14) nuk rregullohet marrëdhënia e punës e rektorit dhe vëllimi i angazhimit të tij nëse zgjidhet nga radhët e profesorëve të Fakultetit të Mjekësisë dhe Stomatologjisë Shkup, të cilët në përputhje me Ligjin për mbrojtje shëndetësore, në të njëjtën kohë kanë themeluar marrëdhënie të dyfishtë të punës me fakultetin dhe klinikën. Pra, me këtë dispozitë nuk është marrë parasysh neni 174 paragrafët 3, 4, 5 dhe 6 të Ligjit për mbrojtje shëndetësore, ku është paraparë që veprimtaria e arsimit të lartë, veprimtaria hulumtuese shkencore dhe veprimtaria shëndetësore të kryhet si tërësi funksionale e pandashme e cila rregullohet me kontratë ndërmjet institucionit të arsimit të lartë publik dhe institucionit shëndetësor publik [19] .

Me Ligjin nuk rregullohet kompetenca për miratimin e aktit për përcaktimin e së drejtës dhe lartësisë së kompensimit - shtesës funksionale për ushtrimin e funksionit udhëheqës. Pra, pagesa e shtesës funksionale të rrogës, përkatësisht shtesës së rrogës themelore neto për ushtrimin e funksionit udhëheqës, që kryhet në bazë të nenit 75 të Marrëveshjes Kolektive për Arsimin e Lartë, parashikon që përcaktimi i së drejtës dhe lartësisë së kompensimit kryhet me akt të përgjithshëm të institucionit. Në kushtet kur me Marrëveshje Kolektive dhe as me ligj nuk rregullohet se kush do ta miratojë aktin për përcaktimin e së drejtës dhe lartësisë së kompensimit, është e nevojshme në Ligjin për arsim të lartë të rregullohet kompetenca për miratimin e aktit në fjalë dhe të caktohet trupi që do të përcaktojë lartësinë e kompensimit - shtesës funksionale për ushtrimin e funksionit udhëheqës.

MBROJTJA SHËNDETËSORE

## Ligji për mbrojtje shëndetësore

Është e nevojshme që Ministria e Shëndetësisë të ndërmarrë aktivitete për përcaktimin dhe vendosjen e listës afatgjate të pritjes, përkatësisht sigurimin e ndjekjes sistematike të nevojës reale për shërbimet shëndetësore diagnostikuese, përcaktimin e afatit për dhënien e rezultateve të incizimeve të kryera, si dhe përcaktimin e udhëzimeve profesionale për kryerjen e diagnostikimit radiologjik me rezonancë magnetike.

Gjithashtu, është i nevojshëm miratimi i aktit nënligjor të paraparë për certifikimin e softuerëve të përdorur nga institucionet shëndetësore për lidhje dhe integrim me sistemin Termini Im.

Miratimi i aktit të caktuar në përputhje me nenin 221 për përcaktimin e llojeve të shpenzimeve që mund të përfshihen në kompensimin e përcaktuar me kontratë për kryerjen e pandërprerë të veprimtarisë shëndetësore dhe rregullimin e mënyrës së përllogaritjes së barazuar të lartësisë së kompensimeve për punëtorët shëndetësorë të angazhuar me kontratë.

[19] Kontrata ndërmjet ISHP Klinikës Universitare të Kirurgjisë Digjestive dhe Fakultetit të Mjekësisë 794/1 nga 21.04.2009.

# 7

# RAPORTI FINANCIAR I ESHR-së DHE RAPORTI I REVIZORIT TË PAVARUR

**РСМ МАКЕДОНИЈА ДООЕЛ Скопје**
Даме Груев 8, 1000 Скопје, Р. Северна Македонија
T+389 (0)2 3233 301
E contact@rsm.mk
www.rsm.mk


## ИЗВЕШТАЈ НА НЕЗАВИСНИОТ РЕВИЗОР

**До Собранието на Република Северна Македонија**

### Извештај за финансиските извештаи

Ние извршивме ревизија на приложените финансиски извештаи на Државниот завод за ревизија - Сметка на основен буџет на Република Северна Македонија 020021504063710, а коишто го вклучуваат билансот на приходите и расходите за годината којашто завршува на 31 декември 2023, како и билансот на состојба заклучно со таа дата, и прегледот на значајните сметководствени политики и други објаснувачки белешки.

*Одговорност на раководството за финансиските извештаи*

Раководството е одговорно за подготвувањето и објективното презентирање на овие финансиски извештаи во согласност со Законот за сметководството на буџетите и буџетските корисници, Правилникот за сметководството на буџетите и буџетските корисници и Правилникот за примена на Меѓународните сметководствени стандарди за јавниот сектор на готовинска основа, и интерната контрола којашто е релевантна за подготвувањето и објективното презентирање на финансиски извештаи кои што се ослободени од материјално погрешно прикажување, без разлика дали е резултат на измама или грешка.

*Одговорност на ревизорот*

Наша одговорност е да изразиме мислење за овие финансиски извештаи врз основа на нашата ревизија. Ние ја спроведовме нашата ревизија во согласност со стандардите за ревизија кои што се во примена во Република Северна Македонија. Тие стандарди бараат да ги почитуваме етичките барања и да ја планираме и извршиме ревизијата за да добиеме разумно уверување за тоа дали финансиските извештаи се ослободени од материјално погрешно прикажување.

THE POWER OF BEING UNDERSTOOD

AUDIT | TAX | CONSULTING


РСМ МАКЕДОНИЈА ДООЕЛ Скопје е член на РСМ мрежата и тргува како РСМ. РСМ е трговското име кое се користи од страна на членките на РСМ мрежата. Секој член на мрежата РСМ е независно друштво кое работи со засебни доделени права и обврски. Мрежата РСМ самата не е посебно правно лице во [illegible]

РСМ МАКЕДОНИЈА ДООЕЛ Скопје
Даме Груев 8, 1000 Скопје, Р. Северна Македонија
T +389 (0)2 3233 301
E contact@rsm.mk
www.rsm.mk

Ревизијата вклучува извршување на постапки за прибавување на ревизорски докази за износите и обелоденувањата во финансиските извештаи. Избраните постапки зависат од расудувањето на ревизорот, вклучувајќи ја и проценката на ризиците од материјално погрешно прикажување на финансиските извештаи, без разлика дали е резултат на измама или грешка. Кога ги прави тие проценки на ризикот, ревизорот ја разгледува интерната контрола релевантна за подготвувањето и објективното презентирање на финансиските извештаи на ентитетот за да обликува ревизорски постапки коишто се соодветни во околностите, но не за целта на изразување на мислење за ефективноста на интерната контрола на ентитетот. Ревизијата исто така вклучува и оценка на соодветноста на користените сметководствени политики и на разумноста на сметководствените проценки направени од страна на раководството, како и оценка на севкупното презентирање на финансиските извештаи.

Ние веруваме дека ревизорските докази коишто ги имаме прибавено се достатни и соодветни за да обезбедат основа за нашето ревизорско мислење.

*Мислење*

Според нашето мислење, финансиските извештаи ја презентираат објективно, од сите материјални аспекти, финансиската состојба на Државниот завод за ревизија - Сметка на основен буџет на Република Северна Македонија 020021504063710 заклучно со 31 декември 2023 година, како и неговите приходи и расходи за годината којашто завршува тогаш во согласност со Законот за сметководството на буџетите и буџетските корисници, Правилникот за сметководството на буџетите и буџетските корисници и Правилникот за примена на Меѓународните сметководствени стандарди за јавниот сектор на готовинска основа.

THE POWER OF BEING UNDERSTOOD
AUDIT | TAX | CONSULTING

РСМ МАКЕДОНИЈА ДООЕЛ Скопје е членка на РСМ мрежата и тргува како РСМ. РСМ е трговското име кое се користи од страна на членките на РСМ мрежата. Секој член на мрежата РСМ е независно друштво кое работи согласно своите државни и правни обврски. Мрежата РСМ сама по себе не е посебно правно лице во ниедна јурисдикција.

**РСМ МАКЕДОНИЈА ДООЕЛ Скопје**
Даме Груев 8, 1000 Скопје, Р. Северна Македонија
T +389 (0)2 3233 301
E contact@rsm.mk
www.rsm.mk

## Извештај за други правни и регулативни барања

Во согласност со Законот за државна ревизија, Државниот завод за ревизија има обврска да изготвува годишен извештај за извршените ревизии и за работата на Државниот завод за ревизија.

Наша одговорност во согласност со Законот за ревизија е да изразиме мислење во врска со конзистентноста на годишниот извештај за работа со годишната сметка и финансиските извештаи за истата година.

*Мислење*

Според наше мислење, податоците во годишниот извештај се конзистентни со оние во годишната сметка и финансиските извештаи на Државниот завод за ревизија за 2023 година.

*Скопје, 03.06.2024*

| Овластен ревизор | Друштво за ревизија<br>РСМ МАКЕДОНИЈА ДООЕЛ Скопје |
|---|---|
| Љубица Евтимовска Костовска | Јаглика Јорданова Андријеска |

Друштво за ревизија РСМ МАКЕДОНИЈА ДООЕЛ Скопје

THE POWER OF BEING UNDERSTOOD
AUDIT | TAX | CONSULTING

РСМ МАКЕДОНИЈА ДООЕЛ Скопје е член на РСМ мрежата и тргува како РСМ. РСМ е трговското име кое се користи од страна на членките на РСМ мрежата. Секој член на мрежата РСМ е независно друштво кое работи согласно своите доделени права и обврски. Мрежата РСМ сама по себе не е посебно правно лице во никоја јурисдикција.

## БИЛАНС НА ПРИХОДИ И РАСХОДИ

во денари

| Опис на позицијата | Образложение | Буџет 2023 | Реализирано 2023 | Реализирано 2022 |
|---|---|---|---|---|
| **Приходи** | | | | |
| Трансфери и донации | 3.1. | 148.530.000 | 145.204.883 | 133.663.705 |
| **Вкупно приходи** | | **148.530.000** | **145.204.883** | **133.663.705** |
| **Расходи** | | | | |
| **Тековни расходи** | 3.2. | | | |
| Плати, наемнини и надоместоци | 3.2.1. | 118.700.000 | 116.449.165 | 100.721.812 |
| Стоки и услуги | 3.2.2. | 21.880.000 | 21.259.202 | 23.526.749 |
| Разни трансфери | 3.2.3. | 700.000 | 522.911 | 1.303.105 |
| **Вкупно тековни расходи** | | **141.280.000** | **138.231.278** | **125.551.666** |
| **Капитални расходи** | 3.3. | | | |
| Капитални расходи | | 7.250.000 | 6.973.605 | 8.112.039 |
| **Вкупно капитални расходи** | | **7.250.000** | **6.973.605** | **8.112.039** |
| **Вкупно расходи** | | **148.530.000** | **145.204.883** | **133.663.705** |
| **Нето вишок на приходи - добивка по оданочување** | | - | - | - |

Скопје, 21.02.2024

Раководител на сектор за финансиски прашања
Данче Ангеловска

Главен државен ревизор
Максим Ацевски

## БИЛАНС НА СОСТОЈБА

| Опис на позицијата | Образло-жение | 2023 | 2022 |
|---|---|---|---|
| | | | во денари |
| **Актива** | | | |
| **Тековни средства** | **4.1.** | | |
| Побарувања од купувачи | 4.1.1. | - | 218.497 |
| Побарувања од вработените | 4.1.2. | 202.994 | 223.301 |
| Активни временски разграничувања | 4.1.3. | 16.057.413 | 14.219.873 |
| Залихи | 4.1.4. | 1.772.431 | 1.694.777 |
| **Вкупно тековни средства** | | **18.032.838** | **16.356.448** |
| **Постојани средства** | **4.2.** | | |
| Нематеријални средства | 4.2.1. | 8.312.459 | 9.054.927 |
| Материјални средства | 4.2.2. | 432.251.403 | 440.110.900 |
| **Вкупно постојани средства** | | **440.563.862** | **449.165.827** |
| **Вкупна актива** | | **458.596.700** | **465.522.275** |
| **Вонбилансна актива** | | - | - |
| **Пасива** | | | |
| **Тековни обврски** | **4.3.** | | |
| Краткорочни обврски спрема добавувачи | 4.3.1. | 2.494.097 | 1.301.645 |
| Краткорочни обврски за плати и други обврски спрема вработените | 4.3.2. | 11.067.646 | 9.054.967 |
| Пасивни временски разграничувања | 4.3.3. | 202.994 | 441.798 |
| **Вкупно тековни обврски** | | **13.764.737** | **10.798.410** |
| **Долгорочни обврски** | **4.4.** | **2.495.670** | **3.863.261** |
| **Извори на средства** | **4.5.** | | |
| Извори на капитални средства | | 367.583.294 | 376.107.605 |
| Ревалоризациона резерва | | 74.752.999 | 74.752.999 |
| **Вкупно извори на деловни средства** | | **442.336.293** | **450.860.604** |
| **Вкупна пасива** | | **458.596.700** | **465.522.275** |
| **Вонбилансна пасива** | | - | - |

Скопје, 21.02.2024

Раководител на сектор за финансиски прашања
Данче Ангеловска

Републиka Северна Македонија • ДРЖАВЕН ЗАВОД ЗА РЕВИЗИЈА • Скопје • ENTI SHTETËROR I REVIZIONIT • Shkup • Republika e Maqedonisë së Veriut

Главен државен ревизор
Максим Ацевски

## ПРЕГЛЕД НА ПРОМЕНИ НА ИЗВОРИ НА СРЕДСТВА

| | | | во денари |
|---|---|---|---|
| О П И С | Државен јавен капитал | Останат капитал (залихи на материјали, резервни делови и ситен инвентар и хартии од вредност) | Вкупно |
| **Состојба 01.01.2023 година** | **449.165.827** | **1.694.777** | **450.860.604** |
| **Зголемување по основ на:** | **9.335.681** | **1.465.961** | **10.801.642** |
| Зголемување на вредноста (капитализација) | 9.335.681 | 1.465.961 | 10.801.642 |
| По попис 2023 | | | - |
| Ревалоризација | | | - |
| **Намалување по основ на:** | **17.937.647** | **1.388.306** | **19.325.953** |
| Амортизација | 17.879.671 | | 17.879.671 |
| Издатници | | 1.386.182 | 1.386.182 |
| По попис 2023 | 57.976 | 2.124 | 60.100 |
| Ревалоризација | | | - |
| **Состојба 31.12.2023 година** | **440.563.861** | **1.772.432** | **442.336.293** |

RSM

**РСМ МАКЕДОНИЈА ДООЕЛ Скопје**
Даме Груев 8, 1000 Скопје, Р. Северна Македонија
T +389 (0)2 3233 301
E contact@rsm.mk
www.rsm.mk

## ИЗВЕШТАЈ НА НЕЗАВИСНИОТ РЕВИЗОР

**До Собранието на Република Северна Македонија**

### Извештај за финансиските извештаи

Ние извршивме ревизија на приложените финансиски извештаи на Државниот завод за ревизија - Сметка на основен буџет на Република Северна Македонија 020021504063119, а коишто го вклучуваат билансот на приходите и расходите за годината којашто завршува на 31 декември 2023, како и билансот на состојба заклучно со таа дата, и прегледот на значајните сметководствени политики и други објаснувачки белешки.

*Одговорност на раководството за финансиските извештаи*

Раководството е одговорно за подготвувањето и објективното презентирање на овие финансиски извештаи во согласност со Законот за сметководството на буџетите и буџетските корисници, Правилникот за сметководството на буџетите и буџетските корисници и Правилникот за примена на Меѓународните сметководствени стандарди за јавниот сектор на готовинска основа, и интерната контрола којашто е релевантна за подготвувањето и објективното презентирање на финансиски извештаи кои што се ослободени од материјално погрешно прикажување, без разлика дали е резултат на измама или грешка.

*Одговорност на ревизорот*

Наша одговорност е да изразиме мислење за овие финансиски извештаи врз основа на нашата ревизија. Ние ја спроведовме нашата ревизија во согласност со стандардите за ревизија кои што се во примена во Република Северна Македонија. Тие стандарди бараат да ги почитуваме етичките барања и да ја планираме и извршиме ревизијата за да добиеме разумно уверување за тоа дали финансиските извештаи се ослободени од материјално погрешно прикажување.

THE POWER OF BEING UNDERSTOOD
AUDIT | TAX | CONSULTING

РСМ МАКЕДОНИЈА ДООЕЛ Скопје е член на РСМ мрежата и тргува како РСМ. РСМ е трговското име кое се користи од страна на членките на РСМ мрежата. Секој член на мрежата РСМ е независно друштво кое работи согласно своите доделени права и обврски. Мрежата РСМ самата не е посебно правно лице во ниедна јурисдикција.

**РСМ МАКЕДОНИЈА ДООЕЛ Скопје**
Даме Груев 8, 1000 Скопје, Р. Северна Македонија
Т+389 (0)2 3233 301
E contact@rsm.mk
www.rsm.mk

Ревизијата вклучува извршување на постапки за прибавување на ревизорски докази за износите и обелоденувањата во финансиските извештаи. Избраните постапки зависат од расудувањето на ревизорот, вклучувајќи ја и проценката на ризиците од материјално погрешно прикажување на финансиските извештаи, без разлика дали е резултат на измама или грешка. Кога ги прави тие проценки на ризикот, ревизорот ја разгледува интерната контрола релевантна за подготвувањето и објективното презентирање на финансиските извештаи на ентитетот за да обликува ревизорски постапки коишто се соодветни во околностите, но не за целта на изразување на мислење за ефективноста на интерната контрола на ентитетот. Ревизијата исто така вклучува и оценка на соодветноста на користените сметководствени политики и на разумноста на сметководствените проценки направени од страна на раководството, како и оценка на севкупното презентирање на финансиските извештаи.

Ние веруваме дека ревизорските докази коишто ги имаме прибавено се достатни и соодветни за да обезбедат основа за нашето ревизорско мислење.

*Мислење*

Според нашето мислење, финансиските извештаи ја презентираат објективно, од сите материјални аспекти, финансиската состојба на Државниот завод за ревизија – Сметка на основен буџет на Република Северна Македонија 020021504063119 заклучно со 31 декември 2023 година, како и неговите приходи и расходи за годината којашто завршува тогаш во согласност со Законот за сметководството на буџетите и буџетските корисници, Правилникот за сметководството на буџетите и буџетските корисници и Правилникот за примена на Меѓународните сметководствени стандарди за јавниот сектор на готовинска основа.

THE POWER OF BEING UNDERSTOOD
AUDIT | TAX | CONSULTING

РСМ МАКЕДОНИЈА ДООЕЛ Скопје е член на РСМ мрежата и тргува како РСМ. РСМ е трговското име кое се користи од страна на членовите на РСМ мрежата. Секој член на мрежата РСМ е независно друштво кое работи согласно своите дозволени права и обврски. Мрежата РСМ самата не е посебно правно лице во ниедна јурисдикција.

**РСМ МАКЕДОНИЈА ДООЕЛ Скопје**
Даме Груев 8, 1000 Скопје, Р. Северна Македонија
Т+389 (0)2 3233 301
**E** contact@rsm.mk
www.rsm.mk

## Извештај за други правни и регулативни барања

Во согласност со Законот за државна ревизија, Државниот завод за ревизија има обврска да изготвува годишен извештај за извршените ревизии и за работата на Државниот завод за ревизија.

Наша одговорност во согласност со Законот за ревизија е да изразиме мислење во врска со конзистентноста на годишниот извештај за работа со годишната сметка и финансиските извештаи за истата година.

*Мислење*

Според наше мислење, податоците во годишниот извештај се конзистентни со оние во годишната сметка и финансиските извештаи на Државниот завод за ревизија за 2023 година.

*Скопје, 03.06.2024*

Овластен ревизор
Љубица Евтимовска Костовска

Друштво за ревизија
РСМ МАКЕДОНИЈА ДООЕЛ Скопје
Јаглика Јорданова Андријеска

Друштво за ревизија РСМ МАКЕДОНИЈА ДООЕЛ Скопје

THE POWER OF BEING UNDERSTOOD
AUDIT | TAX | CONSULTING

РСМ МАКЕДОНИЈА ДООЕЛ Скопје е член на РСМ мрежата и тргува како РСМ. РСМ е трговското име кое се користи од страна на членките на РСМ мрежата. Секој член на мрежата РСМ е независно друштво кое работи согласно своите доделени права и обврски. Мрежата РСМ самата не е посебно правно лице во ниедна јурисдикција.

## БИЛАНС НА ПРИХОДИ И РАСХОДИ

*во денари*

| Опис на позицијата | Образло жение | Буџет 2023 | Реализирано 2023 | Реализирано 2022 |
|---|---|---|---|---|
| **Приходи** | 3.1. | | | |
| Трансфери и донации | 3.1.1. | 3.000.000 | 374.733 | 2.494.120 |
| **Вкупно приходи** | | **3.000.000** | **374.733** | **2.494.120** |
| **Расходи** | 3.2. | | | |
| **Тековни расходи** | | | | |
| Стоки и услуги | 3.2.1. | | - | 84.316 |
| **Вкупно тековни расходи** | | - | - | **84.316** |
| **Капитални расходи** | | | | |
| Капитални расходи | 3.2.2. | 3.000.000 | - | 2.039.966 |
| **Вкупно капитални расходи** | | **3.000.000** | - | **2.039.966** |
| **Вкупно расходи** | | **3.000.000** | - | **2.124.282** |
| **Остварен вишок на приходи** | | - | **374.733** | **369.838** |
| **Даноци, придонеси и други давачки од вишокот на приходи** | | | | |
| **Нето вишок на приходи** | | - | **374.733** | **369.838** |
| **Распоредување на вишокот на приходи** | | | | |
| Дел од нето вишокот на приходи за пренос во наредна година | | - | 374.733 | 369.838 |
| Обврски за данок на добивка | | | - | - |
| **Вкупно распоред на вишок на приходи** | | - | **374.733** | **369.838** |

Скопје, 21.02.2024

Раководител на сектор за финансиски прашања
Данче Ангеловска

Главен државен ревизор
Максим Ацевски

## БИЛАНС НА СОСТОЈБА

*во денари*

| Опис на позицијата | Образложение | 2023 | 2022 |
|---|---|---|---|
| **Актива** | | | |
| **Тековни средства** | **4.1.** | | |
| Парични средства | 4.1.1. | 374.733 | 369.838 |
| Побарувања од купувачите во земјата | 4.1.2. | 8.930.068 | 9.341.850 |
| Побарувања од вработените | 4.1.3. | - | - |
| Активни временски разграничувања | 4.1.4. | - | - |
| **Вкупно тековни средства** | | **9.304.801** | **9.711.688** |
| **Постојани средства** | **4.2.** | | |
| Нематеријални средства | 4.2.1. | - | - |
| Материјални средства | 4.2.2. | - | - |
| **Вкупно постојани средства** | | **-** | **-** |
| **Вкупна актива** | | **9.304.801** | **9.711.688** |
| **Вонбилансна евиденција - актива** | | **-** | **-** |
| **Пасива** | | | |
| **Тековни обврски** | **4.3.** | | |
| Краткорочни обврски спрема добавувачи | 4.3.1. | - | - |
| Пасивни временски разграничувања | 4.3.2. | 9.304.801 | 9.711.688 |
| **Вкупно тековни обврски** | | **9.304.801** | **9.711.688** |
| **Извори на средства** | **4.4.** | | |
| Извори на капитални средства | | - | - |
| Ревалоризациона резерва | | - | - |
| **Вкупно извори на деловни средства** | | **-** | **-** |
| **Вкупна пасива** | | **9.304.801** | **9.711.688** |
| **Вонбилансна евиденција - пасива** | | **-** | **-** |

Скопје, 21.02.2024

Раководител на сектор за финансиски прашања
Данче Ангеловска

Главен државен ревизор
Максим Ацевски

- 7 -

RSM

РСМ МАКЕДОНИЈА ДООЕЛ Скопје
Даме Груев 8, 1000 Скопје, Р. Северна Македонија
T+389 (0)2 3233 301
E contact@rsm.mk
www.rsm.mk

# ИЗВЕШТАЈ НА НЕЗАВИСНИОТ РЕВИЗОР

**До Собранието на Република Северна Македонија**

## Извештај за финансиските извештаи

Ние извршивме ревизија на приложените финансиски извештаи на Државниот завод за ревизија - Сметка на буџет на донации 020021504078550 Проект од General Court of Audit – Saudi FISP, а коишто го вклучуваат билансот на приходите и расходите за годината којашто завршува на 31 декември 2023, како и билансот на состојба заклучно со таа дата, и прегледот на значајните сметководствени политики и други објаснувачки белешки.

### *Одговорност на раководството за финансиските извештаи*

Раководството е одговорно за подготвувањето и објективното презентирање на овие финансиски извештаи во согласност со Законот за сметководството на буџетите и буџетските корисници, Правилникот за сметководството на буџетите и буџетските корисници и Правилникот за примена на Меѓународните сметководствени стандарди за јавниот сектор на готовинска основа, и интерната контрола којашто е релевантна за подготвувањето и објективното презентирање на финансиски извештаи кои што се ослободени од материјално погрешно прикажување, без разлика дали е резултат на измама или грешка.

### *Одговорност на ревизорот*

Наша одговорност е да изразиме мислење за овие финансиски извештаи врз основа на нашата ревизија. Ние ја спроведовме нашата ревизија во согласност со стандардите за ревизија кои што се во примена во Република Северна Македонија. Тие стандарди бараат да ги почитуваме етичките барања и да ја планираме и извршиме ревизијата за да добиеме разумно уверување за тоа дали финансиските извештаи се ослободени од материјално погрешно прикажување.

Ревизијата вклучува извршување на постапки за прибавување на ревизорски докази за износите и обелоденувањата во финансиските извештаи. Избраните постапки зависат од расудувањето на ревизорот, вклучувајќи ја и проценката на ризиците од материјално погрешно прикажување на финансиските извештаи, без разлика дали е резултат на измама

THE POWER OF BEING UNDERSTOOD
AUDIT | TAX | CONSULTING

РСМ МАКЕДОНИЈА ДООЕЛ Скопје е член на РСМ мрежата и тргува како РСМ. РСМ е трговското име кое се користи од страна на членките на РСМ мрежата. Секој член на мрежата РСМ е независно друштво кое работи согласно своите додолнителни права и обврски. Мрежата РСМ сама по себе не е посебно правно лице во ниедна јурисдикција.

RSM

**РСМ МАКЕДОНИЈА ДООЕЛ Скопје**

Даме Груев 8, 1000 Скопје, Р. Северна Македонија
T +389 (0)2 3233 301
E contact@rsm.mk
www.rsm.mk

или грешка. Кога ги прави тие проценки на ризикот, ревизорот ја разгледува интерната контрола релевантна за подготвувањето и објективното презентирање на финансиските извештаи на ентитетот за да обликува ревизорски постапки коишто се соодветни во околностите, но не за целта на изразување на мислење за ефективноста на интерната контрола на ентитетот. Ревизијата исто така вклучува и оценка на соодветноста на користените сметководствени политики и на разумноста на сметководствените проценки направени од страна на раководството, како и оценка на севкупното презентирање на финансиските извештаи.

Ние веруваме дека ревизорските докази коишто ги имаме прибавено се достатни и соодветни за да обезбедат основа за нашето ревизорско мислење.

*Мислење*

Според нашето мислење, финансиските извештаи ја презентираат објективно, од сите материјални аспекти, финансиската состојба на Државниот завод за ревизија - Сметка на буџет на донации 020021504078550 Проект од General Court of Audit – Saudi FISP заклучно со 31 декември 2023 година, како и неговите приходи и расходи за годината којашто завршува тогаш во согласност со Законот за сметководството на буџетите и буџетските корисници, Правилникот за сметководството на буџетите и буџетските корисници и Правилникот за примена на Меѓународните сметководствени стандарди за јавниот сектор на готовинска основа.

THE POWER OF BEING UNDERSTOOD
AUDIT | TAX | CONSULTING

RSM

РСМ МАКЕДОНИЈА ДООЕЛ Скопје
Даме Груев 8, 1000 Скопје, Р. Северна Македонија
T+389 (0)2 3233 301
E contact@rsm.mk
www.rsm.mk

**Извештај за други правни и регулативни барања**

Во согласност со Законот за државна ревизија, Државниот завод за ревизија има обврска да изготвува годишен извештај за извршените ревизии и за работата на Државниот завод за ревизија.

Наша одговорност во согласност со Законот за ревизија е да изразиме мислење во врска со конзистентноста на годишниот извештај за работа со годишната сметка и финансиските извештаи за истата година.

*Мислење*

Според наше мислење, податоците во годишниот извештај се конзистентни со оние во годишната сметка и финансиските извештаи на Државниот завод за ревизија за 2023 година.

*Скопје, 03.06.2024*

| Овластен ревизор | Друштво за ревизија |
| --- | --- |
| | РСМ МАКЕДОНИЈА ДООЕЛ Скопје |
| Љубица Евтимовска Костовска | Јагника Јорданова Андријеска |

RSM
Друштво за ревизија РСМ МАКЕДОНИЈА ДООЕЛ Скопје

THE POWER OF BEING UNDERSTOOD
AUDIT | TAX | CONSULTING

## БИЛАНС НА ПРИХОДИ И РАСХОДИ

| Опис на позицијата | Образложе ние | Буџет 2023 | Реализирано 2023 | Реализирано 2022 |
|---|---|---|---|---|
| **Приходи** | **2.1.** | | | |
| Трансфери и донации | 2.1.1. | 1.710.000 | 1.709.880 | - |
| **Вкупно приходи** | | **1.710.000** | **1.709.880** | **-** |
| **Расходи** | **2.2.** | | | |
| Капитални расходи | 2.2.1 | 1.710.000 | 1.709.880 | - |
| **Вкупно капитални расходи** | | **1.710.000** | **1.709.880** | **-** |
| **Вкупно расходи** | | **1.710.000** | **1.709.880** | **-** |
| **Нето вишок на приходи - добивка по оданочување** | | - | - | - |

Скопје, 21.02.2024

Раководител на сектор за финансиски прашања
Данче Ангеловска

Главен државен ревизор
Максим Ацевски

## БИЛАНС НА СОСТОЈБА

| Опис на позицијата | Образло-жение | 2023 | 2022 |
|---|---|---|---|
| | | | во денари |
| Актива | | | |
| Вкупна актива | | - | - |
| Пасива | | | |
| Вкупна пасива | | - | - |

Скопје, 21.02.2024

Раководител на сектор за финансиски прашања
Данче Ангеловска

Главен државен ревизор
Максим Ацевски

RSM

**РСМ МАКЕДОНИЈА ДООЕЛ Скопје**

Даме Груев 8, 1000 Скопје, Р. Северна Македонија

Т+389 (0)2 3233 301

E contact@rsm.mk

www.rsm.mk

## ИЗВЕШТАЈ НА НЕЗАВИСНИОТ РЕВИЗОР

**До Собранието на Република Северна Македонија**

### Извештај за финансиските извештаи

Ние извршивме ревизија на приложените финансиски извештаи на Државниот завод за ревизија - ДОНАТОРСКА СМЕТКА 020021504078564-EUROSAI, а коишто го вклучуваат билансот на приходите и расходите за годината којашто завршува на 31 декември 2023, како и билансот на состојба заклучно со таа дата, и прегледот на значајните сметководствени политики и други објаснувачки белешки.

*Одговорност на раководството за финансиските извештаи*

Раководството е одговорно за подготвувањето и објективното презентирање на овие финансиски извештаи во согласност со Законот за сметководството на буџетите и буџетските корисници, Правилникот за сметководството на буџетите и буџетските корисници и Правилникот за примена на Меѓународните сметководствени стандарди за јавниот сектор на готовинска основа, и интерната контрола којашто е релевантна за подготвувањето и објективното презентирање на финансиски извештаи кои што се ослободени од материјално погрешно прикажување, без разлика дали е резултат на измама или грешка.

*Одговорност на ревизорот*

Наша одговорност е да изразиме мислење за овие финансиски извештаи врз основа на нашата ревизија. Ние ја спроведовме нашата ревизија во согласност со стандардите за ревизија кои што се во примена во Република Северна Македонија. Тие стандарди бараат да ги почитуваме етичките барања и да ја планираме и извршиме ревизијата за да добиеме разумно уверување за тоа дали финансиските извештаи се ослободени од материјално погрешно прикажување.

Ревизијата вклучува извршување на постапки за прибавување на ревизорски докази за износите и обелоденувањата во финансиските извештаи. Избраните постапки зависат од расудувањето на ревизорот, вклучувајќи ја и проценката на ризиците од материјално погрешно прикажување на финансиските извештаи, без разлика дали е резултат на измама

THE POWER OF BEING UNDERSTOOD

AUDIT | TAX | CONSULTING

RSM

РСМ МАКЕДОНИЈА ДООЕЛ Скопје
Даме Груев 8, 1000 Скопје, Р. Северна Македонија
T +389 (0)2 3233 301
E contact@rsm.mk
www.rsm.mk

или грешка. Кога ги прави тие проценки на ризикот, ревизорот ја разгледува интерната контрола релевантна за подготвувањето и објективното презентирање на финансиските извештаи на ентитетот за да обликува ревизорски постапки коишто се соодветни во околностите, но не за целта на изразување на мислење за ефективноста на интерната контрола на ентитетот. Ревизијата исто така вклучува и оценка на соодветноста на користените сметководствени политики и на разумноста на сметководствените проценки направени од страна на раководството, како и оценка на севкупното презентирање на финансиските извештаи.

Ние веруваме дека ревизорските докази коишто ги имаме прибавено се достатни и соодветни за да обезбедат основа за нашето ревизорско мислење.

*Мислење*

Според нашето мислење, финансиските извештаи ја презентираат објективно, од сите материјални аспекти, финансиската состојба на Државниот завод за ревизија - ДОНАТОРСКА СМЕТКА 020021504078564-EUROSAI заклучно со 31 декември 2023 година, како и неговите приходи и расходи за годината којашто завршува тогаш во согласност со Законот за сметководството на буџетите и буџетските корисници, Правилникот за сметководството на буџетите и буџетските корисници и Правилникот за примена на Меѓународните сметководствени стандарди за јавниот сектор на готовинска основа.

THE POWER OF BEING UNDERSTOOD

AUDIT | TAX | CONSULTING

РСМ МАКЕДОНИЈА ДООЕЛ Скопје е член на РСМ мрежата и тргува како РСМ. РСМ е трговското име кое се користи од страна на членките на РСМ мрежата. Секој член на мрежата РСМ е независно друштво кое работи согласно своите доделени права и обврски. Мрежата РСМ самата не е правно лице во ниедна јурисдикција

RSM

РСМ МАКЕДОНИЈА ДООЕЛ Скопје
Даме Груев 8, 1000 Скопје, Р. Северна Македонија
T+389 (0)2 3233 301
E contact@rsm.mk
www.rsm.mk

### Извештај за други правни и регулативни барања

Во согласност со Законот за државна ревизија, Државниот завод за ревизија има обврска да изготвува годишен извештај за извршените ревизии и за работата на Државниот завод за ревизија.

Наша одговорност во согласност со Законот за ревизија е да изразиме мислење во врска со конзистентноста на годишниот извештај за работа со годишната сметка и финансиските извештаи за истата година.

*Мислење*

Според наше мислење, податоците во годишниот извештај се конзистентни со оние во годишната сметка и финансиските извештаи на Државниот завод за ревизија за 2023 година.

*Скопје, 03.06.2024*

Друштво за ревизија

Овластен ревизор
Љубица Евтимовска Костовска

РСМ МАКЕДОНИЈА ДООЕЛ Скопје
Јаглика Јорданова Андриjеска

Друштво за ревизија РСМ МАКЕДОНИЈА ДООЕЛ Скопје

THE POWER OF BEING UNDERSTOOD
AUDIT | TAX | CONSULTING

РСМ МАКЕДОНИЈА ДООЕЛ Скопје е член на РСМ мрежата и тргува како РСМ. РСМ е трговското име кое се користи од страна на членките на РСМ мрежата. Секој член на мрежата РСМ е независно друштво кое работи согласно своите доделени права и обврски. Мрежата РСМ сама по себе не е посебно правно лице во ниедна јурисдикција.

## БИЛАНС НА ПРИХОДИ И РАСХОДИ

| Опис на позицијата | Образложение | Буџет 2023 | Реализирано 2023 | Реализирано 2022 |
|---|---|---|---|---|
| **Приходи** | **2.1.** | | | |
| Трансфери и донации | 2.1.1. | 930.000 | 815.341 | - |
| **Вкупно приходи** | | **930.000** | **815.341** | - |
| **Расходи** | **2.2.** | | | |
| **Тековни расходи** | **2.2.1** | | | |
| Стоки и услуги | 2.2.1.1. | 930.000 | 815.341 | |
| **Вкупно тековни расходи** | | **930.000** | **815.341** | - |
| **Вкупно расходи** | | **930.000** | **815.341** | - |
| **Нето вишок на приходи - добивка по оданочување** | | - | - | - |

Скопје, 21.02.2024

Раководител на сектор за финансиски прашања
Данче Ангеловска

Главен државен ревизор
Максим Ацевски

## БИЛАНС НА СОСТОЈБА

| Опис на позицијата | Образло-жение | 2023 | 2022 |
|---|---|---|---|
| | | | во денари |
| Актива | | | |
| Вкупна актива | | - | - |
| Пасива | | | |
| Вкупна пасива | | - | - |

Скопје, 21.02.2024

Раководител на сектор за финансиски прашања
Данче Ангеловска

Главен државен ревизор
Максим Ацевски

## SHKURTESAT E PËRDORURA

| | |
|---|---|
| **APRMV** | Agjencia për Punësim në Republikën e Maqedonisë së Veriut |
| **SHA** | Shoqëri Aksionare |
| **SHA Ekonomia e Ujërave** | Shoqëria aksionare në pronësi shtetërore Ekonomia e Ujërave e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Shkup |
| **SHA MEPSO** | Operatori i Sistemit Elektrotransmetues i Republikës së Maqedonisë së Veriut, Shoqëria Aksionare për Transmetim të Energjisë Elektrike dhe Menaxhimin e Sistemit Elektroenergjetik |
| **SHANEHBHA** | SHA për ndërtimin dhe ekonomizimin e hapësirës banesore dhe me hapësirën afariste me rëndësi për Republikën |
| **SHAEHA** | SHA për ekonomizimin e hapësirës afariste në pronësi shtetërore |
| **SHA ESM** | SHA për prodhimin e energjisë elektrike ESM |
| **AMC** | Audit management system |
| **ASOSAI** | Organizata Aziatike e Institucioneve Supreme të Revizionit |
| **BPV** | Bruto prodhimi vendor |
| **VMRO-DPMNE** | Organizata e Brendshme Revolucionare Maqedonase - Partia Demokratike për Bashkim Kombëtar Maqedonas |
| **ISR** | Institucioni Suprem i Revizionit |
| **FVD** | Fondacioni Vestminster për Demokraci |
| **KRSH** | Kryerevizori shtetëror |
| **GREKO** | Grupi i Shteteve Kundër Korrupsionit i këshillit të Evropës |
| **TVSH** | Tatimi mbi vlerën e shtuar |
| **ESHR** | Enti Shtetëror i Revizionit |
| **ESHS** | Enti Shtetëror i Statistikës |
| **KSHZ** | Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve |
| **KSHPK** | Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit |
| **ISHP** | Inspektorati Shtetëror i Arsimit |
| **KSHS** | Konvikti Shtetëror Studentor |
| **BDI** | Bashkimi Demokratik për Integrim |
| **KE** | Komisioni Evropian |
| **NJVL** | Njësia e Vetëqeverisjes Lokale |
| **STE** | Sistemi i transmetimit të energjisë |
| **SEPP** | Sistemi elektronik për prokurime publike |
| **SEPEO** | Sistemi elektronik për paraqitje dhe evidentim të detyrimeve |
| **BE** | Bashkimi Evropian |

| | |
|---|---|
| **EUROSAI** | Organizata Evropiane e Institucioneve Supreme të Revizionit |
| **ZKRSH** | Zëvendës kryerevizori shtetëror |
| **BNJVL** | Bashkësia e njësive të vetëqeverisjes lokale |
| **LPP** | Ligji për prokurime publike |
| **IDI** | INTOSAI Development Initiative |
| **TIK** | Teknologjitë e informacionit dhe komunikimit |
| **INTOSAI** | Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Revizionit |
| **IPA** | Instrumenti për ndihmë paraaderuese |
| **ISSAI** | Standardet ndërkombëtare të institucioneve supreme të revizionit |
| **TI** | Teknologjia informatike |
| **IFES** | Fondacioni Nderkombetar per Sistemet Zgjedhore |
| **NKP** | Ndërmjarrja komunale publike |
| **PP** | Prokurime Publike |
| **PPRM** | Prokuroria Publike e Republikës së Maqedonisë së Veriut |
| **NP** | Ndërmarrja Publike |
| **ZHVP** | Zhvillimi i vazhdueshëm profesional |
| **MPB** | Ministria e Punëve të Brendshëm |
| **MSHIA** | Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës |
| **FMN** | Fondi monetar ndërkombëtar |
| **MB** | Ministria e Mbrojtjes |
| **MASH** | Ministria e Arsimit dhe Shkencës |
| **RM** | Rezonanca Magnetike |
| **SNK** | Standardet ndërkombëtare të kontabilitetit |
| **MTL** | Ministria e Transportit dhe Lidhjes |
| **MPPS** | Ministria e Punës dhe Politikës Sociale |
| **MF** | Ministria e Financave |
| **NATO** | Organizata e Traktatit të Atlantikut Verior, |
| **BKRMV** | Banka Kombëtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut |
| **IKD** | Instituti Kombëtar Demokratik |
| **NPAA** | Programi nacional për miratimin e së drejtës së Bashkimit Evropian |
| **OECD** | The Organisation for Economic Co-operation and Development |
| **PV** | Plan Veprimi |
| **PO** | Plani Operativ |
| **ISHP** | Institucionet shëndetësor private |
| **SPI** | Sigurimi pensional-ivalidor |
| **KP** | Kompensimi me para |
| **PP** | Partit politike |

| | |
|---|---|
| PEPR | Partia për Emancipimin e Plot të Romëve |
| KEM | Kombinati Energjetik i Minierave |
| LSDM | Lidhja Socialdemokrate e Maqedonisë |
| SÇE | Sekretariati për Çështje Evropiane |
| SIGMA | Support for Improvement in Governance and Management |
| SHPPP | Shërbimi për Punë të Përgjithshme dhe të Përbashkëta |
| CTE | Centrali termoelektrik |
| TIKA | Agjencia Turke për Bashkëpunim dhe Koordinim |
| TFMA | Grupi operativ i EUROSAI-t për revizionin e komunave |
| DAP | Drejtoria e të Ardhurave Publike e Republikës së Maqedonisë së Veriut |
| KU | Klinika Universitare |
| UN WOMEN | Trupi i Kombeve të Bashkuara për barazi gjinore dhe forcimin e gruas |
| UNDP | Programi për zhvillim të Kombeve të Bashkuara |
| USAID | Agjencia Amerikane për zhvillim ndërkombëtar |
| FB | Facebook |
| FSSH | Fondi për sigurim shëndetësor |
| QP | Qendrat e punsimit |
| CIPFA | Instituti i Pavarur i Financave Publike dhe Kontabilitetit (Chartered institute of Public Finance and Accountancy) |
| QZHQ | Qendra për zhvillim të qëndrueshme |
| CAAT's | teknikat e revizionit të ndihmuar me kompjuter |
| | |
| | |
| | |

A3P